

Kozma Billa



Vlora
nëpër festivale

KOZMA BILLA

*Vlora nëpër
festivale*

(Një vëzhgim historik)

“...banorët e Labërisë, kanë prirje dhe aftësi natyrore për poezi dhe këngë ...”

Sami Frashëri
(Enciklopedia Shqiptare)

“ Vlora ka një shtrirje të madhe gjeografike dhe si e tillë, edhe kënga polifonike labe ka po këtë shtrirje, por kjo ndryshon muzikalisht sipas zonave etnomuzikore të caktuara, ndonjëherë edhe sipas fshatrave të veçantë, gjë që sjell të ketë një dallim të dukshëm, jo vetëm nga krahina në krahinë, por edhe nga fshati në fshat, por duhet pranuar se kjo ndarje nuk është e prerë asnjëherë me thikë “.

“ Si të ta mat trimërinë,
gjakun me se ta peshojë,
do ta shkruaj historinë,
sikur sa bota të rrojë”.

Lefter Çipa

Autor: KOZMA BILLA
Titulli: VLORA NËPËR FESTIVALE
(Variant i ripunuar)
Redaktor: SEJMEN GJOKOLI
Puna në kompjuter: KOZMA BILLA
Korrektor: KOZMA BILLA

@ Copyringht: Kozma Billa

Të gjitha të drejtat janë të mbrojtura me ligj dhe të rezervuara prej autorit. Riprodhimi i librit, qoftë edhe në formë të pjesëshme, është i ndaluar. Nuk mund të kopjohet asnjë pjesë teksti pa lejen dhe miratimin paraprak të autorit, i cili është mbajtës i vetëm i së drejtës së botimit, përveç rasteve, kur kjo e drejtë lejohet qartazi nga Ligji.

ISBN

VLORA NËPËR FESTIVALE

(*Pak, histori*)

Kënga popullore i ka rrënjët në kohë të hershme dhe është bashkudhëtare e historisë së popullit tonë. Ajo e ka shoqëruar atë gjatë gjithë historisë së tij. Është aq e lashtë, sa dhe vet historia. Ngjarjet historike, zakonet, traditat, doket, ritet e ndryshme, gëzimet dhe hidhërimet janë gdhendur në këto këngë, të cilat kanë për autor një person të thjeshtë, apo dhe një rapsod, por që duke kaluar gojë më gojë, sot mbajnë për autor anonimin popull dhe kjo ka logjikën e vet. Popullit nuk i shpëton asgjë pa fiksuar nga ngjarjet më të mëdha historike që ka përjetuar e deri tek ndodhitë personale të jetës së tij.

Folklori është pasqyra e jetës së një populli dhe aspiratave shekullore të tij. Folklori është krijuar nga vet populli.

Krahina e Labërisë, në të cilën bën pjesë Vlora, është një gurrë e pashtershme e këngës polifonike. Janë mijëra e mijëra këngë, të cilat janë kënduar nga breza të tërë këngëtarësh dhe që kanë ardhur deri në ditët e sotme, por që mund të ketë dhe plot këngë të tjera që edhe mund të kenë humbur. Populli i Labërisë është sa trim, aq edhe poet.

Kur nisa të shkruaj radhët e para në këtë libër për këngët popullore të Labërisë, m'u kujtuan disa nga vargjet lapidarë të poetit Lefter Çipa. Për këngën ai shprehet:

“Se kur është këngë shpirti,
i ngjall të vdekurit prapë,
ashtu siç ngjall shqiptarizmi,
burrat me emër të lartë.
Vdeksha edhe prapë u ngrefsha,
shokët në këngë i gjetsha!”

Dhe kënga polifonike e tillë është.

Të flasësh për Labërinë dhe këngën e saj nuk mund të mos përmendësh rapsodin e njohur Xhebro Gjikhën, apo xha Xhebron, siç kemi mësuar t'i flasim, i dëgjuar, jo vetëm në Labëri, por edhe në gjithë vendin, apo të mirënjohurin dhe të paharruarin Selim Hasanin, ose Selim Brati, siç jemi mësuar ta njohim, i cili jetoi në tri periudha të caktuara të historisë të popullit tonë që, si krijues i talentuar popullor, ka mundur t'i shprehë këto cilësi dhe veçori dalluese, duke shfrytëzuar me mjeshtëri të madhe elementet më pozitive të traditës folklorike, apo dhe krijimet e këngëtarit të përmendur Qazim Ademi, i njohur për këngën e tij që, sipas emrit të tij u quajt "qazimademçe" (*stil të kënduari*), të cilat janë një përpunim i thellë i këngëve epike dhe lirike e që janë kënduar përpara dhe në kohën e tij, në disa çaste dasme, apo dhe shumë rapsodë të dëgjuar të tjerë, sikundër mund të flasim edhe për Mato Hasanin e të tjerë burra të njohur në Lumin e Vlorës për dhuntinë e tyre për të thurur e kënduar këngë popullore.

Folklori lab shquhet për një begati të veçantë. Gjinitë kryesore të tij janë katër: *ninulla*, *boroitja ose logatja*, *vajtimi dhe kënga*. Prej tyre, tri të parat këndohen në mënyrë homofonike, njëzërshe, ndërsa kënga, në mënyrë polifonike. Është pikërisht kjo gjini që ka bërë dhe bën një jetë artistike më vepruese në krahinën e Labërisë.

Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar i kanë mbledhur dhe sistemuar këto visare të paçmuara të gurrës popullore, apo dhe i kanë botuar ato. Në këto përmbledhje kënga polifonike labe daton e hershme. Në kohët e sotme, për Vlorën dhe rrethinat e saj, një meritë të veçantë ka mbledhësi i njohur i folklorit Fatos Mero Rapaj, i cili me të vërtetë ka bërë një punë titanike në këtë drejtim, duke na lënë qindra e mijëra këngë të krahinave të ndryshme të Labërisë dhe të krahinës së Çamërisë.

Polifonia labe shquhet për origjinalitet në krahasim me pjesët e tjera të kulturës polifonike shqiptare dhe ajo ekziston në disa lloje. Krahas monofonisë, ose njëzërëshit, dallojmë dyzërësha, trezërësha, karakresistikë kjo me treshen e mirënjohur

të Dukatit, kënduar nga Leko Gjoleka, Sulo Bozhani dhe Bego Vangjeli, pjesëmarrës dhe laureuar disa herë në Festalet Folklorike Kombëtare. Por ka dhe mënyrë tjetër të kënduari, siç është katërzërëshi e kështu me rradhë.

Vlora ka një shtrirje të madhe gjeografike dhe si e tillë, edhe kënga polifonike labe ka po këtë shtrirje, por kjo ndryshon muzikalisht sipas zonave etnomuzikore të caktuara, ndonjëherë edhe sipas fshatrave të veçantë, gjë që sjell të ketë një dallim të dukshëm, jo vetëm nga krahina në krahinë, por edhe nga fshati në fshat dhe brenda të njëjtit fshat, por duhet pranuar se kjo ndarje nuk është e prerë asnjëherë me thikë. Kështu dallohet kënga e Dukatit për të veçantën e saj nga ajo e Tragjasit, e Lumit të Vlorës, e Dhërmiut, Himarës, Pilurit, Smokthinës, Bratajt, Kaninës, Tërbaçit, Ftterrës, Nivicë-Bubar, Sasaj, etj.

Të gjitha këngët, apo dhe vallet asnjëherë nuk kanë qenë spontane. Grupe të veçanta këngëtarësh, në raste festash, ngjarjesh a ndodhish të ndryshme, apo dhe gëzimesh e hidhërimesh, kanë demonstruar talentin e tyre në të gjitha stilet e të kënduarit, apo të vajtuarit. Kjo ka sjellë pak e nga pak edhe konsolidimin e grupeve për të ardhur më tej në takimet e ndryshme zonale që janë organizuar për vite e vite me radhë, nën kujdesin e drejtpërdrejtë të institucioneve kulturore e artistike të asaj kohe në bazë fshati, apo dhe qendër kooperative. Por kënga polifonike, si dhe shumë veprimtari të tjera të kësaj natyre, filluan të organizohen më mirë me kalimin e viteve dhe pa mohuar në asnjë rast kujdesin e madh shtetëror për këtë kulturë të lashtë shpirtërore të popullit tonë. Por ajo që vlen të theksohet në këtë drejtim është fillimi i organizimit të Festivaleve të mëdha Folklorike Kombëtare, të cilat kalonin nëpër disa faza që mendoj se njihen mirë nga të gjithë dhe nuk ja vlen të përmenden.

Festivali Folklorik Kombëtar (FFK) është aktiviteti më i rëndësishëm në fushën e etnokulturës mbarëkombëtare shqiptare. Megjithëse FFK janë zhvilluar edhe më përpara, FFK që mban emrin e qytetit organizator të tij, Gjirokastrës, janë festalet që

krijuan traditën e këtij lloj aktiviteti në Shqipëri. Festivali, i cili, i parapriu Festivaleve Folklorike Kombëtare të Gjirokastrës është ai i zhvilluar në Tiranë nga datat 25-27 nëntor 1959 me siglën “Festivali Kombëtar i këngës, muzikës dhe valleve”. Në këtë festival kanë marrë çmime për herë të parë solistë popullorë si, Laver Bariu, Ndue Shyti si dhe janë vlerësuar me diploma të ndryshme afro 400 pjesmarrës.

Festivali i parë i Gjirokastrës u zhvillua në vitin 1968, prej datës 08 deri më 16 tetor. Pas këtij festivali të parë, ku morrën pjesë të gjitha rrethet e vendit, në çdo pesë vjet (*respektivisht 1973, 1978, 1983, 1988, 2000, 2004.2009, 2015*), në kalanë e këtij qyteti janë zhvilluar rregullisht FFK-të.

Me organizimin e Festivaleve Folklorike Kombëtare, Vlora gjithmonë ka qenë pjesëmarrëse në të gjitha këto evente, që nga viti 1968 e deri në festivalin e 2015 -s, gjë që tregon se në Vlorë i kushtohet një rëndësi e madhe folklorit dhe se ajo është një gurrë e pashtershme, gjë që dëshmohet edhe nga prurjet e mëdha në këto festivale.

Në këto festivale Vlora është nderuar dhe laureuar disa herë në grupe polifonike të veçanta, individë, apo dhe si Vlorë në përgjithësi.

Kështu në Festivalin Folklorik të vitit 1968 Vlora shpalosi vlerat e saj më të mira në lëmin e folklorit. Grupi i Dukatit u paraqit me këngët “*O populli me traditë*”, ku evokon traditat më të shkëlqyera të popullit tonë në shekuj, apo dhe kënga “*U tretim plumbin në gojë*”, apo grupi i Smokthinës, Himara me këngën “*Gjithë vendin se ç’ e ndriti*”, grupi i përzier i fshatit Brataj me këngën “*Fusha jonë aty ka qenë*” e shumë grupe e këngë të ndryshme. Në këtë Festival grupi i Dukatit ka qenë fitues i medaljes së bronzit.

Në festivalin e vitit 1973 shohim të aktivizohen e të marrin pjesë edhe shumë grupe të tjera. Kështu Dukati, për karakteristikën epike të tij, vjen në këtë Festival me grupin e burrave dhe prezantohet me këngën “*O Dervish Aliu dole*”.

Mbresëlënës për Vlorën ka lënë në këtë festival kënga “*O trima flini të qetë*”, kushtuar dëshmorëve të Atdheut. Grupi i vajzave të Dhërmiut, një grup i ri, paraqitet në Festivalin e këtij viti me këngën e bukur “*Lulëzo bregdet i bukur*”, grup që dallohet për veçantinë e tij në të kënduar, interpretimin plot vitalitet e kolorit të veçantë, nivel e cilësi të lartë artistike, apo grupi karakteristik i Himarës që paraqitet me këngën “*Di vajza, të dija labe*”, kushtuar heroinave Bule Naipit dhe Persefoni Kokëdhimës, me marrës kryesor Artistin e Merituar Dhimitër Varfi, një nga korifejtë e këngës himarjote në vite, apo dhe grupi i Pilurit, i cili është një grup tjetër pjesëmarrës në këtë festival. Në këtë pjesëmarrje ai prezantohet si një grup tepër profesional dhe solid me të veçantën dhe karakteristikat e tij, me një interpretim e timbrik të shkëlqyer. Dhe kjo për meritë të poetit e folkloristit të mirënjohur Lefter Çipa, me këngët “*Tundu bejk’e bardhë, tundu*” e “*Bilbili që dëgjon bota*”, të cilat u shoqëruan edhe me instrumenta popullore aerofone që mund të quhet edhe një risi, që iu ndaluan për t’i përdorur, por ata me zgjuarsinë dhe mënçurinë e tyre ditën t’i fshihnin e t’i përdornin pastaj në skenë.

Grupi i mirënjohur i Smokthinës që bëri emër në festivalin e vitit 1968, përsëri është pjesëmarrës i festivalit të vitit 1973, krahas grupit të Tërbaçit si dhe grupeve të tjera. Në Festivalin Folklorik Kombëtar të vitit 1973 Vlora ka fituar çmimin e parë.

Disa nga vargjet e këngëve që u gdhendën përjetësisht në folklorin tonë:

“Lulëzo Bregdet i bukur,
sot je mbushur me stoli,
bota të shikon së largu
dhe ajo të ka zili.”

(Dhërmi 1973)

“Duke tundur zbret te zalli,
me shamin’ lidhur te balli,

tundu bejk' e bardhë, tundu,
natënë me hënë duku,
bejk' e bardh' e bor' e malit
ti je ilaç' i çobanit.”

(Pilur 1973)

Viti 1978 solli prurje të reja dhe një cilësi shumë më të lartë artistike në polifoninë labe të Vlorës në krahasim me dy festivalet e para. Si në festivalin e parë, të dytë edhe në festivalin e tretë, organizimi bëhej vetëm në bazë rrethi dhe Vlora përfaqësohej me grupet e saj vetëm nga ky rreth. Në takimet zonale, apo dhe në ato në bazë rrethi, kishte një prurje më të madhe, aq sa ishte tepër e vështirë të përzgjidhje më të mirat, sepse të gjitha këngët shquheshin dhe kishin nivel e cilësi të lartë artistike dhe interpretative. Në skenën e Festivalit ngjitet përsëri grupi i Dukatit me këngën “*O Qemal kur të përzunë*”, grupi i Tragjasit me këngën “*Sot ka ardhur komisari*”, me këngëtarin e njohur e plot vitalitet e dinamizëm, Aranit Daupi dhe Tartar Avdyli, si dhe me këngët “*Leshverda këngën dëgjo*” dhe “*Shqipëri moj pallëzhveshur*”. Piluri ngjitet edhe këtë herë në skenën e këtij festivali me këngën “*Shqipëri, flakë dyfeku*”, Tërbaçi me këngën “*Tërbeçët haraçe s’dhanë*”, apo dhe grupi i Kaninës me lirikën “*Nëno, jam e vogël*”. Grupi i valles së Vranishtit tund kalanë e festivalit me vallen e burrave “*Çdo shqiptar në një llogore*”, apo dhe grupe të tjera . Në këtë festival shpaloset edhe kënga qytetare vlonjate. Për Vlorën, viti 1978 dhe festivali folklorik i tij shënoi rritje, ku Vlora u shpall laureat i Festivalit.

Kur flasim për Festivalin Folklorik Kombëtar të vitit 1978 nuk mund të lëmë pa përmendur disa nga perlat që u interpretuan atje:

“O trima vallen ma mbani,
lidhur si fishekë gjerdani,
jemi zot të këtij vatani,

kush na prek, i humbet nishani.”

(Vranisht 1978)

“Malet s’tremben nga gjëmimi,
as shkëmbenjtë nga rrufeja,
Shqipëri t’u rrit prestigji,
është e jona epopeja.”

(Pilur 1978)

“Dridhe vallen, Gjirokastër,
merrja ti, o Mal i Gjerë,
ktheja, o Çajup i lartë,
iso mban, Shqipëri e tërë.”

(Tragjas 1978)

Në Festivaslin Folklorik të vitit 1983 që shënonte edhe festivalin e katërt të këtij lloji dhe me përmasa gjigande, krahas grupeve më të dëgjuaara që përmendëm më lart, në festivalet e mëparshme dhe që ishin pjesëmarrëse të padiskutueshme, edhe në festivalin e këtij viti, shohin të lindin edhe grupe të tjera.

Kështu shohim të ngjitet në sofrën e këngës të festivalit grupi i fshatit Armen me këngën “Ç’u mbush vendi xinxërfile”, shkruar nga rapsodi Lefter Haxhiraj dhe interpretuar me mjeshtëri të rrallë nga këngëtari i mirënjohur Rahman Nuredini që jo vetëm e bëri të njohur këtë grup, por dhe u bë njëkohësisht për kompozitorët tanë objekt studimi dhe përpunimi.

Një grup tjetër që prezantohet denjësisht në këtë festival, është edhe grupi i Lapardhasë që nxjerr nga arkivi i tij një nga perlat e polifonisë labe e që bëri jehonë të madhe duke e bërë të njohur këtë grup, pikërisht me këngën “Janinës ç’i panë sytë”.

Kënga humoristike “Dardanake” e grupit të Alibanit

Vlorë, shton repertorin cilësor të Vlorës në këtë festival, ndërsa kënga himarjote *“Llaj çoban”*, interpretuar me mjeshtëri të rrallë nga këngëtarja e mirënjohur Katina Beleri, ngre peshë publikun në kalanë e Gjirokastrës, një variant i ri i kësaj kënge, apo dhe grupi polifonik i qytetit me këngën *“Ca bejte për ca shtete”* me marrës këngëtarin virtuoz Vasil Sera, vallja humoristike e interpretuar nga grupi i Bolenës me titull *“Plaku me plakën ç’u zunë”*, monofonia e fshatit Kallarat *“Ç’u këput një këmbë mali”*, interpretuar me mjeshtëri të rrallë nga Zeqo Hoxha, me tekst të autorit Llambro Hysi etj. Këto ishin disa nga pikat kulmore që paraqiti Vlora në këtë festival. Larmia e tematikës, interpretimi me një nivel e cilësi të lartë artistike bëri që Vlora në vitin 1983 të vlerësohet me Flamurin e festivalit.

Përmendim disa nga vargjet e këngëve që spikatën në këtë festival:

“Lidhën besë e fjalën dhamë,
s’japim xhelep, as nizamë.

Shpata jonë gris fermanë,
kanë zot trojet tanë.”

(Vranisht 1983)

“ Xinxërfile, xinxërfile,
ç’bukuri që ke mbi krye,
ylberin hedhur mbi supe,
buzëlule ç’më këpute.”

(Armen 1983)

“Ç’u këput një këmbë mali,
o Stamboll të djegtë zjarri,
djemtë tanë hajmedet,
djep’ i that’ e vatra shkretë.”

(Kallarat 1983)

“ Shqipëri, o shkëmb i serrtë,
ti bilbila i ke djemtë,
shekujt vijn’ e vitet shkojnë,
Naim djemtë ligjërojnë.”

(Pilur 1983)

“ Janinës ç’i panë sytë,
Janin-o,
ish e premte ajo ditë,
të pesë pusët në grykë,
Zenel Çelua vet i dytë,
Zeneli me të velçionë,
dhe trimi Jaçe Mavrovë,

ç’u hodhnë e ia bënë forë,
çau mespërmes taborrë,
kur shtriu pashanë, e njonë.”

(Lapardha 1983)

Viti 1988 që ishte njëkohësisht edhe i pesti festival i këtij lloji, falë, tashma një përvoje të grumbulluar, shënoi një rritje akoma më të madhe. Tashmë Vlora kishte krijuar traditë, jo vetëm për pjesëmarrjen në këto evenimente të mëdha folklorike, por edhe për vlerësimet e jurive dhe të publikut artdashës shqiptar.

Spikatën shumë grupe e këngëtarë, të cilët duke ecur në traditën e bukur të polifonisë labe, e lartësuan vlerën e ansambllit të Vlorës, në këtë festival. Grupet e Tërbaçit, Smokthinës, Kuçit, Himarës, Pilurit, grupi i Dhërmiut etj, ishin ndër më të spikatura. Gjithmonë Vlora e ka patur të vështirë për të përzgjedhur programin e vet për t’u paraqitur në festival, sepse kishte aq shumë vlera, sa që ishte e pamundur për të vendosur, se kë do të hiqje e kë do të lije, nëse do të përdorim të folurën popullore. U

bë një punë shumë e madhe dhe voluminoze me një përkushtim të jashtëzakonshëm të drejtuesve të grupit. Meritë të veçantë ka padyshim muzikologu i njohur Haxhi Dalipi.

Ja disa nga vargjet e këtyrë këngëve:

Shtizën e flamurit, penë e mbaj në duar,
për jetën që dhanë djemtë, do të shkruaj,
do të shkruaj nëpër male, mbi dafina,
këngën e gjakut të derdhur nga ata trima,
shqipe ligjëro...”

(*Pilur 1988*)

“ O Janullë, o leshprerë,
leshprer-o,
krisma, krisma anembanë,
për shortin, për djalin-o,
të kesh mall për atë derë.”

(*Dhërmi 1988*)

Në këtë festival vjen edhe një gjini tjetër e polifonisë labe që në ndonjë festival të mëparshëm ishte interpretuar nga zë burri, por që kësaj here vjen me një zë tjetër, të ngrohtë, siç është ai i Fatbardha Hosit (Bolenë), monofonia “*Ritu, se të pret martia*”.

Ashtu si në festivalet e mëparshme edhe në këtë festival, një vend të veçantë zënë edhe instrumentet popullore, siç është fyelli, cula dyjare, etj. Në trevën muzikore të Vlorës njihet me emrin fyelli i Vendim Kapaj, Mjeshtër i Madh, një nga fyelltarët më vituoz, me një interpretim të shkëlqyer dhe karakteristikë të veçantë të të rënit (*me dhëmbë*). Dhe në festivalet e tjera, por edhe në këtë festival, ky instrumentist vlerësohet laureat i festivalit.

Duhet thënë, se një pjesë e mirë e tematikës të këtyre festivaleve që përmendëm deri këtu, kanë qënë të politizuara, duke u thurur lavde e himne udhëheqësve të periudhës në të cilën jetonim, sigurisht nëpërmjet teksteve, sa ngandonjëherë do të

duket çudi që në ndonjë rast kënga fliste për “iks”luftëtar, por që këto abtribute ja vishnin udhëheqësit, e megjithatë mund të theksojmë se vlera interpretative asnjëherë nuk u zbeh, përkundrazi lartësohej duke arritur gjithmonë maja.

Një meritë e veçantë për organizimin dhe përkushtimin në këto festivale, krahas grupeve pjesëmarrëse, vlerë të pamohueshme kanë edhe rapsodët e tyre, si Dule Havari në Dukat, Lefter Çipa në Pilur, Muhamet Tartari në Vranisht, Kujtim Mici në Tërbaç, Meleq Kapllani në Kaninë, Hamdi Pulo në Tragjas, Nertesi Asllani në Bolenë, Lefter Haxhiraj në Armen, Pelivan Bajrami, etj. Një meritë e veçantë u takon dhe atyre që punonin dhe gjithmonë qëndronin prapa kuintave të këtyre festivaleve, ata që derdhnin në to, jo vetëm talentin, por edhe shpirtin e tyre profesional, artistik e kulturor. Vlen të përmendet puna e palodhur dhe plot përkushtim e talent e atyre që i drejtonin këto grupe, i të paharruarit Themistokli Mone, i cili udhëhoqi festivalin e vitit 1968 dhe festivalin e vitit 1973 ,

Artistin e Merituar Haxhi Dalipi, i cili ka përgatitur dhe udhëhequr festivalet që nga viti 1978 e deri në vitin 1988, tre Festivale Folklorike Kombëtare, duke vazhduar më pas me festivalin e vitit 1995 dhe 2000, të cilat u drejtuan nga Kozma Billa dhe Vahit Kuçaj, atë të vitit 2004, që u drejtuan nga Istref Dobi dhe Vahit Kuçaj, Guri Gjeçi, Kozma Billa, si dhe festivalin e vitit 2009 e 2015 , drejtuar nga një komision i përbërë nga Istref Dobi, Kozma Billa, Novruz Bajrami, Vahit Kuçaj, Artur Dhamo e Sajmir Sadikaj, mbështetur nga këshilli i Qarkut.

Ndryshimet politike pas viteve '90 bëri që të prishet tradita e organizimit të këtyre festivaleve. Ato që organizoheshin një herë në pesë vjet në kalanë e Gjirokastrës, për një periudhë shtatëvjeçare mbetën në harresë të plotë. Lëvizja demografike e popullsisë, si brenda vendit, por dhe jashtë tij, bëri që shumë grupe të shpërbëheshin. Shumë prej këngëtarëve emigruan, të tjerë lëvizën duke lënë kështu një farë boshllëku, jo vetëm në grupet e tyre, por në gjithë polifoninë labe të Vlorës në përgjithësi.

Lindi dhe një tendencë e re në këto vite, ajo e krijimit të shoqatave kulturore, nga ku shumë këngëtarë e grupe u përfshinë në këto grupe e shoqata, gjë që e devijoi në një farë mase shtratin autentik të polifonisë, duke humbur autenticitetin, vlerat folklorike, për të rendur pas zhurmës e bujës, edhe pse, pas komercit me anë të kasetave audiovizive. Si në të gjitha fushat, edhe në këtë fushë pati një hemoragji të madhe këngëtarësh.

Pas kësaj pauze shtatëvjeçare, rinisi organizimi i festivaleve folklorike në vitin 1995. U zhvendos edhe sofa e festivalit, nga kalaja e Gjirokastrës në atë të Beratit. Kështu rinisi edhe organizimi i grupeve polifonike duke ndeshur edhe vështirësi nga më të ndryshme, por me një mobilizim, përkushtim dhe një staf tjetër, nisi puna për Festivalin VI Folklorik Kombëtar. Vlora edhe këtë herë u paraqit denjësisht. U ringritën grupet dhe stafet drejtuese. U bënë takimet zonale

për përzgjedhjen e grupeve dhe elementeve më të mirë nëpër zona. Pas një pune këmbëngulëse, serioze dhe tepër profesionale, grupi i Vlorës arriti të jetë pjesëmarrës i këtij festivali, drejtuar nga Kozma Billa, drejtor i Qendrës Kulturore Vlorë dhe udhëhequr nga muzikanti Vahit Kuçaj.

Jo vetëm larmia e tematikës, por edhe larmia e gjinive muzikore ishte dëshmia e këtij festivali. Grupet e njohura ishin prezente, por edhe grupe e individë të tjerë që debutonin për herë të parë ishin organizuar më së miri. Kështu grupi i njohur i Himarës, me marrëse këngëtare e talentuar Katina Beleri erdhi në këtë festival me këngën "*Një thëllëzë e shkruar prilli*", grupi i Lapardhasë sjell një variant të ri të këngës "*Dallëndyshe e vogëlo*", Vezhdanishi, si gjithmonë i arrirë artistikisht sjell këngën "*Lado, moj për kokën tënde*", marrës, këngëtar i shkëlqyer Kalo Bregu, Tragjasi, sjell monofoninë "*Qani, moj çobanka, qani*", interpretuar me mjeshtëri nga këngëtarja e Tragjasit, Bukurie Selimi, ndërsa grupi i Treblovës vazhdon në linjën e vet karakteristike, në atë të humorit. Interesant dhe shumë i pëlqyeshëm ishte grupi i Selenicës. Kënga "*Ç'belë kanë këta*

zogjë” ishte e arrirë në kulminacionin e vet artistik. Ajo u përcoll me ngrohtësi dhe melodicitet të shkëlqyer, Gumenica solli “Këngë për Hamit Vashkon”, Bolena “Aman millona”, ndërsa Piluri erdhi si gjithmonë krenar dhe i patundur, kësaj here me këngën “Ra një lot e lagu synë” dhe “Amanetet zgjojnë trimat”, interpretuar me mjeshtëri nga këngëtarja që i ka dhënë emër këtij grupi, Ermioni Mërkuri, një këngë që i bënte jehonë ndryshimeve politike në vendin tonë pas viteve '90. Ky festival tregoi më së miri se kënga polifonike në Vlorë ruhet e gjallë, e freskët, me gjithë origjinalitetin e saj. Ndoshta, për arsye që dihen dhe që nuk dihen dhe që nuk ka nevojë të përmenden, Vlora në këtë festival nuk u vlerësua me ndonjë çmim, por ajo që vlen të theksohet është se në koncertin përfundimtar që u organizua në Tiranë, në Pallatin e Kongreseve, nga grupi i Vlorës u përzgjedhën shtatë materiale muzikore, nga më të mirat, kur rrethet e tjera kishin nga një, ose asnjë.

Festivali VII Folklorik Kombëtar që u rikthye përsëri në Gjirokastrë, për Vlorën ishte një nga prurjet më të shkëlqyera të të gjithë festivaleve, sa që në Nr.4, që mban datën 22 shtator 2000, të gazetës “FEST FOLK 2000”, botim special i Komitetit organizator i Festivalit Folklorik Kombëtar, Gjirokastrë 2000 , në vend të kryeartikullit, me gërma kapitale, shkruhej:”VLORA, SI VLORA... DHE ME KËNGË JA BËRI FORA!”, ku midis të tjerave shkruhej:”*Zërat gurgullues të lumit të Vlorës dhe Bregut tërmetuan kalanë e këngës. Nëse figurativisht kemi thënë që kënga pushton kalanë, pushtimi prej vlonjatëve këtë të premtë qe real. Njëqind e njëzet e pesë këngëtarë dhe tetëdhjetë e pesë minuta, sa katër prefektura bashkë, sfiduan të gjitha kanunametë e komitetit organizator. Tri fjalë më të përsëritshmet, qarkuan bedenat: stuhia, habia dhe mrekullia. Pra, në 18 numra të programit, vlonjatët shpalosën njera pas tjetrës këngët e etëshme që burojnë nga gryka e individualiteteve të zëshëm”.*

Po të njëjtën gjë mund të themi edhe për festivalin VIII që u mbajt në vitin 2004.

Më poshtë po japim në mënyrë më të detajuar disa mendime, ide për grupet pjesëmarrëse në këto evenimente, si dhe disa prej teksteve të këngëve që u ekzekutuan në këto festivale.

FESTIVALET FOLKLORIKE KOMBËTARE

Festivali i parë Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës u zhvillua në vitin 1968, në datat 8-16 tetor, në Kalanë e gurtë të Gjirokastrës. Pas këtij festivali, ku morën pjesë të gjitha rrethet e vendit në çdo pesë vjet, përkatësisht 1973, 1978, 1983, 1988, në Kalanë e Gjirokastrës janë zhvilluar rregullisht FFK-të. Në festivalin e vitit 1973 në fazën përfundimtare, morën pjesë 1370 vetë, në festivalin e vitit 1978, në fazën përzgjedhëse u aktivizuan rreth 53 mijë pjesëmarrës, ndërkohë që vetëm 1560 mbartës interpretuan gjatë ditëve të festivalit. Në vitin 1995, FFK u zhvillua në kalanë e qytetit të Beratit. Në muajin shtator 2000 FFK rikthehet përsëri në qytetin e Gjirokastrës. Ky festival ka qenë i konceptuar në formën e një gare folklorike, ku deri në

festivalin e vitit 1988 janë dhënë çmime për grupet më të mira, ndërkohë që në edicionet e fundit të tij çmimet do të ndaheshin për bartësit dhe interpretuesit e folklorit. FFK 2004 u zhvillua në Gjirokastrë nga data 29 shtator deri në 5 tetor. FFK 2009 u zhvillua në Gjirokastrë në datën 24 deri në 29 shtator 2009.

Kjo veprimtari e rëndësishme e trashëgimisë shpirtërore kombëtare, pra edicioni i nëntë i FFK-së, këtë vit që u zhvillua në Kalanë dhe Qendrën Historike të qytetit muze të Gjirokastrës përkoi në Ditën e Trashëgimisë Kulturore Kombëtare.

Festivali Folklorik Kombëtar Gjirokastra 2009, ishte veprimtaria më e madhe kulturore mbarëkombëtare që synoi mbrojtjen e vlerave më të mira të trashëgimisë sonë kulturore që përfshin grupe përfaqësuese nga të 12 qarqe të vendit. Në skenë do të ngjiten mbi 900 bartës të folklorit nga i gjithë vendi.

Në vitin 2015 u zhvillua edicioni i dhjetë.

Pjesëmarrja në Festival e grupeve folklorike nga Kosova, shqiptarët e Maqedonisë dhe Malit të Zi, arbëreshëve, arvanitasit, diasporës së largët si dhe të folklorit çam, etj. shërben për të zgjeruar jo vetëm hapësirat gjeografike të folklorit shqiptar, por sjell edhe vlera të papërsëritshme në interpretimin dhe ekzekutimin e trashëgimisë kulturore shpirtërore tradicionale shqiptare duke e kthyer këtë veprimtari të rëndësishme në një festë të folklorit shqiptar.

Organizimi i Festivaleve Folklorike Kombëtare, Gjirokastrë, kanë për qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe propagandimin e vlerave më të mira të trashëgimisë sonë shpirtërore, të vlerave etnomuzikore, etnokoreografike, etnokulturore, të kostumeve popullore, veglave muzikore, riteve, traditave, zejeve etj., të krijuara prej shekujsh nga populli shqiptar.

Qëllimi kryesor i organizimit të këtij lloji festivali, përveç atyre që u përmendën më sipër, është edhe pasqyrimi i gjerë i gjinive të folklorit dhe vlerave të tij. Ky festival ka gjithashtu si qëllim të mbrojtë, të promovojë , të transmetojë në brezat e tjerë

dhe të popullarizojë në publikun e gjerë vlerat më të mira muzikore, koreografike, etnografike të krijuara prej shekujsh. Veprimtaritë e këtij festivali promovojnë dhe krijimet e reja folklorike me karakter improvizues, lojërave me karakter imitativ, pantonimik e humoristik. Sjellja në vëmendje e krijimeve të lashta, por duke ruajtur origjinalitetin e tyre, nuk mbetet jashtë fokusit të këtij festivali.

FFK GJIROKASTËR 1968 ***(Festivali i parë)***

Siç u përmend edhe në hyrje të këtij vëzhgimi të shkurtër historik, Festivali i Parë Folklorik Kombëtar e ka ditëlindjen e tij në vitin 1968. U zgjodh pikërisht ky vit, pa dyshim me porosi të Partisë, sepse përkonte me lindjen e Enver Hoxhës, ndaj dhe do të organizoheshin një herë në pesë vjet dhe pikërisht në muajin tetor, kur ishte dhe ditëlindja e tij.

Nisur nga kjo dhe ky festival do të ishte si një dithiramb për Partinë dhe udhëheqësin e saj. Dhe kështu ka ndodhur. Pothuaj, pjesa më e madhe e të gjitha teksteve që janë paraqitur në këtë festival ishin tejet të politizuara, siç ishte ndërtuar dhe gjithë jeta e vendit dhe e popullit tonë. Detyrimisht, duke u nisur nga ky orientim, nuk mund të kërkoje ndonjë folklor të pasur dhe

autentik. Edhe pse nuk mungonte në pjesën më të madhe, nuk mund të kërkoje vlera reale, apo të futeshe thellë në krijimtarinë gojore të popullit prej vitesh, duke qenë se ishte edhe festivali i parë i këtij lloji që organizohej në vendin tonë. Të vetmet gjëra që ishin të palëvizura ishin meloditë, ritmet e valleve dhe të daulleve, apo dhe instrumentat popullorë.

Nisur nga ky këndvështrim, nuk mund të flasim për një tematikë të larmishme në këtë festival. Dhe në se ndonjë këngë e vjetër vinte në këtë festival, duhej që patjetër që trajtohej dhe të ndryshoheshin vargje që të përmendej partia dhe shoku Enver, ndërtimi i socializmit e tjera si këto, gjë që për mendimin tonë e zbehin qëllimin madhor të organizimit të këtij evenimenti të madh folklorik. Tashma kulti i madhështisë për udhëheqësin që kishte filluar pas çlirimit të vendit, kishte marrë përmasa gjigandeske dhe kjo nuk mund të shmangej kurrësesi, sepse diheshin pasojat.

Dhe për të ilustruar mendimin tonë, në një almanak folklorik të asaj periudhe, botuar nga Shtëpia e Kulturës Vlorë, midis të tjerave shkruhej: *“Folklori po i bën më shumë se kurrë jehonë të menjëhershme, flakë për flakë, realitetit të ditëve tona, frymës së lartë revolucionare që ka shpërthyer kudo në vendin tonë”*, ose më poshtë vazhdon: *“Popullit nuk i shpëton asgjë pa fiksuar nga ngjarjet më të mëdha historike, deri te ndodhitë personale të njeriut tonë. Ai i këndon e thurr lavde Atdheut, trimave të djeshëm të luftës dhe heronjve të ditëve tona. Vendos në piedestalin më të lartë, duke e vlerësuar, siç e meriton, qëndrimin parimor marksist-leninist të partisë sonë në luftën e saj për mbrojtjen e Atdheut, pastërtisë së marksizëm-leninizmit, duke hedhur vallen në gojën e ujkut”, etj.*

Po japim disa prej teksteve të këngëve të këtij festivali, për të vërtetuar politizimin në këto tekste të asaj periudhe. Pasqyrë e qartë e këtij politizimi është një valle e kënduar nga grupi polifonik i Dukatit, ku dhe ka fituar medaljen e bronxtë, si dhe kënga e kënduar nga grupi polifonik i Himarës.

PRINA, MOJ PARTIA JONË

Prina, moj Partia jonë,
se këtu, në vendin tonë
flamuri i kuq do valojë,
me ty, Parti do marshojmë.
Këjo është rruga jonë,
çështja jonë do triumfojë,
se prin Partia shqiponjë,
që qëndron në pararojë.

(Dukati)

GJITHË VENDIN SEÇ E NDRITI

Në dizet e një të vitit,
në Shqipëri një zë buçiti,
një shkëndi nga mali zbriti,
gjithë vendin seç e ndriti,
Enver zemër astriti,
një Parti të re kaliti,
popullin në këmbë e ngriti,
e mësoi, e stërviti,
mbi armikun ç'e vërtiti,
jashtë kufive e qiti,
gjer në Mal të Zi arriti,
gjithë botën e çuditi.
(Himara)

Grupi polifonik i Dukatit Vlorë

O POPULLI ME TRADITË *(kënduar nga grupi i burrave)*

O populli me traditë,
rrëmbe armët e lufto,
skuadrën me krushovistë,⁽¹⁾
me një sulm e shpartallo;
të shiturit n' Amerikë,
na pushteti i qëro,⁽²⁾
hidhu litarin në grykë,
të të shtypin, mos duro,
zagarëtë e kromosur,
në botën tjetër i dërgo.

Durimi si s' është sosur,
ngreu shpejt e mos vono,
atdheunë e Leninit,
nga fashizmi e shpëto,
fitoret e socializmit
me revolucion i mbro,
mbroje veprën e Stalinit,
kurrë jo, mos u nënështro.

1) është fjala për hrushovianët

2) trajtë dialektore e parafjalës “nga”

U TRETIM PLUMBIN NË GOJË

Njëzet e pesë vjetori,
i Frontit Demokratik,

themeluesi Enver Hoxha,
jep raportin hirtorik
të luftësë fitimtare,
të ndërtimit socialist.
Fitoret që kemi korrur,
seç i tërbojnë armiqtë.

Rrini urt', more të gjorë,
se nuk preken kufijtë,
u tretim plumbin në gojë,
mësojeni prej historisë.
Neve nukë kemi frikë,
nga presion' i borgjezisë,
kokënë do t'u dërrmojmë,
atje te vij' e kufisë;
po deshën le ta provojnë,
ç'janë të zotët e shtëpisë.

Grupi polifonik i Smokthinës

Marrës: Hysen Ruka

VITI NËNDËQIND E TETË

Viti nëndëqind e tetë,
kur lindi trimi me fletë,
Enveri, ball' i Partisë,
fat i madh i vegjëlisë.
Sivjet feston Shqipëria
gjashtëdhjetvjetor e tia,
ne nga zëmra i urojmë:
- Sa mali Tartar¹⁾ të rrojë!

1) Mal në Smokthinë të rrethit të Vlorës

Grupi polifonik i përzier Brataj Vlorë

FUSHA JON' ATY KA QËNË

Kur na erdhën bab' e nënë,
u ngre populli në këmbë,
punojmë për veten tënë,
shkulim përrenjtë me rrënjë,
s'ka më gërxhe dhe shkëmbënjë.
Tunde, tunde, moj Shushicë,⁽¹⁾
që të mbushen magazinë,
si Brati me Lepenicë.

1) Është fjala për lumin e Shushicës

Pra, për mendimin tonë, do të ishte e tepërt të vazhdonim të flisnim më tej për tematikën e këtij festivali.

Kur flasim në këtë mënyrë për festivalin e këtij viti, nuk kemi aspak për qëllim të zbehim, apo të denigrojmë vlerat që solli ai në folkloristikën shqiptare për meloditë e këngëve, apo variantet e valleve, në interpretimin e tyre, por duhet pranuar që politizimi e mënjanon në një farë mënyre folklorin nga shtrati i tij i vërtetë, nuk lejon atë lirëshmëri që e karakterizon, por e kufizon atë duke e futur në një brazdë, ashtu siç është orientimi. Stilstika poetike e përdorur në këto këngë është e pasur me figura artistike, ajo ngrihet në pedestal, por që shpesh herë zbehet nga përdorimi i panevojshëm i emrave të përveçëm, pa të cilat nuk mund të vlerësohej kënga. Ky është mendimi im, pa dashur të hap polemika në këtë drejtim, si dhe pa dashur të prek asnjë nga poetët, apo rapsodët me tekstet e tyre...

FFK GJIROKASTËR 1973 *(Festivali i dytë)*

Po t'i hedhim një vështrim panoramik këtij festivali që u organizua po në muajin tetor, duke krijuar tashma një traditë për organizimin e Festivalit Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës, vëmë re se kemi një ndryshim, ndoshta pjesërisht, përse i përket tematikës. Kështu shohim të ngjiten në skenën e këtij festivali figura historike të një periudhe të hershme, futet lirika, tematika të ndryshme etj, por as ky festival nuk i shpëton himnizimit dhe kultit të udhëheqësit të partisë, ndoshta me një patetizëm të lartë e figuracion të pasur artistik, apo dhe luftëtarëve që ranë në Luftën Antifasiste Nacinalçlirimtare, u visheshin kostume partiake, pavarësisht idealit të tyre për të cilin ata kishin dalë në luftë dhe dhanë jetën e tyre. Patjetër, në këto tekste dhe në gojën e atyre që ranë në këtë luftë, duhej përmendur emri i partisë. Edhe pse them,

se nuk dua që të merrem fare me këtë problem dhe as dua të ngjall polemika, duke lexuar këto tekste, më lind vetvetiu mendimi, idea, fjala, duke e parë në këndvështrimin e pas viteve '90, ku fjala është e lirë. Në atë kohë nuk bëhej ndryshe.

Kështu grupi i mirënjohur i Dukatit vjen në këtë festival me këngën kushtuar Dervish Aliut si dhe me këngën "*O trima flini të qetë*", kënduar nga këngëtarja plot vitalitet e mjeshtëri të rrallë interpretative Pika Gjoleka(Ferruni).

Një grup i ri del në skenë, i cili do të pagëzohej më vonë si grupi i vajzave të Dhërmiut, të cilat krijuan një fizionomi të veçantë në folklorin shqiptar. Ndoshta të një moshe të re, ky grup diti të përcjellë vlera të paharrueshme folklorike. Kënga "*Lulëzo, bregdet ibukur*", kënduar në këtë festival, do të bëhej një nga grupet më të pëlqyeshme, jo vetëm për krahinat e Jugut, por për mbarë vendin dhe që do të niste të shtonte dalëngadalë repertorin e tij.

Duke evokuar heroizmin e popullit tonë gjatë Luftës Antifasiste Nacionalçlirimtare, në këtë festival, vjen grupi karakteristik i Himarës me marrësin e njohur Dhimitër Varfin, me këngën "*Di vajza, të dija labe*", këngë kushtuar Heroinave të Popullit Bule Naipi dhe Persefoni Kokëdhima.

Ajo që vlen të përmendet është se në këtë festival paraqitet me dinjitet, nivel e cilësi të lartë artistike dhe interpretative grupi i Pilurit me të veçantën e tij, e cila shpërtheu si një përrua që rrjedh nga mali dhe nisi të shkruante emrin e tij me gërma të arta në folklorin shqiptar. Kënga "*Tundu bejkë ebardhë, tundu*" u bë këngë himn, këngë që përveç publikut tërhoqi edhe vëmendjen e kompozitorëve në përpunimin që i bënë më vonë asaj, apo dhe kënga "*Bilbili që dëgjon bota*". Një meritë të veçantë për këtë grup ka mjeshtri i madh i vargut, poeti i mirënjohur i vargjeve lapidarë, Lefter Çipa. Këto lloj këngësh filluan të shoqëroheshin edhe me instrumenta popullore aerofonë, siç ishte fyelli, nën interpretimin e Milto Gjicalit e të tjerë.

Kështu dalëngadalë Festivali Folklorik Kombëtar, nisi të merrte një fizionomi të re, si në drejtim të organizimit, ashtu edhe në drejtim të rritjes së vazhdueshme të cilësisë artistike, interpretative dhe hulumtimit nga folklori i kaluar.

Më poshtë po rendisim disa nga këngët që u kënduan në këtë festival.

Grupi polifonik i Dukatit

Marrëse: Pika Gjoleka (Feruni)

O TRIMA FLINI TË QETË

Kur të nisa për në çetë,
bashkë me shokë të tjerë,
gjer të kroi të përcolla,
të puth dy a tri herë.

Edhe ti më përqafove,
të mos qaj më këshillove,
dhe një fjalë më premtove,
se si trim do të luftoje.

Letrën që kishe dërguar,
disa her' e kam lexuar,

dhe yllin që kishte brenda,
në gji e ruante nëna.

Kur të pa nëna të vrarë,
të kuqon gjaku te balli,
aty plumbi të kish marrë,
aty ku vritet luani.

Kaq vjet shkuan e vanë,
që nëna nuk të ka parë,
po ti për atdhe ke rarë,
ndaj jeton e je i gjallë.

Kur më merr malli për tynë,
dal e shikoj Shqipërinë,
si kopësht me trëndelinë,
ashtu siç e doje tinë.

O trima flini të qetë,
se Shqipëria vëtrretë,
siç e kishit ëndërruar,
u bë vend i lulëzuar.

Amanetin që na latë,
do ta ruajmë për jetë,
Shqipërinë do ta mbrojmë,
kush të dojë le ta prekë.

Se e mbron populli ynë,
Enver Hoxha me Partinë,
dhe ushtria populllore,

që rri gati në llogore.

Në këtë këngë shohim një vargëzim tjetër nga ai i zakonshmi, monokolonë. Këtu kemi një poezi strofike, të rregullt, me një rimë të përputhur (AABB), shpesh herë dhe asonancë.

Nëse gjithë poezia është ndërtuar në mënyrë të tillë që bart me vete idealin e atyre që dhanë jetën për lirinë e atdheut, ëndrrën e tyre, pse patjetër, në fund të saj do të duhej ajo strofë që nuk i shton asgjë poezisë, por që për mendimin tim, këmbëngul, që mund ta zbehë atë.

O DERVISH ALIU DOLLE (*kënduar nga grupi i burrave*)

O Dervish Aliu,¹⁾ dolle,
o Dervish Ali Dukati,²⁾
në Berat vajte qëndrove,
të tërrin' e ti s'dëgjoje,
me terxhuma kuvendoje,
ti dije turçe, po s'doje.

1) Fshatar nga Dukati që u bë një nga udhëheqësit e kryengritjes në frontin e Beratit në vitin 1847

2) Përsëritet si refren pas çdo vargu.

Grupi polifonik i vajzave të Dhërmiut

Marrëse: Dhimitrulla Bixhili (Iliadhi)

Kthyese: Eftihia Stramarko (Panojoti)

Hedhëse: Rutha Ruci

Mbushëse: Kasjani Dhima & Shana Ruci (Leka)

LULËZO, BREGDET I BUKUR

Lulëzo, Bregdet i bukur,
sot je mbushur me stoli,
bota të shikon së largu
dhe ajo të ka zili.

Djem e vajza punëtore,
punojnë me krenari,
Bregdetin e zbukurojnë,
portokalle dhe ullinj.

Për grupin e vajzave të Dhërmiut, pjesëmarrës edhe në këtë festival është shkruar shumë pak, ose edhe fare. Ky grup është krijuar rreth fundit të viteve '60 me vajza të fshatit Dhërmi, të cilat jetonin dhe punonin po në Dhërmi. Dashuria për këngën e bukur të krahinës së Himarës, në variantin e këngës së Dhërmiut, i bashkoi me njëra-tjetrën duke krijuar një grup polifonik që për periudhën pati një jehonë për interpretimin e tyre cilësisht të lartë.

Pjesëmarrja e tyre nëpër këto evente folklorike kombëtare, daton me pjesëmarrjen në Festivslin e gjashtë Folklorik të Elbasanit, i cili është zhvilluar në 1966.

Fama e grupit i kalon kufinj të vendit. Grupi polifonik i vajzave të Dhërmiut , në përbërje të Ansambllit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore, merr pjesë në Festivalin Ndërkombtar të Ohrit në Jugosllavi në vitin 1971.

Ky grup përbëhet kryesisht nga këto vajza të asaj periudhe: Rutha Beli, e cila ishte edhe marrëse e këngëve, Evgjëni Bixhili, - kthyesë e këngës, hedhëse Dhimitrulla Bixhili (Iliadhi), e cila në këtë këngë “Lulëzo, Bregdet i bukur” është në rolin e marrëses si edhe Rutha Ruci, Jolanda Çulla dhe Vasillo Stramarko, Shana Ruci (Leka). Megjithëse pati një jetë të shkurtër, pasi disa nga këto vajza u martuan dhe u larguan nga fshati, megjithëse vazhdoi edhe për një kohë tjetër, duke patur

prurje të tjera, të reja, ku kanë hyrë e dalë duke plotësuar grupin sipas nevojave, si: Jollanda Çulla, Hajdho Bixhili, Shana Ruci, Moska Dhima etj. , nga Palasa ishte Lefteri Kashta, e cila ndërroi jetë në moshë të re dhe më vonë ky grup pushoi së ekzistuari. Në repertorin e tyre ka shumë pak këngë, nga të cilat mund të përmendim këngët: “Lulëzo, Bregdet i bukur, pjesëmarrës në këtë festival, këngën “Erdhi prilli, shkriu bora”, “ O moj vajza bregdetare” e këngë të tjera,

Duke dëgjuar këtë këngë mbretëresha e këngës himarjote, Katerina (Katina) Beleri dhe duke uruar hartuesin e kësaj video, zotin Leonard Bixhili, shprehet: “..Këto pamje të mbrekullushme... , sa bukur i ke shoqëruar me ato zëra brilante të grupit të vajzave me marrësen e talentuar Dhimitrulla Iljadhin... Ky grup mbeti një gur i rëndë në themelet e polifonisë himarjote”.

Grupi polifonik i Himarës

Marrës: Dhimitër Varfi

DI VAJZA, TË DIJA LABE

Di vajza, të dija labe,
Bule¹⁾, Persefoni²⁾,
lule partizane,³⁾
prej Gjirokastre, Himare,
vajza shkollë, por luane,
s’iu trëmbët tortur’s gjermane,⁴⁾
as nga vdekja, as litari;
se deshët një bot’ të re,
heroinat shqipëtare!

1) Bule Naipi, Heroinë e Popullit

2) Persefoni kokëdhima, Heroinë e Popullit.

3) Vargjet 2-3 përsëriten pas çdo vargu.

4) Nënkupto – torturës gjermane

Grupi polifonik i përzier i Pilurit Vlorë

TUNDU, BEJK' E BARDHË, TUNDU

Duke tundur zbret te zalli,
me shamin' lidhur te balli,
tundu bejk' e bardhë, tundu,
natënë me hënë duku.
Bejk' e bardh' e bor' e malit,
ti je ilaç' i çobanit.

Gjithë natën e beharit,
cula dëgjohet te stani,
bëj të flë, gjumi s'më zë,
cula bije ëmbëlë,
e dëgjoj e gëzon xhani,
i bije djalë çobani.
Kur merr ujë të burimi,
më duke si lule prilli,
tundu bejk' e bardhë, tundu,
natënë me hënë duku.
Bejk' e bardh' e bor' e malit,
ti je ilaç' i çobanit.
Kopeja na kullot malit,
ato han' majën e barit,
bëj të flë, gjumi s'më zë,
cula bije ëmbëlë,
e dëgjoj e gëzon xhani,
i bije djalë çobani.
Kur më bën shkarpa në brinjë,
atje do ta ngre pusinë.
Tundu bejk' e bardhë, tundu,

natënë me hënë duku.
Bejk' e bardh' e bor' e malit,
ti je ilaç' i çobanit.
Në saba, pa dirë mirë,
do takonem me barinë,
bëj të flë, gjumi s' më zë,
cula bije ëmbëlë,
e dëgjoj e gëzon xhani,
i bije djalë çobani.

Ndoshta është shkruar shumë për këtë këngë, është marrë në dorë dhe është përpunuar nga emra kompozitorësh të dëgjuar duke e lartësuar, jo vetëm për lirizmin që ka në vetvete, por edhe për ndërtimin metrik të saj. Është një lirikë e ëmbël që sa herë që e dëgjon, mediton, të tërheq e të merr me vete kudo që shkon, të ngjall emocion, të grish, të bën të inskenosh e të përfytyrosh. Ndoshta nuk gjej fjalë për të shprehur e nxjerrë në pah vlerat e mëdha që ka kjo këngë, nga që ekzaltohem sa herë që e dëgjoj. Është me të vërtetë një vlerë e vyer e nxjerrë nga muza e pashtershme e Lefter Çipës.

BILBILI QË DËGJON BOTA

O Enver, bilbil' i jetës,
ngrije zërin tënd kudo,
ti je trim i së vërtetës,
Partia kështu të do.

Bilbilin që dëgjon bota¹⁾,
e ka lindur Shqipëria,
ky bilbil është' Enver Hoxha,
në krye e ka Partia.

Komisar i partisë,
ti ke qënë e do të jesh,
dhe drita e Shqipërisë,
që lëshon rreze ylber.

Gjithë globi, rruzullimi,
sot zërin tënd e dëgjon,
ti je besnik i marksizmit,
udhëheq's i partis' sonë.⁽²⁾

Bilbil je, bilbil të thonë,
për të gjithë vegjëlinë,
e gjith' bota të dëgjon,
nga ty kanë kthyer sytë.

- 1) Vargjet 5-8 përsëriten si refren pas katër vargjesh.
- 2) Nënkupto - udhëheqës

Grupi polifonik i Smokthinës

PARTIA JONË ME FORRË

(kënduar nga grupi i burrave. Marrës: Hysen Ruka)

Partia jonë me forrë,
o faqebardha si borë,
çave retë si rufeja,
solle dritë mbi atdhe.
Parti, moj zemërçelnike,
bij' e marksizmit besnike!

Grupi polifonik i burrave Tërbaç Vlorë

LINDI LUANIA, LUANË

Nëna shqipëtare,
mbes' e ilireshës,
ke lind' e ke rritur,
trima dhe të besës.

Vojsava krutane,
lindi Skënderbenë,
kreshnikun e lartë,
që tronditi dhenë.

Nëndëqind e tetën,
një nën' e gëzon,
Gjirokastrës trime,
një djal' i dhuron.

Lindi nënë Gjylua,
luania, luanë,
dhurat' më të shtrënjtë,
nuk kish për vatanë!

Ajo s'lindi djalë,
bij' e Labërisë,
ajo lindi burrë,
kokën e Partisë!

FFK GJIROKASTËR 1978 ***(Festivali i tretë)***

Festivali i këtij viti ishte një dëshmi tjetër i vlerave që mbart në vetvete folklori lab. Ndoshta nuk kemi mundur të grumbullojmë të gjitha tekstet që u paraqitën në këtë festival, por duhet thënë se Vlora arriti pikën më kulmore të saj në historinë e organizimit të këtyre festivaleve, sa që u shpall dhe laureat i festivalit.

Krahas këngës dukatase me të veçantën e saj, shohim të promovohen edhe me grup valle burrash, siç është vallja “ *O Qemal kur të përzunë*” me një interpretim të shkëlqyer e nivel të lartë artistik, apo dhe kënga e grupit të Tragjasit me vargje të pjekura artistikisht të poetit Hamdi Pulo, kur thotë:

“Argjiro, vetullashkruar,
hapi krahët e dil nga shkëmbi,
kala e vjetër në Jugë,
seç ka që lëviz nga vendi.”

apo,

“Dridhe vallen, Gjirokastër,
merrja ti, o Mal i Gjerë,
ktheja, o Çajup i lartë,
iso mban Shqipëri e tërë.”

Kur zhvilloheshin Festalet Folklorike Kombëtare, gjithë vendi ishte në festë dhe sytë e gjithësecilit ishin drejtuar në këtë sofër të madhe të këngës, ku shpaloseshin vlerat më të vyera të folklorit shqiptar.

Siç kemi thënë edhe në fillim, kënga popullore i përgjigjet flakë për flakë realitetit, sipas kushteve historike në të

cilat jetojmë. Një realitet i tillë është edhe vallja e grupit të Vranishtit “*O trima vallen ma mbani*”, shkruar nga pena e artë e Muhamet Tartarit etj.

Treshja e Dukatit ishte një risi e grupit të Vlorës, pjesëmarrës në këtë festival. Kjo treshe e përbërë nga Leko Vangjeli, Sulo Bozhani dhe Bego Vangjeli paraqiti vlera të papërsëritshme, të cilat paraqiteshin për herë të parë, duke nxjerrë nga arkivi i tyre një margaritar nga thellësia e shekujve. Një interpretim brilant i kësaj treshe që tërhoqi vëmendjen e studjuesve.

Përveç këngëve që përmendëm më lart. grupi i Vlorës në repertorin e tij kishte edhe këngë të tjera, si: “Shqipëri, moj pallëzhveshur”, interpretuar nga grupi i Tragjasit, “Zoga kaçake në male, i paraqitur nga grupi i Pilurit, nëpërmjet penës së artë të Lifter Çipës, ku nëpërmjet vargjeve të saj evokon luftën e himarjotëve kundër pushtimit otoman. Po kështu nga ky grup, pra nga grupi i Pilurit, shohim interpretimin virtuoz të këngës “Këngët e Atdheut tim”. Repertori i grupit të Vlorës ishte i larmishëm.

Kënga që ndezi kalanë e festivalit dhe që korri më shumë sukses, përveç këngëve të tjera, ishte padyshim kënga interpretuar me mjeshtëri nga grupi polifonik i Pilurit. Kjo këngë është një

këngë që buron nga thellësia e shpirtit të poetit, ashtu si vet kënga që buron nga thellësia e shekujve.

Stilistika letrare e përdorur mjeshtërisht nga autori, i jep kësaj kënge një ëmbëlsi, si rrjedhë e një burimi, si gurgullimë që vjen nga thellësia, ndaj dhe autori në refrenin e saj shpërthen me gjithë dinamikën e tij:

“ Do t’ja marr, siç merret kënga,
kënga shqipëtare,
siç ma ka mësuar nëna,
kthejani, o male.
Këngët e Atdheut tim,
janë ilaç, janë more shërim”.

Dhe Lefter Çipa, si mjeshtër i vargut di ta latojë atë, siç di ai vet, si ai gurëgdhendësi që e skalit gurin për t’i dhënë formën e duhur.

Kjo këngë u bë kaq e dashur, sa që u thith menjëherë edhe nga grupi polifonik i Ansambllit të Këngëve dhe Valleve Popullore për t’u përhapur edhe jashtë territorit shqiptar.

Spiro Shituni, njohës dhe studjues mirëfilltë i polifonisë labe në kumtesën e tij “Elementë novatorizmi në polifoninë labe”, botuar nga Akademia e Shkencave në librin “ Probleme të zhvillimit të folklorit bashkëkohor, fq. 102, për këngën “Sot ka ardhur komisari”, paraqitur në këtë festival, mes të tjerash shkruan: “ Melodia e këngës “Sot ka ardhur komisari, duke e zhvilluar mbi bazën e traditës, sjell intonazione të reja, në fund të fundit, kanë kristalizuar edhe një stil të caktuar muzikor, aq masiv e aq të bukur. Ky stil vërtet mbështetet në traditën folklorike, pra, në të njëjtën kohë e përsërit atë në cilësi e sasi. Në pjesën e parë të këngës, marrësi tashmë bën një paraqitje të gjerë të mendimit muzikor, duke kënduar vargun e fundit të saj. Kurse në pjesën e dytë të këngës, marrësi, kthyesi, hedhësi dhe isoja marrin pjesë në interpretim, njësoj si në traditë”.

Ja disa nga tekstet që u paraqitën në këtë festival.

Grupi i valleve të Dukatit

O QEMAL KUR TË PËRZUNË

O Qemal, kur të përzunë,
kur të përzuri Turqia,
erdh' e të mori gjemia,
brenda në Paris të shpuri,
atje tek ish katimia.
Ç't'u ngrinë kralët në këmbë,
mbretëresha dhe e bija:
- Cili je ti, more burrë,
Që kërkon vulat e mija?
- Unë jam Smail Qemali,
prapa më vjen historia.
Të shtatë vulat ja dhanë:
- Po do mos dojë Turqia.
- Do dojë, se s'është punë,
Ësht' e jona Shqipëria.

Grupi polifonik i Tragjasit Vlorë

Marrës: Aranit Daupi

SOT KA ARDHUR KOMISARI

Argjiro, vetullashkruar,
Hapi krahët e dil nga shkëmbi,
kala e vjetër në Jugë,
seç ka që lëviz nga vendi.

Çeçua me nagant në dorë,
po qëllon si do zakoni,
si perri nga deg' e rrapit,
zbresin Bulja, Persefoni.

Gëzon guri e qesh sokaku,
derdhen malet vetëtimë,
del fëmija, vrapon plaku,
që të puth' në sy Partinë.

Mashkullor' , eshkë stërralli,
si të këndoi mauzeri,
te Rrapi i bilbilenjet,
këmbëkryq ç'u ul Enveri.

Bij' ,që prehi në lëndina,
sot ka ardhur Komisari,
grushtin lart, kushtrim betejash,
është' flamur çdo pllakë varri.

Dridhe vallen, Gjirokaštër,
merrja ti, o Mal i Gjerë,
ktheja, o Çajup i lartë,
iso mban Shqipëri e tërë.

LESHVERDHA CULËN DËGJOI

Një çoban lartë nga mali,
po ia thoshte me xambare,
më lëndoi plagët dhe mua,
ndaj mora cylvdyjare.

Po i bjerë duke qarë,
cula dhëntë i tërboi,
zër' i cules mori fshatin,
leshverdha culën dëgjoj.
Zëmra filloi të më dridhej,
mu si zogut në dëborë;
gjunjët nuk më mbanin fare,
cul' e shkret' më mbet në dorë.
E shkreta me vete thashë,
dhe tani që e kam pranë,
m'i mori dreqi të gjitha,
nuk ia çfaqa dot sevdanë.
Mos u mërzit, more djalë,
janë ethe dashurie,
me to do ecur ngadalë,
po nxitove, shi se bie.

Besoj se “*Leshverdha culën dëgjoj*” e Hamdi Pulos , interpretuar me mjeshtëri nga grupi i Tragjasit është një nga lirikat më të bukura të këtij festivali, një lirikë e ndjerë, ku vargu rrjedh vetvetiu, vjen vet, pa e kërkuar. Është një ndjenjë që të mbërthen e nuk të lëshon. Rënia e culëdyjares është aq e ndjerë sa dhe dhentë tërbohen dhe ka një domethënie. Në botën dhe ëndrrën e tij instrumentisti popullor ka një objektiv dhe ky është i qartë dhe i drejtpërdrejtë që ta dëgjojë “leshverdha” e poetit, ta grish atë, ta afrojë e ta bëjë për vete. Dhe gjetja e stilistikës që përdor poeti është e thjeshtë. Bukuria e “leshverdhes” e shtang. Para saj mbërthehet e mbetet në vend, tamam, siç thotë në një nga këngët e tij këngëtari i madh grek Janis Parios “sikur dashuroj për herë të parë në jetën time”. Vargjet e fundit të kësaj lirike janë si një këshillë për ata që dashurojnë.

Grupi polifonik i përzier i Kaninës Vlorë

NËN-O, JAM E VOGËL

Nën-o jam e vogël,
do të rritem dhe më,
pushkën do ta mbaj,
s'jam e vogël shumë.
Kaq sa mua shoqet,
kan' qen' partizane,
në zjarrin e luftës,
kan' qëndruar luane.

Dhe armiku lig,
po desh, të guxojë,
me zjarr e me hekur,
do ta përvëlojmë.
Bashk' me shok' e shoqe,
do të mbroj vatanë,
pushkën do ta mbaj
si të parët tanë.
Pushkën fort do mbaj,
do mbroj Shqipërinë,
do nderoj Atdheun,
Enverin, Partinë.

Grupi i valleve të burrave Vranisht Vlorë

O TRIMA VALLEN MA MBANI

(valle vënçe burrash)

O trima, vallen ma mbani,¹⁾
lidhur si fishek' gjerdani,
jemi zot të këtij vatani,

kush na prek i humbet nishani,
shkrum e hi bëhet nga zjarri;
zjarr' i luftës popullore,
çdo shqiptar në një llogore,
prina, Parti, në fitore!

1) Çdo varg në të kënduar përsëritet dy herë.

Ndoshta do t'i quaja këto vargje si një nga kulmet më të mira të krijimtarisë të poetit popullor Muhamet Tartari. Në të është derdhur artistikisht mjeshtëria e tij poetike për të paraqitur në mënyrë të sintetizuar karakterin e kahershëm dhe të paepur të shqiptarit që për mbrojtjen e atdheut të tij bën edhe sakrificën më sublime, siç është jeta.

Grupi i Pilurit

ZOGA KAÇAKE NË MALE

Zunë malet e rënkojnë,
zunë kaçakët e shkojnë,
shkojnë,more,shkojnë,
natënë kalojnë.
-Nënë,do shkoj dhe unë,
maleve t'serrta me gurë,
kaçake do vete,
do vete se më kërkojnë,
këmba-këmbës më gjurmojnë,
xhandarët e burgut,
sulltanët e turkut.
- Bijë,të kam kalamake,
të kam rriturë bonjake,
bij',o bija ime,
o Zoga jetime.

-Nëna mbeçë tu mirë,
se kam nënë Shqipërinë,
më thërret t'i vete;
do vesh rrobat e vëllait,
do marr pushkën e babait,
nënë,ika natën,
turkut t'i vë flakën.

-O ju zogj,ju fluturakë,
Ju që piqi me kaçakë,
mos ma patë Zogën,
që e kam të vogël?!
Zoga jote nëpër male,
lufton me Turqinë e madhe,
mbi gjoksin e shkëmbit,
për lirin' e vëndit..
O ju trima kapedanë,
ju që piqi me kaçakë,
më thanë,Zogën e vranë.
Por kur u vra Zoga,
fluturoi shqiponja.
- Nënë,mos ki dëshpërime,
se vajzën e pate trime
dhe e derdhi gjakun,
për lirinë e pragut.

KËNGA JONË, KËNGË DJEPI Grupi i Pilurit

Kënga jonë, këngë djepi,
flakërin si shpata,
sa shumë jeta e deshi,
më ëmbël si mjalta.

Refreni: Do t'ja marr, siç merret kënga,
kënga shqipëtare,
siç ma ka mësuar nëna,
kthejani, o male.
Këngët e Atdheut tim,
janë ilaç, janë more shërim.

Janë këngë që tregojnë
mallin e zhuritur,
nga ky dhe ku dhe burojnë,
me to jemi rritur.

Refreni: Do t'ja marr, siç merret kënga,
kënga shqipëtare,
siç ma ka mësuar nëna,
kthejani, o male.
Këngët e Atdheut tim,
janë ilaç, janë more shërim.

Sa e fortë dhe sa e gjërë,
kënga shqipëtare,
sa shumë e ka mbrojtur nëna,
janë proletare.

Refreni: Do t'ja marr, siç merret kënga,
kënga shqipëtare,
siç ma ka mësuar nëna,
kthejani, o male.
Këngët e Atdheut tim,
janë ilaç, janë more shërim.

GJURMË TË KUQE BORËS LARË

(Kjo këngë është kënduar nga një grup vajzash mix të shkollës së mesme të Mesaplikut "Laze Nuro" – Brataj, Laureat i Festivalit).

Marrëse: Nazo Dautaj nga Tërbaçi,

Kthyesë: Fedirete Sulçaj nga Mesapliku,

Hedhëse: Shpresa Kapo nga Tërbaçi.

Kur ndodhej vendi në flakë
trima lule, partizanë,
ngjeshët radhët në brigadë
bijat tona - djemtë tanë.

U bë shamikuqe
Bramyshnja lëndinë,
shtatqind copa shkëmbi
maleve kur zbrinë.

Gjurmë të kuqe borës latë
lule yje - zëmra jonë,
nga Bramyshnja në Sanxhak
lule yje - jeta jonë.

Shqipe rreth e qark
Besnik komisarit
liria, o bij ju ndriste
mbi yllin e ballit.

E mbollët gjakun si farë,
farë lufte, dritë lirie,
lindën treqind lapidarë,
shkëmb mermeri, Shqipërie.

Në gjoks të lirisë
djemtë tanë i pamë,
këngët na shpërthyen,
lotët na u thanë.

Dafinat mbi thinja,
moj Brigad' e Pestë,
edhe yll' i artë
do të ndris për jetë.

FFK GJIROKASTËR 1983 *(Festivali i katërt)*

Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës 1983, i katërti në radhë, është në vazhdim të festivaleve të mëparshme të zhvilluara në këtë qytet. Është i njëjti format, me të njëjtat kritere. Përveç folklorit tradicional, duhej që patjetër të dilte në pah edhe folklori i ri i ditëve të socializmit, himnizimi i udhëheqësit deri në atë shkallë, sa gati – gati, shihej si perëndi, gjë që e kornizonte në një farë mënyre këtë festival. Rapsodët dhe grupet rendnin si në garë, kush e kush të shkruante vargjet më të mira për udhëheqësin dhe si rrjedhim, edhe nga juria, në shumë raste, nisur nga kjo, bëhej edhe vlerësimi i grupeve. Në programin e çdo grupi kishte dhe tekste të tilla, ku flitej për imperializmin, titizmin, socialimperializmin, luftën kundër tyre e të tjera si këto që jo vetëm zinin vendin më të madh të programit, por në të njëjtën kohë cungonin folklorin e vjetër dhe tradicional. Dhe jeta e re duhet të kalonte patjetër vetëm nëpërmjet kësaj ideologjie të ngulitur, jo vetëm te grupi pjesëmarrës, por tek të gjithë shqiptarët. E tillë ishte politika shtetërore dhe ishe i detyruar që ta zbatoje atë deri në detaje.

Një gjë e tillë nuk i shpëtonte asnjë grupi, ku edhe Vlora,

patjetër ishte e përfshirë në këtë vorbull. Pjesa më e madhe e teksteve vazhdojnë të jenë tejet të politizuara, me himnizime, deri dhe të hiperbolizuara. Në qoftë se do t'i hedhim një vështrim teksteve që u paraqitën në këtë festival, të gjitha grupet janë dalluar për politizim, deri në absurd. Edhe Vlora nuk mbetej prapa. Mjafton të përmendim këngën e titulluar “*Ca bejte për ca shtete*”, e cila bënte fjalë për demaskimin që i bëri Enver Hoxha revizionizmit hrushovian në Moskë në Mbledhjen e 81 partive në nëntor të vitit 1960.

Por, duke lënë mënjanë këtë politizim, ajo që është kryesore për grupin e Vlorës në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës dhe që duhet theksuar është që, si zakonisht, edhe në këtë festival, Vlora çoi kulme të traditës folklorike dhe kapi maja të larta vlerësimi. Mjafton të përmendim këngët “*Janinës ç'i panë sytë*”, interpretuar me mjeshtëri të rrallë nga grupi i Lapardhasë, apo dhe këngën “*Xinxërfilë*”, kënduar si rrallë ndonjëherë nga grupi i Armenit me këngëtarin virtuoz Rahman Nuredini dhe që u bë një nga këngët më të bukura, më të pëlqyeshme dhe më me popullaritet, e cila më vonë u përpunua bukur dhe u këndua po aq bukur nga këngëtarja e mirënjohur Aurela Gaçe, duke ruajtur fizionominë dhe autenticitetin e saj. Një nga perlat që u paraqit në këtë festival është edhe kënga kushtuar poetit dhe mendimtarit Naim Frashëri “*Bilbil i vendeve të mia*”, kënduar me mjeshtëri të rrallë nga grupi i Pilurit, me marrëse këngëtarene e paarritshme Ermioni Mërkuri, falë fjalëve të gjigandit të penës së Pilurit dhe gjithë Shqipërisë Lefter Çipës. Për mendimin tim kjo këngë mund të quhet këngë himn për Naim Frashërin. Nuk do të gjeja fjalë t'i përshkruaja këto perla dhe këto vlera, se sa fjalët e vet këngëve.

Litota e përdorur që në fillim të këngës, apostrofat, thirrjet eksklamative të mbërthejnë emocionalisht. Kënga e gjithë është ndërtuar me një figuracion të pasur artistik. Çdo fjalë është e qendrisur, çdo varg është i latuar dhe gjithë kënga është situar mjeshtërisht artistikisht që vetëm një penë e artë si e Lefter Çipës mund ta bëjë.

“Shqipëri, o shkëmb i serrtë,
ti bilbila i bën djemtë,
shekujt vijn’ e vitet shkojnë,
Naim, djemtë ligjërojnë”.

Shqiptari gjithmonë krahas pushkës ka mbajtur edhe penën. Të dyja këto simbole të luftës për liri dhe dituri. Në gjurmët e poetëve dhe mendimtarëve të mëdhenj që ka nxjerrë kombi nëpër shekuj, ecin dhe poetët më të rinj që siç thotë poeti “djemtë ligjërojnë”. Është vazhdimësi. Me këto vargje e mbyll këngën poeti.

Kënga himarjote në këtë festival, pas të madhit dhe themeluesit të saj Neço Mukës, pasuesit mjeshtëror, Artistit të Merituar Dhimitër Varfit, vjen me një figurë të re, po aq të rëndësishme dhe virtuozë, me një pasuese të denjë, me një interprete të shkëlqyer, siç është Katina Beleri. Ajo ishte një risi e këngës himarjote, jo vetëm vazhduese e denjë, por që e ngjiti këtë lloj kënge në një pedestal më të lartë. Katina Beleri solli në këtë festival një variant të ri të këngës “*Llaj çoban*” më të moderuar, me një interpretim sa dinjitoz, aq dhe virtuoz. Ajo pa frikë mund të quhet një brilante e këngës himarjote.

Ninulla, është një tjetër prurje e këtij festivali. Është një nga ato këngët që u këndohen fëmijëve në djep. “*Djepi ynë burim flori*”, kështu titullohet kjo ninull, ardhur në këtë festival, kënduar me patos e mjeshtëri nga këngëtarja Evgjëni Jonuzi. Është një tregim që nëna ia thotë djalit të vet në djep. Flet për trimërinë e të parëve tanë. I tregon të birit për gjyshin e tij, i cili u vra në brigadat luftarake, gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, edhe përtej kufijve të Shqipërisë. Gjyshi u vra në luftë për çlirimin e Kosovës.

Nëna kërkon që djali i saj të rritet shpejt, të shkojë në shkollë e të shkollohet, se përpara e pret jeta e re që do të nis.

Një vend të rëndësishëm në këtë festival zunë edhe këngët humoristike. Ajo që spikati më shumë në këtë gjini dhe që u bë shumë shpejt një nga këngët, jo vetëm nga më të pëlqyeshmet, por edhe më shpotitëse është vallja e kënduar dhe interpretuar me mjeshtëri nga grupi i njohur i vajzave të Bolenës: "*Plaku me plakën ç'u zunë*", drejtuar me patos nga rapsodi Nertesi Asllani. Në formën e një loje fjalësh, të një shakaje me kripë, siç thuhet në Labëri, del karakteri epror i

plakut, i cili kërkon të vërë veton në shtëpi, si shtyllë e saj, por ama edhe plaka, e zonja e shtëpisë nuk bie më poshtë. Ajo është, tashma, e çliruar nga frika e dikurshme dhe në replikat e këngës del qartë kjo karakteristikë e re, duke iu përgjigjur në moment, me humor të thellë therrës plakut. Dhe ja përgjigja e saj, si në majë të gjuhës:

“-Barku gjunjët s't'i ka zënë,
merre vet' se jam me punë;
po deshe përshesh me dhallë,
ngrihu vet' se s'je i çalë.”

Ajo (plaka) nuk e lë të bjerë fjala në shesh, mburrjeve të plakut. I përgjigjet edhe ajo po me mburrje:

“ Kur ishe tinë me pallë,
jesha bejk' e gushëbardhë.”

Një këngë tjetër humoristike dhe e vlerësuar në këtë festival është edhe kënga e kënduar nga grupi polifonik i Alibanit e titulluar “Dardanake”, ku rapsodi popullor nëpërmjet epitetëve dhe krahasimeve shumë të bukura ravijëzon portetin e vajzës myzeqare të Vlorës.

Ky festival nuk kishte vetëm një kulm, ai kishte disa. Dhe si të tilla nuk mund të lëmë pa përmendur një kulm që mjeshtri popullor e ka gdhendur në katër vargje, sa domethënëse, aq dhe kuptimplote. Në këto katër vargje është gdhendur një “Ah”, një

dert që e ka munduar për pesë shekuj shqiptarin nën sundimin otoman. Ai ofshan, urren, mallkon me gjithë shpirt atë që i la “djepi that’ e vatra shkretë” tek monofonia “Ç’u këput një këmbë mali”, interpretuar me një mjeshtëri të rrallë e virtuozytet nga këngëtari Zeqo Hoxha nga fshati Kallarati i Vlorës, mbi katër vargje të arta të rapsodit Llambro Hysi. Nuk mund të lëmë pa përmendur edhe vallen e burrave të Vranishtit (valle vënçe), valle e tabanit popullor mbi vargje të gdhendura të poetit popullor Muhamet Tartari me eposin karakteristik lab të tyre.

Grupet pjesëmarrëse në këtë festival u paraqitën me këtë repertor.

Grupi i Brataj Vlorë

CA BEJTE PËR CA SHTETE

Ejani t’ia marrim-o,
labçes-o, bratçes-o,
me ca bejte për ca shtete,
kënga jonë plumb ç’u vete,
t’ia fillojm’ me Titon-o,
o bobo, marshall-o,
mot për mot e port’ më portë,
hëngre, po s’lave dot,
kur kujtonë gjashtëdhjetën-o,
carët e Kremlinit-o,
përpëliten si nga zjarri,
tradhtin’ s’e fal shqiptari.
Vijnë rreth tri botët-o,
rotull-o, anës-o,
lule mbjellin, po nuk çelin,
lodhen kot e kot i mbjellin.
CIA, KGA-ja-o,

Oznos, jo s'i shkoi dot,
tradhëtari, mercenari,
vetes-o, dërckanjari.
Në malet e shqipes-o,
ditët-o,çelin-o,
flak' të kuqe, plot burbuqe,
në tokën me yje lufte,
në djepin ku qesh fëmija,
mbi kalan' ku prin Partia.

Grupi i valleve Vranisht

SHPATA JONË GRIS FERMANË (Valle vënçe burrash)

Mesaplik, te rrapi tëndë,
këmbëkryq, ngremë kuvendë;
Shqipëri, na ke më këmbë,
mbrojm' lirin' dhe nderin tënë!
Lidhëm bes' e fjalën dhamë,
s'japin xhelep e nizamë.
Shpata jonë gris fermanë,
kanë zot trojet tanë.

Grupi i Pilurit Vlorë

BILBIL I VENDEVE TË MIA

Ku peshon më shumë guri?
Ku s'ka të vdekurë burri,

more Naim Shqipëria?
Peshon në vendin e tija,
ku të flet gjuhën fëmija,
bilbil i vendeve të mia.
O pena me flori larë,
mbi botë lulja e parë,
more Naim Shqipëria,

Naim-o, Naim-o, Naim-o,
more Naim Shqipëria.
Hënë yjesh, hën' behari,
ç'u bë Naim këngëtari,
more Naim Shqipëria?
Gjuh' e zogjve nëpër djepe,
zgjove kombin, dritë derdhe,
bilbil i vendeve të mia,
bilbil-o, bilbil-o, bilbil-o,
more Naim Shqipëria.
O i ëmbël për të gjallë,
i gjalli për shqipëtarë,
more Naim Shqipëria,
pak jetove, shum' na le,
shumë more dhe në dhé.
Bilbil i vendeve të mia,
bilbil-o, bilbil-o, bilbil-o,
bilbil i vendeve të mia,
s'të mban dot dheu përbrenda,
del nga varri e nis nga kënga,
more Naim Shqipëria.
Nëna jonë shamikuqe,
shtatin mal veshur si nuse,
bilbil i vendeve të mia,

bilbil-o, bilbil-o, Naim-o.
Shqipëri, o shkëmb i serrtë,
ti bilbila i bën djemtë,
shekujt vijn' e vitet shkojnë,
Naim, djemtë ligjërojnë.

Grupi i Lapardhasë Vlorë

JANINËS Ç'I PANË SYTË

(kënduar nga grupi i burrave)

Janinës ç'i panë sytë,
Janin- o,⁽¹⁾
Ish e prëmtë ajo ditë,
të pesë pusët në grykë,
Zenel Çelua vet' i dytë,
Zeneli me të velçionë
dhe trimi Jaçe Mavrovë,
ç'u hodhë e ia bën forrë,
çau mes për mes taborrë;
kur shtriu pashan' e njonë.⁽²⁾

1) përsëritet si refren pas çdo vargu

2) formë dialektore për "e njohën"

DJEPI YNË BURIM FLORI

(Kjo ninull në këtë festival është kënduar nga Evgjeni Jonuzi nga fshati Kallarati)

Do t'i këndoj djalit-o,
këngën-o, dertin-o,
gëzimin e djepit-o.
Djepi yn' burim flori,
ç'trima që rriti ai.
Rritu, si rritet lastari,
si zbukurohet bari,
maleve kur vjen behari,
qendisur fije gajtani.

Fustan' edhe xhamadani,
dhurat' për valle nga malli,
djalit-o, yllit-o,
të parit e valles-o,
në yllkat e fshatit-o.
Rritmu, se shkolla të pretë,
rritmu, të dalësh në jetë.
do të tregoj edhe pakë.
Dertet-o, mallet-o,
na i dinë hallet-o,
q'i jan' hequr valles-o.
Pa dëgjo mamin dhe pak;
gjyshi t'u vra në brigadë,
në Kosovën me bajrak.
i kish vajt' pranë një nënë,
kosovare, grykëzënë,
ca ligje i kishte thënë
dhe plagët ia kishte larë,
me lot' Kosove të bardhë.
Djepi yn' burim flori,
ç'trima që rriti ai,
bota na i kan' zili.
Djepet-o, nënat-o,
që përkundën trimat-o

bashkë me martinat-o.

Grupi polifonik i Bolenës

PLAKU ME PLAKËN Ç'U ZUNË

Plaku yn' ka një mërzi,
me plakën është' në mëri,
plaku me plakën ç'u zunë,
kush je ti e kush jam unë.

Plaku, moj plaku,
o mustaqe sharku;
plaka, moj plaka,
plaka gjithë lajka.

Kush je ti e kush jam unë;

- Bjemë kutruven ⁽¹⁾me ujë!
- Aman, se më plase xhanë!
- Bjemë çanakun me dhallë!

Ja se ç'i tha plaku,
plaku shenjëraku,
plaku, moj plaku,
o mustaqe sharku.

-Barku gjunjët s't'i ka zënë,
merre vet' se jam me punë;
po deshe përshësh me dhallë,
ngrihu vet' se s'je i çalë.

Plaka,moj plaka,
plaka gjithë lajka,
gjithë lajka.

-Jo, moj, jo se s'jam i çalë,
isha më trimi me pallë,
do bërtas sa të tund fshanë,
bjemë çanakun me dhallë.

Plaku, moj plaku,
është zot konaku,
shenjëraku.

-Kur ishe tinë me pallë,
jesha bejk' e gushëbardhë.
Ç'ke, o plak, a rrënjëdalë?!
Do na dëgjojn' në mëhallë!

Plaka, moj plaka,
plaka gjithë lajka,
gjithë lajka.

Qeshi plaku, plaka qeshi,
plakun e zbuti përsheshi.

Plaku, moj plaku,
o mustaqe sharku;
plaka, moj plaka,
plaka gjithë lajka,
gojëmjalta.

1) Shtëmbë uji

Grupi i Alibanit Vlorë

DARDANAKE

(Humoristike)

T'u bëfsha qumësht për mëngjes,
dardanake, ferracake,
faqekuqe, rumbullake,
gusha jote si bardhake.
O kokosh, more kokosh,
që nga trari re përposh,
syri yt mu bë si grosh.
O Sali, more Sali,
un' të quajta jabanxhi,
ndaj të thirra në shtëpi,
të dhash' ver', të dhash' raki,
ti kërkonje syn' e zi,
oji, oji.
Ç'u nisa për në Vlorë,
Vlorë, moj, e mira Vlorë,
prapa malit shkova,
dy cingar' t'i drodha,
një selam ta çova.
Moj syzezë, vetullzezë,
me gajtan ta mata mesnë;⁽¹⁾
moj llokumja me sheqer,
rashë në mejtim të thellë,
kush bën sevap të më nxjerrë?!

1) mesin, belin

Grupi i Armenit Vlorë
Marrës: Rahman Nuredini

Ç'U MBUSH MALI CIXËRFILE

Ç'u mbush mali cinxëfile,
si cicërimat në pyje,
ajo që këngët m'i zgjoi,
billonjë¹⁾ mbi shoqet shkoi.
Cinxërfile, cinxërfile,
ç'bukuri që ke mbi krye,
ylberin hedhur mbi supe,
buzëlule, ç'më këpute.

Shtati yt me shumë nure,
gjurmëleht' e thëllëz' fushe,
ç'djalë në merak nuk vure,
cila nën' s'të desh për nuse.
Të dëgjoja kur ja merrje
bashkë me shoqet e tua,
n'ato net' të ëmbla vere
s'të shkonte kënga pa mua.
Balluket mbi ballin stisur,
t'i merr veriu në lëmë,
kulaçin me miell të situr
nga gruri i ri gëzuar bëmë.

1) vajzë a grua me shtat të gjatë e të drejtë, biskonjë

Një harmonizim i shkëlqyer i vargjeve të shkruara nga
Lefter Haxhiraj dhe një interpretim akoma më i shkëlqyer i
këngëtarit të mirënjohur Rahman Nuredini.

Grupi polifonik i Himarës Vlorë

Marrëse: Katina Beleri

LLAJ ÇOBAN

Ku janë nisur e venë,
llaj, llaj, llaj çobani ¹⁾?
Në stan, te çobani venë.
Dhe çobani mirë i priti,
therri qengj e i gostiti,
qengj të mir' e qengj të pirë,
qengjin e bejkës kërthinjë.

Dola në majë te tënda,
mbajta vesh se ma kish ënda,
dëgjova zile të rënda,
m'u ndez syri, m'u drodh zemra

1) Përsëritet si refren pas çdo vargu

Kënduar nga Zeqo Hoxha



Ç'U KËPUT NJË KËMBË MALI (monofoni)

Ç'u këput një këmbë mali,
o Stamboll, të djegtë zjarri.
Djemtë tanë, hajmedet,
djepi that' e vatra shkretë.

FFK GJIROKASTËR 1988 (Festivali i pestë)

Nga njeri festival tek tjetri, grupi i Vlorës ka treguar se ka shumë vlera folklorike, mund të themi me plot gojë, se është një burim i pashtershëm. Nisur nga kjo, çdo grup drejtuesish e ka të vështirë të për zgjedhë nga kjo mori prurjesh për të çuar në një festival, brenda një tridhjetëminutëshi, gjithë folklorin e bukur të kësaj treve që ka një shtrirje të gjerë gjeografike, si dhe një shumëllojshmëri variantesh të kënduari.

Në organizimin e këtij grupi për të çuar në Gjirokastër perla të polifonisë labe, është dashur një punë, jo vetëm e madhe, por edhe një përkushtim dhe profesionalizëm i lartë, gjë që ka gjetur një zgjidhje shumë të mirë, në mënyrë që të paktën, të përfaqësoheshin të gjitha zonat etnokulturore dhe etnomuzikore. Dhe kjo meritë e padiskutueshme i takon padyshim udhëheqësit artistik të grupit të Vlorës, Artistit të merituar, Haxhi Dalipi.

Pa dashur të hyj në një analizë për për zgjedhjen e pjesëmarrësve në FFK Gjirokastër dhe punës së mirë që u bë në këtë drejtim, dua të theksoj se në këtë festival, me të vërtetë Vlora tregoi perla të folklorit autentik, gërshetuar me elemente të folklorit të ri.

Në tematikën e këtij grupi u gërshetuan elemente të së kaluarës së largët me të renë që ia diktonin kushtet, ngjarjet që

ndodhën pas vitit 1985, me vdekjen e Enver Hoxhës, të cilit akoma vazhdonin t'i këndoheshin këngë, sikur të ishte gjallë. Pra, edhe në këtë festival nuk mund t'i shmangeshe dot politizimit, himnizimit të figurave qëndrore, pasuesve të Enver Hoxhës. I tillë ishte sistemi dhe patjetër duhet të thurje dithirambe, gjë që ndikonte edhe në vlerësimin nga ana e jurisë. Pra, mund të themi, se ishte një garë se kush e kush mund të

sillte krijimet më të mira për komandantin, si dhe për pasuesin. E tillë ishte kënga e kënduar nga grupi polifonik i Pilurit *“Koha është e guximtarëve”*

Por, pavarësisht nga këto që thamë, Vlora në këtë festival, tregoi edhe një herë se ka një folklor të pasur dhe të bukur.

Në repertorin e këtij grupi të Vlorës në këtë Festival, përveç të tjerave, u interpretuan këngë të tilla, si: “ Dimëro përtej në shpellë” kënduar nga grupi polifonik i Vezhdanishtit me marrës Kalo Bregu; “ O Selman ç'i bëre dhentë”, - një lirikë elegjiake, kënduar nga grupi i Dukatit; “ I dua malet e mia” – melodi me fyell nga Vendim Kapaj (Mjeshtër i Madh); “Ç'kanë djemtë që lanë fshanë”, - interpretuar nga grupi polifonik i fshatit Kuç; “ Legjenda e Tanës”, - si vazhdim i eksplorimit në thellësi të tabanit të popullit, interpretuar nga grupi i Lapardhasë, nën drejtimin e rapsodit Feti Brahim; “ Thëllëzë që shkel mbi vesë”, - një variant i ri i këngës himarjore, interpretuar nga marrësja Katina Beleri; “ Malet rrotull hedhin lule”, - këngë epike e interpretuar mjeshhtërisht nga grupi polifonik i Tragjasit.

Ndoshta për herë të parë në historinë e grupit të Vlorës, pjesëmarrës në Festalet Foklorike Kombëtare të Gjirokastrës, në repertorin e këtij grupi u fut edhe kënga qytetare vlonjate që në këtë festival u përfaqësua me këngën “ Unë të kisha trupin tënd”, - kënduar nga Mentor Veizi dhe Kozeta Shabani.

Më poshtë po paraqesim disa nga këngët që u prezantuan në këtë festival.

Grupi polifonik i qytetit

Ç'MË KËNDON SOT ZEMRA

Prej detit të kaltër,
nga e kuqja Vlorë,
vim', o Gjirokastër,
në çdo përvjetor.¹⁾

Lum ty kush të vjen,
kush po ngjit kalanë,
Partia, Enveri,
bilbilat me këngë.

Për ty, Gjirokastër,
flori më rrjedh kënga,
më shumë se buza,
ç'më këndon sot zemra.

1) Vargjet 5-8 përsëriten edhe në fund të këngës

Grupi polifonik i Pilurit

KOHA ËSHT' E GUXIMTARËVE

Shtizën e flamurit, penë mbaj në duar,
për jetën që dhanë djemtë, do të shkruaj,
do të shkruaj nëpër male, mbi dafina,
këngën e gjakut të derdhur nga ata trima,
shqipe ligjëro.

Nxirr nga zemra këngë, moj ti këngë kombi,
çohuni të rënë, se malli na mori,
mall' i zemrave;
gjall' i kemi ata trima
që shkelën mbi vetëtima.

Shqipëri, e mira nënë, zjarr e vesë,
syn' e bukur ta lan vesa çdo mëngjes,
shtatin ta skalit Partia vet' me dorë,
bukurin' Enver liria me dëshmorë,
shqipe lulëzo.

Plot diell lirie veshur Shqipëria,
si deti me valë ne na ka Partia,
lum ti, o Atdhe;

Shqipëri, mbi gush' e faqe,
çdo pik' gjaku manushaqe.

Mbi supe të amanetit ligjëron betimi,
këtij populli në jet' të gjat' s' merr mjegull syri,
djemt' e rën' të gjall' i kemi, të kemi Partinë,
koha është e guximtarëve, me Ramiz Alinë,
shqipe fluturo.

Rritu ideali ynë, rritu përmbi djep me fletë,
trimat vazhdojn' historinë, lule nëna, lule djemtë,
zemra ime Shqipëria, jo,moj, jo, guri s'të tundet,
nuk të plaket trimëria,flamur tjetër mbi ty s'ngulet.

Siç e do qiellin toka, do lirinë Shqipëria,

si do qiellin shqiponja, e do popullin Partia.

Ninull-kënduar nga Fatbardha Hosi –Bolenë

RRITU SE TË PRET MARTINA

Vaji-vaj, nina-nina,
djalin-o, nina-nina,
nina-nana, nina-nina,
rritu, djalë si hardhia,
vaji-vaj, djalin-o,
se kërkon zot shtëpia;
se yt at' për dy stërlina,
e vavis e vaj,
mbeti tej në shkretëtira.
Vaji-vaj, djalin-o,
nina-nina,
rritu se të pret martina,
t'i thuash armikut prina;⁽¹⁾
vaji-vaj, nina-nina,
djalinë e djalin-o,
nina-nina, nina-nina.

1) Pritna

Grupi polifonik i Treblovës

JO,MOR JO, SE BËJM' SHAKA

- Kam një grua teveqele,
shkon për bath' e sjell bizele,
kur merr fshesën për të fshirë,
tre sahat e çon avllinë.
- Pse kuvendon kështu, o lumë,
po ti je më keq se unë,
kur nisesh vete për dru,
do dy dit' t' më kthehesh t'hu.⁽¹⁾
- S'të vjen rënd' nga gjitonia,
Si mavri bërë shtëpia,
Kur shikon gjellën për kripë,
Katër lug' e një kafshitë.
- Rri rehat, more veqil,
se je burr' , s'je xerxebil,
se kemi një tuf' fëmijë,
jalla, mos ngjafshin në ty.
- Mos e ngjat, se s'ka lezet,
se dëgjon gjith' ky milet.
- I gjith' mileti ta marr vesh,
se më je bërë peshqesh.
Bëm' shaka sa deshëm vetë,
dhe kjo që tham' s'është e vërtetë,
të kam zot e më kë ke zonjë,
jeta jon' mjalti në gojë.

1) Të kthehesh prapë

Valle e kënduar nga grupi i burrave Gërrec Vlorë

RRAP' I LELE DEGATËNDË

Rrapi Lele¹⁾ degatëndë,
burra, Çelua bën kuvëndë;
na kërkon Harrizi²⁾ gjënë.
Ç'u hodhën trimat në këmbë.
Bilbil Kapetan Ormëni,
Ormën Dashi³⁾ një pëllëmbë,
nxorri koburen ergjëndë,
dhe ja ndezi dhëmb' për dhëmbë;
kudhësjetët kështu ta bëjnë.

- 1) Rrap i madh në fushë të Sevasterit, ku ka qenë vendi i mbledhjes në kuvend për burrat e Kudhësit.
- 2) Hariz Kanani, i ngarkuar nga ana e Ali Pashë Tepelenës për vjeljen e taksave në popull.
- 3) Fshatar i thjeshtë nga Sevasteri, që i revoltuar, qëllon i pari mbi Hariz Kananin.

Grupi i valleve i Gërncit shfaqet në këtë festival, duke sjellë një karakteristikë të veçantë nga vallet e tjera labe që ishim mësuar të shikonim. Një grup relativisht i ri në moshë, por me një interpretim dinjitoz.

Grupi i burrave të Dhërmiut Vlorë

TË KESH MALL PËR ATË DERË¹⁾

O Janullë, o leshprerë,
leshprer-o,
krisma-krisma an' e mbanë,
për shortin-o, për djalin-o;
të kesh mall për atë derë.

1) Ngjarje e vitit 1700. Është një fragment vajtimi i babait për të bijën, Janullën, të cilës iu vra burri dhe djali nga armiqtë. Mbasi mbetet e shkretë, sipas zakonit, kjo pret flokët dhe kthehet në derën e babës. Ky vajtim këndohet në formën e një ligjërimi tragjik, nga gratë e fshatit Dhërmi, kur në mëngjes herët bëhen varg dhe shkojnë në mal për të bërë dru. Herë pas here, në grupin e grave që ligjëronin, bashkohet në kor edhe ndonjë plak i panjeri, i cili shkonte edhe ai për dru.

Ndoshta nuk do të gjeja fjalë të përshkruaja emocionet për interpretimin e lartë artistik të kësaj boroitje, me marrës Koço Gjukurinë që mund të them pa frikë se ishte më i arriri për zërin e tij karakteristik dhe me një timbrik që do t'ia kishte zili çdo këngëtar tjetër popullor.

Sa herë që e dëgjon këtë këngë, të shpie larg, të kujton vajticat e dikurshme të Bregut të Detit, ku për një dhembje kaq të thellë gërshetohet zëri femëror me atë mashkullor, në një duet të papërsëritshëm, me anë të të cilit, vajtuesit, jo vetëm shprehim dhembjen e madhe, por shfrenjë dufin e brendshëm, duke u çliruar nga kjo gjëmë e madhe që i ka pllakosur. Sa herë që e dëgjon këtë këngë, të duket sikur zbulon ndonjë diçka të re.

Grupi i këngës qytetare të Vlorës

Këngëtarë:

- 1. Mirela Bakiu*
- 2. Kozeta Shabani*
- 3. Etleva Kalo*
- 4. Mentor Veizi*
- 5. Neptun Gjata*

Orkestrina:

- 1. Istref Dobi - fizarmonikë*
- 2. Sokol Toto - klarinetë*
- 3. Vladimiri Tahiri - kitarë*
- 4. Altin Llakaj - llahutë*
- 5. Shpëtim Sulejmani - dajre*

UN' TË KISHA TRUPIN TËND

Un' të kisha trupin tënd,
dija , moj si ta mbaja;
trupin prej teje,
fustanin prej meje.

Un' i ziu ç'më ka gjetur,
ç'u treta mbas teje,
eh, të kisha trupin tënd,
dija si ta mbaja.
Un' të kisha gushën tënde,
dija si ta mbaja;
gushën prej teje,
ruazat prej meje.
Un' i ziu ç'më ka gjetur,
ç'u treta mbas teje,
eh, të kisha gushën tënde,
dija si ta mbaja.
Un' të kisha fjalën tënde,
dija si ta mbaja;
fjalën prej teje,
besën-o prej meje.

Un' i ziu ç'më ka gjetur,
ç'u treta mbas teje;,
eh, të kisha fjalën tënde,
dija si ta mbaja.

Grupi i Vezhdanishtit

DIMËRO PËRTEJ NË SHPELLË

Marrës: Kalo Bregu

Dimëro përtej në shpellë,
moj leshverdh-o,¹⁾
në shpellë ke shtëpinë tënde,
ç'më lajkose me kuvende,
më preve në besën tënde.

1) Përsëritet pas çdo vargu

Edhe kjo këngë, interpretuar me mjeshtëri nga këngëtari me potencë Kalo Bregu, mund të quhet pa frikë një ndër kulmet e këtij festivali. Zëri kumbues i këngëtarit, i qartë, i kthjellët, i lexueshëm në çdo fjalë, bëri atë që vihet në vëmendjen e kompozitorëve tanë për një përpunim artistik të arrirë dhe plot dinjitet.

Grupi i Dukatit

O SELMAN Ç'I BËRE DHËNTË

O Selman, ç'i bëre dhëntë,
o Selman, e mane, mane zilja⁽¹⁾
Në Skalom²⁾ ç'i therë frënjtë,⁽³⁾
desht' e cjeptë me këmborë,
zgjedhur Selmani me dorë.
Qajnë të zonjat e stanit;
me lot' e me djersë të ballit.
Ligjëron nën' e Selmanit;
o ylli në mes të malit;
qëllon motra për vëllanë.

1)Përsëritet si refren pas çdo vargu

2)Vend në afërsi të Borshit (Sarandë)

3) Frengjtë , francezët

Kënga, sipas të dhënave të traditës gojore, ka marrë shkas nga zbarkimi i trupave franceze në vitin 1798 në Skalomë, që u thyen keq në sajë të trimërisë së mbrojtësve.

Është e tepërt të shkruash për vlerat që çoi Vlora në këtë festival, se ashtu siç kemi përmendur edhe më lart ishte e vështirë të dalloje, se cila është më e arrira. Vlora ishte e gjithë e tillë.

Grupi i Kuçit Vlorë

Ç'KANË DJEMT' QË LANË FSHANË

Ç'kanë djemt' që lanë fshanë,
lanë nënën dhe babanë,
për të zënë kasabanë,
ca në Vlor', ca në Tiranë;
gullu – gullu gollovarë.¹⁾
Venë djemtë gollovarë,
i bëjn' punët me kandar,
atje del qar e mbi qar,
gjetën nuse në pazar.
Kthyen jetën allasoj,
dhëndërrri të nusërojë
dhe vjerrës që do gjej' brënda,
le t'i thotë hanko nëna.
Ti njëzet, nusja tridhjetë,
thatanike, plot me huqe,
mja²⁾ të ket' dy e guzhinë,
lavatriçe dhe kolltuqe.
Shihni na³⁾ me nur e dritë,
një si yll e një si hënë,
bulevardi i zu sytë,
s'ka si vajz' e fshatit tënë;
lum e det , o gollovar.

1)Përsëritet pas çdo katër vargjesh

2)mjaft, mjafton

3)shihni ne

Kjo këngë për kohën që doli në skenë për herë të parë bëri jehonë për vetë kushtet në të cilat jetonim, sepse ishte me të vërtetë reale, mbasi të gjithë muarrën arratinë për të ikur nga fshati e për të zënë qytetin, apo dhe kryeqytetin.

Grupi i Lapardhasë Vlorë

LEGJENDA E TANËS

Dola përjashta në shkallë,
o çoban, more çoban,
çdo avaz binte një fjalë,
o çoban, more çoban:
Zgjuaj nënën dhe babanë,
Tan' , moj, e zeza Tanë,
se dhënt' i muarr dhe vanë
Tan' , moj, e zeza Tanë,
dhe mua lidhur më kanë,
Tan' , moj, e zeza Tanë,
korbecin në shtrung' e vranë,
Tan' , moj, e zeza Tanë,
erdhën hajdutët në stan,
Tan' , moj, e zeza Tanë,
u nisën me kuaj revan.
O çoban, more çoban,
Vetë babai me kalë,
o çoban, more çoban,
e kaluan millonanë,¹⁾
o çoban, more çoban.
Mos u merakos, moj Tanë,

Tan' , moj, e zeza Tanë,

un' mir' dhe shëndoshë jam,
Tan' , moj, e zeza Tanë,
hajdutët i zum' të gjallë,
Tan' , moj, e mjera Tanë,
Tanë, moj, e mira, Tanë.

1)mullixhi

Shënim: Dihet se kjo këngë e kënduar në këtë festival nga grupi i njohur i Lapardhasë Vlorë, bën pjesë në ato këngë tipike baritore. Kjo legjendë, ose baladë është e njohur në shumë treva shqiptare, pra mund të themi me plot gojë që është mbarëkombëtare. Pa dashur të flas për subjektin e saj, se është i kuptueshëm nga fjalët e këngës, por ajo që dua të theksoj është se fundi i kësaj balade, në të gjitha variantet e gjetura deri tani është triumfues, thënë ndryshe, ka një fund të gëzueshëm, sepse kusarët, të cilët kanë marrë bagëtinë:” hajdutët i zum' të gjallë”. Duke qenë baritore, shoqërohet edhe me instrumentin e fyellit, karakteristikë e kësaj gjinie të folklorit tonë. Prof.Qemal Haxhihasani, i cili ka një punim të gjatë për këtë baladë, në librin “Balada shqiptare”, në përdorimin e fyellit gjatë kullotjes së bagëtive, midis të tjerave shprehet: “ për t’i qetësuar e për të patur mbarësi”. Dhe kjo këngë, në këtë festival erdhi në shoqërimin e fyejve.

Grupi i Himarës Vlorë

THËLLËZË QË SHKELL MBI VESË (Marrëse:Katina Beleri)

Thëllëzë që shkel mbi vesë,
lere, lere, aman, aman,¹⁾
më erdhe larë me djersë.

Me buzën lule behari,
sa të pa deti me valë,
tha:”Sikur të isha djalë,
nuk të lija pa të marrë.”

1)Përsëritet pas çdo vargu

Nuk e teproj, që sa herë e shoh atë në skenë, ose dëgjoj këngët e kënduara prej saj, shpreh vlerësimin tim personal, duke përsëritur e thënë shpesh herë, se është me të vërtetë një zë i veçantë, për të cilën kemi konsumuar të gjitha epitetet e duhura për këtë këngëtare, pasuese e denjë e Artistit të Merituar, Dhimitër Varfi, si pasuese fisnore e themeluesit të këngës himarjote, Neço Mukës dhe Koço Çakalli. Me një metaforë të goditur dhe të arrirë stilistikisht, zbulon bukurinë e vajzës bregase, të cilën e krahason me thëllëzën, shpend i atyre anëve që shquhet, si për bukurinë karakteristike, ashtu edhe për zërin e bukur e melodioz.

Nuk e teproj, kur them, se kjo këngë është bërë një nga këngët më të dashura për publikun dhe që kërkohet e këndohet në raste gëzimesh familjare.

Grupi i Tragjasit Vlorë

MALET RROTULL HEDHIN LULE *(Marrës: Aranit Daupi dhe Tartar Avduli)*

Si shqiponj' që zbret nga mali,
majë këngës ndezur zjarr,
shkon e shkrep mbi gur stërralli,
sot po vjen në festival.
Dilni shihni, shihni, more shihni,
ja, tek vjen,
Enver Hoxhë komandanti,

ylli që shkëlqen,
ja, tek është në Gjobek,
si gjithmonë.
Festebardhë përbi vetull,
shpatit ku Argjirua ra,
krahëhapur, buzëqeshur,
ja, ku ngjitet në kala.
Dilni shihni, shihni, more shihni,
ja, tek vjen,
Enver Hoxhë komandanti,
ylli që shkëlqen.
Komisari sypafjetur,
në zemër të kombit qepur,
kalldrëmin ka marr' përpjetë;
rrahin lodrat dhe daullet,
me mall e puthin anetë,
malet rrotull hedhin lule.
Dilni shihni, shihni, more shihni,
ja, tek vjen,
Enver Hoxhë komandanti,
ylli që shkëlqen.

Dilni shihni, shihni, more shihni,
ja, tek vjen,
komandanti tërë nur,
shpalos dorën si flamur.

Pavarësisht se fjalët e tekstit i janë kushtuar ish-udhëheqësit, tashma i vdekur, ajo që të tërheq dhe që të bën të mendosh në këtë këngë, është varianti me dy marrësa, siç janë Aranit Daupi dhe Tartar Avduli, i cili futet në refren, duke e ngritur këngën në një pedestal më të lartë, duke i dhënë larmi dhe një muzikalitet të arrirë interpretativ.

Nëse më lart kemi thënë se rapsodët, apo poetët rendnin kush e kush të thurte vargje më të bukura për udhëheqësin, kjo është një dëshmi e atyre që kemi përmendur. Mund të themi se poetët kanë zbratur të gjithë arsenalin e tyre artistik, stilistikor dhe mjeshtëror. Një gjë të tillë mund ta gdhendnin pena të larta, si ajo e mjeshtrit Hamdi Pulo.

FFK BERAT 1995 ***(Festivali i gjashtë)***

Festivali Folklorik Kombëtar i vitit 1995, mund të quhet festivali i parë pas rrëzimit të diktaturës komuniste që u zhvillua në qytetin muze të Beratit në muajin shtator. Ideja e organizimit të këtij festivali në këtë qytet ishte për të thyer monotoninë e organizimit të festivaleve të mëparshme në të njëjtin vend, në të njëjtën kala, siç u tha të paktën, me mendimin që edhe festivalet pasardhëse do të zhvilloheshin në ato qytete ku kishte kala. Por mbeti i vetmi festival që u zhvillua në qytetin e Beratit, sepse më vonë iu rikthyen traditës në kalanë e Gjirokastrës. Idea e hedhur nga Ministri i atëhershëm i Kulturës, zoti Teodor Laço, për një gjë të tillë ngjalli jo pak polemika në qarqet folkloristike dhe akademike. Kalaja e Gjirokastrës kishte krijuar, tanimë, fizioninë e vet dhe pavarësisht nga politizimi, njerëzit këngën e donin në këtë kala dhe jo në tjetër.

Ndonëse, duhet thënë se Kalaja e Beratit dhe vet ky qytet mijëravjeçar, e përballoi me sukses të plotë, si në performancën artistike ashtu dhe në drejtim të mikpritjes e akomodimit.

Puna për organizimin e këtij festivali, nisi si zakonisht herët duke kaluar në disa etapa dhe faza përgatitore, por kishte edhe probleme, sepse shumë këngëtarë të grupeve të dëgjua kishin emigruar, disa të tjerë ishin grumbulluar me shoqata të ndryshme kulturore, gjë që nuk e lejonte pjesëmarrjen e tyre me këto shoqata në këtë festival, sipas udhëzimeve të saj kohe nga MKRS. Kështu që lindën vërshtirësi, sepse drejtuesit e shoqatave,

këta këngëtarë i kishin bërë si pronë të tyre. Na duhet të kujtojmë se në këtë kohë, thuajse, të gjitha firmat piramidale që shtrinin veprimtarinë në qytetin e Vlorës kishin ngritur edhe grupet e veta të polifonisë. Megjithëkëtë, Vlora grumbulloi rreth vetes dhe çoi në këtë festival vlera të çmuara të folklorit autentik

e burimor. U zbuluan këngëtarë të rinj, po aq të lartë artistikisht dhe interpretativ, sa dhe paraardhësit e tyre.

Në këtë festival, Vlora, me të vërtetë, shpalosi jetëgjatësinë e folklorit duke vulosur se ai nuk është pronë vetëm e disa individëve, apo grupeve të dëgjua, por e popullit që e mbart, e ushqen, e rrit dhe e transmeton po aq bukur nga njëri brez në tjetrin.

Përveç tematikës dhe teksteve që tanimë ishin të zhveshura politikisht, u vu re një shpengim, një lirshmëri interpretative dhe shumëllojshmëri variantesh e prurjesh të reja në zhanre të ndryshme folklorike, megjithëse nuk më vjen aspak mirë të theksoj se gjatë rrugës për përgatitjen e grupit të Vlorës për këtë festival, pati pengesa nga më të ndryshme nga individë të ndryshëm për arsye xhelozie të mospërfshirjes së tyre në stafin organizator, gjë që u vu re edhe gjatë zhvillimit të ditëve të festivalit, sa që ndikuan në juri, falë njohjes së tyre, edhe për mosvlerësimin e këtij grupi që meritonte shumë e më shumë. Nuk mund ta lë pa përmendur këtë fakt, sado i hidhur që të jetë për këdo. Megjithë këto, pa hyrë në komente të tilla, themi me plot gojë se arti dhe kultura nuk është pronë private, monopol, e askujt dhe Vlora ka dhe do të ketë njerëz, specialistë të folklorit që punojnë me përkushtim e devotshmëri për të ecur përpara në fushën e artit dhe të kulturës së saj shpirtërore.

Kur i dëgjon këto këngë pas një kohe relativisht të gjatë, prej afro 15 vitesh, të ngjallin po atë emocion, kur u interpretuan për herë të parë, të duket ende sikur të ndjek pas jehona e atyre ditëve, përjeton ato çaste e momente të gëzuara dhe ndoshta euforike të një interpretimi virtuoz të atyre këngëtarëve e grupeve

pjesëmarrës në këtë festival, përjeton atë skenë e ata shikues që kishin mbushur kalanë e Beratit, si asnjëherë tjetër e që gjëmonte nga kjo polifoni e mrekullueshme labe e krahinës së Vlorës. Edhe sot që shkruaj këto radhë e kam të vështirë të përzgjedh, se cila nga këto prurje është më e mira, më e arrira

artistikisht dhe interpretative, sepse ato ishin të gjitha si një ansambël i papërsëritshëm. Që nga kënga e parë e deri tek e fundit, secila prej tyre, ka bukurinë e vet, ka fjalën e artë të poetit popullor, stilistikën e përdorur në mënyrë më të përkryer që rrjedh vetvetiu, pa e kërkuar, interpretimin brilant të këngëtarëve të vjetër dhe e atyre të rinj që deputuan për herë të parë. Mbresëlënëse ishin të gjitha këngët, por nuk mund të lësh pa përmendur këngën e grupit të Lapardhasë, Vlorë, të titulluar “*Moj bonjakja, pa mama*”, nën interpretimin mahnitës të Fatbardha Brahimit dhe grupit, apo zërin bilbil, karakteristik, të veçantë dhe të papërsëritshëm të këngëtarit nga Smokthina Hysen Ruka në këngën “*Doli zonja në bedenë*”, apo timbrikën e shkëlqyer të këngëtarit virtuoz të grupit të Vezhdanishtit Kalo Bregu, në interpretimin e këngës “*Lado, moj për kokën tënde*”, e cila shquhet për një figuracion të pasur artistik popullor, kur thotë:

“Kur të pash’, mua më shtënge,
Lado, moj për kokën tënde,
ata flokë degëtënde,
o me syrin e zi më hëngre,
ngjyrë gruri kuqërrëme,...”, etj.

Të shkruash për festivalin folklorik kombëtar të vitit 1995, nuk mund të lësh pa përmendur grupin e Pilurit, shkrirë në penën e artë të Lefter Çipës dhe zërit melodioz, të ëmbël, vital të këngëtares Ermioni Mërkuri. Sa herë që dëgjon këngën “*Amanetet zgjojnë trimat*”, këngë që hyn në folklorin e ri, nuk mund të mbetesh pa u emocionuar, sepse në këtë këngë janë

harmonizuar në mënyrë të pandashme të gjitha elementet artistike, si të vargut, ashtu dhe të kënduarit e interpretimit. Nuk mund të ketë vargje më të bukura, vargje lapidarë, siç di të ndërtojë i madhi Lefter Çipa, kur thotë:

“Se jemi të etur,
merak na ka mbetur,
me buzë të qeshur,
të mbyllet ky shekull”.

ose:

“...prapa e lamë natën,
ditën vetë e hapëm...”.

apo në mbyllje të këngës, kur shprehet:

“...Do ta shkruaj historinë,
sikur sa bota të rrojë”,

vargje metaforike, të cilat hyjnë vetvetiu në fondin e artë të poezisë, pa koment e analizë, pa zberthim për të nxjerrë vlerat, sepse vet poezia është vlerë e mbi vlerë. Ndoshta, i rrëmbyer nga një emocion i papërshekrueshëm, sa herë që dëgjoj këtë këngë, më detyron ta tejkaloj sensin, por mendoj se nuk e kam tepruar, por se e meriton dhe ndoshta më shumë. Lefter Çipa në këtë rast tregoi se mbetet poet i papërsëritshëm i vargut polifonik dhe një bardës i këngës së Bregut. Vargu i tij nuk ishte i lidhur thjesht me kalatë, por me popullin dhe vendin e tij.

Një vlerë tjetër që mendoj se duhet theksuar në këtë festival, padyshim është dhe kënga “*Një thëllëzë e shkruar prilli*”, kënduar nga grupi i Himarës me marrëse këngëtaren e mirënjohur Katina Beleri.

Ndoshta teksti i kësaj kënge krijoi alibi dhe hapi polemika në shtypin e shkruar të asaj kohe, jo se kishte ndonjë aludim, siç mendonin artikullshkruesit e paformuar profesionalisht, adoleshentë, por siç duket, duke qenë vet nostalgjikë për regjimin

e kaluar, kërkonin ta evokonin. Më vjen sinqerisht keq që shkruaj në këtë mënyrë, por edhe në atë kohë e kundërshtova, duke ua zbërthyer në mënyrë artistike kuptimin e atyre vargjeve të këngës dhe shumë vonë e mësova edhe vet që kisha të drejtë, se vet autori, këtë këngë e kishte shkruar për një njeriun e tij të afërt që kishte vdekur në prill të atij viti që u mbajt festivali, por në shtypin e shkruar të atij viti, u shkruan edhe disa shkrime të tjera të pavërteta, shtyrë nga persona, të cilët e mbivlerësonin veten, duke mos i besuar stafit që përgatiti grupin e Vlorës për këtë festival.

Por le t'i kthehemi këngëve të këtij festivali.

Interesante ishte prurja e re në këtë festival nga grupi i Selenicës që deputonin për herë të parë. Ata sollën, me të vërtetë një këngë që befasuan, jo vetëm shikuesit e shumtë, por edhe studiuesit që ishin të pranishëm në këtë eveniment. Kënga e tyre “Ç’bela kanë këta zogjtë” ishte me të vërtetë një risi e këtij grupi, një këngë lirike shumë e goditur artistikisht dhe me një nivel të lartë interpretativ që tërhoqi me të vërtetë vëmendjen e shikuesve në skenë. Ishte një simfoni e mirëorkestruar.

Vlejnë gjithashtu të përmenden edhe këngët “*Aman millona*”, kënduar nga grupi polifonik i Bolenës, monofonia “*Qani, moj çobanka, qani*” kënduar me shpirt e patos dhe një përjetim origjinal nga këngëtarja Bukurie Selimi, nga Tragjasi, përgatitur nga Arqile Alimerko, këtë njeri pasionant e të kudo-gjendur për këngën polifonike. “*Këngë për Hamit Vashkon*”, kënduar me dinjitet nga grupi i Gumenicës, i cili deputonte për herë të parë në festivale folklorike kombëtare, kënga humoristke e grupit polifonik të njohur për këto lloj këngësh, i Treblovës, etj.

Grupi i Vlorës në Festivalin Folklorik Kombëtar të vitit 1995 u paraqit me këto repertor:

1. Monofoni: “Më mbenë sytë nga deti” – interpretuar nga Jolanda Habili, - Bolenë

- 2.Këngë:"Moj bonjakia pa mama"- kënduar nga grupi polifonik i Lapardhasë
- 3.Këngë:"Doli zonja në bedenë" – kënduar nga grupi polifonik i Smokthinës
- 4.Këngë:"Lado,moj për kokën tënde" – kënduar nga grupi polifonik i Vezhdanishtit
- 5.Këngë:"Dialog babë e bir"
- 6.Monofoni:"Qani,moj çobanka,qani" – interpretuar nga Bukurie Selimi - Tragjas
- 7.Këngë:"Ra një lot e lagu synë" – kënduar nga grupi i Pilurit
- 8.Këngë humoristike – kënduar nga grupi polifonik i Treblovës
- 9.Këngë:"Një thëllëz' e shkruar prilli" – kënduar nga grupi polifonik i Himarës
- 10.Këngë për Hamit Vashkon – kënduar nga grupi polifonik i Gumenicës
- 12.Këngë:Ç' bela kanë këta zogjtë" – kënduar nga grupi i të rinjve Selenicë Vlorë
- 13.Këngë:"Aman millona" – kënduar nga grupi polifonik i Bolenës
- 14.Këngë:"Amanetet zgjojnë trimat" – kënduar nga grupi polifonik i Pilurit
- 15.Këngë:"Më muarr malli,më muarr" – kënduar nga grupi polifonik i Tragjasit
- 16.Monofoni:"Në det duall dy sorevë" – interpretuar nga Jolanda Habili

Ja disa nga tekstet e këngëve që u interpretuan në këtë festival:

Grupi polifonik i Lapardhasë Vlorë

MOJ BONJAKIA PA MAMA
(Marrëse Fatbardha Brahimi)

Moj bonjakia pa mama,
moj Eleni,¹⁾
të vdiq jot ëmë e të la,
zëmra dhe shpirti t'u tha,
s'pate fat për një vëlla,
Eleni një ditë s'u pa,
u hodh nga shkëmbi dhe ra,
si një tuf me manxura.

1) Përsëritet pas çdo vargu

Grupi polifonik i Vezhdanishtit Vlorë

Marrës: Kalo Bregu

LADO, MOJ PËR KOKËN TËNDE

Kur të pash', mua më shtënge,¹⁾
Lado, moj për kokën tënde,²⁾
ata flokë degëtënde,
o me syrin e zi më hëngre,
ngjyrë gruri kuqërrëme,
moj kuatë ball' i dhëne,³⁾
ç'kërrab' do të zër' për këmbe.

1) më shtange, më le në vend

2) përsëritet si refren pas çdo vargu

3) i dhënve(dhanore)

Grupi polifonik i Selenicës

Ç'BELA KANË KËTA ZOGJTË

Ç'bela kanë zogjtë,
që s'më lënë të flerë,

vërtiten gjithë ditën,
po ndërtojnë folenë,
cërr-cërr,
cicërojnë nëpër pemë.¹⁾

Do marr çiften do qëllojë,
do u prish folenë,
mos më zgjojnë thëllëzën,
që ka rënë të flerë,
cërr-cërr,
cicërojnë nëpër pemë.
Ç'të kanë bërë të shkretët zogjë,
që u prish folenë,
këputën një trëndelinë
që t'i marrte erë,

cërr-cërr,
cicërojnë nëpër pemë.

Hodha dorën dhe këputa
një lule të verdhë,
ato ishin flok't e tua
që ndiçuan dhenë.
cërr-cërr,
cicërojnë nëpër pemë.

1) Çdo strofë me gjithë refren përsëritet dy herë.

Grupi polifonik i Himarës

NJË THËLLËZ' E SHKRUAR PRILLI

Një thëllëz' e shkruar prilli,
obobo sytë m'i mbylli,

obobo ç'i mbylli sytë,
na la shtëpinë dritë,
drita m'u shua,
u errësua,
u errësua,
jeta për mua.

Një thëllëz' e shkruar prilli,
obobo sytë ç'i mbylli,
obobo më mbylli këngën,
i ziu ma thau zemrën,
zemrën ma thau,
më dysh ma ndau,
më dysh ma ndau,
shpirtin ma vrau.

Një thëllëz' e shkruar prilli,
obobo jetën ç'e mbylli,
obobo ç'e mbylli jetën,
vdekja ma mori të shkretën,
të shkretën grua,
ma mori mua,
ma mori mua,
lumë e përrua.

Shënim: Stanca e parë përsëritet edhe një herë në fund.

NË DET DUALL DY SOREVË ¹⁾

(Monofoni interpretuar nga Jolanda Habili – Bolenë)

Në det duall dy sorevë,
po vinë me shpejtësi,

kushedi ç'haber do kenë,
ç'haber do të vijë.
Isuf Bushin vrarë e gjenë,
në Korfuz, në një pusi,
kartë e zezë për në Bolenë,
sjell një lajm të zi.
Në shkallë doli e kunata,
qan me lot në sy,
jo, mor, jo, s'besohet karta,
s'i beson njeri,
sa të vijnë armët e arta,
armët larë flori.
Armët e arta i erdhë,
i erdhën ato stoli,
pisqollë, jatagan mbështjellë,
larë me gjak të tij.

1)Kjo baladë i kushtohet Isuf Bushit, luftëtar i shquar nga fshati Bolenë, i cili u vra në Korfuz(Greqi), ku kishte shkuar në krye të luftëtarëve të Lumit të Vlorës, në ndihmë të revolucionit grek të vitit 1923. Kjo baladë është përpunuar nga rapsodi Nertesi Asllani.

Grupi polifonik i Bolenës

BLUAJ, MILLONA

Dielli perëndoi,
qielli ç'u nxi,
bluaj, millona,
aman, mullixhi.

Jashtë dimri gjëmon,

borë edhe stuhi,
aman, millona,
bluaj, mullixhi.

Bluaj, millona,
se kam pesë fëmijë,
aman, millona,
bluaj, mullixhi.

Bluaj, millona,
në kë perëndi,
aman, millona,
zoti Pandeli.

QANI, MOJ ÇOBANKA, QANI

(Monofoni-interpretuar nga Bukurie Selimi - Tragjas)

Ë....ë....ë.....ë.....ë... .

Qani, moj çobanka, qani,
burrat i mori nizami,
ikën e nuk vij në më,
mbenë andeja përgjithnjë.

Ë....ë....ë.....ë.....ë... .

Atë ditë kur u nis në,
nëna, motra po thërris në,
me vaj e me ulërimë.
Qani, moj çobanka qani,
për burrat zotë vatani.

Ë....ë....ë.....ë.....ë... .

Qajnë të zonjat e stanit,
me lot' e me djersë ballit,
qani, moj çobanka, qani,
për burrat zotë vatani.
Oho....., oho...., oho...., ohoooo.

Në Jemen kur zbrinë ¹⁾,
të rrethuar me zabinë,
i lefterosni ²⁾një çikë,
të shikojnë Shqipërinë.
Qani, moj çobanka, qani,
burrat i mori nizami,
qani, moj çobanka, qani,
se s'vijjnë më nga nizami.

Hëëë...., hëëë...., hëëë...., ëëë...

1)trajtë dialektore e foljes “zbritën”

2) na lironi

Shënim: Interpretimi i kësaj monofonie, ose logatje është bërë duke patur një furkë leshi në dorë, duke tjerrur.

Grupi polifonik i Pilurit

DUA VAJZËRINË

Marrëse: Ermioni Mërkuri

Ra një lot e lagu synë,
syrin-o, zemëra ime,
ishte lot për vajzërinë,
tretur si lulja nën hije.

Vërtet isha lule,

isha hëna vetë,
sytë e mi kobure,
qëllonin mbi djemtë.

Si era e prillit,
çelja trëndelinë,
në kafaz të gjirit
zgjoja dashurinë.

Vjen një zog në fluturim,
zogu im i vajzërisë,
lermë, o zog në ëndërrim,
se jam zanë e bukurisë.

Dua të jem zanë,
borë e pashkelur,
të dal nëpër natë
duke loz' e qeshur.

Të më pritet rruga,
të fluturojë syri,
të më puthet buza,
të më ndizet gjiri.

Vjen një botë, një psherëtimë,
nëpër natë zëmëra ime
dhe me mall e përgjërim,
dal e pres, pres në kujtime.

Grupi polifonik i Tragjasit

MË MUARR MALLI, MË MUARR

Marrës: Shkëlqim Stepa
Kthyes: Novruz Gjoni
Hedhës: Engjëllush Polo

Më muarr malli, më muarr,
për Sirotic' e Izvuar,
për të dy rrepet në krua,
xhami, mezi të paguam,
plakat me furkë në duar,
shikoj malin përkundruall,
e lëron Duda me pluar.

Grupi polifonik i Treblovës

Përgjegjës grupi: Pelivan Bajrami

Grupi përbëhet:

Fiqrete Islami

Alem Islami

Bexhet Mahmuti

Simon Simoni

Servet Kojdheli

Qemal Zotaj

Bledar Mahmuti

Ajet Sadiku

KËNGË HUMORISTIKE

-Ç'më ka gjet derën i ziu,
që nuk gjej tjetër gjetiu,
-mos e gjënje shoqërinë,
se un' po ta mbaj shtëpinë.

-S'je e zonja për shtëpi,
për dybek e kullandri,
-ç'të kullandrisë, u shofsh,
dybeku çarë nga poshtë.

-Sot që kemi bagëtinë,
t'u hap dybeku në brinjë,
-jam sëmurë, a derëzi,
therrmë një keq të kërthinjë.

-Mendjen e ke tek bixhaku,
po mua më zuri gjaku,
-s'të kam thënë kot, o lumë,
që ti je më keq nga unë.

-Ik, moj plakë, mo shengjërake,
se ma njih këtë radake,
-e qysh u plake e nuk nxure,
tërë jetën mendjen kobure.

-Plakë, të hëngërt një tënjë,
kaluam jetën në gërnjë,
-e po neve na njih dynjaja,
që na ka lezet shakaja.

Grupi polifonik i Treblovës është një grup karakteristik që lëvron, pothuaj këngën polifonike humoristike. Është pjesëmarrës në disa festivale me këtë zhanër, ashtu siç erdhi në këtë festival. Kënga është trajtuar në formën e një dialogu midis plakut dhe plakës, të cilët nuk e ndajnë shakanë. Nëpërmjet kësaj shakaje nxjerrin “të palarat” e njeri-tjetrit. Kënga rrjedh vetvetiu me një humor karakteristik dhe ngjarjeve reale të fshatit ku jeton ky grup, me një fjalor të thjeshtë, por të ngritur artistikisht nga rapsodi i njohur Pelivan Bajrami, thuajse i binjakëzuar me grupin e këtij fshati.

FFK GJIROKASTËR 2000

(Festivali i shtatë)

Në vitin 2000 skena e festivalit spostohet përsëri në kalanë e Gjirokastrës. Ishte një këmbëngulje e kryetarit të Bashkisë, të asaj kohe, zoti Ylli Asllani. Ai këmbëngul dhe sqaron, pse festivali të bëhet në Gjirokastrë, duke dhënë edhe argumentet për këtë problem. Ai thotë se zyra e kulturës në Bashki e ka të gatshme procedurën e festivalit dhe thotë se Gjirokastra, ballafaquar me rrethet e tjera, ka një sërë avantazhesh: ka traditat historike, kulturore dhe arkitektonike më të spikatura.” *I paarritshëm,- pohon ai,- është konfiguracioni i qytetit dhe kështjellës*”. Duke folur për sponsorizimin nga ana e biznesmenëve, ai shton:”*Që tani biznesmenët dhe tregtarët kanë rënë dakord të mbliidhen në një takim nën drejtimin tim që të diskutojnë mundësinë e dhënies së parave lidhur me shpenzimet*. Duke folur për kalanë, ai shprehet:”*Asnjë kala në Shqipëri, asnjë mjedis nuk u ofron festivalistëve dhe publikut avantazhe të tilla, siç është amfiteatri i gatshëm, sheshi madhështor i kalasë, deri edhe kulla e regjistrimit për valët televizive, veç dekorit natyror*”.

Duhet thënë, se në këtë periudhë MKRS nëpërmjet një qarkore hapi një konkurs për zhvillimin e këtij Festivali në ato qytete që kishin kala. Kështu që edhe Vlora ishte pjesëmarrëse në këtë konkurs nëpërmjet një dokumentari të përgatitur me kamera të Luan Nanaj dhe tekst të Kozma Billës.

Ky konkurs nuk u muarr edhe shumë në konsideratë, kështu u vendos që festivali të zhvillohej në kalanë e Gjirokastrës, kësaj radhe me një dekor ndryshe nga vitet e kaluara dhe një sistem organizimi tjetër. Duke iu shmangur traditës së organizimit të festivaleve të mëparshme, ky festival pati një organizim tjetër.

Grupet nuk paraqiten sipas ndarjes së tyre administrative, por në bazë Prefekturë, ku Vlorës i shtohen edhe qytetet e Sarandës dhe Delvinës me rrethinat e tyre. Po i njëjti minutazh dhe i njëjti numër njerëzish, gjë për mendimin tonë, lë mangut përfshirjen e të gjitha vlerave folklorike të një treve të caktuar, aq më tepër për polifoninë labe. E përmendim

këtë fakt, sepse, nuk mund të paraqiten vlerat etnokulturore dhe etnomuzikore të një prefekturë me këtë numër të kufizuar njerëzish. Kjo ka arsytet e veta. Ka shumë për të diskutuar në këtë drejtim, por parësorja dhe kryesorja është, se nuk mund të ndërtohet një grup miks, me një numër të kufizuar njerëzish për të përfaqësuar një larmi të gjerë, siç është polifonia labe, ku grupi i Vlorës bën pjesë dhe mbetet kryesori në këtë zhanër muzikor. Çdo grup ka të veçantën e vet dhe karakteristikat e tij të veçanta dhe si rrjedhojë duhet të ketë mbështetësit e vet. Këtu bëhet fjalë, jo vetëm për marrësin, kthyesin dhe hedhësin, apo pritësin në disa grupe, por edhe për ison e vet. Nuk mund ta realizojë ison e një grupi, një grup tjetër, kjo, nëse kërkohen vlera autentike kulturore dhe folklorike. Një gjë e tillë mund të bëhet vetëm me një sforcim jashtë mundësive të një grupi të mirëfilltë dhe të organizuar mirë, nga ana etnokulturore. Kjo është një trokitje për organizatorët e festivaleve të tilla me përmasa kaq të mëdha, siç është Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës.

Megjithatë, me të vërtetë, u shpalosën vlera. Tematika ishte e larmishme dhe gjithëpërfshirëse. Ajo që të bie në sy në grupin e Prefekturës së Vlorës është se në tematikën e tij një vend të rëndësishëm zinin legjendat, këngët epike dhe historike, kënga humoristike, lirika, monofonia, interpretuar me mjeshtëri nga këngëtari i njohur i Sarandës Petrit Metushi, laureuar dhe dekoruar me urdhëra e medalje të ndryshme, sazet e Delvinës, etj. Gjithsej, grupi i Prefekturës së Vlorës, në këtë festival, u paraqit me 18 materiale, të cilat u përzgjedhën pas atij vërshimi të furishëm në takimet zonale e ndërzonale, sa që ishte shumë e vështirë që ta bëje një përzgjedhje të tillë. Në se Vlora çoi në

Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës një sasi vlerash të spikatura, në Vlorë mbetën po aq vlera të tjera.

Për organizimin dhe përgatitjen e Grupit të Prefekturës të Vlorës, në Prefekturë u ngrit edhe grupi, i cili do të drejtonte të gjitha punët deri sa të krijohet stafi organizator, i cili do të ndiqte gjithë ecurinë e grupeve deri në pjesëmarrje në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës.

Komisioni i ngritur për drejtimin e Festivalit Folklorik Kombëtar, Prefektura Vlorë:

- 1.Arqile Lici – Sekretar i Përgjithshëm i Prefekturës Vlorë
- 2.Medin Xhelili – Kryetari i Këshillit të rrethit Vlorë
- 3.Thoma Papagjika – Kryetar i Këshillit të rrethit Sarandë
- 4.Ismail Muço – Kryetar i Këshillit Delvinë
- 5.Kozma Billa – Drejtor i Qendrës Kulturore Vlorë
- 6.Zamir Brinja – Përgjegjës i Kulturës Bashkia Sarandë
- 7.Guri Gjeçi – Përgjegjës i Pallatit të Kulturës “Labëria” Vlorë
- 8.Bexhet Shenaj – Drejtor i Estradës Sarandë
- 9.Hasan Alizoti – Drejtor i Qendrës Kulturore Sarandë
- 10.Namik Xhaferi – muzikant Sarandë
- 11.Lefter Çipa – poet popullor – Himarë
- 12.Muhamet Tartari – poet popullor – Vranisht
- 13.Vahit Kuçaj – Qendra Kulturore e Fëmijëve Vlorë
- 14.Agron Jakupi – Skenograf-Teatri “Petro Marko” Vlorë
- 15.Bardhosh Gaçe – Dr.i shkencave folklorike Vlorë

Nga ky komision i përbërë prej 15 vetash u zgjodh edhe kryesia e përbërë prej tre vetash:

- 1.Kozma Billa – Kryetar
- 2.Zamir Brinja – zv/kryetar
- 3.Guri Gjeçi – sekretar

Shënim: U vendos që të gjitha vendimet do të merren me konsensus, në rast të kundërt, ato do të merren me shumicë votash.

Përbërja e stafit drejtues:

- 1.Kozma Billa – drejtor organizator
- 2.Guri Haskaj – koordinator
- 3.Guri Gjeçi – koreograf – regjisor
- 4.Llambro Hysi – tekstolog – folklorik
- 5.Perlat Kulla – etnograf
- 7.Vahit Kuçaj – Udhëheqës artistik

Në këtë festival u angazhuan edhe rapsodët:

Pelivan Bajrami

Namik Jahaj

Meleq Kapllani

Hiqmet Mehmetaj

Feti Brahimi

Nexhip Sera

Nertesë Asllani

Muhamet Tartari

Përgatitja për të arritur në fazën përzgjedhëse finale, kaloi nëpër disa faza. Kështu në fazën e parë që u organizua më 26 korrik 2000, nga rrethinat e Vlorës u paraqitën rreth 21 grupe, si psh: grupi i Tërbaçit, ai i Kuçit, Himarës, sazet popullore të qytetit, grupi i Dukatit, i Gumenicës, grupi i vajzave të Bolenës, grupi i Vezhdanishtit, Tragjasit, Treblovës, Selenicës, Jehona labe, grupi i Armenit, i Kaninës, i Kropishtit, grupi i Smokthinës, grupi i Mazharit, etj.

Sipas kriterëve të përcaktuara më parë, këto grupe u paraqitën me nga pesë materiale, pra mbi 100 këngë e materiale të tjera muzikore me mbi 180 artistë të trevave të ndryshme.

Kjo fazë, e cila u ndoq me shumë përparësi nga grupi selektor i ngritur enkas, e pati shumë të vështirë për të përzgjedhur materialet që do të përbënin programin e koncertit që do të

përfaqësonte Qarkun e Vlorës në festival. Prurjet ishin të shumta dhe cilësisht të arrira, një interpretim brilant, nëse do

të shpreheshim kështu, pothuaj nga të gjitha grupet pjesëmarrëse në këtë fazë. Me gjuhën popullore:Kë të marrësh e kë të lësh. Përzgjedhja bëhej më e vështirë për shkak të kohës së kufizuar, por edhe, sepse ende nuk ishte bërë përzgjedhja nga Saranda dhe Delvina që detyrimisht, ishin edhe ato në programin që do të shkonte në festival. Ndoshta nga përzgjedhja që u bë, pati edhe qejfmbetje, sepse mbetën jashtë grupe të tilla të dëgjua, si ai i Tragjasit, i Smokthinës etj, ndaj dhe u qarkullua thënia, se Vlora në Gjirokastrë çoi një program, por në Vlorë la një Festival tjetër. Ndaj duhen parë kriteret e përcaktuara nga MTKRS për zona të caktuara etnomuzikore. Ato nuk duhen parë si tabu.

Po cili ishte programi që grupi i Prefekturës së Vlorës u paraqiti në këtë festival?

Më poshtë po e rendisim këtë program:

- 1.Këngë:"Do marrim dhe ne një këngë"-Grupi i Tërbaçit
- 2.Këngë:"Martohet Nica me Gjonin"-Grupi i Gumenicës
- 3.Këngë:"Doli hëna, hëna dritëergjenda"-Grupi i Himarës
- 4.Këngë:"Gur i rëndë në ven të vet"-Grupi i Delvinës
- 5.Këngë për kurbetin dhe valle çame-Grupi çam i Sarandës dhe i Vlorës
- 6.Këngë:"Bën tërtip Rugjin' e gjorë-Grupi i Dukatit Vlorë
- 7.Këngë:"Të keqen plaku, moj plakë"-Grupi i Treblovës Vlorë
- 8.Këngë:"Legjenda e qyqes"-Grupi i Vezhdanishtit Vlorë
- 9.Valle e kënduar:"Buronjat shterrim s'do ketë"-Vranisht Vlorë
- 10.Këngë:"Dallgë deti" – Grupi i Lapardhasë Vlorë
- 11.Këngë:"Hamit Guga një pëllëmbë"-Grupi i qytetit Vlorë
- 12.Monofoni:"Ara mban farën e saj"-Petrit Metushi Sarandë
- 13.Këngë:"Çobanësia me çoban"-këndojnë:Perlat Merkaj dhe dhe Hëna Xhemali – Delvinë
- 14.Këngë:"I gëzofsh ato stoli"- Grupi i qytetit Vlorë

15.Melodi baritore - Në fyell vendim Kapaj,në dyjare Arap
Çeloleskaj

16.Këngë:"Mahmud Beu selam dërgon-Grupi i Kaninës Vlorë

17.Këngë:"Bezhan, i ziu Bezhan"-këndon Eduart Veliu Sarandë

18.Këngë:"Sarandë, e bukur, Sarandë"-Grupi i Sarandës

Grupit polifonik të Tërbaçit i ra shorti të hap siparin për grupin e Prefekturës së Vlorës. Kënga "*O shokë do zëmë një këngë*" vjen si një oshëtimë nga malet e Labërisë, si një shpalesje e fustanellës labe, me zërin plot kumbim të këngëtarit të mirënjohur e potent Syrja Hodo për të pasuar me legjendën "*Martohej Nica me Gjonin*" nga një grup i ri që mban emrin Gumenicë, Vlorë. Katina Beleri, edhe kjo një nga nga perlat e këngës himarjote, vazhduese e denjë e këngëtarit Dhimitër Varfi me këngën "*Doli hëna, hëna dritëergjenda*" e ngrenë më lart cilësinë artistike të grupit të kësaj prefekturë, për të vazhduar më pas me këngët "*Gur i rëndë në vend të vet*", interpretuar nga grupi polifonik i Delvinës, si dhe vallja e kënduar nga grupi çam i Sarandës dhe i Vlorës. Grupi i Dukatit me këngën "*Bën tërtip Rugjin' e gjorë*" ishte një tjetër prurje e shkëlqyer në këtë festival me zërin melodioz të këngëtarit Fatosh Likaj, apo dhe kënga humoristike e grupit të Treblovës "*Të keqen plakun, moj plakë*", interpretuar me mjeshtëri e plot humor nga ky grup. "*Legjenda e qyqes*" është një vlerë e papërsëritshme e grupit të Vezhdanishtit me këngëtarët Vendim Zykaj e Kalo Bregu. Interesante ishte edhe vallja e fëmijëve të Vranishtit "*Buronja shterim s'do ketë*" nën drejtimin e të mirënjohurit Muhamet Tartari, si dhe grupi polifonik i Lapardhasë me këngën "*Dallgë deti*". Kënga polifonike "*Hamit Guga një pëllëmbë*", interpretuar me shumë mjeshtëri nga këngëtarit Berdo Berdaj dhe grupi, ngre peshë kalanë e festivalit. Gjithashtu interesante ishte edhe monofonia "*Ara mban farën e saj*" interpretuar nga veterani Petrit Metushi, laureat i disa festivaleve folklorike, kënga e sazeve të Delvinës "*Çobanësja me çobanë*", kënduar nga Perlat Merkaj dhe Hëna

Xhemali. Melodia baritore, interpretuar me virtuozyt nga fyelltari i mirënjohur Vendim Kapaj dhe në dyjare Arap Çeloleskaj, zgjuan interes për të gjithë spektatorët që kishin mbushur kalanë, kur Vlora ishte ngjitur në skenë. Grupi polifonik i Kaninës erdhi në festivalin e vitit 2000 me këngën “Mahmud beu selam dërgon”, ndërsa grupi polifonik i Sarandës paraqitet me këngën “Sarandë, e bukur Sarandë”, si dhe grupi çam i këtij qyteti erdhi me këngën “Bezhan, i ziu Bezhan”, interpretuar nga Eduart Veliu.

Të gjitha këngët ishin të bukura dhe me një interpretim të lartë artistik. Kur flet për këtë festival nuk mund të lësh pa përmendur vargjet e këngës “ Hamit Guga një pëllëmbë”, ku autori midis të tjerave thotë:

“ Hamit Guga një pëllëmbë,
ju ngre valiut në këmbë,
i ra me çibuk në dhëmbë.
.....
Luftoj vetëm, vetëm filli,
Hamit Guga trëndafili.”

Në këtë këngë kaq të bukur, jo vetëm nga ana interpretative, por edhe me vargje të fuqishme, vihet re një karakteristikë e hershme e shqiptarit, ajo e mosçarmatosjes së tij. Populli e ngre lart këtë virtyt të shqiptarit dhe kur ai, për një moment nuk ka armë me vete, di të mbrojë dhe të luftojë për nderin dhe vendin e tij. Detaji i gjetur nga ana e poetit popullor ”i ra me çibuk në dhëmbë” që është sa sinjifikativ, po dhe aq i goditur, e vërteton më së miri atë virtyt që përmendëm më lart. Dhe nuk ka si të shkojë më bukur. Vargu i latuar, fjalë dhe figuracion i gjetur dhe tepër i goditur.

Në Nr.4, që mban datën 22 shtator 2000, të gazetës “FEST FOLK 2000”, botim special i Komitetit organizator i Festivalit Folklorik Kombëtar Gjirokastër 2000 , në vend të

kryeartikullit me gërma kapitale shkruhej:”VLORA, SI VLORA... DHE ME KËNGË IA BËRI FORA!”), ku midis të tjerave shkruhet: *”Zërat gurgullues të lumit të Vlorës dhe Bregut tërmetuan kalanë e këngës. Nëse figurativisht kemi thënë që kënga pushton kalanë, pushtimi prej vlonjatëve këtë të premtë qe real. Njëqind e njëzet e pesë këngëtarë dhe tetëdhjetë e pesë minuta, sa katër prefektura bashkë, sfiduan të gjitha kanunametë e komitetit organizator. Tri fjalë, më të përsëritshmet, qarkuan bedenat:stuhia, habia dhe mrekuillia.Pra në 18 numra të programit, vlonjatët shpalosën njera pas tjetrës këngët e etëshme që burojnë nga gryka e individualiteteve të zëshëm”*. Dhe më tej vazhdon: *”Kështu, përveç të mirënjohurve të grupit të Bregut, të Lapardhasë, Vranishtit, Vezhdanishtit, etj, në natën e konkurimit të Folkut 2000, në Gjirokastër, Vlora solli vlera të reja në skenë, si: interpretimi i legjendës së Gumenicës, ”Martohet Nica me Gjonin”, kënga humoristike e Treblovës, ajo e të rinjve të qytetit të Vlorës, si dhe e djemve të Lumit me gjetjen historike për Hamit Gugën...Ndonëse në dukje, i ngarkuar, programi ishte interesant, kjo e lidhur dhe me faktin që asnjë numër nuk kaloi pa u vlerësuar e duartrokitur prej spektatorit.*

Kështu “stuhia” Vlorë, paralelisht me një stuhi të motit, që vazhdon përgjatë gjithë koncertit, la në bedenat e kalasë shijen e më të ëmblës, mbrëmjeve festive të këngës”.

Ky ishte grupi i Prefekturës së Vlorës i vitit 2000 , ku Vlora, siç u quajt ato ditë të festivalit, pushtoi kalanë e Gjirokastrës me këngë.

Ishte një punë e përkushtuar nga stafi drejtues dhe organizator i Vlorës dhe ky mund e kjo punë e palodhur, padyshim që pati edhe vlerësimin maksimal nga juria e festivalit, e cila përbëhej nga emra të dëgjuar të muzikologjisë shqiptare,si: Thoma Gaqi, që ishte edhe kryetar jurie e duke vazhduar me anëtarët:Zana Çela, Besim Jazexhi, Irini Qirjako, Spiro Shkurti, Vaso Tole dhe Hysni Zela.

Pas përfundimit të Festivalit, në procesverbalin e jurisë, mbajtur më datën 24.09.2000, me përfundimin e Festivalit, midis të tjerave thuhet: *”...nga ndjekja me vemendje dhe përkushtim të këtij aktiviteti madhor, ku u shpalos me madhështi i gjithë Folku shqiptar në treva etnike, vlerësoi me çmimin “Laureat i Festivalit” Grupet e burrave të këngëve polifonike labe – Vlorë”.*

Në librin “Festivali Folklorik Kombëtar, Gjirokastër 2000” me autor Ermir Dizdari, për grupin folklorik, përfaqësues i Prefekturës Vlorë, thuhet: *” Tradita e bukur e folklorit të Labërisë, të Bregut të Detit e të zonës së Sarandës, u rikonfirmuan sërish me koncertin e grupit të Prefekturës së Vlorës në festival.*

Spikatën rishtaz grupet polifonike të njohura, si ai i Lapardhasë e i Dukatit, por edhe grupe të reja si ai i Gumenicës e “Jehona labe”, grupi çam i Sarandës, etj.

Laureat i Festivalit u shpallën “Grupet e burrave të këngës polifonike labe”.

SHPIRTI QË RRON

Të gjithë e dëgjuam këngën e parë, me të cilën grupi i Tërbaçit i priu koncertit të Vlorës, në skenën e kalasë, në të tretën ditë të festivalit. Dy vargjet e para thonë:

“Shokë do të marr një këngë,
do ma mbani, a ta lëmë?”

Duket se këngëtari Syrja Hodo, ky interpretues brilant i polifonisë labe, e ka një hall. Ka 12 vjet që s’ e ka parë këngën në Kala dhe po kaq kohë që tranzicioni “trazoi” dhe këngën. Ja pse të ngjan, se i pari i këngës u drejton një ftesë publike, jo vetëm të vetëve(Vlorës), por gjithë bartësve dhe interpretëve të folkut shqiptar. Dhe duket se pret, ç’do të thonë e ç’do të bëjnë shokët e “instikamit” të këngës. Po kur shikon se kënga vete mirë dhe isoja labe pushton kalanë, kur pas këngës së parë hapet kënga si deti e vallja, si valët, përgjigja është dhënë qartë e prerë: Këngën do ta mbajmë.

Më së miri po e tregon këtë të vërtetë edhe ky Festival. *(bëhet fjalë për festivalin e vitit 2000-shënimi im-KB)* U duk se kënga u trondit, u davarit, u ligështua. Absolutisht jo. Shpirti i popullit bën të vetën. Ai rron, krijon dhe përcjell. Afro 800 festivalistë, nga gjithë Shqipëria e trevat shqiptare, po e përcjellin me këngë, valle e ngjyra këtë mesazh, këto pesë ditë shtatori këtu në Gjirokastrë, në Kalanë e Festivalit.

Sejmen Gjokoli

(Botuar në gazetën “Festivali” shtator 2000)

Marrë nga libri “ Shpirti që rron...”

Disa nga këngët që u paraqitën në këtë festival:

Grupi i Tërbaçit Vlorë

Përgjegjësi i grupit: Pelivan Bajrami

Përbërja e grupit:

Syrjat Hodo	Irakli Hodo
Nebi Xhaka	Simin Shiroku
Bilbil Xhaka	Simon Këça
Rexhep Këça	Sinan Hoxha
Luan Canaj	

DO MARRIM DHE NE NJË KËNGË

Shokë do të marr një këngë,
do ma mbani, apo ta lëmë,
të zestë ne për mëndjen tënë,
bëjmë shamata dhe grënjë,
dhe një metër vend që zëmë,
o do dalë gur e shkëmbënj,
o baltë e kuqe këllkënjë.

Grupi i Gumenicës Vlorë

Përgjegjës grupi: Caush Mehmet Sinanaj

Përbërja e grupit:

Gëzim Delaj	Hajro Kanani
Artan Osmanaj	Nazmi Veshi
Përparim Çunaj	Josif Delaj
Myfti Shehaj	Shezai Xhaferaj

MARTOHEJ NICA ME GJONIN

(Legjendë)

Tejpërtej lumit këndonin,
martohej Nica me Gjonin,
lulet u bënin sehir.

Dyzet kuaj bëhen shkumë,
nusëron Nica mbi lumë,
nëna pret nusën e birit,
“mos, o zot, hataj e syrit”.

“Hajde ujk” gremiset kali,
ç’na gjet, o kurorë mali,
këmbehet kënga me kuje.

Bjer rrufe e vrim dhe mua,
i dukej varri patkua,
Gumen¹⁾ lotët e verbonin,
natën dil e flit me Gjonin.

Në themel të Manastirit,
pikon trëndafilin i gjirit,
Gumenicës i dhe emër.

¹⁾Gume – murgeshë

Grupi i Himarës Vlorë

Përgjegjës grupi : Lefter Çipa

Grupi përbëhet:

Katina Beleri

Kristo Varfi

Aleksandër Dhima

Qirjako Bala

Vito Dhimojani

Florika Kocka

Milto Gjiçali

Angjelo Beleri

Spartak Konomi

DOLI HËNA, HËNA DRITËERGJËNDA

Shkuan ditë, shkuan netë
kan’ shkuar kaq kohë,
o moj dritë,
s’morra asnjë letër,

ku je që nuk të shoh
natë për natë në ëndërr të kam parë,
po ti vallë, më sheh?
S'më zë gjumi,
malli më ka marrë,
të iki, apo të pres:
Doli hëna, hëna dritëergjënda,
dil, mo dritë, po pse rri brenda,
dil dhe ti dëgjo,
dil dhe ti shiko.
Kujto ato netë,
o netë të ëmbla,
goja imë ç'më këndon, moj nuse,
po zëmëra më qan.

Doli hëna, hëna dritëergjënda,
ndriçon edhe shkëlqen,
me atë heshtje, në merak më vure,
t'iki, apo të pres.
Dije, se të shkoi djalëria,
s'ka në botë, jo si dashuria,
hajde, mos mendo,
hajde, mos vono,
shpejt a vonë shuhet dashuria.

Grupi çam i Sarandës dhe i Vlorës

KËNGË PËR KURBETIN

O zogj që fluturoni lart mbi re,
a e patë gjë djalin tim?!
Ta puthni, ta përqaftoni me mall shumë,
o nënë, o bir,

o nënë, o bir që nuk të shoh me sy,
zëri yt, o nënë, malli për tokën,
me del në gjumë, o nënë, o bir,
o nënë, o bir që nuk të shoh,
oh që nuk të shoh me sy.
Të përcolli nën-ja, djal-o,
bir për në kurbet-o,
xhan, o shpirt, o nën', o djal-o,
ç'm'u ndave për jet-o,
seç na erdhi lajmi, djal-o,
se të kanë vrarë, djal-o,
xhan, o shpirt i nënës, djal-o,
vallë, kë kishe pranë,
do të vijë nën-ja, djal-o,

të të zbulojë varrë,
xhan, o shpirt i nënës, djal-o,
malli ç'na ka marrë,
ka dalë nën-ja tek parmaku,
kanë dalë të zezat motra,
shumë, o djalë, se ç'na helmolve,
zembrën ma helmolve.

Grupi i Dukatit Vlorë

Përbërja e grupit:

Fatosh Lika

Idajet Muko

Hysni Kapo

Beqir Velaj

Bajram Hunda

Syrja Brahimi

Petref Habili

Aranit Kulluri

BËN TËRTIP RUGJIN' E GJORË

Pllakosi turku në Vlorë,
ç'ka që rri Rugjin' e gJORë.

Refreni: Bën tërtip, Rugjin' e gJORë,
mblidhi djemt' e bënia forra. ¹⁾

Pashai me tre taborrë,
kërkon të të hedh në dorë.

Turqit – topa dhe trumpeta,
Rugjina – gur dhe shigjeta.

Rugjina zemrën si shkëmbi,
zgjodhi djemtë e këtij vendi.

Me shigjet' e jataganë,
çau turqit, doli mbanë.

1)Përsëritet pas çdo dy vargjeve

ARA MBAN FARËN E SAJA

(Monofoni, - kënduar nga Petrit Metushi – Sarandë)

Dëgjo, more dëgjo, oh dëgjoni,
ta dëgjojë gjithë Shqipëria,
se flet Jugu me Verinë,
Idriz Suli, Zhulat Labëria,
flet me Lek Dukagjinë.

Një burim mund të shkatërrojë,

po sido të vijë dynjaja,
prapë do rrjedhë e do pikojë,
se ara mban farën e saja.

Të mos mbetet punë sehirit,
hasmëri – hallka e zinxhirit,
gjysh pas gjyshi e bir pas birit,
plot me lot gropat e syrit.

Kush është puro gjak shqiptarit,
nuk ja shtyn hurat e zjarrit,
s'jemi sua prej barbarit,
por zemërgjer' e shpirt bujari,
mos të tilla gropa varri,
sepse ka të tillë të qarit.

Grupi i Kaninës Vlorë

Përgjegjës grupi: Meleq Kapllani

Përbërja e grupit:

Piro Bregu
Sazan Sadiraj
Neshet Madhaj
Petro Limaj

Besnik Merkaj
Arshi Merkaj
Lekmi Xhindi
Sinan Xhafa

MAHMUD BEU SELAM DËRGON

Në malet mbi Janinë,
dhan' e dhan', dot s'u ngjinë.
Taborr i Vlorës kur vanë,
me yxhym morrën kalanë,

në kalan' zbardhur nga bora,
po lufton Mahmud Bej Vlora.

Grupi i Delvinës

Perlat Merkaj
Hëna Xhemali
Irfan Muço

JO, MOJ JO, S'TË LË PA MARRË

Dil, moj dil, se doli hëna,
kush të ka kyçur brenda,
shkarfosi, moj penxheretë,
se më vure në siklet.

Kaleshe, moj gjeraqinë,
shtatë nure mbi Delvinë,
më e mirë e gjithë kazasë,
ja ta marr, ja do pëlcas.

Ta dish mirë, moj delvinjote,
se unë ty s'të lë pa marrë,
një fjalë nga buza jote,
dimrin e kthen në behar.

Grupi i valles së fëmijëve Vranisht – Vlorë

Përgjegjës grupi: Muhamet Tartari

Valltarët:

Selion Shkurti

Geli Habibi

Endro Mici

Mimi Kanani

Vasil Gjikondi

Eli Basho

Valmir Kongjoni

Ardit Hasani

Endri Laba

Marsel Varfi

Ermir Hallko

Ari Meta

BURONJA SHTERRIM S'DO KETË

(Valle e kënduar)

Kënga labe na thërret,
të hedhin vallen e serrtë,
si e hodhën bilbilejtë,
si baballarët dhe djemtë,
Buronja shterrim s'do ketë,
tradita, thesar i shtrenjtë.

Grupi i Lapardhasë Vlorë

Përgjegjës grupi: Feti Brahimi

Grupi përbëhet:

Nazif Çela

Selim Lika

Golik Lika

Babaçe Brahimi

Meleq Çela

Toto Brahimi

DALLGË DETI

(Kushtuar emigrimit intelektual)

Po bje deti dallgët-o,
dallgët deti, dallgët deti, dallgët-o ¹⁾
dallgë që tronditen-o,
ikin djemtë e Shqipes-o,
iku trur' i Kombit-o,
dil, moj nënë e varfër-o,
dil dhe jep uratën-o,
kudo që të ndodhen-o,
thuaju të vijën-o,
se vetëm Nëna i do.

1) Shërben si refren pas çdo vargu

Grupi i qytetit Vlorë

Përbërja e grupit:

Vasil Sera	Zeço Haxhia
Astrit Mahilaj	Nexhip Sera
Sadik Hodaj	Robert Prifti
Viktor Gjoka	Viron Laci
Vendim Kapaj - fyell	

ME SHËNDET ATO STOLI

Ç'u mblodhë, shokë, ç'u mblodh,
ilaka, krushq e dasmorë,
delja ftujë e bejka sorrë,
dem larashi me këmborë,
gomari nga ajo soj,
berr-berr, delez-o,

po ku fjete bejkëz-o,
fjeta prapa malit-o,
gjeta fren e kalit-o,
ja vara gomarit-o,
hopa – hopa këngën-o,
shkojnë e vijnë zonjat-o,
shihni kë martojën-o,
breshkën e ugarit-o,
cinxurin e malit-o,
cvi – cvi ftujëz-o,
ç'gjete prapa malit-o,
gjeç zilen e kalit-o,
ja vara gomarit-o,
kërr – kërr sojëlli,
me shëndet ato stoli.

Grupi i Sarandës

Grupi përbëhet:

Katerina Kule

Veli Caushi

Myrdar Koshi

Idajet Islami

Markati

Markati

SARANDË, E BUKUR SARANDË

Gjysmë hëna qan me lot,
ç'ke, moj hënë e bukur-o,
mos qaj ti, moj hënëz-o.

Gjysma tjetër më mungon,
ç'ke, moj hën' e bukur-o,
e kërkoi e s'e gjej dot.

Dyzet shenjtorët e morën,
ata e zbritën në tokë,
qaj, moj hën' e bukur-o,
mos qaj ti, moj hënëz-o.

I vunë emrin Sarandë,
moj Sarand' e bukur-o,
ti je gjysmë e hënës-o.

Grupi i Vezhdanishtit Vlorë

Përgjegjë i grupit :Hiqmet Mehmetaj

Përbërja e grupit:

Vendim Zykaj

Fuat Shahaj

Yzedin Sina

Kalo Bregu

Nebi Sina

Nelo Sina

Engjëllush Tahiraj

Cane Sina

LEGJENDA E QYQES

Refreni: Ç'panë...,ç'panë,
ku-ku-ku-ku janë?!
qan motra për vëllanë.

Në një ditë të bukur prilli,
dy vëllezërit në stan
dhentë qethnin me gërshërë,
nuk u muarr vesh ç'panë.

Mbi një gur i mospastëpjesi,
i dymbëdhjetë shejtan,
u trazoi muhabetin,
me gërshër' u therr...,u vranë.

Gjaku e skuqi vërrinë,
motërzeza tundi mal,
“ku i kam vëllezërit unë”,
ku-ku-ku, mori dynjanë.

Grupi “Jehona labe” Vlorë

Përgjegjës grupi: Nertesë Asllani

Grupi përbëhet:

Berdo Berdaj	Sadush Kanaj
Themistokli Ferra	Vullnet Sila
Valter Sulçe	Ylsi Demiraj
Kalo Zeneli	Avdi Zholi

HAMIT GUGA NJË PËLLËMBË

Hamit Guga një pëllëmbë,
ju ngre valiut në këmbë,
i ra me çibuk në dhëmbë,
hiqmani këtej qën,
se paska hije të rëndë.

Refreni: Luftoi vetëm, vetëm filli,
Hamit Guga trëndafili.

Dihet se historia e popullit tonë është një histori lufrash e përpjekjesh të përgjakshme, të cilat janë pasqyruar në mënyrë poetike edhe në folklor.

Këngët popullore të epikës historike na japin një ndihmesë të madhe për njohjen e kësaj historie të popullit tonë. Këto lloj këngësh janë produkt ideoartistik i realitetit historik, në të cilën jetuan heronjtë dhe bëmat e tyre. E tillë është edhe kënga kushtuar Hamit Gugës. Kjo këngë ka të bëjë me fenomene historike dhe sociale të përcaktuara mirë dhe të njohura historikisht, me personazhe të identifikuar. Ajo ka si motiv, atë kundër pushtuesve të huaj, kundër Turqisë.

Kënga ka një rëndësi të madhe historike për vlerat e saj njohëse, dokumentare, historike dhe estetike.

E zhveshur nga elementët hiperbolikë, kjo këngë ka një sfond të theksuar realist. Hamit Guga është një personazh popullor i mburjtur me urrejtjen për të huajin.

Nëse në këngët e ndryshme të epikës historike shohim armët që përdorin luftëtarët, tek kjo këngë kemi një mjet rrethanor, çibukun, i cili është simbol i zgjedhur, tërësisht i gjetur dhe i arrirë dhe mendoj se vargu „*i ra me çibuk në dhëmbë*“ është një varg lapidar, i latuar, si vetë çibuku, ku përmbledh njëherazi burrërinë dhe heroizmin. Vet këngëtari e sjell të gjallë trimin, si në karakterin e interpretimit, plastikën, ashtu edhe në variantin e të kënduarit, pra të melodisë.

(Fjalët e mia nga biseda në TVSH, ku i ftuar isha dhe unë – K.B)

Grupi i Treblovës Vlorë

Përgjegjës grupi: Pelivan Bajrami

Grupi përbëhet:

Fiqrete Islami	Ajet Sadiku
Alem Islami	Bledar Mahmuti
Bexhet Mahmuti	Qemal Zotaj
Simin Simoni	Servet Kojdheli

TË KEQEN PLAKU, MOJ PLAKË

Plakë, a të hëngërt një tënjë,
pse s'më ndrysh, se jam zaif,
që kur më zbulove prëmë,⁽¹⁾
më zu ftoma mualif.

U rrënjëdalë, a ç'më thua,
po ti prëmë vetë m'u pofitise,
se t'u shpif e s't'u durua,
vërc me dorë e vërc me pungjishte.

S'ma hedh dot, moj budallaqe,
vet më le në shtrat të hyj,
kur nuk doje, pse më the hajde,
çoç ta kish qejfi dhe tynë.

De, m'u bëfsh kurban, m'u bëfsh,
po ty prëmë të flit rakia,
sos shtëpinë ma bëre lëmsh,
po doje dhe koçmandisa.

Të keqen plaku, moj plakë,
ne shaka po bëjmë me këngë,
se do na ngelej merak,
pa ne s'kemi asnjë dhëmbë.

Mirë, po ti na nxorre bojën,
do na qesh nusja dhe djali,
nuses thuaji, të mbyll gojën,
do e shihi kur të plaki.

1) trajtë dialektore : mbrëmë

Përbërja e grupit:

Ethem Shaqiri
Remzi Hyseni
Arjan Mehmeti
Afrim Tasimi
Artur Beqo

Hamdi Habibi
Qazim Saliu
Skënder Myrtezai
Artan Shabani
Bajram Staro

KËNGË PËR KURBETIN

Të përcolli nëna, djal-o,
bir për në kurbet,
xhan, o shpirt i nënës, djal-o,
ç'm'u ndave për jetë.

Se ç'na erdhi lajmi, djal-o,
se të kanë vvarë,
xhan, o shpirt i nënës, djal-o
vallë kë kishe pranë.

Do të vinë nëna, djal-o.
Të të zbulojë varrë,
Të të shikoj nëna, djal-o,
Ti ç'nur të ka rarë.

Ka dalë nëna te parmaku,
djalë ore,
kanë dalë, qajnë të zezat motra,
bir, more,
shumë, o djalë se ç'na helmolve,
zembrën ma përvëlove.

Grupi çam i Sarandës(këndon Eduart Veliu)

BEZHAN,I ZIU BEZHAN

Janinë, e zeza Janinë,
ç'i le vëllezërit që të vdisnë,
taborret e Vlorës vijnë,
për Bezhan e për janinë.

O Bezhan, o i ziu Bezhan,
gjashtë muaj në instikam,
luftojnë burra dhe gra,
trima Shqipëria ka.

Grupi sazeve të Delvinës

Grupi përbëhet:
Perlat Merkaç
Hëna Xhemali

Selamet Musta
Martin Muço

ÇOBANESHA ME ÇOBANË

E bukur e zonja e stanit,
ja shpure bukën çobanit?
Ja shpura, o zemër-o,
atje lart në shull-o.

Refreni: Do vemi bashkë në stan,
Tanë, moj e bukur tanë,
Çobanësja me çobanë,
Të bukur, o jetë që kanë.

Bota le të thonë fjalë,
Nesër do dërgoj babanë,
Nuk dal dot, mor zemër-o,
se na dalin fjalët-o.

Refreni: Do vemi bashkë në stan,...

***KONFERENCË SHTYPI PARA FESTIVALIT FOLKLORIK
KOMBËTAR QË U ORGANIZUA NË GJIROKASTËR NË
VITIN 2000 NGA ZOTI KOZMA BILLA (Drejtor i Qendrës
Kulturore Vlorë, njëkohësisht drejtor i festivalit)***

Të nderuar gazetarë të medias së shkruar dhe audiovizive.
Ju falenderoj për mirëseardhjen.

Menduar të organizojmë këtë konferencë shtypi me ju në
prag të Festivalit Folklorik Kombëtar që organizohet në
Gjirokastrë në datat 20-24 shtator 2000, ku dhe grupi i Vlorës do
të jetë pjesëmarrës në këtë eveniment të madh kulturor të vitit.

Pa dashur të bëjë një paradë suksesesh, që në fillim dua të
theksoj, se ky festival është pritur nga forcat artistike me një
interes të madh. Kjo vërtetohet edhe nga pjesëmarrja në fazën e
parë të konkurimit, ku u paraqitën dhe muarrën pjesë mbi 150
forca artistike duke përfaqësuar kështu pothuaj të gjitha ndarjet
etnokulturore të rrethit. Kjo që u quajt edhe faza e parë, tregoi një
impenjim dhe përgatitje të cilësishme nga të gjitha grupet
pjesëmarrëse, duke u munduar të sjellin ato vlera folklorike që u
menduan se me të vërtetë ishin të tilla. Kurorëzimi i kësaj faze
ishite data 15 gusht 2000, ku të gjitha grupet dhanë provimin e
parë. Puna e madhe dhe voluminoze, impenjimi maksimal i
grupeve pjesëmarrëse, prurja e vlerave folklorike nga folklori
tradicional dhe folklori i ri, e vështirësoi komisionin selektor në
punën e tij në përzgjedhjen e grupeve për në fazën e dytë.

Faza e dytë, që ishte dhe më vendimtare, dëshmoi akoma më tepër për një punë më serioze të të gjitha grupeve që kaluan turin e parë për pasurimin me vlera të reja folklorike, bartjen trashëgiminë e tyre nga një brez në tjetrin. Kjo fazë, e cila e mbylli siparin e saj më datën 4 shtator 2000, shpалosi para komisionit selektor të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, vlera shumë të vyera dhe të shkëlqyera të thesarit të pashterrur-popull, ku edhe në këtë fazë, u ndie vështirësia e përzgjedhjes së grupeve që do jenë pjesëmarrës në Festivalin Folklorik në Gjirokastër, të cilat, nga ana jonë, u bënë publike nëpërmjet televizionit “Amantia”.

Gjatë rrugës sonë ka patur edhe pengesa, të cilat me një punë këmbëngulëse i kemi kapërxyer për të arritur sukseset e sipërpërmendura më lart.

Nisur nga vështirësitë financiare, duke përfituar nga kjo konferencë për shtyp, dua të sensibilizoj të gjithë opinionin artdashës, biznesmenët dhe gjithë të tjerët të kontribuojnë për kurorëzimin me sukses të këtij evenimenti madhor artistik.

Duke përfunduar, dua të falenderoj të gjithë ata që kontribuan dhe vazhdojnë të kontribuojnë për kurorëzimin me sukses të këtij festivali, gjithashtu dua t’u tërheq vëmendjen atyre mediave audiovizive që kanë qëllime dashakeqase dhe që gatuajnë në kuzhinat e tyre anakronike sajesa nga më të fëlliqurat dhe demode.

Faleminderit.

Shtator 2000

FFK GJIROKASTËR 2004
(Festivali i tetë)

Përshëndetje e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë, Zotit Theodhori Shia

Kam kënaqësinë që në emër të Këshillit të Qarkut Vlorë, të përshëndes të gjithë Grupin Folklorik të Qarkut dhe t'ju urojë suksese me urimin tradicional:

Si goja, zëmra !

Ju buroftë kënga !

Kjo veprimtari e rëndësishme është rezultat i një punë të gjatë dhe të kualifikuar të speclistëve të folklorit e të këngës popullore të Qarkut Vlorë, i angazhimit të shumë rapsodëve, si *Xhebro Gjika, Mato Hasani, Selim Hasani, Neço Muko, Kujtim Mici, Lefter Çipa, Feti Brahimi, Pelivan Barjami, Llambro Hysi, Llambro Gjomema, Sinan Xhelili, Paskal Papa, Qazim Ademi, Dule Havari, Halil Leli, Dhimitër Varfi, Namik Jahaj, Bexhet Mehmeti, Apostol Pango, Kiço Kapedani, Taip Madani, Hamdi Pulo, etj.*

Emrat e atyre që kontribuan janë të shumtë dhe nuk mund t'i përmend të gjithë, por nga masiviteti i tyre do të dalloja: *Punën e madhe që bëri Grupi i Koordinativ i Qarkut; Vahit Kuçaj, Kozma Billa, Piro Cakrani, Bardhosh Gaçe, Haxhi Dalipi etj.*

Me këtë rast do të falenderoja komisionet e përzgjedhjeve, të komunave dhe bashkive, të kryetarëve të komunave dhe bashkive, veçanërisht zotrinjtë; *Shpëtim Gjika, Mëno Besimi, Përparim Shameti, Naim Zotaj, Islam Jupri, Edmond Gjoka, Beqir Kashuri, Pëllumb Aliaj, etj.*, cilët e filluan punën nga evdientimi

i zonave etnofolklorike e duke “*situr*” këngët e interpretimet për të sjellë në skenë, perlat e këngës popullore dhe të krijimtarisë së popullit.

Falënderoj Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Qendrën Kombëtare të Veprimtarive Folklorike, zotin Ermir Dizdari, komisionerët e kësaj ministrie, specialistët e folklorit, *Agron Xhangolli, Ramazan Bogdani, Barjam Lapi, Piro Miso*, për ndihmën mjaft të kualifikuar që dhanë.

Nuk mund të lë pa përmëndur punën që u bë nga Qendrat Kulturore të qyteteve *Vlorë, Sarandë dhe Delvinë*.

Shpreh bindjen se gjithë kjo punë e kujdesshme, do të kurorëzohet me sukses dhe do të gjejë vlerësimin e duhur.

Urime e suksese Ansamblit Artistik të Qarkut të Vlorës !

Urime e suksese Festivalit Folklorik Kombëtar !

**Kryetari i Këshillit të Qarkut
Theodhori Shia**

Festivali Folklorik Kombëtar i Gjirokastrës 2004, është një dëshmi tjetër e prurjeve të mëdha folklorike që bart kjo krahinë e Labërisë. U paraqitën në fazën e dytë rreth 60 grupe folklorike, disa konkuronin për herë të parë, nga të cilat u përzgjedhën më të mirët prej tyre. Gjatë kësaj faze u bë një punë

e kujdesshme dhe profesionale në përzgjedhjen e grupeve për të thithur nektarin e polifonisë labe. Kështu që komisioni i ngritur për këtë problem e kishte të vështirë të vendoste gishtin, se cili nga grupet pjesëmarrëse do të përfaqësonte Qarkun e Vlorës në këtë eveniment të madh folklorik të vitit. Kështu, pas një pune lodhëse dhe profesionale, u vendos që të ishin në garë rreth 32 grupe, nga të cilat do të përzgjidheshin më të mirat për të arritur para grupit selektor të MKRS të datës 29 korrik 2004. Krahas grupeve të dëgjuaara, si ai i Tërbaçit, Smokthinës, Dukatit, Tragjasit, Himarës, Lapardhasë, Kaninës, etj debutojnë edhe grupe të tjera si ai i Velçës, Mavrovës, Selenicës, i Orikumit etj, të cilat kanë një CVⁱ të gjerë në këngën e bukur popullore polifonike dhe deri në shoqata e grupe të ndryshme polifonike, si: *”Jehona labe”*, grupi *”Bilbili”*, etj.

Kështu që u vendos që para grupit selektor të MKRS të paraqiteshin rreth 24 grupe, të cilat ishin:

1. Grupi *”Jehona labe”* me përgjegjës rapsodin e njohur Nexhip Serra, me këngën *”Ç’e nxorre kartën nga guna”*
2. Grupi i Trevllazërit me këngën *”Trevllazër hane-hane”*
3. Grupi i Tragjasit me këngën *”Mbeçë, more shokë, mbeçë”*
4. Grupi i Dukatit me këngën kushtuar Mehmet Selimit
5. Grupi i Vllahinës që deputonte për herë të parë me këngën *”Të më bëjë Zoti dhe mua”*
6. Grupi i rinjve të shkollës së mesme të Vllahinës me këngën *”Shqipëri, kala me trima”*
7. Grupi i Vezhdanishtit me këngën *”Cullufe vetull katran”*
8. Grupi i Selenicës me këngën *”O moj pushkë që u nxifsh”*
9. Grupi i Armenit me këngën *”Bejkë e vogël balukore”*
10. Grupi i Treblovës me këngën humoristike *”Plaka ime hane-hane”*
11. Grupi i valleve të Gërnecit me vallen *”Këmbëkryq përmbi Selishtë”*
12. Grupi i Kotës me këngën *”Këngë e kohës së qametit”*

13. Grupi i Mavrovës me këngën “Bijë mavronjote, Tana legjendare”
14. Grupi “Djemtë e Sevasterit” me këngën “Asllan, o Ali Asllani”
15. Grupi i Kudhës-Grehot Sevaster me këngën “U mblodh kuvendi në Sinjë”
16. Grupi “Krojet e Velçës” me këngën “Vishet vasha bukuroshe”
17. Grupi i Tërbaçit me këngën “Mëmëdheu”
18. Grupi “Kristalet e Smokthinës” me këngën “Treqind diva çepeverdhë”
19. Grupi i Lapardhasë me këngën “Pse ky komb i merakosur”
20. Grupi i Himarës me këngën “Unë jam Damiani i Himarës”
21. Grupi “Jehona” me përgjegjës poetin popullor Nertesë Asllani me këngën “Do këndo këngën e pleqe”
22. Grupi i Gumenicës me këngën “Varej plaka malit-o”
23. Grupi i Orikumit me këngën “Bukuroshes së Orikut”
24. Grupi çam “Thesprotia” me një valle.
25. Grupi “Bilbili “ – “Shokë më bini Longarë “

Tematika e këngëve pjesëmarrëse, të grupeve pjesëmarrëse të Qarkut të Vlorës në FFK Gjirokastër 2004 ëshë e larmishme. Në vetvete ajo përmbledh disa nga gjinitë kryesore të krijimtarisë popullore, si epika historike, lirike, logatja, vaji etj e deri tek folklori i ri, gjë që vihet re tek disa nga këngët e këtyre grupeve.

Kështu grupi i Tragjasit vjen me një këngë nizamësh shumë të dëgjuar “*Mbeçë, more shokë, mbeçë*”, me një variant të përpunuar nga rapsodi *Hamdi Pulo*, këngë që është ndër më të bukurat e lirikës sonë elegjiake.

Tema historike është ndër më të prekurat në këtë festival. E tillë është kënga e grupit polifonik të Dukatit “*Telat vinë e venë*”, ku heroikja del në plan të parë, apo dhe kënga e grupit të Smokthinës “*Treqind veta çepeverdhë*”, si dhe kënga e grupit “*Kaonët*” Delvinës “*Ç’u prish Lëkurësi*”. E njëjta tematikë vihet

re edhe tek grupi i Sevasterit me këngën “*U mblodh Kuvendi në Sinjë*”.

Interesante është kjo temë tek kënga e grupit polifonik “*Jehona labe*”, “*Ç’e nxorre kartën nga guna*”, ku protagonist kryesor është figura e Mehmet Selimit, figurë, kjo e njohur popullore, apo dhe tek grupi i Vezhdanishtit me këngën “*More të zestë çapkën*”.

Me mjeshtëri të pazakontë vjen tema e atdhedashurisë, e cila përcillet bukur me vargjet e Çajupit të madh “*Mëmëdheu*”, nga grupi i mirënjohur i Tërbaçit. Ajo ka një vlerë të madhe dhe aktuale edhe sot, ku një pjesë e madhe e popullsisë ka emigruar. Dihet që historia përsëritet dhe si e tillë kjo këngë është një grishje, një thirrje e fortë popullore, ku në refren të çdo strofe ajo të ngjeth dhe të krijon një emocion të thellë për ta dashur dhe për të mos e harruar mëmëdheun.

Shumë bukur, në këtë aspekt, tingëllon edhe kënga e grupit të Himarës “*Unë jam Damjan i Himarës*”, ku thelbi i së cilës konsiston tek simboli ynë kombëtar. Autori thotë: “*Flamur tjetër s’ka pranuar*”.

Gërshetuar dhe sjellë nga thellësitë e shekujve është edhe legjenda e Tanës, e cila ka një gjeografi të gjerë të kënduari, por kësaj rradhe, në mënyrë të rrjedhshme dhe origjinale vjen nga grupi i Mavrovës nën titullin “*Bijë mavronjote, Tana legjendare*”.

Edhe lirika zë vend në tematikën e grupeve folklorike të qarkut të Vlorës. Është një portret i stilizuar në mënyrë të përkryer i vajzës labe nëpërmjet vargjeve të këngës “*Kumbulla, moj kumbulla*”, kënduar nga grupi “*Krojet e Velçës*”, etj.

Ashtu si lirika, edhe elegjia është pjesë përbërëse e tematikës së këtij festivali, e cila vjen bukur. “*Shokë më bini longarë*” është një prej këngëve, të cilën e përcjell grupi “*Bilbili*”, apo dhe ajo e grupit polifonik “*Dea*” të Sarandës, “*O moj dardha dimërore*”.

Duke mos marr përsipër të bëj ndonjë analizë të plotë, këto ishin disa nga temat që çoi grupi i Qarkut të Vlorës në FFK Gjirokastër 2004.

Duhet thënë se në këtë numër nuk përfshiheshin grupet e Sarandës dhe të Delvinës.

Përgatitjet për këtë festival kaluan nëpër disa etapa, të cilat treguan një seriozitet dhe përkushtim, falë organizimit të mirë nga ana e Qarkut Vlorë, kryetarit të këshillit të këtij Qarku, zotit Theodhori Shia. Duke patur për bazë kriteret e përcaktuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, u bë një punë sistematike që nga hulumtimi i folklorit burimor të kaluar e deri tek folklori i ri. Pa dashur të marr rolin e një studiuesi, dua të theksoj, se puna e nisur prej disa muajsh është marrë seriozisht nga të gjithë që nga Këshilli i Qarkut e deri tek specialistët që tregojnë një përkushtim të gjithanshëm, duke sjellë në këtë festival, jo vetëm prurje të reja, por edhe cilësi e nivel të lartë artistik, duke përfshirë pothuaj pjesën më të madhe të zonave etnomuzikore nga gjithë treva e Labërisë të këtij qarku.

Stafi i përgatitjes për këtë festival është tepër profesional dhe i përkushtuar. Një meritë e veçantë u takon edhe kryetarëve të komunave që ishin ndër të parat që e muarrën këtë punë seriozisht.

Nëse grupi i Vlorës në Festivalin Folklorik Kombëtar të vitit 2000 u paraqit me 18 numra, njeri më i mirë se tjetri, në këtë festival Grupi i Vlorës u paraqit me 20 numra, gjë që habiti edhe komisionin organizator, sa në një nga numrat e saj gazeta "Festivali", botim i veçantë për Festivalin Folklorik Kombëtar, Gjirokastra 2004, gazetarja Gentiana Brahimë e hap kështu shkrimin e saj: *"Me të ecurën karakteristike, vështrim krenar e pamje të ashpër "rrebelët" e festivalit pushtojnë skenën. Të shumtë në numër, gati sa trefishi grupeve të tjera, artistët e Qarkut të Vlorës kanë mbushur gjithë hapësirën dhe sfondin e platesë të festivalit, duke bërë që kalaja të ushtojë për 120 minuta nga zërat e burrave të Labërisë, duke përcjellë 20 numra*

artistikë”. Dhe më poshtë artikullshkruesja vazhdon: *”një melodi e ëmbël me fyell krijon atmosferë idilike për publikun dhe pas saj marrësi i njohur Syrjat Hodo i grupit të Tërbaçit, ekzekuton këngën “Mëmëdheu”, duke çelur mozaikun e polifonisë. Megjithëse polifonia duket si e njëjtë, secili grup ka të veçantën e tij, ngjyrimet, notat dhe ritmi janë të ndryshme. Kjo shpjegon edhe numrin e madh të pjesëmarrësve, pasi një grup nuk interpreton dot ison e tjetrit”*. Dhe shkrimi përfundon: *”hynë me gjëmim e dalin me gjëmim nga skena, për këtë është preferuar që mbyllja e programit të bëhet me vallen e kënduar “Labëri, majat me çika” nga grupi i burrave të Gërrecit.”*

Polifonia imponon prishjen e rregullave

(Intervistë me udhëheqësin artistik të grupit të Qarkut Vlorë, Vahit Kuçaj – Intervistoi Gentiana Brahimi)

Grupi i Qarkut të Vlorës, ka thyer rregullat e vendosura nga Ministria për pjesëmarrjen, grupi ka gati 3-fish më shumë anëtarë nga grupet e tjera, pse?

Kjo dukuri në lidhje me numrin e pjesëmarrësve ndodh për shkak të specifikës së veçantë që kanë këngët popullore polifonike të trevës sonë. Secili grup ka në përbërje 8-9 vetë dhe ne nuk mund të bëjmë përshtatje të artistëve të një grupi me tjetrën, pasi isoja e Tërbaçit, Mavrovës e Dukatit s’bëhet me ison e Gumenicës, apo të Lapardhasë. Vet kënga është e tillë që kërkon grupin e vet për të ardhur e plotë, me të gjithë elementët e saj.

Edicionin e kaluar, ky grup u vlerësua me çmim të parë, vini me të njëjtin pretendim edhe në këtë festival?

Sigurisht që prej festivalit të ’68, grupi i Vlorës ka qenë ndër pretendentët për fitimin e vendit të parë. Kjo besoj, së pari lidhet me dashurinë e madhe që kemi për këngën polifonike dhe për ta përfaqësuar atë të plotë në kalanë e festivaleve duhet të vinim me 600 artistë. Gjatë festivalit të sivjetshëm, veç vijës

melodike tradicionale, do të vijnë edhe elementë të rinj nga disa grupe, si ai i Himarës, Dukatit, Velçës, grupet e Delvinës, etj.

Qarku i Vlorës në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës u paraqit me këtë program:

- 1.Kënga :“Mëmëdheu” - Grupi i Tërbaçit Vlorë
- 2.Kënga:”Telat vene e vinë” - Grupi i Dukatit Vlorë
- 3.Kënga:”Kumbulla, moj kumbulla” - Grupi i Velçës Vlorë
- 4.Kënga:”Bijë mavronjte,Tana Legjendare -Grupi i Mavrovës
Vlorë
- 5.Kënga:”Mbeçë, more shokë, mbeçë”- Grupi i Tragjasit Vlorë
- 6.Kënga:”Shokë, më bini longarë” – Grupi”Bilbili” Vlorë
- 7.Kënga:”Ç’e nxorre kartën nga guna” Grupi mix Vlorë
- 8.Kënga:”O moj dardha dimërore” – Grupi “Dea” Sarandë
- 9.Kënga:”Ç’u mblodh kuvendi në Sinjë” – Grupi Kudhës-
- Grehot Sevaster
- 10.Kënga:Pusi i ujit, Gumenicë” – Grupi i Gumenicës Vlorë
- 11.Valle – Grupi çam Vlorë
- 12.Kënga:”More të zestë çapkënë”– Grupi Vezhdanisht Vlorë
- 13.Kënga:”Ç’u prish Lëkurësi i shkretë”–Grupi“Kaonët”
Sarandë
- 14.Kënga:”Unë jam Damjan i Himarës”–Grupi i Himarës Vlorë
- 15.Kënga:”Treqind diva çepeverdhë”–Grupi i Smokthinës Vlorë
- 16.Kënga:”Ç’ka ky djali që ma bën me dorë” –Grupi i këngës
qytetare Vlorë
- 17.Kënga:”Engjëlli i mirësisë” Grupi “Djemtë e Delvinës”
Delvinë
- 18.Kënga:”Pse ky komb i merakosur” – Grupi i Lapardhasë
Vlorë
- 19.Kënga:”Dollinë ta ngremë me këngë” – Grupi i Kaninës
Vlorë

20. Valle e kënduar: "Labëri, majat me çika" – Grupi i valles Gër nec Vlorë

Regjisor i këtij spektakli, në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës, ishte Guri Gjeçi, specialist për tekstet Kozma Billa, ndërsa udhëheqës artistik Vahit Kuçaj

Kur po rradhisja këto rreshta, hasa vështirësi për të shtuar diçka edhe për grupet e Sarandës dhe Delvinës dhe më vjen sinqerisht keq, por dua të theksoj një fakt për mospërkushtimin e institucioneve kulturore të Sarandës dhe Delvinës që nuk u impenjuan si dhe sa duhet për të pasqyruar më mirë dhe më saktë në këto pak rreshta historinë e grupeve të tyre, pjesëmarrëse në festivalet folklorike kombëtare që nga viti 1968 e deri në vitin 2000, gjë që do të lërë një boshllëk në këtë pak histori folklorike për qarkun e Vlorës, ku dhe ata bëjnë pjesë, por që në të ardhmen besoj se këto boshllëqe do të plotësohen për të dhënë një fizionomi më të plotë të tyre.

Më poshtë po rendisim disa prej grupeve që kanë qenë pjesëmarrëse në këto festivale, aq sa mundëm të hulumtojmë vet.

Në festivalin e vitit 1973 një grup djemsh nga Fushë Vërri, Sarandë është paraqitur me vallen tashma të njohur "*Jam fatos nga Labëria*", grupi i Ftterrës me vallen e grupit të burrave "*Kur dola në lëmë*", grupi Nivicë-Bubar sjell këngën "*Me këngë do t'ja themi, gëzimit që kemi*" si dhe këngën humoristike "*Qafëleshët*".

Dhe në festivalin e vitit 1978 u paraqitën disa grupe, nga mund të veçojmë grupin e fshatit Sasaj me këngën "*Bregu i detit lulëzon*", grupi i Ftterrës me këngët "*Moj e bardha si Jeleni*" dhe "*Kënga labe, kënga jonë*", gazet popullore të Sarandës, ato të Delvinës, etj, apo dhe grupi i Nivicës me këngën "*Kapedan Jano Kumi*", Delvina, me këngën "*Në mes yjesh bëjnë dritë*". Saranda në këtë festival ka qenë laureat i tij .

Në festivalin e vitit 1983 grupet e Sarandës vijnë me disa këngë, nga të cilat veçojmë: "*Kështu të paçim përherë (valle e*

kënduar), "Dritë e bëre Shqipërinë", "Gruri që bëme sivjet", "Këngë zemre", "Kjo hardhi e rrushit", etj.

Siç shihet, në këtë botim, biografia artistike e Sarandës dhe Delvinës, pjesëmarrëse në festivalet folklorike kombëtare dhe sidomos për këtë festival, është e varfër dhe shpreh besimin se në ardhmen një gjë e tillë do të plotësohet.

PAK NGA HISTORIKU I GRUPEVE PJESË-MARRËSE NË FESTIVALIN FOLKLORIK KOMBËTAR TË GJIROKASTRËS PËR VITIN 2004

Për përgatitjen e Festivalit Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës që u zhvillua në qytetin e Gjirokastrës në vitin 2004 punoi një staf i kompletuar specialistësh dhe profesionistësh të fushave të ndryshme dhe udhëhiqet nga Qarku Vlorë. Koordinator është Istref Dobi, për kostumet, veshjet, etnografi, zoti Novruz Bajrami, koreograf dhe regjisor, Guri Gjeçi, redaktor letrar për tekstet e paraqitura, zoti Kozma Billa dhe udhëheqës artistik, zoti Vait Kuçi.

Në këto pak rreshta histori, mendoj se është e nevojshme një paraqitje e shkurtër e grupeve pjesëmarrëse në Festivalin Folklorik Kombëtar 2004. Këto janë:

Jehona labe është një grup polifonik i krijuar vitet e fundit dhe pikërisht në vitin 1998, por që ka vënë vulën në këngën polifonike. Në përbërje të tij ka këngëtarë të dëgjuar si Berdo Berdaj, Valter Sulçe, Vullnet Sila, Bejushe Bajrami, etj, të cilët janë nga fshatrat e ndryshme të Labërisë. Koncertin e tij të parë e ka dhënë në vitin 1998 para publikut vlonjat dhe më pas ka dhënë një sërë koncertesh në qytete e ndryshme të Shqipërisë si, Sarandë, Fier, Tiranë, Durrës, etj. Është pjesëmarrës në Festivalin Folklorik Kombëtar të vitit 2000, ku spikati me këngën :”*Hamit*

Guga një pëllëmbë”, ku dhe u laurea. Përveç pjesëmarrjes në veprimtaritë folklorike brenda vendit ka marrë pjesë në shumë veprimtari edhe jashtë tij. Kështu në Festivalin e Gjirokastrës të polifonisë labe në vitin 2002 ka merituar vendin e dytë, ndërsa në takimin e Isos polifonike, organizuar në Vlorë në vitet 2003 dhe 2004 ka zënë përkatësisht vendin e dytë dhe vendin e parë. Gjatë kësaj jete të re artistike, grupi “*Jehona labe*” ka dhënë koncerte në Greqi, Austri, Itali, Kosovë. Krijimtaria e këtij grupi është përfshirë në katër albume muzikore dhe është në proces dhe albumi i pestë. Me këtë grup punon rapsodi i mirënjohur Nexhip Sera.

Grupi i Tragjasit është krijuar qysh në vitin 1967 dhe përfaqëson trevën e fshatit të tij, që pasqyrohet në modelin e këngës “*Më muarr malli , më muarr*”. Ky grup ka marrë pjesë rregullisht në Festalet Folklorike Kombëtare. Në vitin 1978 fitoi çmimin e parë, në vitin 1983 u vlerësua si grupi më cilësor, ndërsa në vitin 1988 me këngën e kënduar në këtë festival nga këngëtari i mirënjohur Aranit Daupi dhe Tartar Avdyli, me tekst të të mirënjohurit Hamdi Pulo, i cili nuk jeton më, nder dhe homazh për të, fitoi çmimin e parë, apo dhe në festivalin e vitit 1995 , organizuar në Berat, ky grup ishte pjesëmarrës. Grupi ka në repertorin e tij qindra këngë, shumë prej të cilave janë në tregun muzikor në formën e kasetave audio dhe video.

Grupi i Dukatit është kryesisht një nga grupet më të vjetra dhe pjesëmarrës që në Festivalin e parë kombëtar Folklorik të vitit 1968, ku dhe fiton medaljen e bronxtë. Ai është pjesëtar i të gjitha Festivaleve Folklorike Kombëtare, gjithashtu është i njohur edhe me treshen e Dukatit, apo dhe me këngëtaren e mirënjohur Pika Feruni e deri tek Bajram Hunda e Fatosh Lika. Në grupin e Dukatit nuk mund të mbetet jashtë tij rapsodi i mirënjohur Dule Havari, i cili ishte shkrirë dhe bërë një me këtë grup.

Grupi i Vezhdanishtit është krijuar në vitin 1954 dhe është prezantuar po këtë vit në takimet zonale që organizoheshin në atë periudhë ku ka fituar çmimin e parë. Me organizimin e të parit Festival Folklorik Kombëtar, grupi i Vezhdanishtit është pjesëmarrës i vazhdueshëm në të gjitha këto festivale. Në vitin 1983 ka fituar çmimin e parë, ndërsa në vitin 1988 me këngën “*Dimëro përtej në shpellë*” fitoi çmimin Laureat i Festivalit me këngëtarin e mirënjohur Kalo Bregu. Në vitin 2002 në Festivalin e “Isos Polifonike”, organizuar në Vlorë fiton çmimin e parë, ku krahas Kalo Bregut spikat në mënyrë befasuese këngëtari Vendim Zykaj me këngën “*Legjenda e Malit të Vashës*”. Ky grup ka në repertorin e tij rreth mbi 150 këngë, shumica e të cilave janë në tregun muzikor shqiptar.

Grupi i Mavrovës është krijuar në vitin 1953, por në disa studime folklorike ai del më i hershëm dhe po këtë vit me këngën kushtuar Zigur Lelos në festivalin zonal ai fiton çmimin e parë. Lëvizja demografike ka bërë që ky grup të mos përfaqësohet në të gjitha festivalet. Falë vullnetit, përkushtimit dhe pasionit të Xhelal Hodos, ky grup arrin të përfaqësohet dhe të jetë pjesëmarrës në Festivalin Folklorik Kombëtar të vitit 2004.

Grupi ”Krojet e Velçës” Polifonia “Krojet e Velçës” është krijuar në vitin 1969. Ka marrë pjesë në disa festivale zonale e kombëtare dhe ku është vlerësuar në disa nga këto takime. Ka nxjerrë në tregun muzikor një album me rreth 15000 kopje. Linja e pëlqyeshme polifonike kanë qënë objekt përpunimi dhe janë reflektuar në pjesë muzikore të përpunuara në muzikën moderne të vendit.

Grupi i Tërbaçit është një nga grupet më të hershme të polifonisë labe të trevës së Vlorës. Kënga për ta ka qënë si ushqim i shpirtit. Rapsodët e mirënjohur të këtij grupi që nga Xhebro

Gjika, Arshi Xhelili, Hyso Salati, Sinan Mullahu, Izet Skëndo e deri tek i mirënjohuri Kujtim Mici kanë qënë furnizuesit kryesor me tekste për këtë grup. Grupi është pjesëmarrës pothuaj në të gjitha Festalet Folklorike Kombëtare dhe në disa prej tyre dhe është vlerësuar me çmime e medalje. Vlen të përmendet marrësi kryesor i këtij grupi Syrja Hodo, i cili me zërin e tij kumbues dhe mjaft melodioz di të transmetojë bukur emocionet e këtij repertori të shumtë që ruan ky grup.

Grupi i Smokthinës përfaqëson folklorin e krahinës së Smokthinës, me bazë folklorike “qazimademçe” (*mënyrë të kënduari*) të viteve '30 dhe ka përfaqësuar folklorin e kësaj treve në një sërë takimesh e Festivalesh Folklorike Kombëtare, ku dhe ka fituar vende nderi. Në vitin 2000 u bë riorganizimi juridik me status ligjor dhe emblemën e grupit. Që nga kjo kohë ky grup ka vazhduar traditën. Në takimin “Polifonia labe”, grupi i Smokthinës u laureua si grupi më i mirë i Festivalit. Gjatë këtyre viteve kanë dalë në tregun muzikor tre albume me rreth mbi 40 këngë. Kur përmend grupin e Smokthinës nuk mund të lësh jashtë këtij kuadri këngëtarin e mirënjohur Hysen Rukaj. pjesëmarrës që në Festivalin e Parë Folklorik Kombëtar të vitit 1968.

Grupi i Gumenicës Ky grup përfaqëson folklorin e fshatit Gumenicë, pjesë e Lumit të Vlorës, me bazë folklorin e fshatit, në bazë disa legjenda e pasuri të tjera. Ka përfaqësuar folklorin e kësaj zone në disa festivale kombëtare duke fituar edhe vende nderi. Ky grup vazhdon traditën e fshatit.

Ka një pasuri të çmuar, e cila është regjistruar në kaseta dhe videokaseta, ku lirika e këtij grupi hyn në perlat e polifonisë labe.

Grupi i Gërncit është krijuar në vitin 1959 dhe kjo datë lidhet me veprimtaritë lokale të periudhës së kaluar. Ky grup e ka gjetur shtratin e tij në valle. Me këtë lloj gjinie ky grup në

festivalin zonal të vitit 1973 ka fituar çmimin e parë. Në vitin 1988 ka marrë pjesë në Festivalin Folklorik Kombëtar, ku dhe shpallet laureat i Festivalit në gjininë e valles së kënduar të burrave.

Grupi folklorik “Bilbili” juridikisht është krijuar në vitin 1994. Në themel të këngës të këtij grupi është polifonia labe e disa trevave të Labërisë. Është pjesëmarrës në disa festivale zonale e kombëtare si dhe në një sërë takimesh folklorike ndërkombëtare.

Grupi folklorik “Bilbili” është fitues i çmimit të parë në Festivalin Ndërkombëtar zhvilluar në Moldavi, në vitin 1995. Në vitin 1996 është pjesëmarrës në Folkloriadën e Parë Botërore, organizuar në Brunssum (Holandë), në Festivalin Folklorik Ndërkombëtar “*Balltika*” në vitin 1999 është titulluar laureat i Festivalit. Gjithashtu është pjesëmarrës në Festivalin Folklorik “Këngë Jeho”, në Strugë, po në vitin 1999. Në vitin 2002 merr pjesë në Festivalin e Klinës (Kosovë), ku dhe fiton çmimin e parë në këtë festival. Në Tetor të vitit 2009 është pjesëmarrës në Festivalin e pestë Ndërkombëtar të Izmirit-Turqi. Gjithashtu në takimin e shoqatave kulturore, organizuar në qytetin e Sarandës në vitin 1996, grupi “Bilbili” ka fituar çmimin e parë. Ka nxjerrë në tregun muzikor vendas mbi 20 CD-i, të cilat qarkullojnë, si dhe janë përpunuar e kanë zënë vend në muzikën moderne. Drejtues i Grupit “Bilbili” është z. Sejmen Gjokoli.

Grupi i Himarës Kënga himarjote është e hershme. Për të mos vajtur shumë larg, e gjejmë rreth viteve ’30 me pionierin e zhvillimit dhe të përhapjes së saj Neço Muko. Janë të njohura këngët e bukura himarjote, si:”Vajza e valave”, “Erdhi prilli, shkriu bora”, ”Moj Katina nina-nina” e shumë e shumë të tjera.

Ky grup është pjesëmarrës në të gjitha Festalet Folklorike Kombëtare dhe ka fituar disa trofe. Kënga himarjote ka një përmbajtje ideoemocionale, me nota shpesh lirike, ka një

interpretim me nivel e cilësi të lartë artistike. Sa herë që dëgjon këngën himarjote nuk ka si të mos sjellësh ndër mend këngëtarin plot pasion, me zërin e tij drithërues e plot melodik e emocion, të pazëvendësueshmin Dhimitër Varfi, i cili i ka vënë vulën kësaj kënge. Që nga ajo kohë kanë dalë breza të rinj këngëtarësh, të cilët e ruajnë, e kultivojnë dhe transmetojnë shumë bukur këngën himarjote. Dhe këtu vlen për të përmendur këngëtarja e mirënjohur të këtij grupi Katina Beleri, etj.

Grupi i Lapardhasë është një grup më i ri në krahasim me grupet e tjera të trevës së Labërisë dhe sapo shfaqet në skenën e polifonisë labe zgjon vëmendjen, jo vetëm të dëgjuesve, por edhe të studiuesve të shumtë. Përmes këngës “Janinës ç’i panë sytë”, interpretuesit e saj, gjashtë djem të rinj (*për atë kohë*), të gjithë këngëtarë të zellshëm e të talentuar, treguan se polifonia labe mund të jepet me muzikalitet e kulturë të lartë artistike. Ky grup vazhdoi dhe vazhdon të kontribuojë vazhdimisht në polifoninë labe duke sjellë prurje të reja, Është pjesëmarrës në Festalet Folklorike Kombëtare që pas vitit 1983 dhe është laureuar disa herë. Përveç koncerteve dhe takime brenda vendit, ky grup është pjesëmarrës dhe në disa takime ndërkombëtare, ku dhe ka marrë vlerësime të ndryshme. Kur flet për grupin e Lapardhasë gjithmonë mendja të shkon tek rapsodi i njohur, jo vetëm i këtij grupi, por edhe më gjerë, Feti Brahimi dhe që pjesa më e madhe e grupit përbëhet nga familjarët e tij.

Në tregun muzikor shqiptar ata janë paraqitur me disa albume, të cilat janë të pëlqyeshme nga të gjithë. Për interpretimin e tyre virtuoz, ky grup mund të quhet ndryshe edhe Violinat e Lapardhasë.

Më poshtë po paraqesim pjesëmarrësit sipas grupeve dhe disa nga tekstet e këngëve që u paraqitën nga grupi i Vlorës në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës.

Grupi i Tërbaçit

Përgjegjës grupi: Syrjat Hodo

Grupi është krijuar në vitin 1960 dhe ka kënduar mbi traditën e kësaj treve. Nën drejtimin e drejtuesit artistik, zotit Kujtim Mici, ka fituar një sërë çmimesh kombëtare. Ka fituar çmimin Ndërkombëtar “Për ruajtjen e vlerave folklorike”.

Ka me dhjetra kasete dhe videokasete mjaft të pëlqyeshme sot në tregun muzikor.

Këngët e kësaj treve kanë qenë objekt i përpunimit nga muzikantët tanë.

Grupi përbëhet:

Syrja Hodo : *Marrës*

Luan Canaj: *Hedhës*

Nebi Xhaka: *Kthyes*

Napolon Haskaj

Rexhep Kiça

Sinan Hoxha

Shkëlqim Hodo

Neki Skëndo

Pano Mali

Sadik Hodaj

MËMËDHEU

Mëmëdhe quhet toka,
ku më ka lindur koka,
ku kam dashur mëm' e atë,
ku më nje(h) dhe gur i thatë.

Refreni: Këtu kemi lerë,
 këtu na bëjnë nder.

Ku u rrita me thërrime,
ku mësova gjuhën time,
stërgjyshërit ku kanë qënë

dhe varret që kanë lënë.

Refreni: Ku është balta,
e ëmbël se mjalta.

Këtu ku kemi shtëpinë,
këtu ku hamë e po pimë,
ku kam fis e ku kam farë,
ku kam qeshur, ku kam qarë.

Refreni: Ku rrojta me shpresë,
dua dhe të vdes.

Grupi i Dukatit

Përgjegjës grupi:Fatosh Likaj

Grupi aktual është riaktivizuar në vitin 1986, pas një ndërprerjeje. Në vitin 1987 ka marrë pjesë në koncertin e organizuar me rastin e 75-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare. Në vitin 1988, në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës,u shpall laureat i këtij festivali me këngën “O Selman ç’i bëre dhentë”.

Në vitin 1995, u shpall laureat i Festivalit Folklorik Kombëtar të Beratit me këngën”Kush e njih Savo Andonë”, ndërsa në vitin 2000, në festivalin Folklorik të Gjirokastrës u paraqit me këngën “Pllakosi turku në Vlorë”.

Në këtë festival, ky grup paraqitet me këngën “Telat vene e vinë”. Nga ky grup janë bërë dhjetra kasete e CD.

Grupi është një nga më të pranishmet në aktivitetet lokale dhe përbëhet:

Bajram Hunda – *marrës*
Hysni Kapo – *kthyes*
Taire Bozhani – *hedhëse*
Syrja Brahim
Aranit Kulluri

Beqir Vela
Remzi Allushi
Fatosh Lika
Petref Habili
Idajet Muko

TELAT PO VINË E VENË

Telat po vin e venë
Gjirokastër – Tepelenë,
po firarët ku do jenë,
kërkojnë Mehmet Hysenë,
pleqtë të lidhur do venë.

Dhe pleqtë të lidhur vanë,
të gjithë në një gojë thanë:
lini se janë firarë,
në Dukat kanë jataknë,
se kanë ortak Muratnë,
Rrapo Buzi me Shahin Nanë,
Lazemetaj vunë zjarrë,
se ishin shtëpi e parë.

Grupi „Krojet e Velçës“

Përgjegjës grupi: Kastriot Muçaj
Polifonia „Krojet e Velçës“ është krijuar në vitin 1969. Ka marrë pjesë në disa festivale zonale e kombëtare dhe ku është vlerësuar në disa nga këto takime. Ka nxjerrë në treg një album muzikor me rreth 15.000 kopje. Linjat e përqyeshme polifonike kanë qenë objekt përpunimi dhe janë reflektuar në pjesë muzikore të përpunuara të muzikës moderne shqiptare.

Grupi përbëhet:

Bejushe Demaj – *marrëse*
Agim Brahimi – *kthyes*
Çuman Xhaferi – *hedhës*
Bejkush Murati

Valter Shabani
Kalo Zeneli
Fatmir Majloi
Ali Habili

KUMBULLA, MOJ KUMBULLA

Kumbulla, moj kumbulla,
fustani me frutulla,
jeleku me sumbulla,
moj belholla, veshtulla.

Një nishan mbi vetulla,
shamia si mjegulla,
gërshetat sa pjergulla,
majhoshe si nespulla,
shpirti im si vorbulla.

Grupi i Mavrovës

Përgjegjës grupi: Xhelal Hodo

Grupi është krijuar në vitin 1963 dhe me këngën e heroit Zigur Lelo, në festivalin zonal zuri vendin e parë. Është përfaqësuar që nga kjo kohë në të gjitha festivalet zonale dhe kombëtare, si dhe ka fituar disa vende nderi.

Grupi përbëhet:

Myrvete Laçaj – *marrëse*
Hysen Laçaj – *hedhës*
Viron Laçaj – *kthyes*
Angjelina Islami

Leonard Dani
Valter Hado
Teki Muhameti
Halil Muhameti

BIJË MAVRONJTE, TANA LEGJENDARE

Dhe pse shekujt kanë kaluar,
Tanë e bukur s'je harruar,
Tanë moj.

Refreni: Vashëzo mavronjote,
vaji i cules, kënga jote.

Flet kalaja në rrënojë,
vjen legjenda gojë më gojë,
Tanë moj.

Refreni: Tanë, vashëzo si hënë,
hëna kur është në të ngrënë.

Flet legjenda për një zanë,
për një zanë me emrin Tanë,
Tanë moj.

Grupi i Tragjasit

Përgjegjës grupi: Arqile Alimerko

Grupi është krijuar në vitin 1967. Ky grup përfaqëson trevën e fshatit të tij që pasqyrohet me modelin „Më muarr malli, më muarr“.

Ka marrë pjesë rregullisht në festivalet kombëtare. Në vitin 1978, në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës fitoi çmimin e parë. Në vitin 1983 në FFK Gjirokastrë u vlerësua si grup cilësor, ndërsa në FFK Gjirokastrë në vitin 1988 u paraqit me këngën „Dilni shihni...“, me tekst të mirënjohurit Hamdi Pulo, fitoi çmimin e parë.

Ky grup ka një repertor me qindra këngë, shumë nga të cilat janë në tregun muzikor në formën e kasetave, CD-ve dhe videokasetave.

Në këtë festival ky grup u paraqit me këngën „Mbeçë, more shokë, mbeçë“ një nismë e bukur e poetit popullor Hamdi Pulo, i cili nuk arriti ta shijonte, sepse u nda nga jeta në mënyrë krejt të papritur. Grupi pjesëmarrës në këtë festival me emra të rinj është vazhde e atij grupi me emra të dëgjuar, si

Aranit Daupi, Beqir Laçaj, Nuro Ferati, Neki Stepa, Murat Polo, Lefteri Alimerko e deri tek pasuesit e tjerë me Tartar Avdulin, e tj.

Grupi përbëhet nga:

Sofa Daupi – *marrës*

Ramiz Gjoni – *kthyes*

Artan Gjozeneli – *hedhës*

Novruz Gjoni

Emiliano Dauti

Shkëlqim Stepa

Memush Xhuveli

MBEÇË, MORE SHOKË MBEÇË

Mbeçë, more shokë mbeçë
përtej urës së Qabesë,
t’i bëni selam nënesë,
të tre qet’ e zes’ t’i shesë,
t’i japë hakën së resë.

Në pyet nëna për mua
i thoni që u martua,
në pyet se ç’nuse mori,
tre plumba për kraharori,
në pyet se ç’krushq i vanë,
sorrat dhe korbat e hanë,
në pyet se ç’kal i hipi,
atje ku hipën mehiti.

Grupi „Bilbili“ Vlorë

Përgjegjës grupi: Sejmen Gjokoli.

Grupi folklorik „Bilbili“ juridikisht është krijuar në vitin 1994. Në themel të këngës të këtij grupi është polifonia labe e disa trevave. Ka marrë pjesë në një sërë festivalesh zonale, kombëtare, si dhe në një sërë takimesh ndërkombëtare.

Është fitues i çmimit të parë në Festivalin Ndërkombëtar në Moldavi në vitin 1995, në Folkloriadën e Parë Botërore në Holandë në vitin 1996. Është pjesëmarrës i Festivalit Folklorik Ndërkombëtar „Balltika“, Lituani, në vitin 1999, ku është nominuar Laureat i Festivalit, pjesëmarrës në Festivalin

Folklorik „Kënga Jeho“ në Strugë (Maqedoni) në vitin 1999. Ka fituar çmimin e parë në Festivalin Folklorik Klinë, Kosovë, në vitin 2002, si dhe ka fituar çmimin e parë në Festivalin e SHKA(Sarandë) në vitin 1996. Pjesmarrës në Festivalin Ndërkombëtar të Izmirit,Turqi 2009 etj.

Ka një prodhueshmëri mbi 20 disqe, të cilat qarkullojnë, si brenda, ashtu edhe jashtë vendit, të cilat janë përpunuar e kanë zënë vend në muzikën moderne shqiptare.

Grupi përbëhet:

Arap Celoleskaj –*marrës*

Vasil Sera – *marrës*

Sinan Gjoleka – *kthyes*

Spiro Çino – hedhës

Taire Bozhani -*marrëse*

Bilbil Basho- *marrës*

Vendim Kapaj – *me fyell*

Trifon Malaj

SHOKË MË BINI LONGARË

Shokë, më bini longarë,

do t’i bie me të qarë,

për atë miken e parë.

Do marr shatin dhe kazmanë

do vete t’i zbuloj varrë,

ta shoh se ç’nur i ka rarë,

nur i kuq, a nur i bardhë.

Grupi „Mix“ Vlorë

Përgjegjës grupi: Nexhip Serra

Grupi është një nga grupet e reja që u krijuan pas lëvizjeve demokratike në Shqipëri dhe pikërisht ka ditëlindjen në vitin 1994. Ka marrë pjesë në një sërë aktivitetesh zonale, kombëtare, si dhe jashtë shtetit. Ka fituar disa çmime.

Ka një prodhueshmëri kasetash dhe videokasetash.

Grupi përbëhet:

Berdo Berdaj – *marrës*

Valter Sulçe – *kthyes*

Resmi Ferra

Sadush Kamaj

Kalo Zeneli

Robert Memaj

Bejushe Bajrami

Vullnet Silaj

Adem Peçuli

Ç'E NXORRE KARTËN NGA GUNA

O Kapedani me thinjë,
aman, o Kapedan – o,
supet përmbi suferinë,
çepeja hedhur mbi to.
O Memet Selim, o burrë,
rritur si losi gurë,
Memet Selim – o,
malet shtizë e ti flamur.

Hipur mbi hallet e rënda,
aman, o Kapedan – o,
mbi supe të ulej hëna,
fajko' i Beunit – o.

O lis i shkëmbit me dega,
rritur maleve të serrta,
Memet Selim – o,
o trimi që trembej vdekja.
E nxorre kartën nga guna,
aman, o Kapedan – o,
gjeneralit ju drodh buza,
mjekrra s'i qëndronte dot.

O mëngabardhi me pala,
çika që lëshoi palla,
ç'u drodhën topat nga fjala,
Memet Selim – o.

Grupi Polifonik „Dea“ Sarandë
(Qendra Kulturore Sarandë)

Përgjegjës grupi: Adrian Xhuvani.

Grupi është krijuar juridikisht më 26.11.2002.

Ka marrë pjesë në një sërë festivalesh zonale e kombëtare, si dhe është vlerësuar me certifikata nderi.

Ka një prodhimtari të madhe në kasete e videokasete, të cilat qarkullojnë e janë mirëpritur nga publiku.

Grupi përbëhet:

Persefoni Miha – *marrëse*

Adrian Xhuvani

Arjan Begalla

Artan Barka

Artan Muçi

Aranit Qorri

Zhaneta Pasha

Karafil Duka

Sefer Muho

Sefer Muho

Pelivan Basho

O MOJ DARDHA DIMËRORE

O moj dardha dimërore,
ç'e bëre burrin që more?

Refreni: Ç'e bëre, ç'e bëre,
ç'bëre burrin që more,
rron, s'rron, korbë ç'ta vranë.
E dërgove me pashanë,
ta vranë, korbë, ta vranë.

Refreni: Ç'e bëre.....

Ndanë lumit e lanë,
ta vranë, korbë, ta vranë.

Refreni: Ç'e bëre.....

Mbiu bari, e mbuloi,
doli lumi, e zbuloi.

Refreni: Ç'e bëre.....

Grupi :Kudhës – Grehot” Sevaster Vlorë

Përgjegjës grupi:Telo Shameti

Si viti i krijimit të grupit është viti 1968, por ky grup vazhdoi traditën e këngës polifonike të trevës Kudhës – Grehot.

Ka marrë pjesë në një sërë festivalesh zonale dhe kombëtare. Grupi ka paraqitur interes nga mediat elektronike dhe për këtë grup janë bërë një sërë emisionesh në Radio Televizion.

Ka nxjerrë në tregun muzikor rreth 10 kasete dhe 3 videokasete, të cilat janë të pëlqyera në tregun e muzikës polifonike.

Grupi ka ecur në traditën e të parëve, duke e zhvilluar dhe e çuar më tej këtë traditë dhe përbëhet:

Metlli Shameti – *marrës*
Kastriot Kamberi – *kthyes*
Fatmir Islamaj – *hedhës*
Besnik Kamberi

Fetah Derraj
Ëngjëllush Dapaj
Ilijjan Grabova
Shahin Pashaj

U MBLODH KUVENDI NË SINJË

U mblodh kuvendi në Sinjë,
Kudhësi dërgon parësinë,
Mustafa Begë bilbilë
dhe plakun Imer Alinë.

Bëjnë luftë me Vrioninë,
tek ura në Konisbaltë,
edhe pleqtë pa takatë,
ja bënë pallës fapë.

Grupi i Gumenicës Vlorë

Përgjegjës grupi: Namik Jahaj

Ky grup që përfaqëson folklorin e fshatit Gumenicë, Vlorë, pjesë e Lumit të Vlorës, me bazë folklorin e fshatit, ka në bazë disa legjenda e pasuri të tjera. Ka përfaqësuar folklorin e kësaj zone në disa festivale kombëtare dhe ka fituar disa vende nderi.

Në vitin 2000, u bë riorganizimi juridik me statusin ligjor, simbolin e grupit, etj. Që nga kjo kohë, ky grup ka vazhduar traditën. Ka marrë pjesë në festivalet e organizuara gjatë katër viteve të fundit, ku dhe ka fituar dy çmime të para (me një legjendë dhe një baladë).

Ka një pasuri të regjistruar në kasete dhe videokasete me mbi 20 këngë, ku lirika e këtij grupi, hyn në perlat e polifonisë labe. Pjesë të këtyre këngëve kanë qenë objekt përpunimi të gjinive të ndryshme muzikore.

Grupi përbëhet:

Gëzim Delaj – *marrës*

Përparim Çuni

Josif Delaj

Mejdin Delaj

Selam Xhaferi

PUSI I UJIT GUMENICË

(Legjendë)

Mal më mal,
shtatë stane qethin dhëntë,
shtatë mishëra në hellë,
shtrojë sofrat nusët-o...!
Mbushna ujë dhe një herë,
merr për qafe ysmetçiu,
iku djali, u bë erë,
qënë i bardhë pas vetiu.

Djalë, o djalë,

pyet gjyshja, ç'u bë djali,
ulërin qëni te zalli,
u, bonjaku i nënës – o...!
“Falëm, nënë, nuk kam faj,
m'u çfaq mami vet e dytë
dhe më pret në gji të saj.”
Grat' e qyqja kujen prenë,
është gjynah, se erdhi darka,
zogë Gjon, mallin do nxjerrë,
mbi jetim darka me darkën.

Ç'qe ky hallë,
asnjë fije lesh konakut,
shkuan kurban i bonjakut,
mbetën sofrat shtruar-o...!
Edhe mali që është mal,
u rohit, nga brenda plasi,
pusin thau për atë djalë,
gurra shpërtheu tek Tragjasi.

Grupi i Vezhdanishtit Vlorë

Përgjegjës grupi: Mynyr Zyka

Grupi është krijuar në vitin 1954 dhe është prezantuar po këtë vit në festivalin zonal dhe fitoi çmimin e parë. Që nga kjo kohë, ka marrë pjesë rregullisht në festivalet kombëtare. Në vitin 1984 fitoi çmimin “Naim Frashëri”.

Në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës në vitin 1988, u paraqit dhe bëri emër me këngën “Dimëro përtej në shkellë”, me protagonist këngëtarin e mirënjohur Kalo Bregu, i cili u dallua për zërin e tij karakteristik dhe të papërsëritshëm, duke u shpallur edhe Laureat i Festivalit. Në vitin 2002, në Festivalin Kombëtar të Iso-polifonisë, fitoi çmimin e parë me këngën “Legjenda e malit të Vashës”.

Ky grup ka në repertor mbi 150 këngë, shumë nga të cilat janë në tregun muzikor.

Në këtë Festival u paraqit me grupin e përbërë:

Vendim Zyka – *marrës*

Cane Sinaj

Nebi Sina – *kthyes*
Ëngjëllush Tahiraj – *hedhës*
Kalo Bregu

Fuat Shahaj
Nelo Sina

MORE TË ZESTË ÇAPKËNË

More të zestë çapkënë,
çepetë katërpëllëmbë,
u kërkujën e dot s’u zënë.

Si drëra nëpër shkëmbënjë,
shkurti ua prishi takëmë,
kur hodhi borën e rëndë.

Bora shtigjet ua ka zënë,
po në fusha pesë pëllëmbë,
ha veten kali me dhëmbë.

Grupi “Kaonët” Sarandë

(Qendra Kulturore Delvinë)

Përgjegjës grupi: Idajet Duka

Grupi është krijuar juridikisht më 26.11.2002.

Ka marrë pjesë në disa festivale zonale e kombëtare, si dhe është vlerësuar me certifikata nderi.

Ka një prodhueshmëri të madhe në kaseta e videokasetash, të cilat qarkullojnë e mirëpritur nga publiku.

Grupi përbëhet:

Idajet Duka – *marrës*
Viktor Ligaçi – *kthyes*
Nuri Hamzaj – *hedhës*
Siri Muzhaj

Bashkim Sulko
Krenar Duka
Artan Muzhaj

Ç'U PRISH LËKURSI I SHKRETË

Vjen pampori zeherli,
nëpër det si mal i zi,
shikon vendin me dylbi,
ku bie Lëkursi.
Amanet ju djemtë tanë,
me gjak ta mbani kalanë.

Zeherli, pampori shkoi,
në liman erdhi qëndroi,
topat në tokë i lëshoi,
kalan' e Gërxxhit qëlloi.

Haber Labërisë dërgoi,
se Delvina do luftojë.
Treqind topa kapaklli,
ja vuri në themeli,
turçe foli me topçinë,
gjylja e parë në Delvinë.

Mbahu, Delvinë, bukuria,
se të erdhi Labëria.

Gurë në themel s'mbeti,
ç'u prish Lëkursi i shkreti,
me topa marifeti,
tri nga Gjashta, tri nga deti.

Nga klithmat e Labërisë,
heshtën topat e Turqisë,
Labëria me levendë,
s'e lëshuan vilajenë.

Grupi i Himarës Vlorë

Përgjegjës grupi: Kristo Çipa

Grupi karakteristik i Himarës i ka rrënjët rreth viteve '30 të shekullit të kaluar. Regjistrimet e para të këtij grupi i dedikohen Neço Mukës. Por grupi ka marrë formë të plotë rreth viteve 1968, kohë , e cila lidhet dhe me aktivitetet e asaj kohe, si dhe konkurimet zonale.

Grupi gjithmonë ka patur si burim folklorik atë të zonës, që ka një karakteristikë të veçantë dhe dalluese nga grupet e Labërisë.

Kur flet për grupin e Himarës nuk mund të lësh pa përmendur Artistin e merituar, këngëtarin e papërsëritshëm dhe ta paarrirë Dhimitër Varfin e për të vazhduar më tej, si pasuese e denjë të kësaj këngë, këngëtaren, po aq të njohur Katina Bejleri. Ashtu siç nuk mund të lësh pa përmendur, atë që i dha një shtysë akoma më të madhe këngës himarjote në përgjithësi, folkloristin dhe poetin e talentuar, të madhin Lefter Çipa.

Këngët e këtij grupi janë prodhuar e riprodhuar në qindra disqe e videokaseta, të cilat qarkullojnë në tregun muzikor, si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

Përbërja e grupit në këtë festival:

Kristo Çipa – *marrës*

Eleni Çali – *marrëse*

Janaq Tata

Qendro Zeno

Stavro Mërkuri.

Harilla Dhimojani

Foto Leka

Vasil Mërkuri

UNË JAM DAMJAN I HIMARËS

Hapu vetëtimë se shkova,
pritmëni malet e flakës,
si zogu nga deti dola,
unë jam Damjan i Himarës.

Ku je, Sulltan i oborrit,

gremis male e shterron dete,
kthehu prap' prej Anadolli,
Himarën e kam për vete.
Këtu në vendet e mia,
ku dhe Zoti vjen i ftuar,
mbretëron vetëm liria,
flamur tjetër s'ka pranuar.
Kjo është Himara që thonë,
dielli përmbi shqiponjë.

Grupi “ Kristalet e Smokthinës “ – Vlorë

Udhëheqës artistik: Namik Jahaj

Ky grup përfaqëson folklorin e krahinës së Smokthinës me bazë folklorik të kënduarit “qazimademçe” të viteve '30 të shekullit të kaluar. Ky grup ka përfaqësuar folklorin e kësaj zone në një sërë festivalesh kombëtare, që nga Festivali Folklorik kombëtar i Gjirokastrës në vitin 1968 dhe ka fituar disa vende nderi. Këtu nuk mund të lëmë pa përmendur këngëtarin e mirënjohur Hysen Ruka.

Në vitin 2000, u bë riorganizimi juridik i grupit me statusin ligjor, simbolin e tij ,etj. Që nga kjo kohë, ky grup ka vazhduar traditën. Ka qenë pjesëmarrës në tre aktivitete, ku në Festivalin “Polifonia labe”, në vitin 2000, ky grup u laureua si grupi më i mirë i Festivalit, etj.

Gjatë këtyre viteve të riorganizimit të tij, në tregun muzikor, kanë dalë tre volume, me gjithsej 40 këngë.

Grupi përbëhet:

Hysen Ruka – *marrës*

Piro Tafili – *kthyes*

Halil Kaçi – *hedhës*

Arjan Rudi

Artan Kaçi

Fan Bocaj

Astrit Zogaj

Gjon Deromema

Pelivan Meçorapaj

TREQIND DIVA ÇEPEVERDHË

Shkojnë ata që flenë te retë,
mbi Greshicë ndezen rrufetë.
Nga na vijnë

Kudo venë ...

Tirqekuq gjysmë opingës,
mos janë drerat e Smokthinës,
po qenë drerët e Smokthinës,
dil në shesh, o pjell e shtrigës.

Palla kullonte burbuqe,
njëmijë turq pa kokë në supe.
Moj dynjaja
Ç'janë këta

Në Greshicë e në Smokthinë,
gjashtëdhjetë pishtarë ndezur rrijnë.
Qaj nëno
Vaj djemo

V.O. Kënga bën fjalë për betetjën e Greshicës,- Mallakastër 1847. Në këtë betejë u vranë 1000 turq dhe 200 bijë të Labërisë, midis tyre 60 smokthinjotë.

Grupi “Djemtë e Delvinës” Delvinë

Përgjegjës grupi: Islam Jupi

Grupi është krijuar në vitin 1960. Që nga ajo kohë grupi është ripërtërirë dhe ka marrë pjesë në një sërë takimesh e festivalesh zonale e kombëtare.

Këngët e këtij grupi janë hedhur në treg në dhjetra disqe. Këngët e kësaj treve të kënduara nga ky grup janë përpunuar e këndohen në muzikën moderne.

Përbërja e grupit:

Bujar Tabulla – *marrës*

Arben Veliu – *marrës*

Avni huda – *kthyes*

Elton Xhali – *hedhës*

Viktor Muzhaj

Fatmir Muzhaj

Zarik Bajo

ENGJËLL I MIRËSISË

Sa herë në ëndërr të shihte,
lotët i binin rrëke,
vinte vërdallë nëpër shilte,
të kërkonte, Emine.

Ishte bijë delvinjote,
qe pasqyrë zemra jote,
pashai kur të hidhte sytë,
shinte gjithë mizoritë.
Dridhej mjekra, dridhej dora,
nuk e prekte jataganin,
jepte urdhëra me fora,
Eminesë, shpini kurbanin.

Refreni: Emine, engjëll që fal,
 kokë e bardhë mbeti pa varr,
 s'qe mallkim nga zëmra jote,
 mbete bijë delvinjote.

Grupi i Lapardhasë Vlorë

PSE KY KOMB I MERAKOSUR

Pse ky komb i merakosur
halle plot,
hallet tona s'kanë të sosur
dje dhe sot.
Vetëm ne mbetëm të shkoqur
duarbosh,
të grindur e të xhindosur
me shoshoq.
Arratisur, syrgjynosur
nëpër botë,
shpirt e zemër të plagosur

të rrosh kot.
Të kesh bukë dhe i pangopur
kush e thotë,
të kesh rrobë e i leckosur
çikë dhe copë.
Të kesh mënd dhe i marrosur,
mos, o Zot,
trup i shkretë rreth e rrotull,
kur s'ka kokë.

Grupi i Kaninës Vlorë

Grupi vjen në këtë festival me këtë përbërje:

Meleq Kapllani – përgjegjës grupi

Piro Bregu – *marrës*

Petro Limaj – *kthyes*

Sinan Xhafa

Çerçiz Lushaj

Ylli Mataj

Sofo Minga

Vasil Habili

Besnik Merkaj

Besnik Mataj

DOLLINË DO TA NGREJMË ME KËNGË

Argjiro, moj dil nga guri,
hajde moj, të dëgjojmë zënë,
të të shomë si të ndrit nuri,
të të shomë nuse në këmbë.

Donika dërgon të fala,
të dërgon një tufë me këngë.

Në sofrën tënde bujare,
dollibashi me lezet,
dollinë do ta ngremë me këngë,
këng' e paç nga mot përjet'.

Këngët labe dert e mall,
pa def e pa violinë,
shkrep si eshka në stërrallë,
mbush me duf polifoninë.

Këto këngë me këngëtarë
gojë më gojë si perla vijnë.

Vlora edhe Gjirokastra,
binjake të historisë,
aty ka rrënjët liria,
thesar të polifonisë.

Moj e mira Gjirokastër,
vendosur shpate më shpate,
sa bukur të ecën kënga,
prite furtunën vlonjate.
Vlora, Vlora, Vlora, Vlora,
thuaja këngës, bëja fora.

Grupi i Gërnecit Vlorë

Përgjegjës grupi : Qatip Beja

Grupi është krijuar 1959. Data e krijimit lidhet me aktivitetet lokale të kohës.

Kjo lloj gjine në Festivalin Zonal të vitit 1973 ka fituar çmimin e parë. Në vitin 1988 në FFK Gjirokastër, shpallet Lureat i Festivalit, në gjininë e valleve të kënduar (*Vallja “ Rrap ’ i Lelos, degë tëndë*).

Grupi përbëhet:

Qatip Beja
Gjolek Totaj
Mustafa Mustafaj
Tare Beja
Fejzi Dalipi
Perikli Bejaj

Viktor Bejaj
Frederik Hoxha
Luan Hodaj
Pandeli Bejaj
Bujar Hodaj

LABERI,MAJAT ME ÇIKA

(Valle e kënduar)

Labëri, majat me çika,
e bukur sa shtatë drita,
Labëria male, male,
det me këngë e det me valle,
derdhur nëpër festivale.
Bijtë e Vlorës hane-hane,
hedhin vallen e të parëve
në kalanë e festivaleve.

Kënga qytetare vlonjate

Soliste: Marjola Kaçani

*Orkestrina e Pallatit të Kulturës Vlorë,
drejtuar nga Istref Dobi*

TAVANI ME LULE

Tavani me lule, moj
Qilimat me mollë,
Ç'ka ky djalë i bukur
Që ma bën me dorë,
ma rrëmbeu shaminë,
ma mbushi me mollë,
s'e di, nëno, s'e di,
se me moll', me zerdeli.

ma rrëmbeu shaminë,
ma mbushi me mollë,
Ç'ka ky djalë i bukur

Që ma bën me dorë,
s'e di, nëno, s'e di,
se me moll', me zerdeli.

Buzagaz më erdhi
Ai vetull hollë
ma rrëmbeu shaminë,
ma mbushi me mollë,

s'e di, nëno, s'e di,
se me moll', me zerdeli.

Tavani me lule, moj
Qilimat me mollë,
Ç'ka ky djalë I bukur
Që ma bën me dorë,
ma rrëmbeu shaminë,
ma mbushi me mollë,
s'e di, nëno, s'e di,
se me moll', me zerdeli.

Shtypi i kohës për grupin e Vlorës në këtë festival

“LABËRI, MAJAT ME ÇIKA”

Me të ecurën karakteristike, vështrimin krenar e pamjen e ashpër, “ rebelët e festivalit”, pushtojnë skenën. Të shumtë në numër, gati sa trefishi i grupeve të tjera, artistët e Qarkut të Vlorës, kanë mbushur gjithë hapësirën dhe sfondin e platesë së festivalit. Në natën e pestë të konkurimit, grupet e rretheve të Vlorës, Sarandës dhe Delvinës kanë përcjellë 20 numra artistikë duke bërë që kalaja të ushtojë për 120 minuta nga zërat e burrave të Labërisë.

Një melodi e ëmbël me fyell(*fyelltar Vendim Kapaj*) krijon atmosferë për publikun dhe pas saj marrësi i njohur Syrjat Hodo, i grupit të Tërbaçit, ekzekuton këngën “Mëmëdheu”, duke çelur mozaikun e polifonisë. “Megjithëse polifonia duket si e njëjtë, secili grup ka të veçantën e tij, ngjyrimet, notat dhe ritmi janë të ndryshme. Kjo shpjegon edhe numrin e madh të pjesëmarrësve, pasi një grup nuk interpreton dot ison e tjetrit”, shpjegon udhëheqësi artistik i grupit të Qarkut të Vlorës, Vahit Kuçaj. Grupet dhe këngëtarët e njohur i lënë vendin njëri-tjetrit.

Këngë epike dhe lirike, zëra të ngrohtë dhe të plotë, një grup me iso të shtruar, larmia e polifonisë së këtyre trevave ka rrjedhë fuqishëm në skenë.

Bajram Hunda, Hysni Kapo e Taire Bozhani, treshja e grupit të Dukatit, e shoqëruar nga isoja e grupit, ka interpretuar këngën “Telat venë e vinë”, ndërsa notat lirike kanë ardhur së pari nga grupi i Velçës në këngën “Kumbulla, moj kumbulla”. Grupet e Mavrovës, Tragjasit e grupi “Bilbili” i Vlorës, ndiqen nga interpretimi i grupit “Dea” të Sarandës që ka sjellë këngën “O moj dardha dimërore”. Folklori i trevës së Çamërisë ka ardhur në skenë përmes valles së vajzave të grupit çam të Vlorës. Kostumet e tyre të veçanta dhe interpretimi elegant, plot hijeshi e finesë ka zbritur në Gjirokastër magjinë folklorike të kësaj treve. Por ajo që ka dominuar në programin artistik të këtij grupi kanë qenë këngët dhe elementët epike.

“Këtu në vendet e mia,
ku dhe Zoti vjen i ftuar,
mbretëron vetëm liria.
Kjo është Himara që thonë,
diell dhe dete shqiponjë.”

Një flamur kombëtar shpaloset në skenë, grupi i Himarës përcjell vargjet e këngës: “Unë jam Damiani i Himarës”, që ka ardhur nga zërat e plotë të dy marrësve, Kristo Çipa e Eleni Çali.

“Ç’ka ky djalë që ma bën me dorë” prezantoi këngën qytetare vlonjate, ndërsa rrethi i Delvinës është paraqitur me “

Djemtë e Delvinës” dhe grupin “ Kaonia” që interpretuan këngët “ Ëngjëll i mirësisë” dhe “ Ç’u prish Lëkurësi i shkretë”.

Hyn me gjënim e dalin me gjënim nga skena, për këtë është preferuar që mbyllja e programit të bëhet me vallen e kënduar “ Labëri, majat me çika”, ekzekutuar nga grupi i burrave të Gërrecit.

E DIEL, 3 TETOR 2004

“JAM VJERSHËTOR I FSHATIT TIM, I KRAHINËS SIME, I VENDIT TIM”

(Intervistë me Lefter Çipën, laureat i gjashtë festivaleve folklorike kombëtare)

Rajmond Taho.

(Këtu gjeta këngën e 1912-ës, të 2004-ës, pse jo edhe të 3004-ës. Në kala këndon historia shqiptare, gjaku, fisnikëria. Unë jam nga Piluri i Himarës, i Vlorës dhe i Shqipërisë)

Ashtu i imët, i zeshkët, i shkathët në lëvizje ka mbetur Lefteri. Portret tipik bregasi. Fytyra e tij pothuajse kockore. Një portret që dallga e detit dhe era e malit ka gdhendur ne vite. Lëviz këto ditë nëpër rrugët e Gjirokastrës, rrugë që të çojnë lart në kala, te skena e festivalit. Në dorë, si gjithmonë dosja që s'e ndan kurrë. Vështirë ta gjesh një herë vetëm. Ai ka shumë miq. Kënga e Pilurit e ka bërë të njohur anekend vendit, madje edhe jashtë kufijve. Dikush e fton për kafe. Tjetri e qiras me ndonjë gotë raki. Lefteri nuk ofendon askënd. Të gjithë di t'i respektojë. Ashtu duke biseduar në një tavolinë e gjeta. E gjeta te klubi i festivalit, në kala. Më ftoi të ulesha. I thashë se më duhej një intervistë për gazetën. Ai porositi nga një raki. Unë i thashë se doja vetëm kafe. Kafeja në vaki, më tha ai. Këtu kemi festival,

kemi gëzim.

-Meqë i dhe udhë vet kësaj pune, cila është përshtypja e deritanishme për ecurinë e festivalit?

- Vija në Gjirokastrë me shpresë të dëshpëruar. E vërteta. Kisha gabuar. Këtu gjeta këngën e 1912-ës, të 2004-ës, pse jo dhe të 3004-ës. Në kala hedhin valle perënditë. Në kala këndon historia shqiptare, gjaku, fisnikeria. Unë jam nga Piluri i Himarës, i Vlorës dhe i Shqipërisë.

- Kënga “Këngët e atdheut tim” ka një histori...

- Po. Dikush nga njerëzit me peshë të asaj kohe që shtruar në një klinikë të Parisit. Në njerën prej ditëve të qëndrimit në të, kishte vënë në magnetofon e po dëgjonte bejken. Doktorin francez e pyeti se ç'që kjo këngë. Bejkë e bardhë e Pilurit, i që pergjigjur ai. Pileri, Pileri. Dua këngen e Pilerit i që drejtuar të nesermen doktori. Jo Pileri, por Piluri, ia ktheu pacienti shqiptar. Dhe që ngritur nga shtrati i të sëmurit i inatosur dhe i që drejtuar mjekut. Edhe Parisin të më falësh nuk ta jap Bejkën e bardhë. Ajo është këngë e atdheut tim, ajo është ilaçi i shpirtit...

Ja kjo që pak a shumë historia që më ka treguar vet me gojën e tij ai burrë. E unë aty mora ngacmim e shkrova vargjet:

Këngët e atdheut tim,
janë ilaç e janë shërim.

- Me sa kam dëgjuar edhe “Bejkë e bardhë” pati peripecitë e saj

- Na e ndaluan të shoqërohej kënga me fyej. Veç ne nuk i dorëzuam fyejt, i fshehem brenda mëngës së këmishës dhe i nxorrëm, kur nuk mund e na ndalonin më, në skenë, para

mikrofonit. Ata që deshën të na ndalonin nuk e dinin se magjia e fyellit vjen nga shpirti i botës shqiptare. Magjia e tij mbloodhi në kuvend perënditë.

-Sa këngë numërohen në arkivin tuaj?

- Vetëm deri në vitin 1998 në fonotekën e RTSH-së numëroheshin plot 1001 këngë. Të gjitha këto këngë janë kënduar nga grupi i Pilurit të Himarës. Tani mund të jenë bërë 2000 e mos më. Fond më vete ka në Institutin e folklorit dhe Akademinë e Shkencave.

-Po libra sa keni botuar?

-Plot trembëdhjetë. Shto këtu dhe dymbëdhjetë vëllime në proces me këngët e popullit të Jugut.

-Për 35 vjet keni qenë përgjegjës kulture në Pilur. Si ia dolët mbanë kësaj jete?

-Ja ku jam. Me këtë pune rrita 5 fëmijë, i bëra burra. Martova 5 vëllezër e 3 motra. Mundimi të burrëron, të bën shqiptar.

-Për Petro Markon keni bërë nje kolazh të plotë kënduar nga gratë e Bregut.

-I munduar lindi, i munduar jetoi, i munduar dhe në varr..., veç eshtrat e tij në Dhërmi me flakë në varr.

-Le të kthehemi te Festivali. Sot konkurron Vlora...

-Vlora vjen në festival me histori. Kënga e grupit të Tërbacit ka për tekst vargjet e Cajupit, poezinë “Memedheu”. Grupi “Bilbili”,

i të rinjve të Vlorës vjen me ligjëratat për Evgjeninë, po të Çajupit. Ndërsa grupi i Himarës me këngën :“ Unë jam Himara që thonë”

“Këtu në vendet e mia,
ku dhe Zoti vjen i ftuar,
mbretëron vetëm liria.
Kjo është Himara që thonë,
diell dhe dete shqiponjë,
tjetër flamur s’ka pranuar.”

-Në krijimtari, ku e vendosni veten; në grupin e poetëve apo në atë të rapsodëve?

-Une jam vjershëtor i fshatit tim, i krahinës sime, i vendit tim. I tillë qe dhe Naimi, Çajupi, Lasgushi..., nuk jam as poet, as rapsod. Jam vjershëtor. Dëgjo këto vargje:

“ Burrit shikoi shikimin e syrit
dhe gruas guximin e gjirit”

-Kur hidhëroheni më tepër në jetë?

-Kur vdes ndonjë burrë i mençur i kombatit.

-I gëzuar kur ndiheni?

-Kur shoh prindërit e mi tek rrojnë të dy, edhe pse i kanë kaluar të 80-at.

-I trembeni vdekjes?

-Kurrë. Edhe ti s'duhet t'i trembesh vdekjes. Mos mbaj kurrë rreth vetes shokë frikacakë. Ata janë të rrezikshëm.

-Tani që jini 60 e kusur, si e fotografoni veten?

-Unë përgjigjen do ta jepja përsëri me vargje:

Më mirë një mike në pleqëri,
se një dashuri në rini.

-Ç'merak të ka mbetur?

-Të plak sa më shpejt gruan, që të mbretëroj unë. Vetëm ta plak, jo ta vdes. Ajo të mos vdesë kurrë edhe pse dua ta plak sa më shpejt.

FFK GJIROKASTËR 2009 ***(Festivali i nëntë)***

Që në muajin shtator të vitit 2008, nëpërmjet një shkrese zyrtare, drejtuar qarqeve, bëhet shpallja e organizimit të Festivalit Folklorik Kombëtar që do të mbahet në kalanë e qytetit muze të Gjirokastrës, "Pasuri kulturore e njerëzimit", mbrojtur nga UNESCO, në shtator të vitit 2009.

Për këtë, ndryshe nga festivalet e mëparshme, u hartua dhe një status ku, në një nga nenet e tij përcaktohet se Festivali Kombëtar Folklorik do të zhvillohet një herë në pesë vjet në kalanë e qytetit të Gjirokastrës, si veprimtaria më e rëndësishme

në fushën e trashëgimisë kulturore shpirtërore shqiptare. Në këtë mënyrë, në bazë të këtij neni, u vendos që Festalet Folklorike Kombëtre do të zhvillohen një herë në pesë vjet dhe jo siç është vepruar disa herë.

Nisur nga udhëzimet e dërguara për këtë problem, Qarku i Vlorës e mori punën seriozisht duke krijuar edhe strukturat përkatëse, nën drejtimin e Kryetarit të qarkut, zotit Agron Sharra dhe drejtor organizator, zotin Istref Dobi, Drejtor i Qendrës Kulturore Vlorë.

Për këtë problem nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Qarkut, zotit Agron Sharra u zhvilluan disa takime, derisa u krijua edhe stafi që do të ndiqte ecurinë e gjithë përgatitjes për në fazën finale.

Stafi i punës përbëhet:

1. Janulla Diamanti – punonjëse e Qarkut
2. Kozma Billa – poet, studiues folklori
3. Vahit Kuçaj - muzikant
4. Artur Dharmo – muzikant
5. Sajmir Sadikaj – muzikant
6. Novruz Bajrami – etnograf

Menjëherë stafi i porsakrijuar, filloi punën për përzgjedhjen e grupeve nëpër zona sipas një kalendari të përcaktuar më parë nga ana e qarkut Vlorë, i cili vijon, si më poshtë:

1. Komuna Novoselë në datën 08.06.2009, ora 10⁰⁰
2. Komuna Vllahinë në datën 09.06.2009, ora 10⁰⁰
3. Komuna Kotë në datën 10.06.2009, ora 10⁰⁰
4. Bashkia Orikum në datën 11.06.2009, ora 10⁰⁰
5. Bashkia Vlorë në datën 12.06.2009, ora 10⁰⁰
6. Bashkia Sarandë, Delvinë dhe komunat në datën 17.06.2009, ora 09⁰⁰

Në të gjitha këto takime u paraqitën gjithsej rreth 80 grupe pjesëmarrëse me rreth mbi 800 këngëtarë, valltarë dhe instrumentistë popullorë me rreth 330 këngë të folklorit të vjetër, si dhe të folklorit të ri, ku dhe u angazhuan rapsodë dhe poetë popullorë, të tillë, si: Feti Brahimi, Namik Jahaj, Pelivam Bajrami, Nexhip Sera, Nertesi Asllani, Kristo Çipa, etj.

Megjithë punën e mirë që kishin bërë bashkitë dhe komunat, duhet thënë se në këtë festival pati një farë zbehje nga ana e grupeve dhe drejtuesve të tyre, gjë që vlen për organet vendore që duhet të ndalen. Ndoshta kjo, për mendimin tim, vjen, sepse nëpër komunat dhe bashkitë e vogla zhvillohet pak, ose për të mos thënë fare, në disa zona, jetë kulturore. Kjo, edhe për faktin se institucionet kulturore që kanë ekzistuar më parë, në disa nga qendrat e komunave ose të bashkive nuk funksionojnë dhe fatkeqësisht kanë ndërruar destinacion, duke u kthyer në zyra për kryetarët e bashkive, ose komunave, siç ka ndodhur në Orikum, Himarë apo Novoselë që ka mbetur vetëm salla, ose dhe më e keqja është fakti si i Selenicës që është shitur fare dhe nuk ekziston më. Është me të vërtetë për të ardhur keq, sepse në këtë mënyrë i është privuar e drejta atij komuniteti, me

ndërgjegje, të mos bëjë jetë kulturore. Mendoj, se është detyrë e pushtetit qëndror dhe atij vendor që të mendojë seriozisht për këto vlera shekullore të papërsëritshme që, jo vetëm po zbehen, por janë lënë në harresë. Atëhere lind pyetja: Duhet lënë këto vlera në harresë deri sa të zhduken fare, apo duhet ndërtuar një politikë afatgjatë kulturore edhe për këtë komunitet? Dhe ajo që është më e rëndësishmja qëndron në faktin se me zhdukjen e tyre, merr fund edhe një nga tiparet kryesorë të të njohurit si komb, ai i kulturës dhe i traditave që populli ynë i ka mbajtur dhe trashëguar në shekuj, edhe pse ka qenë i pushtuar nga sundues të ndryshëm. Në atë komunitet ruhen vlerat më të vyera etnokulturore, pa le pastaj të mendojmë e të flasim për transmetim tek brezat e rinj të këtyre vlerave. Për mendimin tim është një dhembje që me

përkushtim të atyre që drejtojnë duhet kuruar, padyshim duke patur parasysh edhe kujdesin e qeverisë në planin e përgjithshëm të strategjisë kulturore kombëtare. Nëse do të vazhdohet me këtë ritëm, do të vijë një ditë që do të themi: “Si është kënduar kënga polifonike, apo cilat janë traditat e popullit tonë”?

Që në këtë përzgjedhje, u vu re një gjë e tillë, po në festivalet e ardhshme, çfarë do të bëhet, apo ky do të jetë festivali i fundit? Këto fjalë janë një apel si për pushtetin qëndror, ashtu edhe për pushtetin vendor.

Është e pafalshme që grupe të dëgjua të mos marrin pjesë fare në këtë eveniment të madh artistik, i cili zhvillohet një herë në pesë vjet, pa folur pastaj për cilësinë e atyre grupeve që erdhën.

Me sa jam në dijeni, pavarësisht, se nuk ekzistojnë më institucione kulturore në komunë e minibashki, ato në buxhetin e tyre kanë të planifikuar një minibuxhet për problemet kulturore, por asnjëherë nuk janë vënë në shërbim të këtyre eventeve.

Dihet që hemoragjia dhe lëvizja e lirë e popullsisë ka bërë punën e vet, por nuk është e thënë të mos kemi bartës të tjerë të folklorit, aty ku jetojnë e punojnë. Shembull pozitiv në këtë drejtim është grupi i ringritur i Drashovicës. Me pak përkujdesje këto pengesa mund të kapërxeleshin, sepse platforma e festivalit shpaloset gati një vit më parë, për të mos folur pastaj për fondin e kulturës që kanë bashkitë dhe komunat, sado i vogël që të jetë, i cili duhet të vihet në shërbim të këtij komuniteti.

Sinqerisht më vjen keq që është anashkaluar nga disa komuna e bashki ky eveniment, edhe pse nga ana e Qarkut është bërë maksimalisht në këtë drejtim. E them këtë, sepse Këshilli i Qarkut dhe Kryetari i tij, kanë vënë në dispozicion gjithë arsenalin e tyre për ta përballuar me sukses këtë veprimtari që, siç thamë, organizohet një herë në pesë vjet.

Pas selektimit nga ana e specialistëve të folklorit të Vlorës, të cilët zbatuan me rigorozitet kriteret e përcaktuara,

përzgjedhën prurjet më të mira të grupeve që u paraqitën në takimet zonale, duke u dhënë mundësi të gjitha grupeve të prezantoheshin me materialet e përzgjedhura prej tyre.

Që në fillim të kësaj pune u vu re një punë serioze e grupeve të tilla, tashma të konsoliduara, si: i Dukatit, i Gumenicës, i Velçës, Jehona labe, i Sevasterit e të tjera, të cilët e kishin vlerësuar maksimalisht. Ndoshta numri i prurjeve nuk mund të krahasohet me festivalet e kaluara, ku ishin më të mëdha, por përfaqësimi i të gjitha trevave etnokulturore ishte i plotë. Pavarësisht nga këto, duhet thënë se edhe kësaj here ishte e vështirë përzgjedhja për të ndërtuar një program për në FFK Gjirokastër, për arsye të këtyre prurjeve. Minutazhi standart prej 30 minutash e kufizon iso-polifoninë. Edhe pse e kemi përmendur disa herë, edhe në takime të niveleve të larta, është e natyrshme që një qark si Vlora që ka një shtrirje të madhe gjeografike dhe që njëkohësisht është epiqendra e polifonisë, nuk mund të vihet në balancë me një qark tjetër që nuk ka po të njëjtën shtrirje, gjë që nuk është marrë asnjëherë parasysh nga organizatorët, edhe pse si problem është ngritur me të madhe disa herë. Kjo, jo vetëm që nuk arrin të realizojë atë çka është vlerë, por e dëmton atë në përfaqësim të të gjitha trevave. Tjetra që është për të diskutuar dhe që është debatuar disa herë, qëndron në faktin e numrit të kufizuar të pjesëmarrësve, i cili mbetet standart si gjithmonë tek 60 veta. Lind pyetja: Kur flasim dhe janë si kriter parësor paraqitja e vlerave folklorike, a mund të jepen këto vlera me 60 persona të trevave të ndryshme që përfaqësojnë po vlera të ndryshme? E kemi theksuar edhe në fillim të këtij botimi që isoja e Dukatit, nuk shkon me ison e Himarës, apo të Sevasterit, nuk shkon as me Tragjasin që janë gjeografikisht të afërt dhe jo më të bësh kompozime isosh të trevave të tjera. Edhe ky është një problem që duhet parë nga organizatorët dhe ata që merren me këtë problem. Ndoshta këto, në pamje të parë, duken si të parëndësishme, por janë aq të rëndësishme sa dhe vet vlerat që ne kërkojmë të sjellim.

Dihet që vallja ka një numër të caktuar valltarësh, me 10 – 12 veta, atëherë, nëse do të kemi dy valle, del që gjysma e pjesëmarrësve do të jenë vetëm këta. Përmenda vallen, sepse në zonën e Labërisë ka disa lloj vallesh e vlerash, pa përmendur këtu komunitetin çam që ka një shtrirje të gjerë dhe që përbën një pjesë të konsiderueshme në komunitetin e Qarkut të Vlorës.

Megjithë këto vërejtje që përmendëm dhe që patjetër duhen korrigjuar në të ardhmen, Qarku i Vlorës, si gjithmonë, di të përzgjedhë e të çojë vlera në këto evente të folklorit kombëtar.

Për mbarëvajtjen e grupit të Qarkut të Vlorës mori pjesë në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës, nën drejtimin e Kryetarit të këshillit të Qarkut, zotit Agron Sharra, u krijua edhe stafi drejtues, me specialistët e mëposhtëm:

1. Istref Dobi – drejtor i përgjithshëm
2. Vahit Kuçaj - udhëheqës artistik
3. Kozma Billa – tekstolog
4. Artur Dhamo – muzikolog
5. Sajmir Sadikaj – konsulent muzikor
6. Novruz Bajrami – etnograf
7. Halim Halimi – regjisor

Më poshtë po rendisim disa nga grupet pjesëmarrëse, përbërjen e tyre dhe materialet e secilit që do të ekzekutojë në këtë sofër të madhe e bujare të këngës:

PROGRAMI I GRUPIT TË VLORËS NË FFK **GJIROKASTËR 2009**

1. Grupi i valleve Drashovicë me vallen :”Te ura në Drashovicë”
2. Grupi “Ylberi” Babicë me këngën “ Do këndoju këngën e pleqë”
3. Grupi i Sevasterit me këngën.”Këngë për Rapo Çelon”
4. Grupi polifonik “Jehona labe” me këngën:” Ç’është ai që ndez dyfeknë”
5. Grupi i Gumenicës me këngën:” Ku-ku-ku , te kroi i lotit”

6. Grupi çam i Qarkut të Vlorës
7. Grupi i Himarës me këngën :” Rinë e bregut, behar moti”
8. Grupi “Zëri i bilbilit” Sarandë me këngën “Ç’ja merr, ç’ja kthen thëllëza”
9. Grupi i Dukatit me këngën :” Porta mb’udhë të karvanit”
10. Kënga qytetare vlonjate “Vashëza në zall të lumit”
11. Grupi “Krojet e Velçës” me këngën:” Doja një tufë trendelinë”
12. Grupi “Jehona” me këngën “O Dervish, Dervish Aliu”
13. Grupi “Djemtë e Delvinës” me këngën: “ Oda jote ka lezet”
14. Grupi i Treblovës me këngën:” Erdha, por harrova plakën”
15. Grupi i Lapardhasë me këngën: “ Kënga jonë e rrallë “
16. Grupi i Gërncit : Valle: “Këmbëkryq përmbi selishtë”

1. Grupi i Drashovicës

Përgjegjës grupi: Pelivan Ruçi

- | | |
|------------------------|---------------------|
| 1. Adif Mema – Marrës | 6. Resmi Bani |
| 2. Qani Salati – Thyës | 7. Frederik Kola |
| 3. Dule Gjoka – Hedhës | 8. Piro Resuli |
| 4. Qebir Kozhupa | 9. Aleksandër Mënaj |
| 5. Zeqir Fallani | 10. Zamir Gjoka |

TE URA NË DRASHOVICË

(valle e kënduar)

Atje te hani në grykë,
te ura në Drashovicë,
komision i Shqipërisë,
ka nijet që ta vithisë.

O moj Shqipëri e bardhë,
bota ç'ta kanë sevdanë,
ata që kanë rarë,
të keqen ta kanë marrë.

2.Grupi “Ylberi” Babicë e Madhe Vlorë

DO KËNDOJ KËNGËN E PLEQE

Marrës: 1.Dëfrim Mustafaraj

Kthyes: 2.Sinan Gjoleka

Hedhës: 3.Mirjan Agaraj

4.Piro Latifi

5.Trifon Malaj

6.Shamet Shehameti

Do marrte një këngë me derte,
do këndoj këngën e pleqe,
s'është këngë, por janë derte,
jemi rritur në të keqe,
ne bejler' e në oxheqe,
në dorë kabash e qelqe,
për ata e jo për vete,
ata fol e neve peqe.

3.Grupi i Sevasterit

Përbërja e grupit:

1.Telo Shameti

2.Besnik Kamberi

3.Ëngjëllush Dapaj

4.Fatmir Islami

5.Fiqiri Shameti

6.Rahit Shehu

7.Ferjat Mahilaj

8.Safet Binaj

KËNGË PËR RAPO ÇELON

Marrës: Ëngjëllush Dapaj

Kthyes: Fiqiri Shametaj

Hedhës: Telo Shametaj

Thonë se Rapo Çelua ish një mal me borë,
kal' i bardhë dhe Çelua vrapojn' për në Vlorë.

Ishte, more, ishte,
ndaj selinë e kishte,
Rapua sipër kalit,
mbi kal labçe fliste.¹⁾

Rapo shkele e shkove mbi natë të zezë,
mbi një thëmbër sholle mbrapa të vijnë djemtë.

Ishte komandani i Luftës së Vlorës,
kur i flit Sazani malit të Kurorës.

Mustaqet e tija dy palë male,
ndaj dhe Italia dergjet nëpër varre.

1) përsëritet pas dy vargjeve si refren

4. Grupi polifonik “Jehona labe” Vlorë

Përbërja e grupit:

Nexhip Serra – përgjegjës grupi

1. Berdo Berdaj

5. Resmi Ferra

2. Vullnet Sila

6. Viron Laci

3. Robert Mema

7. Avdi Zholi

4. Sadush Kamaj

Ç'ËSHT' AI QË NDEZ DYFEKNË

Marrës: Berdo Berdaj

Kthyes: Viron Laci

Hedhës: Resmi Ferra

Dyqind vjet,
pyet Vlora Tepelenë,
ç'është' ai që ndez dyfeknë.

Çausho,
Çaush Lika, Lame Lika,
me havane shtatë drita,
ç'ishin-o,
ç'ishin, a i rëntë pika.¹⁾

Haj medet,
gjylja me zinxhir kopile,
dor' e këmb' lidhur dërmile.

Tremben ret',
armës ja mbytë gurmazë,
ajo mbush e ti i zbazë.

1) përsëritet pas tre vargjeve si refren

5. Grupi i Gumenicës

Përbërja e grupit:

1. Gëzim Velaj – *marrës*

2. Flaton Kanani – *thyes*

3. Përparim Çunaj – *hedhës*

4. Naim Veshaj – *iso*

5. Nazmi Veshaj – *iso*

6. Ëngjëllush Rapi – *iso*

KU-KU-KU TE KROI I LOTIT

Në më zëntë mal i rëndë,
sa zi do mbash, moj nënë,
o nëno!

Ku-ku-ku te kroi i lotit,
lutem fatit, lutem zotit,
sa të zbardhet pend' e korbit.

Sa zi do mbash për mua,
kur të prehem tej mbi krua,
motër, moj!
Ku-ku-ku, o xhan i motrës,
tre behare te syri i portës,
sa të shkoj te der' e botës.

Zotit ne s'i kishim hua,
pse mori për kurban mua,
babe, babe!
Gjir' i nënës të jep sisë,
fjal' e babës të bën lis,
Zot i madh për udh' të nis.

6.Grupi çam i Qarkut Vlorë

Përbërja e grupit:

- | | |
|--------------------|--------------------|
| 1.Haxhi Myrtezai | 8.Rovena Lola |
| 2.Skënder Myrtezai | 9.Driola Asllani |
| 3.Denis Lekdoda | 10.Fabiola Toska |
| 4.Fabio Muho | 11.Nazif Gjyzeli |
| 5.Puen | 12.Fation Hajro |
| 6.Anxhela Ademi | 13.Andrit Nuredini |
| 7.Alesia Banushi | 14.Mario Loshi |

KËNGË PËR ABAZ HAMITIN

Ti,moj Smërte, e zeza Smërte,¹⁾
zjarri ç'të ra anë e mbanë,
zjarri ç'të ra anë e mbanë,
ç'e bëre Abaz aganë.

Baska vate në Janinë,
të mbaj' me garjet hordhinë.
Telegramet ven' e vinë,
Filipjadh²⁾ edhe Janinë,
na vranë Abaz Hamitnë.

1)Fshat në krahinën e Çamërisë

2)Fshat në Greqi

THËLLËNXA

(*valle e kënduar*)

Si e shkele vëndin tënë,
moj, thëllënxë,¹⁾
kaluar, apo në këmbë,
në qafë të pastë it atë,²⁾
të martoj në oxhak të lartë,
vjerri ka tabiat të rëndë,
ai jashtë e ti në këmbë.

1)përsëritet pas çdo vargu

2) yt atë

7.Grupi i Himarës

Përbërja e grupit:

1.Kristo Çipa
2.Eleni Joshi
3.Dhimitraq Bala
4.Eleni Mërkuri

5.Harilla Dhimojani
6.Foto Leka
7.Qëndrim Zeneli

RINË E BREGUT, BEHAR MOTI

U tret ylli, doli Rina,
u verbua vetëtima,

hëna në qiell rrëzohet,
thëllëza në ves' lëndohet.

Refreni: Rinë, Rinë e bregut, behar moti,
më të bukur s'e bën zoti.¹⁾

Hapet nata e bekuar,
flokëgjata, gjizbuluar,
zbret si mjegulla mbi dete,
vishet pjergulla me gjethe.

Shkrep me syrin si martina,
kur tund gjoksin, plagos trima,
natë gjumi s'kanë djemtë,
i mbledh si lumi rrëketë.
Me gërshetë retë i qëlloi,
ballin e ditës zbuloi,
qiellore vjen mesholla,
i thotë diellit, dil se dola.

1)përsëritet pas çdo strofe

8.Grupi “Zëri i bilbilit” Sarandë

1.Behie Dida – *Marrëse*

2.Astrit Beta – *kthyes*

3.Haxhi Aliko – *hedhës*

4.Agron Imeri

5.Astrit Muko

6.Velo Çausi

Ç'JA MERR,Ç'JA KTHEN THËLLËZA

Tej e përkëtej, o n'atë rrëzë,
ç'ja merr e ç'ja kthen ajo thëllëzë,¹⁾
nën një hije nën mëllëzë,
duarartë mbi avlëmëndë,

hidhe lule mbi velënxë,
ca të kuqe, ca nërënxë.

1)përsëritet pas çdo vargu

9.Grupi i Dukatit

- | | |
|-----------------|------------------|
| 1.Fatosh Likaj | 6.Aranit Kulluri |
| 2.Hysni Kapo | 7.Bajram Hunda |
| 3.Taire Bozhani | 8.Idajet Muko |
| 4.Remzi Allushi | 9.Syrja Brahimi |
| 5.Petref Habili | |

PORTA MB'UDHË TË KARVANIT

Marrës:Fatosh Likaj
Kthyes:Syrja Brahimi
Hedhës:Beqir Vela

Porta mb'udhë të karvanit,
kulla në mes të meidanit,
mijëtë buzës së malit.

Kur vije me to rodhinë,
mbrapa mëllënjat të vijnë,
si siliqokat të nxijnë.

Shpellë e Gramës do të presë,
që t'u vijë rrëmë e zezë
dhe kapedani të zbresë.

Haj medet, o Gjino Dhima,

jastriti me vërshëllima,
trimi dalluar mbi trima.

O Gjino Dhima me derte,
ti nuk mendove për vete,
për gjak dhe gjini ç'u trete.

10.Kënga qytetare vlonjate

Përbërja e grupit:

1.Ludmilla Baballëku – *soliste*
2.Lefter Suparaku – *solist*
3.Drini Kanani – *solist*
4.Roland Rushiti – fizarmonikë

5.Adrian Çifçiu – kitare akustike
6.Astrit Kazanxhi – dajre
7.Albano Kapllani– violinë
8.Bujar Habili – klarinetë

VASHËZA NË ZALL TË LUMIT

Burrat - Vashëza në zall të lumit,
vashëz-oj, e mir-o,
ik,moj vash' se do dal lumi,
vashëz-oj, e mir-o,
o ç'm'u dogj zemëra, m'u dogj.

Vajza - Le të dal' e të më marrë,
o djalo,

Burrat – jo,moj, jo

Vajza – se kam te një burr' të marrë
o djalo,

Burrat – jo,moj, jo

o ç'm'u dogj zëmëra,m' u dogj.

Burrat – Sheg' e kuqe, moj majoshe,
vashëz- oj, e mir-o, - 2 herë

o ç'm'u dogj zëmëra,m' u dogj.

Vajza – Kur më deshe pse s'më thoshje,
o djalo,

Burrat – po,moj, po – 2 herë
o ç'm'u dogj zëmëra,m' u dogj.

Burrat – Jemi rritur që të dy,
vashëz-oj, e mir-o, - 2 herë
o ç'm'u dogj zëmëra,m' u dogj.

Vajza - Unë baresh' e ti bari.
O djalo,

Burrat – po,moj, po – 2 herë
o ç'm'u dogj zëmëra,m' u dogj.

1) Të dyja vargjet përsëriten nga dy herë.

11.Grupi “Krojet e Velçës” Velçë

Përbërja e grupit:Kastriot Muçaj – rapsod

1.Bejushe Bajramaj – marrëse

5.Bejkush Murataj – iso

2.Agim Brahimaj – kthyes

6.Gilo Habilaj – iso

3. Valter Shabanaj

7.Bastri Muçaj – iso

4.Kalo Zenelaj – marrës

8.Fatmir Maliqi – iso

DOJA NJË TUFË TRENDLINË

Doja një lule trendalinë,
mbledhur në Velçë në një brinjë.

Refreni: Doja, mor doja,
në kurbet kur shkoja.¹⁾

Doja dhjath' era manure,
ujë Velçe një pagure.

Doja ca zeje nga lumi,
nën jastëk se s'më zë gjumi.

Doja nga lisi dy fletë,
t'i bëja krahë si bletë.

1) përsëritet pas dy vargjeve

12.Grupi “Jehona”

Përbërja e grupit:Përgjegjës:Nertesi Asllani

1.Lesko Dervishaliu

5.Bastri Muçi

2.Godo Lena

6.Fane Boci

3.Numan Cani

7.Gilo Habili

4.Bejo Selimi

8.Dervish Peçuli

O DERVISH, DERVISH ALI

Marrës:Lesko Dervishaliu

Kthyes:Godo Lena

Hedhës:Numan Cani

O Dervish Ali Ajani,
kali yt ballë karvani,
çika, çika lëshon jatagani,
o Dervish, Dervish Ali.
Kullat e bardhë në brinjë,
qajnë për Dervish Alinë.

Ti dije turçe, po s'doje,
me tërxhumanë kuvendoje,
te ura në Konisbaltë,
luftojnë Tragjas e Dukatë,
bëjnë yxhym e s'hiqen prapa.

O Dervish, Dervish Ali,
kullat e bardha në brinjë,
qajnë për Dervish Alinë.

O trimi që s' u përkule,
vetëtimat nëpër natë,
bashkë me Çelo Radaknë,
hije ç' u bëjnë kalatë,
o Dervish, Dervish Ali,
kullat e bardha në brinjë,
qajnë për Dervish Alinë.

13. Grupi “Djemtë e Delvinës” Delvinë

Përbërja e grupit:

- | | |
|------------------|--------------------|
| 1. Bujar Tabulla | 5. Hektor Muzhai |
| 2. Avni Huda | 6. Ylli Hajdini |
| 3. Elton Zholi | 7. Genci Tozo |
| 4. Zarik Bajo | 8. Roland Dervishi |

ODA JOTE KA LEZET

Marrës: Bujar Tabulla

Kthyes: Roland Dervishi

Hedhës: Avni Huda

Gjirokastër, zonjë e rëndë,
komb' i tërë të vjen me këngë.

Refreni: Nga çdo kontinent kanë ardhë,
kudo që janë shqiptarë,
në kalanë me argjend larë,
këngë e kombit sjell beharë.

Kalldrëmet qëndisur mirë,
stolisur për mysafirë.

Refreni: Mbi kështjellë hedhur ylber,
me portat hapur përherë,
manxuranë a derë më derë,
mirëseardhja na mbush me erë.

Refreni: Gjirokastër dritë e hëne,
na mblodhe në sofrën tënde.
Oda jote ka lezet,
mysafir' të këngës pret,
në porta kanë dalë anetë,
luten,këngë ky komb të ketë.

14.Grupi polifonik i Treblovës Vlorë

Pjesëmarrësit:

- | | |
|---------------------------|-------------------|
| 1.Bexhet Mahmuti – Marrës | 5.Pëllumb Brahimi |
| 2.Ajet Sadiku – kthyes | 6.Fitim Brahimi |
| 3.Qemal Zotaj – hedhës | 7.Qamil Binjaku |
| 4.Gëzim Zani | |

ERDHA, POR HARROVA PLAKËN *(humoristike)*

Ç' do t'u them a rrënjëdali,
Perëndia më marrtë hakën,
ç'm'u desh mua festivali,
kur në krah s'e kam as plakën.

Jo se plaka më ka dekur,
se atë s'e ha as dreqi,
dhe pse hunda i ka mbetur,

mendjen e ka veç tek qejfi.

Nga një anë, them bëra mirë,
pa ç'e do me vete sporën,
sos jetën që ma ka nxirrë,
hajde t'i dëgjosh këmborën.

-Bën shaka se është' me fat,
dhe shakaja s'ka të sosur,
-plaka që më erdhi prapë,
në zemër më ka vulosur.

15.Grupi i Lapardhasë Vlorë

Përgjegjës i grupit:Feti Brahimi

1.Nazif Çela
2.Meleq Çela
3.Golik Lika
4.Selim Lika

5.Manush Brahimi
6.Sali Brahimi
7.Bardha Brahimi

KËNGA JON' E RRALLË

Këngët shqipëtare,
janë këngët e mia,
perëndesh' e madhe,
është polifonia.

Refreni: Labëria ime,
mal e gurë i çmuar,
të kam në gëzime,
xhevahir në duar.

Këto janë këngët,
këto janë vallet,
i nisin thëllëzat,
i presin sorkadhet.

Kur këndojnë bilbilat,
tundet Shqipëria,
dhe çelin bajamet,
çelin dhe qershia.

Kur ja thotë dyjarja,
ëmbël me të dyja,
si violinë xambarja,
buron melodia.

16.Grupi i Gërnecit

Valltarët:

1.Qatip Bejaj – marrës
2.Feji Dalipi
3.Tare Bejaj
4.Luan Hodaj – kthyes
5.Dritan Imeri

6.Pandeli Bejaj
7.Frederik Hoxha
8.Viktor Bejaj
9.Simbol Bejaj

KËMBËKRYQ PËRMBI SELISHTE

Këmbëkryq përmbi selishte,
do hedh vallen labërishte,
tund shaminë e do kujtoj,
djalërinë që më shkoj.

Kujtoj bejkat më këmborë,
porsi nuse me kurorë,
kujtoj dasmat me dolli,

ja këtu në Labëri.

POST FESTIVAL

DY FJALË PËR ORGANIZIMIN

Nuk është hera e parë që organizohen evente të tilla nga MTKRS dhe Qendra Kombëtare e Veprimtarive Folklorike, dhe si e tillë, nga viti në vit duhet të ketë rritje cilësore dhe akomoduese. Por është për të ardhur keq, që në fillim, sa mbërrin në Gjirokastrë, nuk ndien atë atmosferën entuziaste të një festivali me përmasa të tilla gjigande, siç është Festivali Folklorik Kombëtar. Atë nuk e ndien as në rrugët e qytetit të gurtë të Gjirokastrës dhe as në kalanë që është quajtur kalaja e festivalit. Ajo që të bënte përshtypje në të përpjetën e kalasë, ishin pavionet

e hapura nga artistë të ndryshëm që promovonin punimet e tyre artistike që sivjet ishin më të shumta nga vitet e kaluara, duke krijuar në këtë mënyrë një traditë të mirë dhe që duhet përgëzuar. Asgjë tjetër nuk të bënte përshtypje.

Skena e festivalit po ajo, skenografia ajo e rikthimit të festivaleve në vitin 2000, në këtë kala, vetëm ka ndryshuar viti, 2009 dhe me gërma kapitale një “FFK”. Vetëm skenografi nuk mund të quhet. Mos vallë mungonin vlerat monetare për të bërë një skenografi të bukur dhe joshëse?

Nëse do të flasim për akomodimin që nuk do të donim ta përmendnim fare, do të thoshim, se ishte tejet i amortizuar, duke na kthyer dekada prapa dhe jo në shekullin e XXI, apo dhe ushqimi që të kujtonte mensat e kooperativave bujqësore në kohën e diktaturës. Kjo është mënyra e jetesën e popullit tonë në këtë shekull të ri? Mendoj dhe besoj se jo. Po atëhere, pse? Mungesë përvoje, koordinimi e bashkëpunimi apo paaftësi menazhimi? Këtyre pyetjeve le t'i japin përgjigje kopotentët, sepse të 1200, a 1500 pjesëmarrësit(*sa ishin*) janë artistë dhe artistë të niveleve të larta dhe si të tillë nuk mund të trajtohen si aksionistë.

Dëshira e MTKRS që ky festival të zhvillohet më shpesh, është shumë i drejtë, por në këto kushte dhe me këto kushte nuk mund të zhvillohet. Pa le të flasim pastaj për teknikën që linte shumë për të dëshiruar. Kur dëgjohej klarineta, nuk dëgjohej violina e të tjera si këto. Keq, shumë keq dhe më vjen, sinqerisht keq që i shkruaj këto rreshta. Besoj se duhet të trokasin, por jo në vesh të shurdhër.

Këto nuk janë mendimet e mia personale, por të pjesës më të madhe të pjesëmarrësve të këtij festivali.

VLERËSIME PËR GRUPIN E VLORËS

Gazeta Fest-folk 2009 Nr.3 26 shtator 2009 shkruan
“Folklori i qarkut të Vlorës ndez publikun, tremb retë dhe largon shiun nga kalaja”

Dhe në shkrimin për qarkun e Vlorës shkruhet: *“Vlonjatë e sarandiotë ndezën atmosferën e mbrëmjes në kështjellën e lagur nga një shi i imët që njomi gjithçka, por nuk mundi të ndikojë në koncertet konkurruese dhe përshëndetëse”*. Shkrimi vazhdon:

“ Në ditën e dytë të festivalit vlonjatë e sarandiotë ndezën atmosferën e mbrëmjes në kështjellën e lagur nga një shi i imët që njomi gjithçka, por nuk mundi të ndikojë në koncertet konkurruese dhe përshëndetëse të kësaj nate. Harmonia e zërave në polifoni, në pjesët instrumentale popullore, këngët, vallet, elegjitë, vajet, u përcollën tek spektatori me përkushtimin e njohur të këtyre trevave ndaj folklorit të këtyre trevave, ndërsa shiu sa i dha një shkëlqim të argjendë atmosferës festive. Ndërsa shiu nis të rreshtë, ngjajnë me një magji vargjet e poetit lirik

Lefter Çipa (duket thënë se kjo këngë është shkruar nga Kristo Çipa, i vëllai) të kënduara nga grupi himarjot “ U tret ylli, doli Rina, u verbua vetëtima”. Po Vlora, si Vlora. Edhe në këtë festival tejkalonin caqet dhe kufijtë. U prezantuan me më shumë se 100 artistë nga 60 që ishte kufiri limit.”Nuk duam trajtim e akomodim, ne duam vetëm të këndojmë, të kërcëjmë dufin”, - tha një marrës i njohur i labçes nga Vlora. Një valle e kënduar trimërie nga grupi i burrave të Drashovicës, ka rrëmbyer duartrokitjet e shikuesve, të cilët shoqëronin me duartrokitje, sipas ritmit të kërcimit dhe u duk sikur rrahjet e këmbëve të lebërve “trëmbën” retë që silleshin në qiellin mbi kështjellën e

këngës. Mbetet gjithmonë e vështirë kronika e koncerteve të Vlorës. “Te ura në Drashovicë” nuk ishte vetëm një copëz historie dhe kronike nga Lufta e Vlorës e vitit 1920, por edhe një shkulumë e shpirtit lirisht vlonjat. Me të njëjtën ndjeshmëri u përcoll tek publiku edhe kënga përkushtuar Rrapo Çelos, njerit prej komandantëve të luftës së Vlorës me të cilin grupi i Sevasterit u përfaqësua denjësisht në skenën e festivalit. Më pas janë interpretime të reja me magjinë e polifonisë labe. Kënga labe me solemnitetin e saj fillimisht “vendos” qetësinë, por befas spektatori shpërthen. Drejt qendrës rrethore të skenës nxitojnë djemtë “levendë” të grupit polifonik “Jehona labe” me këngën “Ç’është ai që ndez dyfeknë”, vazhdon grupi polifonik i Babicës me “Do këndoj këngën e pleqe” dhe grupi i Gumenicës me këngën “Ku-ku-ku, te kroi i lotit”. Solemniteti qëndron pezull brenda harqeve të çerekglobit të skenës së festivalit, por zërat “bubullimë” përhapen drejt qiellit duke dëshmuar në këtë mënyrë se gjithçka që vjen prej Vlorës, është sovranë dhe e përkryer. Si një ylber, ku ngjyrat ndërthuren plot harmoni, vjen më pas dhembja dhe delikatesa çame, përfaqësuar denjësisht nga dy artistë dhe dy grupe valltarësh, të cilët zotëruan krejt skenën në dhjetë minutat që kishin në dispozicion. Kur në skenë nisën marrjet e para të këngës lirike himarjote e piluriote, “Rinë e

bregut, behar mote”, ky grup që zyrtarisht përfaqësoi Himarën, e bëri “zap” publikun, shoqëruar ëmbël – ëmbël nga fyelli në një ligjërim recitativ. Surprizë bën para publikut edhe grupi i mirënjohur “Zëri i bilbilit” nga Saranda me këngën “Ç’ja merr, ç’ja kthen ajo thëllëzë”. “Nuk ka formë e mënyrë tjetër të kënduari për dashurinë, veçse të kënduarit në polifoni. Këto zëra, ashtu si në dashuri, harmonizohen vet dhe kënga rrjedh e gurgullon si kristal”, - thotë Sinani, themelues dhe “gur qosheje” në performancën e këtij grupi. Grupi polifonik i Dukatit erdhi sivjet me “Porta mb’udhë të karvanit”, ndërsa legjendarët e Lapardhasë, grupet e Gërncit dhe e Treblovës,

sikurse edhe priten, me interpretimet e tyre rrëmbyen duartrokitjet e fansave të shumtë të polifonisë. Ndërkaq, plot dinjitet, u paraqit edhe kënga qytetare e kësaj treve. Delvina u përfaqësua me këngën “Oda jote ka lezet”, qyteti i Vlorës pati për përfaqësues këngën qytetare “Vashëza në zall të lumit”. Pa u zgjatur shumë, të 16 pjesët e ekzekutuara nga grupet përfaqësuese të Qarkut të Vlorës, u pritën me një interes nga të pranishmit, ndoshta edhe nga ndjeshmëria dhe ngjajshëria e motiveve folklorike mes Vlorës dhe Gjirokastrës.”Janë këngë të vjetra, me peshë që u kanë rezistuar kohërave, gjë që i shërben ruajtjes dhe zhvillimit të pasurisë së paçmuar të iso-polifonisë dhe krejt folklorit burimor të Vlorës, Delvinës dhe Sarandës”, - thotë i entuziazmuar pas shfaqjes folkloristi Sejmen Gjokoli. Ndërsa Istref Dobi, drejtues i grupit të Vlorës, ndalet tek vlerat e folklorit çam dhe këngën qytetare vlonjate.”Vallja dhe kënga e Çamërisë ishte një pjesë e veçantë dhe e rëndësishme e koncertit, ndërkohë që për herë të parë në skenën e festivalit u ngjit trioja vlonjate, me Ludmilla Baballëkun, Drini Kanani e Lefter Suparaku, të cilët përcollën traditën e këngës qytetare vlonjate”.

Revista “Gjurmë të shpirtit shqiptar”, botim i Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Folklorike, Viti IV i botimit, Nr.7, dhjetor 2009, në shkrimin “ Më shumë se 100 artistë”, shkruan:

“ Grupi i Vlorës edhe pse në këtë festival tejkaloi kufijtë me prezantimin e më shumë se 100 artistëve, nga 60 që ishte kufiri limit, me 16 pjesë e grupeve përfaqësuese të Qarkut të Vlorës, u pritën me interes, ndoshta dhe nga ngjajshmëria e motiveve folklorike mes Vlorës dhe Gjirokastrës.

Vallja trimërie e kënduar nga grupi i burrave të Drashovicës rrëmbeu duartrokitjet e shikuesve që shoqëronin sipas ritmit të kërcimit, kur u duk sikur rrahjet e këmbëve të lebërve “trembën” edhe retë mbi kështjellën e këngës.

Grupi i Sevasterit përcolli këngën e njohur kushtuar Rapo Çelos, njerit prej komandantëve të luftës së Vlorës.

“Jehona labe”, djemtë e këtij grupi të njohur polifonik erdhën me këngën “Ç’është ai që ndez dyfeknë”, ndërsa grupi i Gumenicës me këngën “Ku-ku-ku, te kroi i lotit”, ndezën skenën, duke përcjellë bukurinë e këngës labe të Vlorës.

U mirëpritën në skenë marrjet e para të këngës lirike himarjote e piluriote “Rinë e bregut, behar moti”, shoqëruar me fyell në një ligjërime recitativ. (me fyelltarin e mirënjohur Vendim Kapaj – Mjeshtë i Madh, - shënimi im)

Grupi i njohur “Zëri i Bilbilit” nga Saranda solli lirikë me këngën “ Ç’ja merr, ç’ja kthen thëllëzë”.

Grupi polifonik i Dukatit me “ Porta mb’udhë të karvanit”, bashkë me grupet e Lapardhasë, të Gërnecit dhe Treblovës. Delvina u përfaqësua me këngën “ Oda jote ka lezet”, qyteti i Vlorës pati për përfaqësues këngën instrumentale “Vashëza në zall të lumit”, kënduar nga trioja e ripërtërirë me Ludmilla Baballëkun, Drini Kananin dhe Lefter Suparakun, që përcollën traditën e këngës qytetare vlonjate që ngjitej për herë të parë në skenën e festivalit.

Emimet

Ndoshta prisnim më shumë, se çuam në festival vlera të folklorit tradicional, autentik, burimor, duke e gërshetuar atë me folklorin e ri, duke e transmetuar këtë nga njëri brez në tjetrin, megjithatë jemi të detyruar t'i bindemi vlerësimit të jurisë, që është më e specializuar. Juritë, si arbitrat nuk diskutohen edhe pse mund të kenë subjektivizëm.

Në çmimet për grupe zhanresh, grupit të Vlorës iu dha çmimi i grupit më të mirë të iso – polifonisë labe, ndërsa interpretuesi më i mirë u dallua Denis Lekdodaj në interpretimin e valles çame, kurse Eleni Mërkuri, e grupit të Himarës, u vlerësua si këngëtarja më e mirë.

Festivali i dhjetë, 10-16 maj 2015

Do të quhet Festivali Jubilar, sepse është Festivali i 10^{-të} Folklorik Kombëtar që mbahet po në Gjirokastrë, e cila tashma ka marrë autorësinë e këtij eventi më të madh të trashëgimisë kulturore mbarëkombëtare shqiptare. E themi këtë, sepse, në këtë Festival, përveç grupeve brenda territorit të Shqipërisë, marrin pjesë edhe grupe të ardhura nga Kosova, nga shqiptarët e Maqedonisë dhe të Malit të Zi, si edhe nga diaspora. Ndaj ky Festival, gjeografikisht është shumë i gjerë.

Si gjithmonë, edhe kësaj radhe, Qarku i Vlorës është i pranishëm në këtë event të rëndësishëm kulturor folklorik.

Nuk ishte aq e lehtë për të mbërritur deri në momentin final të përzgjedhjes së grupeve që do të hipnin dhe për të promovuar vlerat më të shkëlqyera të tabanit popullor që përfaqëson kjo trevë e pasur etnokulturore dhe etnomuzikore.

Tradita e shkëlqyer për të mbajtur gjallë këtë pasuri të madhe folklorike, u pa e qartë në vërshimin e madh të grupeve dhe të individëve për të shpalosur vlerat më të shkëlqyera të këtij folklori.

Ajo që vlen të përmendet, qëndron në faktin, se në këto takime zonale, u vu re pjesëmarrja e grupmoshave të ndryshme që nga fëmijët, të rinj e deri tek të moshuarit, gjë që tregon dashurinë e madhe për folklorin dhe transmetimin nga njeri brez në tjetrin.

Në këtë konkurim u paraqitën mbi 60 grupe e individë me mbi 150 materiale muzikore të gjinive të ndryshme.

Larmia e kostumeve, tematika e përzgjedhur e këngëve, e bënë akoma më serioz konkurimin, falë një pune të përkushtuar nga Qarku i Vlorës, duke e shtrirë këtë gjeografi edhe në trevat më të largëta, duke bashkërenduar punën me Bashkitë dhe komunat e të gjithë Qarkut, si dhe duke e ndjekur në çdo hap këtë ecuri, sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Kulturës.

Sipas një kalendari të paracaktuar nga Qarku i Vlorës, filoi edhe audicioni i parë, nga ku u bënë edhe përzgjedhja e grupeve më të mira, të cilat do të paraqiteshin para grupit selektor të Ministrisë së Kulturës, në datën 27 shkurt 2015, ku u paraqitën mbi 26 grupe dhe individë.

Vlerësimi i punës së kryer së deritanishme nga stafi i punës pranë Qarkut të Vlorës, nuk mbeti pa u lavdëruar nga grupi i Ministrisë së Kulturës, për seriozitetin dhe përkushtimin për këtë ngjarje të madhe folklorike.

Ndoshta minutazhi i kufizuar në kriteret e përcaktuara, gjithsesi e tkurr në një farë mënyre shpalosjen e vlerave të mëdha folklorike që ka kjo trevë dhe për një arsye tjetër që vlen të përmendet dhe që është etniciteti që ka Qarku i Vlorës. Por kriteret janë kritere dhe duhen zbatuar.

Është e vërtetë që Qarku i Vlorës shkon në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës me vlerat më të mira, por duhet thënë, se një festival tjetër mbetet pa u shfaqur.

Krahas grupeve të dëgjura në Festivalin e dhjetë Folklorik Kombëtar, si grupi i valles së Drashovicës, grupi polifonik i Dukatit, “Jehona labe”, “Krojet e Velçës”, grupi i Lapardhasë, grupi “Kaonët” Delvinë, grupi i Himarës, grupi “Bilbili”, kënga qytetare vlonjate etj, rikthehet në skenën e këtij

festivali grupi i Selenicës së Vlorës me një këngë në gjuhën arumune(vllahe), grupi i fshatit Brataj etj.

Larmia e tematikës të këtyre këngëve i jep një bukuri të këtij mozaiku që Qarku i Vlorës paraqet në këtë festival.



Stafi organizator:

1. ISTREF DOBI – Drejtor i grupit – Qarku Vlorë
2. ARTUR DHAMO – Udhëheqës artistik
3. VAHIT KUÇAJ – Kmpozitor, - muzikolog
4. THANAS ÇAÇI – Dirigjent, - muzikolog
5. NOVRUZ BAJRAMI - Etnograf
6. KOZMA BILLA – poet, - studjues folklori
7. JANI GJERGJI - Koreograf

PROGRAMI - QARKU VLORË

1. Grupi polifonik i Kaninës – Vlorë (*Shqipëria qe me fat*)
2. Grupi polifonik i Dukatit – Vlorë (*Kush e njih Dervish Alinë*)
3. Grupi polifonik “ Kaonët “ – Delvinë (*O syri që përgjunj mbretin*)
4. Grupi polifonik i Selenicës Vlorë (*Çezma në lajthi*)
5. Grupi polifonik i fshatit Brataj Vlorë (*Dil, moj Vitë*)
6. Grupi polifonik “ Bilbili “ Vlorë (*O vatra ku ndizet zjarri*)
7. Melodi baritore
8. Kënga qytetare vlonjate (*Me yll të sabahut*)
9. Grupi polifonik “ Krojet e Velçës” – Velçë Vlorë (*E zgjodha e jetë shkova*)
10. Grupi polifonik i Lapardhasë- Vlorë.
11. Ansambli “ Çamëria” – Vlorë (valle)
12. Grupi polifonik “ Jehona labe “ – Vlorë (*Bilbil Leskua më thonë*)
13. Grupi polifonik i Himarës (*Qielli i zi*)
14. Grupi i valleve Drashovicë, - Vlorë (*Rrofsh, moj Labëri*)

GRUPI POLIFONIK “ISMAIL QEMALI” KANINË- VLORË

Grupi polifonik “Ismail Qemali” Kaninë është krijuar në qershor të vitit 2000. Ky grup është vazhdim i grupeve polifonike të Kaninës në vite dhe ruan traditën e këngës kaniniote.

Kënga e Kaninës në përgjithësi është kënduar në ziafete e ditë gëzimi, por në mënyrë të organizuar, në vitin 1908, me rastin e vizitës së parë të Ismail Qemalit në Kaninë.

Adem Mersini, (baba Ademi), krijues dhe interpretues i këngës kaniniote, me këtë rast mblodhi rreth vetes 8-10 kaniniotë, i organizoi, bëri prova dhe u kënguan këngë për Ismail Qemalin dhe patriotë të tjerë kaniniotë.

Që nga viti 2000, grupi polifonik “I. Qemali” ka një aktivitet të pasur artistik, nga ku mund të përmendim: pjesëmarrjen në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës në vitin 2000 dhe 2004, në Festivalin e iso-polifonisë në Vlorë në vitet 2002, 2003, 2004, në Odën dibrane, në vitet 2001,2002, 2003 etj.

Në festivale të ndryshme është nderuar edhe me çmime.

Përgjegjës grupi: Meleq Kapllani.

SHQIPËRIA QE ME FAT

Marrës: Fatjon Hyseni & Piro Bregu

Kthyes: Petro Limaj

Hedhës: Vasil Halili

Iso: Virjon Mici

Çerçiz Lushaj

Besnik Merkaç

Ylli Mataj

Andon Zanaj

Shqipëria qe me fat,
që pati tu, goxha burrë,
deputet e diplomat,
shkrive jetën me flamur.

Me gjuhën tënde të mprehtë,
u ngjite lart më lart,
me mendjen tënde të ndritur,
shkrove histori të artë.

Qëndrove përballë dovletit,
si mali në mes të detit,
Evropën e bëre zapë,
vate kërkove hesapë.

Është jona Shqipëria,
nuk lëshojmë asnjë pëllëmbë,
ne kemi zakonet tona,
gjuhën dhe flamurin tënë.

Cili je ti, more burrë,
që na flet me gjuhë bilbili,
unë jam Smail Qemali,
ta dini mirë, ta dini.

GRUPI POLIFONIK I DUKATIT

Grupi aktual i Dukatit, i krijuar në vitin 1985 si vazhdimësi e grupit të mëparshëm të burrave të Dukatit. Ka filluar veprimtarinë me koncertet që janë dhënë në veprimtari të ndryshme, si në Vlorë, ashtu edhe jashtë saj, si në Tiranë, ku mund të veçohet ai i vitit 1986 në festat e Nëntorit. Kulmi i atyre viteve ka qenë pjesëmarrja në koncertin e madh të 75-vjetorit të Pavarësisë Kombëtare, organizuar në Vlorë në vitin 1987 me vallen për Ismail Qemalin.

Pjesëtarë aktiv në FFK Gjirokastër që ga viti 1968 e në vazhdim, pa u shkëputur asnjëherë.

Në vitet 1997-1999, si shumë veprimtari të tjera të kohës, edhe ky grup nuk pati aktivitet. Në vitin 1999 e në vazhdim, grupi i Dukatit ka marrë pjesë në shumë veprimtari kulturore si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

Sot grupi polifonik i Dukatit ka pesë disqe të regjistruara me rreth 70 këngë si edhe video filmike.

Për veprimtarinë e tij, ky grup ka marrë shumë vlerësime, si çmime të para, të dyta, çmime karriere dhe është nderuar me diplomën “ Mirënjohje e Labërisë” në vitin 2008. Këngëtarë të veçantë kanë marrë pjesë në shumë veprimtari jashtë shtetit të organizuar në formacione të tjera artistike.

Si grup më vete ka marrë pjesë në disa aktivitete jashtë vendit, si në veprimtarinë kulturore-artistike në Holandë e Belgjikë dhe vendet e Ballkanit, ku ka marrë vlerësimet maksimale nga publiku dhe organizatorët.

Përgjegjësi i grupit: Fatosh Likaj

KUSH E NJIH DERVISH ALINË

Marrës: Idajet Muka & Fatosh Likaj

Kthyes: Syrja Brahim

Hedhës: Aranit Kulluri

Iso: Bajram Hunda

Beqir Vela

Petref Kulluri

Belo Brahim

Lavdosh Kulluri
Remzi Allushi

Kush e njih Dervish Alinë,
rroba coh mustaqezinë,
përmbi kal me yzengjinë,
kaluar gjykon valinë,
Myzafer të mbledhësh fiqirë,
të bëj gjyle me zinxhirë,
të dërgoj brenda Janinë.

Refreni:

Kush e njih Dervish Alinë,
kaluar gjykon valinë.

GRUPI POLIFONIK “ KAONËT” DELVINË

O SYRI QË PËRGJUNJ MBRETIN

Ato sy kafe me ngjyrë,
ç'ta shtojnë lezetin,
o syri me dorë skalitur,
që përgjunje edhe mbretin,
kur ule lavdinë e tija,
po mua të shkretin.

Pse t'u prish qefi kaq shumë,
ç'pate, moj gushëbardhë,
a mos vallë këngët e mia,

u bënë plumb, të vranë,
ta prisha qejfin i mjeri,
s'majta dot sevdanë.

Brenda kësaj zemrës sime,
është dhe zemra jote,
plagën që më bëre mua,
ç'pate, pse s'ma hoqe,,
hiqma të mjerit, se vuaj,
dhe sytë m'i përllote.

Pse s'e hap të shkretën zemër,
ta bësh portë kafazi,
të hyj dashuria ime,,
të më dalë marrazi,
si guri çarë nga vapa,
xhani për ty plasi.

GRUPI POLIFONIK I SELENICËS - VLORË

Komuniteti i pakicës gjuhësore vllehe (arumune) ekziston prej shekujsh në qytetin e Selenicës, Vlorë. Ata ruajnë akoma doket, zakonet dhe folklorin e të parëve të tyre.

Kënga tradicionale është polifonia toske. Tematika e këngëve të tyre ka të bëjë me jetën e tyre në të kaluarën dhe në vazhdimësi deri në ditët e sotme.

Grupi i këngës polifonike toske e Selenicës është i njohur në aktivitete lokale e kombëtare qysh pas çlirimit të atdheut, në organizimet e para folklorike e deri në Festivalët Folklorike Kombëtare.

Përgjegjësi i grupit është zoti Paskal Kota.

ÇEZMA NË LAJTHI

Marrës: Nasho Dhama

Hedhës: Paskal Kota

Iso: Përparim Çunaj

Illir Dalipi
Pëllumb Ibrahim
Xhevahir Sinani
Florjan Yzeiri

La fantana dit a – una,
oh, o lele,
tsani kaus-mi zdapuna,
oh, o lele.
Refreni:

Tsani kaus-mi zdapuna,
s-mi adun ku lali Tuna,
s-mi adun ku lali Tuna,
oh, o lele,
s-u patrek korba, una karljaciuna,
oh, o lele.

Karljaciuna sh sanatati,
oh, o lele,
karljaciuna sh sanatati,
oh, o lele.

Refreni:

Karljaciuna sh sanatati,
a-tsje jati sh-aatsuj tati,
oh, o lele.
Tsi mi deadar ahtant daparti,
oh, o lele.
Nu s-afla ficior n-hoara,
oh, o lele.
s-ni vadeama oara di oara,
oh, o lele.

Refreni:

Nu s-afla ficior n-hoara,
s-ni vadeama oara di oara,
s-ni vadeama oara di oara,
oh, o lele.

ÇEZMA NË LAJTHI

(*Përkthimi shqip*)

O moj çezma në lajthi,
oh, lele,
mbama kalin që të zbres,
oh, lele.

Refreni:

Mbama kalin që të zbres,
të takohem me xhaxha Tunin,
të takohem me xhaxha Tunin.
oh, lele.

Refreni:

T'ju dërgoj korba të fala,
oh, lele,
të fala dhe shëndet,
oh, lele.

Të fala dhe shëndet,
asaj nëne dhe atij babai,
oh, lele,

asaj nëne dhe atij babai,
oh, lele,
që më dha aq larg,
oh, lele,
si nuk u gjend një djalë në fshat,
oh, lele.

Refreni:

Nuk u gjend një djalë në fshat,
që të shiheshim herë pas here,
që të shiheshim herë pas here,
oh, lele.

GRUPI POLIFONIK BRATAJ VLORË

Grupi polifonik i fshatit Brataj është një grup i ri dhe është krijuar në vitin 2009.

Gjatë kësaj periudhe që nga krijimi dhe deri më sot, ky grup ka qenë pjesëmarrës në shumë aktivitete, ndër të cilat mund të përmendim festivalin e iso-polifonisë që është zhvilluar, pothuaj çdo vit në qytetin e Vlorës dhe është vlerësuar me çmime të ndryshme dhe konkretisht me çmim të parë në vitin 2011.

Përfaqësues të këtij grupi në vitin 2010 kanë marrë pjesë në festivalin “Ganata” në Francë, ku dhe janë vlerësuar me çmim.

Drejtuksi artistik i këtij grupi është rapsodi i mirënjohur, z. Nexhip Sera, i cili ka një përvojë disa vjeçare në polifoninë labe dhe që daton që nga vitet '80. Është autor i mbi 100 teksteve.

Marrës: Fisnik Sulaj

Kthyes: Ervin Kreshpaj

Hedhës: Zadir Serja

Iso: Elidon Kamaj

Erjon Aliaj

Bledar Seraj

Bardhosh Sulaj

DIL, MOJ VITË

Dil, moj Vitë të takoem,
vate von' e nuk ka hënë.

Leri stolitë pa vënë,
se piratët rrugën zënë.

Mos ma le të zezën nënë,
të dergjet qyqe në lëmë.

Refreni:

Dil, moj Vitë,,
dil, mos pritë,
jo me natë,
po dil me ditë.

GRUPI POLIFONIK “BILBILI” VLORE

Ky grupjuridikisht është krijuar në vitin 1994. Në themel të këngës të këtij grupi është polifonia labe e disa trevave të Labërisë. Është pjesëmarrës në disa festivale zonale e kombëtare si dhe në një sërë takimesh folklorike ndërkombëtare.

Grupi folklorik “Bilbili” është fitues i çmimit të parë në Festivalin Ndërkombëtar zhvilluar në Moldavi, në vitin 1995. Në vitin 1996 është pjesëmarrës në Folkloriadën e Parë Botërore, organizuar në Brunssum (Holandë), në Festivalin Folklorik Ndërkombëtar “Balltika” në vitin 1999 është titulluar laureat i Festivalit. Gjithashtu është pjesëmarrës në Festivalin Folklorik “Këngë Jeho”, në Strugë, po në vitin 1999. Në vitin 2002 merr pjesë në Festivalin e Klinës (Kosovë), ku dhe fiton çmimin e parë në këtë festival. Në

Tetor të vitit 2009 është pjesëmarrës në Festivalin e pestë Ndërkombëtar të Izmirit-Turqi e gjetkë. Gjithashtu në takimin e shoqatave kulturore, organizuar në qytetin e Sarandës në vitin 1996, grupi “Bilbili” ka fituar çmimin e parë.

Biografia artistike e këtij grupi është shumë e gjerë dhe e gjithanshme.

Ka nxjerrë në tregun muzikor vendas mbi 20 CD-i, të cilat qarkullojnë, si dhe janë përpunuar e kanë zënë vend në muzikën moderne.

Drejtimes i Grupit “Bilbili “ është zoti Sejmen Gjokoli.

O VATRA KU NDIZET ZJARRI

Marrës: Piro Latifi & Dëfrim Mustafaraj

Kthyes: Sinan Gjoleka

Iso: Trifon Malaj

Hedhës: Sadik Hodo

Tahire Bozhani,

Adriatik Cenko,

Viktor Gjoka

Nënë, moj, sa shumë' të dua,
bot' e tërë je për mua,
fjalët e dhelet e tua,
si bleta mëmë në zgjua,
o nëno.

Refreni:

O nëno, nënë xhani,
o nënë, t'u falt' imani.⁽¹⁾

Sido bota që të jetë,
të mungojn' diell e retë,
erë nënë prapë do ketë,
djepi që përkund çdo jetë,
o nëno.

Emrin nënë, zoti ta fali,
e bardhë si borë mali,
o vatra ku ndizet zjarri,
përjet i pashuar malli,
o nëno.

() Përsëritet si refren pas çdo strofe

MELODI BARITORE

Përbërja e grupit:

Vendim Kapaj – Mjeshtër i Madh - fyell
Gjergji Karroqe
Vasil Sera
Fatmir Malaj
Robert Prifti

KËNGA QYTETARE VLONJATE

E kënduar në variantin e sazeve, ose e thënë, e kënduar në grup, ku këngëtarë, ishin vet instrumentistët.

Më vonë lindi forma e të kënduarit, orkestër me solist, ose grup solistësh.

Duhet thënë, se Vlora, karakteristikë të spikatur, ka patur trion, pa përfshuar duetet ose solistët, ose e kënduara në grup solistësh, mix.

Kjo këngë, për nga motivi muzikor na vjen shumë e hershme, po ashtu edhe teksti është burimor. Një lirikë tipike e këngëve vlonjate në avazin “ hidh e prit”, e thënë kështu në zhargonin popullor.

Nuk ekziston ndonjë deputim i kësaj kënge në ndonjë konkurim të nivelit kombëtar. Pra, është një prezantim për herë të parë i këtij materiali muzikor.

Kjo këngë i takon repertorit butimor të këngës së traditës qytetare.

Orkestrina:

Sajmir Sadikaj – fizarmonikë	Adrian Çifçiu – llahutë
Albano Kapllani – violinë	Sajmir Rushani – Def
Fatmir Kapllani – violin e dytë	Dorjan Kapllani – sistër

Këngëtarët:

Ludmilla Baballëku Lefter Suparaku

Rovena Brahimi
Drini Kanani

Anida Llanaj

ME YLL TË SABAHUT

Me yll të sabahut-ë,
shkoi trimi, o moj, syzezë,
opo. - 2 herë

O djal' i gëzuar-o,
pse po shkon duke kënduar,
opo. - 2 herë

Të të zgjoj', moj vetullzez',
pa dal', moj dielli në mëngjes,
opo. – 2 herë

Pritëm sa të vi dhe unë,
i lashë nazet, se të dua shumë,
opo. 2 herë

GRUPI POLIFONIK “ KROJET E VELÇËS” VELÇË VLORË

Ky grup është strukturuar në vitin 1949 në veprimtari folklorike locale sipas organizimeve artistike në kontekstin historike – shoqëror të atyre viteve. Merr pjesë në konkurimet zonale në vitin 1956. Në vitin 1974 ftohet dhe inçizon një bllok këngësig ne Radio Tirana. Në vitin 2000 mer emrin “Krojet e Velçës”. Ka qenë i pranishëm në të gjitha veprimtaritë me bazë këngën polifonike si: Festivali i Isopolifonisë, Bylispolifonia, Festivali Folklorik Kombëtar Gjirokastrë dhe në të gjitha veprimtaritë e Shoqatës Atdhetare Kulturore “Velça”.

E ZGJODHA E JETË SHKOVA

Marrëse: Bejushë Demaj Bajrami

Kthyes: Agim Brahimaj

Hedhës: Valter Shabanaj

Iso: Adrian Hoxhaj

Fatmir Maliqi

Bejkush Murataj

Kalo Zenelaj

Klodian Çelaj

Lutfi Habilaj

Gilo Habilaj

Ballkonin gëlqeren borë,
jari nani, nani¹,
dola me ibrik në dorë,
plasën lulet në oborr.

Plasën lulet se është vapë,
më thonë: “portën mos e hap,
se troket një djalë i prapë”.

Lulet me ibrik vadit,
aromat i lanë zilitë,
dhe i thanë djalit: “mos ik”.

Përsëri porta troket,
më thanë lulet: “shihe vetë”,
ish pëllumbi i vërtetë.

GRUPI POLIFONIK I LAPARDHASË VLORË

Ky grup është një grup më i ri në krahasim me grupet e tjera të trevës së Labërisë dhe sapo shfaqet në skenën e polifonisë labe zgjon vëmendjen, jo vetëm të dëgjuesve, por edhe të studiuesve të shumtë. Përmes këngës “Janinës ç’i panë sytë”, interpretuesit e saj, gjashtë djem të rinj (për atë kohë), të gjithë këngëtarë të zellshëm e të talentuar, treguan se polifonia labe mund të jepet me muzikalitet e kulturë të lartë artistike. Ky grup vazhdoi dhe vazhdon të kontribuojë vazhdimisht në polifoninë labe duke sjellë prurje të reja. Është pjesëmarrës në Festalet Folklorike Kombëtare që pas vitit 1983 dhe është laureuar disa herë. Përveç koncerteve dhe takime brenda vitit, ky grup është pjesëmarrës dhe në disa takime ndërkombëtare, ku dhe ka marrë vlerësime të ndryshme.

DËRGON GJOLEKA NJERINË

Marrës: Nazif Çelaj

Kthyes: Golik Likaj

Hedhës: Meleq Çelaj

Iso: Babaçe Brahimaj

Valter Hoda

Dërgon Gjoleka njerin’,
Lumi i Vlorës të më vijn’,
të shkulen gjer në Radhimë,
kemi punë me osmanllin’,
kaptuam Shën Vasin’,⁽¹⁾
hyn pellgut në Delvin’,
me pallë bën’ kërardin’.

ANSAMBLI “Çamëria” VLORE

Ansambli “Çamëria” Vlorë u ktijua në vitin 1978, në kuadër të organizimit të Festivalit Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës për të pasqyruar folklorin e pasur, të larmishëm dhe autentik të kësaj treve.

Deri në këtë kohë kënga dhe vallja çame këndohej e kërcëhej nëpër dasma e gëzime familjare. Ishin këta artistë popullorë të evidentuar ndër vite. Në repertorin e tij të pasur spikatën vallet e burrave dhe të grave.

Ansambli “Çamëria” ka qenë pjesëmarrës në shumë festivale e koncerte, organizuar në shkallë kombëtare, si edhe jashtë shtetit, si: Drenas-Kosovë., Prishtinë, Shkup-Maqedoni, Stamboll, Izmir, Bura, Ynegul të Turqisë e gjetkë.

Sot ansambli “Çamëria” qëndron dhe funksionon rregullisht, si me grupin e të rriturve, të të rinjve, ashtu edhe me fëmijët e vegjël.

Përgjegjësi i grupit është Halim Halimaj.

Përbërja e grupit:

Jugerta Derraj
Xhoela Bejazi
Xhoana Bendo
Desiderja Aliaj
Irisa Bilbilaj

Estela Balo
Kadrina Qerimi
Elvira Xhemalaj
Entela Ymeraj

Orkestrina

Neki Bajrami – klarinetë
Ardian Muka – llahutë

Marsel Muka – violinë
Habib Mama – dajre

GRUPI POLIFONIK “ Jehona labe “ VLORE

Jehona labe është një grup polifonik i krijuar vitet e fundit dhe pikërisht në vitin 1998, por që ka vënë vulën në këngën polifonike.

Koncertin e tij të parë e ka dhënë në vitin 1998 para publikut vlonjat dhe më pas ka dhënë një sërë koncertesh në qytete e ndryshme të Shqipërisë si,

Sarandë, Fier, Tiranë, Durrës, etj. Është pjesëmarrës në Festivalin Folklorik Kombëtar të vitit 2000, ku spikati me këngën : "Hamit Guga një pëllëmbë", ku dhe u laureua. Përveç pjesëmarrjes në veprimtaritë folklorike brenda vendit ka marrë pjesë në shumë veprimtari edhe jashtë tij. Kështu në Festivalin e Gjirokastrës të polifonisë labe në vitin 2002 ka merituar vendin e dytë, ndërsa në takimin e Isos polifonike, organizuar në Vlorë në vitet 2003 dhe 2004 ka zënë përkatësisht vendin e dytë dhe vendin e parë. Gjatë kësaj jete të re artistike, grupi "Jehona labe" ka dhënë koncerte në Greqi, Austri, Itali, Kosovë. Krijimtaria e këtij grupi është përfshirë në disa albume muzikore.

BILBIL LESKUA MË THONË

Marrës: Berdo Berdo

I ziu veqili ynë,
që t'u këpunë e t'u qinë,
që në Vlorë e në Janinë.

Refreni:
Çfar' kërkon, moj çfarë kërkon,
kërkoj bedel për bilbil,
kërkoj bedel për bilbil.

Bilbili shkallë më shkallë,
o i linduri me armë,
me pisqollë e jataganë.

Refreni:

Bilbil Leskua më thonë,
vetëtinë ajo shpatë,
tmerr i Portës së Lartë.

Ja ku doli dhe bilbili,
kot sa u lodh karafili,

hyri brenda te veziri.

Refreni:

Tundu vezir në fron,
seç u ngrenë edhe thanë,
vallë i kujt është ky djalë.

Nga divani seç u ngrenë,
njëri-tjetrin e pyenë,
vallë e kuja kjo pemë.

Refreni:

Shkuan trimat, shkuan tutje,
në Stamboll të shtatë vanë,
pall' e larë e Lesko Duke,
bilbili mbi supet tanë.

GRUPI POLIFONIK I HIMARËS

Kënga himarjote është e hershme. Zanafilla e saj ka nisur shumë vite më parë. Për të mos vajtur shumë larg, e gjejmë rreth viteve '30 me pionierin e zhvillimit dhe të përhapjes së saj i madhi Neço Muko, i cili e ngriti dhe e bëri të njohur, jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë Shqipërisë që me grupin e tij në Paris regjistroi qindra këngë bashkë me këngëtarën e njohur Tefta Tashko Koço.. Janë të njohura këngët e bukura himarjote, si: "Vajza e valave", "Erdhi prilli, shkriu bora", "Moj Katina nina-nina" e shumë e shumë të tjera. Këtë traditë të bukur të këngës himarjote e vazhdoi që në vitet '50 të shekullit të kaluar e vazhdoi me dinjitet grupi me marrës Artistin e Merituar Dhimitër Varfi.

Në vitin 1983 ngjitet për herë të parë një grup i ri, i cili merr pjesë në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës dhe me këngën " Llaj çoban", kënduar me mjeshtëri nga këngëtarja. Tashma e mirënjohur Katina Beleri, vlerësohet " Laureat i Festivalit".

Në vitin 1988. Kënga “ Thllëza që shkel mbi vesë” e bën të mundur që ky grup të ngjitet përsëri në bedenat e Kalasë së Gjirokastrës, ku marrësja Katina Beleri shpalosi edhe një herë vlerat e saj të shkëlqyera interpretative, pasuese e denjë e e Neço Mukos dhe Dhimitër Varfi. Për bioografinë e pasur artistike, ky grup është vlerësuar nga Presidiumi i Kuvendin Popullor me medaljen “ Naim Frashëri”.

Pjesëmarrës ky grup edhe në Festivalin Folklorik Kombëtar të Beratit, i cili u paraqit me këngën “ Një thëllëzë e shkruar prilli”. Në vitin 1996, ky grup merr pjesë në Folkloriadën e parë Botërore në Holandë, si pjesë përbërës i Ansambllit të Vlorës.

Në vitin 2000, po në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës, ky grup vlerësohet me “ Certifikatë mirënjohje”, nga Presidenti i atëhershëm i Festivalit, zoti Edi Rama.

Ky grup është pjesëmarrës në të gjitha Festalet Folklorike Kombëtare dhe ka fituar disa trofe. Kënga himarjote ka një përmbajtje ideoemocionale, me nota shpesh lirike, ka një interpretim me nivel e cilësi të lartë artistike. Sa herë që dëgjon këngën himarjote nuk ka si të mos sjellësh ndër mend këngëtarin plot pasion, me zërin e tij drithërues e plot melodik e emocion, të pazëvendësueshmin Dhimitër Varfi, i cili i ka vënë vulën kësaj kënge. Që nga ajo kohë kanë dalë breza të rinj këngëtarësh, të cilët e ruajnë, e kultivojnë dhe transmetojnë shumë bukur këngën himarjote. Dhe këtu vlen për të përmendur këngëtarja e mirënjohur të këtij grupi Katina Beleri, etj.

QIELLI I ZI

Katina Beleri – *marrëse e grupit*
Arben Zoto – *kthyes i grupit*
Aleksandër Dhrami – *hedhës i grupit*

Iso: Andon Burbo
Niqifor Konomi
Marko Guma
Themistokli Polo

Qielli i zi,
nata ç'u nxi,
o natë e keqe,
o natë e ligë,
bie shi.
Nata vazhdon,
deti gjëmon,

jeta qetsohet,
zëri më s'dëgjohet,
është vonë.

Refreni:

Dil, moj,
dil e dëgjo zënë,
kujto dashurinë.

Ti nuk je,
që bëje be,
atë që thoshje,
që more premtoshe,
ku i ke?
Jashtë s'ka njeri,
një vetëm rri,
jam unë që pres,
që more thërres,
qaj për ty.

GRUPI I DRASHOVICËS

Fillesat, grupi polifonik i Drashovicës, janë në maj të vitit 1950. Me ngritjen e shtëpisë së Kulturës, në vitin 1956, aktiviteti filloi të rritej, duke ruajtur vlerat autentike të fshatit.

Pas ndryshimeve të sistemit, grupi u shpërnda dhe u ringrit në vitin 2005.

Grupi i vales i Drashovicës është vazhdim i grupeve karakteristike të zonës. Ky grup, ndonëse i ri, është vazhdim i traditave të shkëlqyera folklorike të të parëve.

Biografia artistike e këtij grupi ndonëse është e pakët në krahasim me grupet e tjera, por vlen të theksohet se ky grup u paraqit denjësisht në Festivalin Folklori Kombëtar të Gjirokastrës në vitin 2009 me vallen " Të vranë, Drashovicë". Gjithashtu, ky grup është pjesëmarrës në dy festivale ndërkombëtare, në Bylis. Ka dhënë koncerte jashtë Shqipërisë, sin ë Turqi,

Maqedoni, Kosovë e gjetkë. Ka qenë pjesëmarrës në Festivalin “ Oda dibrane, Peshkopi, Në “Shtëpinë e folklorit” Tragjas.

Përgjegjësi i këtij grupi është zoti Nazmi Kola.

RROFSH, MOJ LABËRI

(valle e kënduar)

Resmi Bani – solisti i parë i valles

Frederik Kola – solist i dytë

Dule Gjoka

Qani Salati

Adif Mema

Pelivan Ruçi

Zamir Gjoka

Piro Resuli

Nardi Kola

Artan Hoxha

Kërcejmë dhe tundim vend,
sup më sup si malet zënë,
vallen labe hedhin rëndë,
biem në gjunjë si shkëmb,
ngrihemi shqipe në këmbë,
rrofsh, moj Labëria nënë,
për magjinë që na ke lënë,
për zjarrin që na ke dhënë,
labi monument në këmbë.

*Figura të shquara
grupe dhe rapsodë
mendime... etj*

THEMISTOKLI MONE (*Artist i Merituar*)



Themistokli Mone ishte kompozitor, dirigjent, drejtues artistik i sa koncerteve, drejtues i grupit folklorik të Vlorës në Festvalet Folklorike Kombëtare të Gjirokastrës deri sa doli në pension. Ai është drejtuesi i parë i Ansamblit “Labëria”. Mbetet personaliteti më i spikatur në gjysmën e dytë të shek. XX.

Ndoshta është folur shumë pak për këtë figurë madhore të këngës dhe kulturës dhe artit muzikor vlonjat në përgjithësi.

Rridhte nga një familje me tradita në fushën e kulturës. Ai vet do të studionte në konservatorin e Romës, dëshirë kjo dhe e babait të tij, të cilin nuk e përfundoi dot për shkak të Luftës së Dytë Botërore. Roli i tij është i padiskutueshëm në jetën artistike të qytetit të Vlorës, pas Luftës së Dytë Botërore, duke spikatur me energjinë dhe përkushtimin e tij për të organizuar koncerte dhe argëtuar bashkëqytetarët e tronditur nga pasojat që kishte lënë Lufta në qytet.

Mund të thuhet se është muzikanti i parë dhe i vetëm që solli në skenë këngën qytetare vlonjare, pas një pune të gjatë

hulumtuese, duke i marrë ato drejtpërdrejt nga populli duke i përpunuar e duke u bashkangjitur atyre instrumentet shoqëruese, siç janë: fizarmonika, klarineta, llahuta, defi etj.

Me të drejtë ai mund të konsiderohet “babai” i këngës popullore qytetare vlonjate dhe i grupit “Trio vlonjate”, duke bërë bashkë e ngjitur në skenë tre këngëtarë që i dhanë emër dhe e bënë të njohur Vlorën, me këngët e bukura vlonjate, të cilat edhe sot këndohen në të gjithë vendin, duke u dalluar menjëherë se janë “këngë të Vlorës”.

Punës për vënien në baza muzikore iu shtuar edhe kompozitori dhe këngëtar i mirënjohur Reshat Osmani që të dy së bashku arritën në përfundimin për llojin e orkestrës që i shkonte për shtat kësaj kënge.

Këngët e kënduara nga “Trioja vlonjate” të shoqëruara nga kjo orkestër u pritën mirë në popull dhe ishin lehtësisht të kuptueshme dhe që mësoheshin lehtësisht për t’u kënduar. Kënga popullore qytetare vlonjate ka kryesisht karakter lirik, i kushtohet dashurisë, jetës, realitetit të përditshëm shoqëror e familjar. Ndër vite kënga qytetare vlonjate pati një rritje cilësore, duke ndryshuar shumë nga fillimet e saj, aq sa dy kompozitorët filluan që t’i kompozonin këngët në përshtatje me zërat, stilin dhe karakteristikat e këngëtarëve që përbënin “Trion vlonjate”. Në repertorin e grupit në të gjithë historinë e tij mendohet se janë më shumë se 150 këngë popullore qytetare vlonjate, të cilat deri sot janë të pa mbledhura, me qëllim ruajtjen e tyre dhe botimin për t’u shërbyer brezave.

Një kontribut të jashtëzakonshëm Themistokli Mone ka dhënë edhe në drejtim të këngës polifonike, pasi ai e ka njohur paraprakisht atë, duke e shkelur dhe dëgjuar nga goja e bartësve, gjë që e vuri në pozita pune për t’i paraprirë atij eventit që do niste startin e tij në kalanë e Gjirokastrës, të Festivalit Folklorik Kombëtar, ku Vlora nën drejtimin e tij mori pjesë që në festivalin e parë të vitit 1969, të festivalit të dytë 1973 e për t’ia kaluar stafetën me dinjitet Artistit të Merituar Haxhi Dalipi.

Ka një kontribut të gjithanshëm në jetën kulturore e artistike të Vlorë që nga këngët për fëmijë e deri tek opereta e tablotë muzikore për të vegjël e për të rritur. Në këtë drejtim mund të përmendet “Dasma vlonjate” që është një produksion i plotë prej tij.

HAXHI DALIPI
(Artist i Merituar)



Do të donim ta kishim midis nesh, të bisedonim, të na drejtonte e t'i merrnim mendim, sepse i dha Vlorës në drejtim të festivaleve folklorike kombëtare, por ja që nuk ndodh kështu. Ligjet e natyrës nuk mund t'i ndryshojmë.

Ndonëse i lindur në Gjirokastrë, por jeta, puna artistike e lidhi me Vlorën, aq shumë, sa që shpesh herë kur flitet për ndonjë veprimtari ai do të jetë i pranishëm me emrin dhe veprën e tij, sepse i madh ishte kontributi që ai dha në lëvizjen artistike të qytetit të Vlorës dhe në rrethinat e saj. Pa e hiperbolizuar mund të themi se kishte hyrë në çdo qelizë të artit vlonjat, ishte një njohës i mirë i këngës së Labërisë dhe i këngës qytetare vlonjate, ndaj dhe punoi me përkushtim dhe pasion, duke lënë një model të një intelektualit dhe profesionistit të zot. Do të mbahet mend gjatë nga breza e breza këngëtarësh e talentesh të reja, nga instrumentistë me orkestracionet e tij, këngëtarë e grupe polifonike, nga kolegë e mbarë komunitetin ku ka derdhur shpirtin e tij artistik.

Ky ishte Artisti i Merituar, Haxhi Dalipi, deri në momentet e fundit të jetës së tij.

Studioi fillimisht për flaut në Liceun Artistik “Jordan Misja” në Tiranë dhe më pas përfundoi Akademinë e Lartë të Arteve për dirigjim dhe kompozicion.

Puna e vazhdueshme, e palodhur dhe pasionante bëri që Artisti i Merituar, Haxhi Dalipi, të punojë për 15 vjet rresht si përgjegjës i sektorit të muzikës në Pallatin e Kulturës “Labëria” Vlorë. Gjithashtu ai ka punuar si dirigjent në formacionet më të mëdha të orkestrave të vendit, si në Vlorë, ashtu edhe në Tiranë. Në të njëjtën kohë ai ka qenë edhe drejtor artistik i ansambllit “Labëria”, ku dhe është laureuar edhe me çmime kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në vitin 1988, Haxhi Dalipi krijoi orkestrën simfonike dhe filarmoninë e qytetit të Vlorës. Ka punuar si dirigjent i korit të qytetit të Vlorës, në Akademinë e Lartë të Arteve dhe orkestrën e Radiotelevizionit shqiptar. Në mediat e shkruara ai ka botuar një numër të shumtë artikujsh dhe studimesh duke dhënë përvojën e

tij si muzikolog në shumë simpoziume e konferenca muzikore në Shqipëri dhe jashtë saj, si në Greqi, Itali, etj.

Në gjithë trevat e Jugut ai thirrej edhe si profesor i muzikës polifonike labe. Gjatë karrierës së tij artistike, në fushën e kompozimit, ka shkruar vepra për kor, si: romanca, balada, rapsodi, opereta për fëmijë, këngë të ndryshme dhe për fëmijë, etj. Haxhi Dalipi është gjithashtu i njohur edhe për kompozimin e muzikës së re e asaj alternative.

Artisti i Merituar Haxhi Dalipi, ka përgatitur dhe udhëhequr festivalet folklorike kombëtare të viteve 1978, 1983 deri në festivalin 1988, ku Vlora ka fituar edhe trofe.

Puna si drejtor i shkollës së mesme Artistike “Naim Frashëri” në Vlorë, konsolidoi profesionalizëm në rritjen e talenteve të reja, ashtu siç dihet edhe kontributi i tij si drejtor në Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe të valleve popullore, si dhe pedagog në Akademinë e Lartë të Arteve në Tiranë.

TRIOJA KARAKTERISTIKE E DUKATIT

(Leko Gjoleka, Bego Vangjeli e Sulo Bozhani)



(Dalë në një nga koncertet në Folkloriadën e Parë Botërore – Brunssum – Holandë 1996)

Grupi karakteristik i fshatit Dukat mund të thuhet me plot gojë që është një nga grupet më të degjuara dhe më autentikë të iso polifonisë, mbështetur fort në tabanin popullor.

Ky grup ka nxjerrë këngëtarë dhe rapsodë të shquar dhe që kanë dhënë tonin në çdo ngjarje polifonike, duke u vlerësuar disa herë në Festalet Folklorike Kombëtare, organizuar në qytetin e gurtë të Gjirokastrës.

Në këtë grup kemi një risi dhe ku gjen vend edhe ajo shprehja, se “kur bëhen tre lebër bashkë ia marrin këngës”.

Midis shumë motiveve, njeri më i bukur se tjetri, të këngëve labe, një interes të veçantë paraqet edhe trioja dukatase. Quhet kështu, se është kënduar e vazhdon të ruhet vetëm në fshatin Dukat.

Nga burime të vjetra mësojmë se ky motiv është kënduar shumë kohë më parë vetëm me dy vetë dhe më vonë me tre. Kjo mënyrë të kënduarit me pak këngëtarë, mendojmë se e ka burimin në faktin që dukatasit kanë jetuar të shpërndarë maleve me bagëti

dhe, aty kur ata bashkoheshin dy, ose tre vetë, ia merrnin këngës. Këtë mendim e përforcon edhe pozicioni që marrin këngëtarët, kur këndojnë. Ata ulen në shesh, vendosin një dorë në faqe pranë gojës (*kjo bëhet që të mos shpërndahet zëri*) dhe ia nisin këngës. Pozicioni i marrë prej tyre tregon se kënga është kënduar maleve mbi një bokërrimë, a mbi një gur.

Pikërisht ata janë tre: Leko Gjoleka, Bego Vangjeli dhe Sulo Bozhani. Një harmoni e jashtëzakonshme, një melodicitet i arrirë në shkallën superiore. Ata janë njëkohësisht marrës, kthyes, hedhës dhe mbajtës isoje.

Kujdes i veçantë që është treguar nga bartësit e kësaj veçantie për ruajtjen e pasurimin e traditave të folklorit tonë të mrekullueshëm, e pruri atë deri në ditët tona. Dhe jo vetëm kaq, por e ngriti atë edhe më lart.

Dukatçen e këndojnë, pothuaj të gjithë dukatasit, por një meritë të madhe për ruajtjen dhe përhapjen e saj e kanë këngëtarët e njohur Bego Vangjeli, Leko Gjoleka e Sulo Bozhani. Me zërin e tyre të bukur e melodioz, me punë këmbëngulëse, ata i kanë dhënë këngës dukatçe një forcë të re dhe e kanë bërë atë të bukur e të gëzueshme.

Kur erdhën dritat elektrike në Dukat, Begoja, Lekua dhe Suloja këndonin:

Sa bukur duket Dukati,
me dritë u ndriçua fshati,
në Dukat të Labërisë,
na erdhi drita, na u çelën sytë.

Ishin pikërisht këta tre djem të rinj, atëhere në moshë të re që do të hapnin siparin e tyre në vitin 1966, dy vjet para fillimit të FFK Gjirokastër në një festival folklorik në Lezhë, në vendprehjen e Heroit tonë Kombëtar Gjergj Kastriotit, me një këngë kushtuar këtij heroi të titulluar “Pesëqind vjet kanë kaluar, kapedan, o Skënderbe”.

Kjo dalje në skenë dhe një tjetër para saj u bënë si pikënisje për t’u ngjitur në kalanë e Gjirokastrës që në Festivalin

e parë Folklorik Kombëtar, në vitin 1968, në këtë sofër të madhe të folklorit shqiptar, së bashku me grupin polifonik të Dukatit, i cili u paraqit me këngën “ O popull me traditë, ku në këtë Festival grupi i Dukatit ka qenë fitues i medaljes së bronzit.

Dhe këta të tre, e njohur si treshja e Dukatit, nisën dhe vazhduan rrugëtimin e tyre nëpër skena të ndryshme e festivalesh duke përcjellë me profesionalizëm këtë të veçantë karakteristike të këngës dukatase, një treshë e papërsëritshme, e konsoliduar, duke dhënë një leksion për brezat që vijnë. Ata mbeten autentikë dhe të pakopjueshëm.

Për të folur rreth kësaj kënge të treshes së Dukatit, ndoshta, asnjë libër i veçantë nuk do ta përmbledhte historinë dhe rrugëtimin e këtyre burrave të këngës dukatase.

Në skenat jashtë vendit ata kanë treguar fizionominë e tyre duke vënë në mendime edhe studjuesit më në zë të folklorit botëror.

Unë do të ndalem në një nga këto veprimtari ndërkombëtare, ku ata ishin pjesëmarrës dhe pikërisht në Folkloriadën e Parë Botërore në Brunssum të Holandës në korrik të vitit 1996, ku ansambli i Qendrës Kulturore të Vlorës ishte pjesëmarrës në këtë ngjarje të parë folklorike botërore.

Ata ishin epiqendra e çdo koncerti, në të përditshmet e tyre që jepeshin për publikun e atij qyteti që priti artiste nga 62 vende të botës. Them se ishte epiqendra, për vet karakteristikën dhe veçantinë e të kënduarit të kësaj treshë, sa që tërhoqi vëmendjen e studjuesve që ishin të pranishëm në këtë Folkloriadë. Interpretimi virtuoz i tyre ishte i paarritshëm dhe i papërsëritshëm. Por krahas anës profesionale të të kënduarit, ajo që më ka bërë përshtypje tek këta këngëtarë brilantë, ishte korrektësia, sjellja, edukata, mirësjellja dhe çdo gjë tjetër e mirë që mund të karakterizojë një njeri. Kjo anë vlen për t'u vlerësuar për çdo njeri dhe aq më tepër për çdo artist.

Le të hidhemi përsëri tek kënga dhe mënyra e të kënduarit. Këto këngë dhe ky lloj të kënduari është pronë e tyre, e trashëguar

nga të parët e që vjen e gjallë deri në ditët e sotme. Pikërisht se ka lindur dhe është rritur në Dukat, ajo mban vulën e këtij fshati të dëgjuar për këngë, e trimëri. E lindur dhe lëvruar në këtë fshat, e përsosur në mënyrë jashtëzakonisht bukur pikërisht nga kjo treshe, ajo është e paarritshme dhe e pakopjuar nga të tjerë, në se mund të shprehemi kështu në mënyrë figurative.

Lekoja, Begoja dhe Suloja, sa herë që takohen, bashkohen kokë më kokë dhe ja nisin dukatçes. Të moshuarit i dëgjojnë nga goja e tyre këngët e vjetra të Dervish Aliut e të tjera dhe mallëngjehen, ndërsa të rinjtë mësojnë prej tyre dhe i zhvillojnë këto tradita.

Le të jenë këto fjalët e mia shenjë respekti e mirënjohje për këta tre burra të vyer dhe le të shërbejnë si pikënisje për studjuesit e këtij zhanri për të nxjerrë në pah profesionalisht vlerat e tyre.

KËNGA HIMARJOTE

KËNGA POLIFONIKE E HIMARËS

Kënga polifonike e Himarës ngjall emocione të mëdha, të thella e të fuqishme. Ajo shkakton në ndërgjegjen tonë estetike herë nota lirikeqë të fusin në një ngazëllim të shpirtit njerëzor, në meditime për dashurinë dhe jetën, në një dhembje të thellë, etj. dhe herë nota epike që shprehin përpjekje, sakrificë, qëndresë, vendosmëri.

Përmes kësaj përmbajtjeje ideoemocionale, ne ndiejmë dashurinë e një populli për jetën dhe truallin e tij, hovin dhe dëshirën e tij për ta gëzuar jetën, shpirtin poetik dhe, njëkohësisht, talentin e shquar artistik të tij. Këngët: "Vajzë e valëve", "Hyri prilli, shkriu bora", "Moj Katina nina-nina", "Dallëndysh' e vogël-o", etj, përbëjnë kulme për folklorin muzikor shqiptar në tërësi.

Melodika himarjote shquan nga një shtrirje tonale e gjerë-hapësira mes notave të skajshme të saj shkon prej oktavës e gjer në tercë mbi oktavë (decimë). Ajo ndërtohet, zakonisht, në shkallë muzikore shtatëtingëllore (heptatonike). Kjo lloj melodike fillon, përgjithësisht, me gradën e parë të shkallës dhe mbaron po me këtë gradë, duke qenë kështu mjaft e qartë në ndërtimin modotonal.

Kënga himarjote është një këngë katërzërëshe, ku tre solistët dhe kori, luajnë role e funksione të caktuara. Duke qenë se këtu marrësi, kthyesi dhe isoja parimisht nuk sjellin ndonjë dukuri të re në funksionet e tyre, hedhësi shfaqet i veçantë dhe kësisoj kushtëzon në një masë të konsiderueshme, origjinalitetin e saj. Në këtë këngë, hedhësi përbëhet nga një tingull i vetëm, i cili qëndron ngaherë një tercë të vogël mbi notën bazë, pra, është një lloj isoje e dytë, shfaqet i rrokëzuar, gjithashtu si isoja; interpretimet përmes një drithërime të vazhdueshme zëri tepër karakteristike që afron me një tremolo, nëse mund ta quajmë kështu; parapëlqim i tij duket të jetë, veçanërisht, thirrja patetike

“hajde de”, etj. Ky lloj hedhësi përbën një nga risitë e mëdha të stilit himarjot në rrugën e evolucionit historik të tij.

Në dallim nga mjaft këngë labe krahinash të tjera, kënga polifonike e Himarës krijon një harmoni katërzërëshe, gjë që e kushtëzon prania e vazhdueshme e hedhësit.

Roli i interpretimit mbetet i pazëvendësueshëm, sa në transmetimin e përmbajtjes ideoemocionale, aq dhe në ruajtjen e origjinalitetit të stilit muzikor të Himarës. Melodika e zhvilluar e marrësit, tiparet që e shquajnë atë në përgjithësi, mund të jepen vetëm nga tenorë me aftësi të mëdha profesionale dhe që e njohim mirë stilin himarjot të të kënduarit. Nevoja e njohjes së stilit shtrohet njëkohësisht edhe për kthyesin, sado që ky zë afron mjaft me kthyesin e këngës labe në përgjithësi dhe asaj kurveleshase në veçanti. Drithërima karakteristike e hedhësit, e cila ndikon aq shumë në bukurinë dhe origjinalitetin e stilit muzikor himarjot, kërkon sërish aftësi të mëdha profesionale. Ndërsa isoja e rrokëzuar lipset të stabilizojë sa më mirë tingëllimin e përgjithshëm të këngës.

(Marrë me shkurtime nga libri “Këngë polifonike labe”)

Kënga himarjote ka qënë, është dhe do të mbetet burim frymëzimi për poetët. Bukuria e saj nuk mund t’i lë pa u prekur telat e zemrës atyre, pa derdhur në vargjet e tyre në mënyrë të sintetizuar këtë bukuri, gërshetuar në mënyrë harmonike me qëndresën e himarjotëve, mikpritjen e tyre, figurat e shquara të kësaj krahine mpleksur me këtë qëndresë dhe heroizëm që ka treguar gjatë gjithë historisë së ekzistencës së saj.

Ja si shprehet poeti:

KËNGË HIMARJOTE

O **Himarë** në breg të detit,
fshatrat si margaritarë,

ç'ia rrëmben zemrën poetit,
ja bën zog në tramudanë,,,

Të kam njohur pa të parë,
që kur njoha këngën tënde,
këngën tënde, moj **Himarë**
plot me derte e me dhembje.

Plot me dhembje e me derte,
plot me valë gëzim plot,
kë s'magjeps e s'bën për vete
ti, moj kënga himarjote ? ...

Marrësi, - butë si trëndafil,
kthyesi,- si gurgullim kroi,
hedhësi, - ligjërim bilbili...
kush të ndien e s'drithëroi?...

Mijëra vjet asnjë orkestër
ison tënde nuk e zhduku,
s'ngjiti dot avaz tjetër
as bri turku, as buzuku...

Je një syth dashurie
buzë detit, anës bregut,
majë malit – vrull stuhie,
vetëtimë, krismë dyfeku...

Kur ja merr Ti për kurbetin,
nur i zi u bie reve,
thinjet Çika, nxihet deti
si shami e kallogreve.

Djemtë e tu, ngado që vanë
të morën në gji me vete
çave dete e oqean
po s'u lige, nuk u trete

Neço Muka në Paris
të vu në pllakë gramafoni.
nga çdo vend e nga çdo vis
djemtë e tu po të këndonin.

.....

Te ky Breg me dallgë deti
dhe vajtimi i ngjan këngës...
O jeto! Ojeto!...
nuk shqitet nga buzë e nënës...

O jeto! - i the ti Gjonit,
të birit të Skënderbeut,
kur mbërriti në Himarë
dhe puthi grushtin e dheut...

O Jeto! - i the Damianit,
dhe i lidhur - zgalem deti...
dushmani rrih, ai këndonte:
“Kush është lule e vilajetit...”

O jeto! – i the Bajronit,
dhe i bërë konak mikut,
dhe poeti të këndoi:
“Shpinën s'di t'ia kthesh armikut...”

O jeto! është isua e Bregut
mbi këta gurë të qëmotshtëm,
ndaj dhe Bregasi k'të këngë
s'e ndërron t'i falin botën.

Se ndërron,t'i falin botën
këtë det e këto troje,
andaj **kënga himarjote**
fluturon me krahë shqiponje.

BASHKIM KOZELI
(Shkruar në Qafën e Llogorasë)

* * *

VLERAT E KËNGËVE TË KËNDUARA NGA GRUPI I NEÇO MUKËS

I vetmi grup i organizuar i këngës himarjote, i ngritur para çlirimit, është grupi i Neço Mukës, i cili e ka ushtruar veprimtarinë e tij rreth viteve '30 të shekullit të kaluar.

Ky autor dhe bashkëpunëtorë të tij, e pasuruan dhe i dhanë vlera të reja këngës himarjote. Neço Muko, i mbështetur fort në meloditë e këngëve të vjetra himarjote, duke shkruar vet tekste të goditura në vargje të larmishme, 4, 5, 6, 7, 8 e më shumë rrokëshe, vargje këto të frymëzuara, të mbështetura në krijimtarinë gojore të Himarës dhe Labërisë, përpunoi dhe krijoi melodi të reja të këngëve himarjote. Këngëve që ai krijoi, u futi elementë të rinj, përta i përket strukturës së ndërtimit të tyre.

Duke qenë njeri me horizont të gjerë kulturor, duke njohur në thellësi veprat e gjinive të ndryshme muzikore, duke qenë dashuruar pas këngëve popullore e sidomos atyre të vendlindjes së tij, vuri re se tek kënga himarjote, paraqiste interes zëri i mbajtësit, (prerësit) të saj. Ai me seriozitet, këmbëngulje, punoi dhe e zhvilloi këtë zë, i dha më shumë vend gjatë ekzekutimit, e ngriti gjer në atë shkallë, sa ai të tingëllonte si një element i ri në mënyrën e të kënduarit deri në atë kohë. Ky element i ri që u emërua “hedhje e këngës”, i pasuroi tiparet e saj.

Kënga polifonike himarjote u bë më e bukur, më ekspresive, sepse hedhësi i shtoi asaj ëmbëlsinë, gjithashtu shërbeu si “urëlidhje” ndërmjet marrësit, kthyesit dhe isos. Kjo nuancë e re e shkriu në unitet të plotë polifoninë e këngës, duke i bërë asaj harmonizimin, duke i mbuluar çdo gabim gjatë ekzekutimit të saj. Këtë mënyrë të re të kënduarit, populli, si e pëlqeu, nisi ta përdorë atë. Neçoja me shokët e tij thelloheshin gjithnjë e më shumë në krijimet e herëshme të banorëve të këtyre anëve dhe nxorrën në dritë krijime plot vlera. Kënga “910 viti” ia kushton qëndrimin të papërkulur të himarjotëve kundër pushtimin osman. Materialin e saj e gjeti tek këngët e herëshme të trimërisë,

këngë të kënduara me nota të theksuara epike. Por motivit i shton diçka të re. Melodinë e shtruar të mëparëshme e ngjesh me ritmin “tallaz deti”, me ritëm kushtrim për liri. Gjithashtu përmbajtje epike ka edhe kënga “Më 28 Nëntor” me tekst të vet Neço Mukës që i kushtohet ngritjes së flamurit në Vlorë. Dhe në këtë këngë të ngritur mbi shtratin e këngëve të vjetra himarjote të trimërisë, ai shfrytëzon motivin, duke i shtuar atij bukurinë dhe forcën, nëpërmjet notave të forcuara epike. Këtë këngë e këndon në ditët tona edhe grupi karakteristik i Himarës, por e kanë çuar më tej si strukturë. I ka zhvilluar vijën melodike duke i shtuar optimizmin, gjallërinë, besimin e patundur, se mbi këtë tokë është zot shqiptari për sot e sa të jetë jeta.

Edhe këngës së vjetër lirike himarjote, grupi i Neço Mukës, i bëri ndryshime në vijën melodike e në strukturë, duke e përtëritur dhe zbukuruar atë.


Trashëgimia që na la ky grup i këngëve polifonike, flet për të rejtat që na sollti ai dhe në lëmin e motiveve lirike. Por meloditë e tyre, edhe pse mbi të njëjtin taban, ndryshojnë shumë nga njeratjetra. Në shumë prej këngëve të tij, si tek liriket, po ashtu edhe tek ato epiko – lirike, ky autor ka shfrytëzuar edhe llojet e këngëve himarjote. Këngëtari i vjetër i këngëve himarjote, i vetmi pjesëtar i grupit të Neços që jeton akoma(*bëhet fjalë për kohën kur është shkruar ky shkrim- shënimi im KB*) tregon:”Neço Muka dinte përmendësh, jo vetëm shumë këngë të krahinës së Himarës dhe të Labërisë, por edhe shumë vaje prekëse të grave himarjote, të cilat i recitonte me shumë pasion për miqtë dhe të afërmit e tij. Këto vaje, ai i futi edhe në këngë, si tek kënga “Vajza e valëve”, ”Qielli i zi”, ”Në rrëzë të kallamesë” e në këngë të tjera.

Ky grup i ndihmuar edhe nga Artistja e Popullit Tefta Tashko Koço, me shumë mundime e sakrifica, regjistroi në Paris këngët e popullit të tij, për t’ia sjellë atij të bukura dhe emocionalisht të përkryera. Dhe populli i gdhendi ato thellë në mendje dhe zemër, i mbajti ato gjallë deri në ditët e sotme, duke u transmetuar nga njeri brez në tjetrin, edhe pse ky grup më vonë

u shkri. Grupi i ri që u krijua u dha atyre një ngjyrë e forcë të re shprehëse.

DHIMITËR VARFI
Artist i Merituar
ODISE GORO

NEÇO MUKO



Lindi në Himarë më 21 tetor 1899 dhe vdiq në Paris më 12 dhjetor 1934. Jetoi gjithsej 35 vjet, por la pas emrin e tij në këngën himarjote.

Këngëtar i shquar dhe konsolidues i zërit të “hedhësit” në këngën polifonike të Bregut.

Shkollën fillore e përfundon në Himarë. Vazhdon studimet në Greqi, ku përfundon me 1919 “Teknikumin” për mekanikë. Mëson në mënyrë autodidakte violinën, mandolinën dhe ndjek shfaqje të ndryshme teatrore. Më 1924 emigron në Francë. Kthehet në atdhe më 1926 ku organizon në qytetin e Sarandës grupin koral “Pif-Paf”, për të cilin bën dhe krijimet e paramuzikore të tij. Më 1929 me një pjesë të grupit koral shkon në Paris për të regjistruar këngë të ndryshme popullore dhe pjesë të tij muzikore e letrare në disqe gramafoni. Në grupin e tij polifonik të përbërë nga Koço Çakalli – *marrës i këngës polifonike*; Pano Kokëveshi - *kthyes i këngës polifonike* dhe Neço Muko- *hedhës i këngës*, bën pjesë edhe këngëtarja e njohur lirike Tefta Tashko Koço. Më 1930 realizon disqe të reja po në

Paris. Më 1932 sëmuret dhe vdes dy vjet më vonë, më 1934, nga një faringit tuberkular. Sipas Shitunit: Neço Muko rradhitet ndër këngëtarët popullorë më me emër të ditëve tona.

Disqe të “Pathe”-s, me muzikë popullore të Neço Muko (H) Marjotit:

Disku 44003- “*Lule je, lule të thonë*”. K.Çakalli, Dh. Rumbo, N.Muko.

Disku 44005- “*Kanakarja*”. K.Çakalli, Dh. Rumbo, N.Muko.

Disku 44008- “*Vajza e malit*”. K.Çakalli, Dh. Rumbo, N.Muko.

Disku 44009- “*Katina nina-Nina*”. K.Çakalli, Dh. Rumbo, N.Muko.

Disku 44010- “*Naze-naze puna jote*”.

Disku 44011- “*Marikë moj e dashuro*”. K.Çakalli, N.Muko.

Disku 44014- “*Këngë dasmore*”. K.Çakalli, T. Paleologu, A. Bala, N.Muko.

Disku 44018- “*Konispolatja*”.

Disku 44019- “*Mbeçë, more shokë, mbeçë*”.

Disku 44020- “*Llaj çobani*”.

Disku 44023- “*Dropullitja*”.

Disku 44024- “*Jo, moj jo*”. K.Çakalli, A. Bala, P. Kokaveshi, N.Muko.

Disku 44025- “*Lule Manushaqe*”.

Disku 44030- “*Minush Agai*”.

Disku 44031- “*Çerciz Topulli*”.

Disku 44032- “*E pabesa*”. K.Çakalli, A. Bala, P. Kokaveshi, N.Muko.

Disku 44033- “*Vajza e Valëve*”. K.Çakalli, A. Bala, P. Kokaveshi, N.Muko.

Disku 44036- “*Doli hëna dritargjënda*”. K.Çakalli, A. Bala, N.Muko.

**DISA VEÇORI TË KËNGËS HIMARJOTE NËPËRMJET
TEKSTEVE TË SHKRUARA NGA NEÇO MUKO
(MARJOTI)**

Kënga himarjote, si të gjitha këngët e Labërisë kanë veçoritë e tyre stilistikore. E kemi përmendur edhe më lart, pavarësisht se këto këngë quhen këngë popullore polifonike dhe kanë kaluar nga njëri brez në tjetrin, e kanë një autor që e ka shkruar fillimisht. Në këngën himarjote njihet si autor i këtyre këngëve Neço Muko (H)Marjoti. Emri i tij i vërtetë është Nestor Muko.

Në tematikën e këtyre këngëve në përgjithësi, dallojmë dy tema kryesore, atë historike dhe atë lirike të dashurisë, e cila në repertorin e këngëve himarjote zë më tepër vend se tematika tjetër.

Në përgjithësi kënga himarjote vjen e ëmbël, e dashur, si valë deti, e shtruar, melankolike, harmonike dhe tërheqëse.

Ajo që e ka bërë të njohur këngën himarjote, pa dyshim, është kënga “Vajzë e valëve”, e cila ka një pëlqyeshmëri dhe një audience të madhe, madje, duhet thënë, se shpeshherë është bërë edhe ngacmim i kompozitorëve duke e përpunuar atë, pa humbur origjinalitetin e saj.

Si të gjitha këngët polifonike, edhe kënga himarjote është trashëguar dhe ka kaluar nga njëri brez të tjetrin.

Për herë të parë kjo këngë është kënduar nga vet autori dhe grupi i tij, Neço Muko, duke kaluar pastaj në një këngëtar tjetër virtuoz, siç çshtë Artisti i Merituar Dhimitër Varfi që e ka nxjerrë këtë këngë dhe këngët e tjera nga arkiva duke i dhënë jetë dhe gjallëri këtyre perlave e duke vazhduar aktualisht me një pasuese të denjë të kësaj kënge, e mirënjohura dhe për mua do ta quaja Perëndeshë e këngës himarjote, Katina Beleri.

Krijimtaria e Neço Mukës, siç thamë është e larme.

Janko Ll. Pali, bashkëkohës dhe bashkënxënës me artistin Neço Muko, ka bërë një punë të lavdërueshme në mbledhjen e këngëve të këtij artisti të madh, i cili i la dorëshkrim dhe nën kujdesin e të birit Petraq J. Pali panë dritën e botimit, duke i përmbledhur në librin e tij të titulluar “Lyra”, botim i parë, 2018,

gjë që nuk e kishim deri tani një përmlledhje të tillë. Për këtë autori i përëbledhjes meriton një falenderim të veçantë.

Nuk kam ndërmend të merrem të analizoj gjithë përmbledhjen me krijimet e Nestor (Neço) Mukos, por do të ndalem tek disa prej tyre, të cilat janë edhe më të njohura për publikun, sidomos me lirikën e tij.

Siç e shpreha edhe më sipër, për mendimin tim, kënga himarjote, ka si kryekëngë *“Vajza e valëve”*.

Kjo këngë është një nga ato këngë që të fut drithërimën në shpirt, të kujton atë plagën e pashëruar të shoqërisë gjatë gjithë kohërave, kurbetin. Në vetvete kjo këngë është një elegji që sa herë që e dëgjon ose e lexon, jo vetëm që të çon në atë kohë për të cilën është shkruar, por edhe sot është po aq aktuale sa dhe dje.

Ndoshta në tekstin original kjo këngë është më e gjatë, sa ne e kemi dëgjuar. Në tekstin e kënduar kjo këngë del e redaktuar pa iu prishur kuptimi dhe logjika aspak. Kjo kuptohet edhe për një arsye tjetër, e cila ka të bëjë me variantin e të kënduarit, ndaj dhe ka pësuar edhe disa ndryshime më tepër fonetike.

Kënga hapet me një peizazh rrënoqethës. Që nga vet titulli, kjo i ngjan një përmendoreje, një statuje të mbirë aty buzë detit, me sy të kthyer nga ky det, i cili është simboli i zakonit të Bregut. Kjo përmendore, kjo statujë ka si pedestal një gur anës detit, ku qëndron kjo vajzë në pritje të burrit të saj nga kurbeti, duke qarë e vajtuar dhe me një dhembje thellë në shpirt. Ky është portreti i “Vajzës së valëve”, ku autori e ka vizatuar aq bukur dhe aq realisht, sa vështirë do të gjendej një skulptor ta derdhte në bronc këtë figurë emblematike.

Në se çdo vend, çdo krahinë a trevë ka një diçka simbolike, Himara duhet të ketë “Vajzën e valëve”.

Gjithë poezia është një histori tragjike, e trishtë dhe plot dhembje.

Vajz' e valëve,
zëmëra s'ja mban,
mbi një gur anës së detit,

qan e zeza, qan.
Pret atë që pret
dhe një dhimbje ndjen,
gjithë bota ven e vin',
por ai nuk vjen.

Nëpërmjet këtyre vargjeve autori e ka skalitur me mjeshtëri të rrallë portretin e kësaj “vajze të valëve” duke derdhur gjithë arsenalin e tij mjeshtëror, artistik, duke nxjerrë në pah edhe anën e brendshme shpirtërore të vajzës, e cila është ngujuar mbi këtë gur anës së detit, ditë edhe natë, me muaj të tërë për të pritur ndonjë lajm.

Në pranverë që vijnë dallëndyshet nga viset e largëta, ajo është prapë aty.

Pranver' arrin,
një mëngjes të qet',
shkojn' e vijn' dallëndyshet,
vajza u thërret:
ju të bukur zogj,
tek ju kam një shpres',
ju që shkoni det e male,
dua t'ju pies.
Mos e patë ju,
rron apo nuk rron,
ndonjë lajm a ndonjë letër,
vall' a më kujton.

Dhe ajo me një thirrje apostrofike u drejtohet atyre me shpresën se mos e kanë parë, “rron apo nuk rron”, u drejtohet ajo zogjve, apo “vall' a më kujton”.

Vetëm dhembje, vetëm trishtim, vetëm lotë të dala nga thellësia e shpirtit.

Kjo dhembje, ky trishtim arrin kulmin në vargjet:
Një jetime jam,
pa nën' e pa bab',
një që kisha, një që doja,

iku dhe më la.

Ajo jeton vetminë, ka mall dhe refren, kjo dhembje, ky mall përmblihet në vargun kuptimplotë “por ai nuk vjen” dhe ndaj si refren i këngës përsëriten vargjet:

“qan e zeza, qan,
qan e mjera,
qan e zeza qan”.

Nëse do të flasim për metrikën e vargut, duhet thënë se më tepër i ngjan një vargu pesërrokësh me ndonjë përjashtim që kalon edhe në një varg tetërrokësh, por jo gjithmonë. Kemi përdorimin e apostrofit tek rënia e “ë”-së fundore që nuk shqiptohet zakonisht, pra një “ë” e pazëshme.

Edhe përsa i përket rimës mund të themi se nuk kemi atë sistem tradicional që kemi mësuar të gjejmë zakonisht nëpër poezi të ndryshme, të sistemit AABB ose ABAB, por shpeshherë mund të themi se vargu i parë me vargun e tretë, pothuaj nuk rimojnë fare, përveç vargut të dytë dhe vargut të katërt, por sidomos duhet thënë se kemi të bëjmë me një rimë alternative.

Dhe sa herë e dëgjon këtë këngë, e përfytyron veten në Himarën perlë të Bregut dhe aty, buzë deit, sheh “Vajzën e valeve” në pritje. Një pamje që të grish. A nuk është aktuale edhe sot kjo këngë?...

Një lirikë tjetër shumë e bukur në këngët himarjote të Neço Mukos është edhe kënga “*Vajza e malit*”, një lirikë e mirëfilltë, e shkruar me ndjenjë e që i këndohet me pathos vajzës së malit. Kjo këngë është kënduar fillimisht nga K. Çakalli, një tjetër këngëtar virtuoz i këngës himarjote, N.H. Marjoti dhe dhe M. Rumbo. Më pas kjo këngë është kënduar nga Dhimitër Varfi dhe grupi karakteristik i Himarës, si edhe nga grupi i vajzave të Dhërmiut. Teksti i kësaj kënge është më i gjatë se sa këndohet. Tek grupi i Dh. Varfit është akoma më i shkurtër, se sa tek grupi i vajzave të Dhërmiut.

Në qendër të kësaj kënge është stina e pranverës, stina më e bukur, ku jeta gjallërohet. Dëbora nis të shkrijë majave të maleve, bagëtitë dalin në kullotë me mbirjen e barit, zogjtë kanë ardhur nga shtegtimi, pra me një fjalë, ardhja e stinës së pranverës i ngjan më tepër nisjes së një jete të re, ndryshe. Dhe autori këtë e përshkruan bukur, duke rreshtuar të gjitha këto elemente që përmendëm më lart. Ndaj edhe ai shkruan:

Erdhi prilli, ç’u shkri bora,
majave,
mbani vesh, bie këmbora,
maleve.

Dhe më poshtë, nëpërmjet një apostrofi, autori lajmëron ardhjen e stinës së pranverës me gjithë arsenalin e saj, me këngën e zogjve, me ndryshimin e natyrës, toka ka filluar të marrë një pamje të re, është zbukuruar, “lulëzon”, thotë autori, me ecejaket e zogjve, zogj të çiftëzuar që “dy nga dy, / jetojnë në fole”. Një ëndërr ndoshta e poetit për vajzën që dashuron, një ëndërr ndoshta e përealizuar.

Krahasimi është figura letrare më e përdorur në këtë tekst-poezi të Neço Mukos, i cili siç duhet është një njohës i mirë i figurave stilistikore, por pa lënë mënjane figurat e tjera, siç është apostrofi, apo metafora, e përdorur me shumë finesë apo edhe epiteti.

Vajzës së malit në këtë tekst poezi, autori i vesh bukurinë e një ylli duke e krahasuar me të, e quan “si një lule maji”, “trëndafil”, ose e quan “kanakare”, një epitete që tregon delikatesën e femrës, ajo femër e përkëdhelur, nazemadhe, të cilat këto vyrytje, cilësi, i përmblesh vetëm me një fjalë, “kanakare”.

Është vajza, vajz’ e malit,
si një yll,
si një lule, lul’ e majit,

trëndafil.

Në këtë tekst poezi autori i këndon me një ndjenjë të thellë vajzës që dashuron dhe që ka kohë që nuk e shikon më. Ndaj dhe ai shprehet:

Ësht' ajo që dashurova
që me koh',
dy-tre vjet për të lëngova
që s'e shoh.

Me thirrjen që bën autori:

O moj vajzë kanakare,
ç'bën atje?
As më njeh, m'harrove fare,
ç'zemër ke?

Dhe vajza i përgjigjet:

Dashurin' s'e kam harruar,
s'e harroj,
brenda thell' e kam të shkruar,
sa të rroj.

Pra kemi të bëjmë këtu me një fare dialogu ndërmjet vajzës dhe djalit. Ndjen dhembje dhe mall për ato tre vjet që ata nuk janë parë, ndaj dhe thotë:

Po tre vjet që jemi ndarë,
gjithmonë,
nat' e dit' duke qarë,
shkova koh'n.

Përsa i takon metrikës së vargut të kësaj poezie, duhet thënë se kemi të bëjmë me një tetërrokësh të mirëfilltë, të thyer

pas çdo vargu me një trerrokësh, i cili shërben si refren i këngës dhe që rrokëzohet: “ma, o majave”.

Rima është një rimë e zakonshme alternative e sistemit ABAB.

Një këngë interesante dhe që vlen të përmendet, si nga ndërtimi strukturor i saj, ashtu edhe nga stilistika e përdorur është edhe kënga “*Vogëlushja*”, e cila është një sintezë e plotë e vajzës himarjote, e cila ka përqafuar të renë. Autori e përshkruan këtë ndryshim me mjeshteri të hollë artistike duke përdorur krahasimin si figurë qëndrore në të. Në pak vargje ai bën bën portretin fizik të kësaj vajze, ndaj edhe ai shkruan:

Vogëlushe ane-ane,
aman mike kapedane ¹⁾
veshurë si pariziane,
leshtrat si evropiane,
e hollë e qafësorkadhe,
zëmëren ma more fare.

1) përsëritet

Poezia tekst është ndërtuar thjesht me gjashtë vargje, monokolonë, me një tetërrokësh, me rimë të përputhur dhe në vargjet e fundit me asonancë.

Stili, mënyra, varianti i të kënduarit i këngës himarjote të imponon edhe sistemin e vargëzimit, gjë, të cilën ne e vëmë re në shumë këngë të kësaj treve.

Kështu ndodh edhe me këngën “*Katina, nina-nina*”, e cila është edhe kjo një nga këngët më të bukura, më të pëlqyeshme dhe më të spikatura të këngës lirike himarjote, jo se këngët e tjera himarjote nuk janë të bukura. Kënga himarjote, e tëra, është e bukur duke qenë në majat më të larta të iso-polifonisë, për të veçantën e të kënduarit që mbart ajo në vetvete.

Ja disa nga vargjet e kësaj kënge:

Vajz' e bukur-o,
pa dil të të shoh,
moj Katina nina-nina,
vajz' e dashur-o.

Pa dil në penxher',
të të shoh një her',
moj Katina nina-nina,
zëmërën ma merr.

Fol një her' me goj',
dua të shpresoj,
moj Katina nina-nina,
pa ty s'mund të rroj.

Syri yt më tret,
zëri yt më vret,
moj Katina nina-nina,
bukuri je vet.

.....

Aj, se nata shkon,
hëna perëndon,
moj Katina nina-nina,
djalëria shkon.

Ky është teksti që është kënduar nga Artisti i Merituar Dhimitër Varfi dhe që këndohet nga pasuesja e denjë e këngës himarjote Katina Beleri. Ndërsa nëse do të vëmë re tekstin original, botuar në përmbledhjen “Lyra” me autor Petraq J. Pali, sipas shënimeve të babait të tij Janko LL. Pali, kemi disa

ndryshime, si në anën ndërtimore të vargut e strofës, ashtu edhe në disa ndryshime përsa i përket fjalëve.

Sipas Petraq J. Palit, strofa e fundit e kësaj kënge nuk përmbahet në pllakën origjinale të Neço Mukës, ndërsa ne e gjejmë në tekstin e këngës që këndohet edhe sot.

Një ndryshim tjetër vihet re edhe në ndërrimin e strofave. Në tekstin original, strofa:

Syri yt më tret,
zëri yt më vret,
moj Katina nina-nina,
bukuri je vet.

në radhë është pas strofës “Pa dil në penxher”. Mendoj se këto kanë ardhur si rrjedhojë për logjikën dhe mbarëvajtjen e këngës.

Frymëzimin për këtë këngë Neço Muko e ka marrë nga jeta reale në Himarë. Tregojnë, në ato vite, kur është shkruar kënga, ka qenë një mësuese në Himarë, po me këtë emër që autorit i ka bërë përshtypje për bukurinë e saj dhe e ka frymëzuar poetin për të shkruar këtë tekst kënge.

Në variantin original të saj, vëmë re se kemi të bëjmë me strofa dyshe, pra me dy vargje, ku vargu i dytë shërben si refren, pas çdo marrje. Pra kemi të bëjmë me një varg dhjetërokësh, ndërsa refreni na del me një dymbëdhjetë ose trembëdhjetërokësh.

Nëse do ta shkruanim në strofa katërshe, këtu kemi të bëjmë me një pesërokësh në vargun e parë dhe të dytë, ndërsa vargu i tretë na del një tetërokësh dhe vargu i katërt na del po një pesërokësh, si vargjet e para, të cilat kanë edhe të njëjtën rimë.

Bukuria e saj e ka mahnitur autorin, ndaj edhe ai shprehet:

“Fol një her’ me goj’,
thuam’ të shpresoj,
moj Katina nina-nina,

pa ty s'mund të rroj”.

Metaforat e përdorura në këtë poezi, sikur të shkrijnë në gjithë bukurinë përrallore të kësaj vajze, siç e përshkruan autori me nota origjinale, të ngrohta, të ëmbla mjaltë, të mbledhura si bleta nektarin e atyre anëve, me aromë dehëse. Ndaj dhe ai shpërthen, kur thotë:

“Syri yt më tret,
zëri yt më vret”...

Dhe sa herë që e dëgjon këtë këngë, aq herë ke çfarë të zbulon, aq e thellë është ajo.

Është me të vërtetë një lirikë shumë e bukur, e shkruar me dëshirë e mall të zjarrtë për këtë femër që autorit i ka lënë mbresa të pashlyeshme pas largimit të saj nga Himara.

Një këngë tjetër, lirikë e bukur, është edhe kënga “*Marikë, moj, e dashur-o*”.

Kjo këngë na del me dy variante të shkruari. Njëra është sipas botimit të përmbledhjes të librit “Lyra”, përgatitur për botim nga Petraq J. Pali (44011. *Këngë popullore*) dhe variant tjetër sipas të kënduarit nga grupi i Himarës.

Për korrektesë, ne po i japim të dyja variantet.
Varianti sipas përmbledhjes së Petraq J. Pali.

MARIKË, MOJ, E DASHUR

Marika moj, e dashur,
ku je, ku kishe vajtur-ë.

Shkova një herë në shtëpi,
më thanë: s’jeshe brenda ti.

Vërtet fjalën a po më qesh,
më duket je njeri pa bes’.

Marik' e parë jo, moj jo,
nuk jam..., po le ç'e do.

Marika ti më ëmbëlson,
ti më kënaq, ti më shëron.

Ç'e ti lam' fuqia ra,
fajin e ke ti, moj Marika –o.

Varianti i këngës sipas të kënduarit sot nga grupi i
Himarës me marrëse Katina Beleri.

MARIKË, MOJ, E DASHUR-O

Marika moj, e dashur-o,
ku je, ku kishe vajtur-o.

Erdha një ditë në shtëpi,
më thanë që s'jeshe brenda ti.

Vërtet djal-o a po më qesh,
më thanë se je njeri pa bes'.

Marikë, moj aman-aman,
e të kam shpirt e të kam xhan.

Ç'e do tani, fuqia ra,
faj'n e ti, mor maskara.

Të shtatat thika, ja ku i kam,
me një ma more shpirt e xhan.

Marika, moj ti je, moj je,
shtatin ma ke si minare.

E në je burr' me trimëri,
ç'ke për ta bërë, bëje tani.

Pra, siç shihet, boshti i këtyre dy varianteve është i njëjtë, por që kemi ndryshime, shtesë vargjesh që për mendimin tim e plotësojnë më së miri fizionominë e këngës. Nuk dihet në se autori Neço Muko, pas regjistrimit të kësaj kënge i është rikthyer për ta përpunuar variantin e dytë apo është përpunuar nga dikush tjetër. Madje duhet thënë, se në dy vargjet e parafundit, ndeshim edhe një variant tjetër:

Marika, moj, për perëndi,
më je si top dyzet e di.

Ndoshta mund të themi se ky tekst kënge, siç e përmendëm edhe më lart ka patur disa përpunime.

Në variantin e parë të këngës, mendoj se qëllimi për të cilin është shkruar nuk del dhe aq i plotë sa në variantin e dytë të përpunuar.

Në variantin e parë, Marika sa e skicon pabesinë e djalit, ndërsa ai kërkon ta shmang këtë pabesi të tij duke i thurur elozhe, ndërsa në variantin e dytë të përpunuar pabesia e djalit del më e plotë. Ajo ia vë në dukje pabesitë e tij, ndaj me një vendosmëri i kërkon të lozet finalja e kësaj tragjedie, kur shprehet:

E në je burr' me trimëri,
ç'ke për ta bërë, bëje tani.

Të dyja përpunimet plotësojnë njëra-tjetrën, por nuk do të pranoja kurrësesi një përpunim të kësaj perle, të cilën e ka kënduar Fatbardha Aliçka (Maya) nën termin e shpikur “turbofolk”.

Megjithëse e kam trajtuar këtë gjë edhe në një shkrim të veçantë. Dihet që këto lloj përpunimesh janë për efekt përfitimi monetar, por nuk duhen lejuar kurrësesi shtrëmbërime të tilla deri në absurditet, duke e kthyer figurën e një femre, siç është Marika në këngën e mësipërme, në pijanece të rëndomtë. “Turp e marre” është një shprehje shkodrane. “Turp” për ata që i përpunojnë këto perla të polifonisë dhe “marre” për ata që i publikojnë dhe për instancat që e kanë për detyrë të mbrojnë e të ruajnë vlerat shpirtërore të popullit tonë.

Pak më lart përmendëm se përveç lirikës që vihet re në këngët himarjote të Neço Mukës, një vend të rëndësishëm zë edhe tema patriotike. Mjafton të përmendim këngën kushtuar Ismail Qemalit, themeluesit të shtetit të parë shqiptar, me Shpalljen e Pavarësisë Kombëtare më 28 Nëntor 1912. *(sipas pllakës 44021, kënduar prej K. Çakalli, N.H. Marjoti, P. Kokaveshi e A. Bala)*

Teksti i kësaj kënge është shkruar në monokolonë, me një rimë alternative ABAB, me një varg tetërrokësh.

Ja se si e mbyll poezinë e tij autori:

“Evropa le ta dëgjojë
që ka djelm Shqipëria,
Skënderbenë do ta nderojë,
do ta shkruajë historia”.

KUSH ËSHTË THANAS (NASE) BENI?

Kushdo që ka dëgjuar këngën e bukur himarjote që nis me vargjet:

“Kush është lule vilajeti,
q’i kanë bota sevdanë,
Himara në breg të detit...”

patjetër duhet të di se autori i saj është luftëtari i luftës së 1920-s, poeti popullor dhe këngëtari i lirisë Nase Beni, nga Vunoi i Himarës, i cili shkroi dhe mblodhi këngë në traditën e folklorit.

Nase Beni, me Shpalljen e Pavarësisë Kombëtare në vitin 1912 u bashkua me ushtrinë e Qeverisë provizore të kryesuar nga Ismail Qemali. Vendosmërinë dhe zgjuarsinë e tij, ai e tregoi në luftën e Kallaratis, ku u shqua, jo vetëm si luftëtar trim, por edhe si agjikator ushtarak.

Me pushtimin e vendit nga ana e ushtrisë italiane, Naseja revoltohet. Urrejtjen e thellë për armikun, si dhe besimin në fitoren e popullit, ai e shpreh me vargjet:

“Breshkë e bretkocë e fëngut,

s'qëndron dot në gur të thatë,
se këtu këndon bilbili,
që e ka namin e lartë..."

Gjithashtu Thanas (Nase) Beni është autori i këngës së mirënjohur e të dëgjuar popullore “ Evropa shkruajnë e thonë”, që bën fjalë për Epopenë e Luftës së Vlorës të vitit 1920.

Heroizmin e pamposhtur të popullit tonë, me figura të shkëlqyera poetike, ai e shpreh edhe në vargje të tjera. Kështu, duke krahasuar Atdheun e pamposhtur me Çikën shekullore, ai këndon:

“Hajmedet, e shkreta Çikë,
që s'të tund bor' e tufani,
le ta dinë gjithë armiqtë,
se këtu ka zot vatani.”

LEFTER ÇIPA



LEFTER ÇIPA – PENË QË BURON VEÇ MJALTË

Nëse do të ngrihej diku një piramidë, si ato të Egjiptit të Lashtë, për polifoninë labe, në majë të kësaj piramide do të qëndronte pa më të voglën mëdyshje, poeti, autori dhe drejtuesi i grupit polifonik të Pilurit, i madhi Lefter Çipa.

Kur fillova të shkruaja këtë vëzhgim të shkurtër historik rreth pjesëmarrjes së Vlorës nëpër Festalet Folklorike Kombëtare, në çdo festival është emri i këtij dishepulli me penën e tij të artë që buron veç mjalhtë, vjen erë trendelinë, erë jodi të detit Jonian, vjen erë mushti, përshkohet nga patriotizmi i pashëmbullt, nga një atdhetarizëm i lartë që flladitet me puhizën dhe erën e vargmaleve të Akroqeranës.

Lefter Çipa është ai që është lidhur pazgjidhshmërisht me vendlindjen, me “bregun e ashpër”, - siç shprehet vet ai, me atë që e mbush me frymëzim dhe i jep krahë të fluturojë si një shqiponjë e lirë në lartësitë e atyre majave për të mbledhur nektarin e historisë, legjendat, ninullat, logatjet, lirikën e dashurisë që e ka për zemër, fluturon në Kosovë, duke folur vetëm në gjuhën e të parëve të tij, shqip.

Kënga për të është gjithçka, është vet jeta, është shpirti që ka zënë vendin më të madh në zemrën e tij. Jeta pa këngë, për Lefter Çipën, është e pakuptimtë, kënga është frymëmarrja e tij, është gjaku i pastër që rrjedh në damarë. Ai është poeti, është këngëtar, është hulumtuesi, është thesari që vetëm nxjerr visare. *Më tregon Sejmen Gjokoli, një nga miqtë e shumtë të Lefterit: “Ishte dhjetori i vitit 1994. Kisha ideuar krijimin e Grupit “Bilbili” dhe Lefterin e kisha menduar drejtuesin artistik të tij. Doja ta takoja e të bisedoja me të. Kisha kohë pa e takuar. Pas ndryshimit të sistemit vinte rrallë në Vlorë, e kalonte me përtesë Llogoranë. I kisha dërguar një copë letër ku i thoshja për takimin në Vlorë, pranë Hotel Sazanit. Në ditën dhe orën e caktuar po shikoja një burrë të imët që po afrohej. Sepse m’u duk më i dobët se zakonisht, i pakur fare. Më shumë përkundej se ecte. Mos, - thashë me vete, - nuk qenka mirë. U ulëm dhe nisa t’i flas për iniciativën. Do bëjmë këngë - i thashë. Me Ermionin e Qirjakon*

tënd (Ermioni Mërkuri e Qirjako Bala,- shënimi im), me Arjan Shehun, Mehmet Vishën e Petrit Lulon e Gjirokastrës, me Arap Çeloleskën , Sinan Gjolekën e Spiro Çinon e Vranishtit... Filloi të gjallërohet, të tjetërsohet në çast, të bëhet Lefter Çipa që kisha njohur.Do bëjmë këngë ; po folë, o burrë i dheut, - më thotë dhe u çel i tëri e mori ngjyrën e paparunes...”

Të gjithë e njohim krijimtarinë e tij, këngët e shkruara prej tij, vargu i zgjedhur dhe i latuar, i vënë në piramidën e polifonisë, duke i çimentuar themelet e saj e duke e ngjitur atë në majat më të larta. Ai hyn në plejadën e atyre poetëve që i kërkon koha, i lind koha dhe mbeten për një periudhë shumë më të gjatë se koha, ndaj dhe është vështirë të përzgjedhësh për ilustrim ndonjë nga vargjet e tij, sepse të gjitha vargjet janë njëlloj, njëri më i bukur se tjetri.

Lefter Çipa është dhe mbetet udhërrëfyesi bashkëkohor i polifonisë labe.

LEFTER ÇIPA POETI DHE FOLKLORI

Lefter Çipa është njeriu që ka në AND-në e tij frymëzim poetik, çka do të thotë se lënda e tij shpirtërore është e kësisojshme, e shkruar në këtë formë. Nuk mundej kurrsesi të ndryshonte nga rrjedha e gjithëhershme njerëzisë që ka ardhur nga pjesa e sipërme. Lefter Çipa nuk është Zot, por ai qëndron përmbi kohën e hapësirën.

Lefter Çipën unë e quaj një poet të konsoliduar, një zë brilant, një mendjemprehtë, një poet të mençur, por mund të jetë edhe i vuajtur, një poet me vizion, një gjeneratë që nxorri dhe solli perla. E kam thënë ndoshta diku, perlat apo brilantet nuk

kanë asnjë vlerë për sa kohë gjenden në tokë. Kur na mbërrijnë në sipërfaqe ato rrezatojnë, ndriçojnë, pra bëhen dritëz.

Lefter Çipa është si blea që kërkon në të gjitha lulet dhe zgjedh e merr nektarin, e sjell në zgjua. Lefter Çipa është si ai vreshtari që merr rrushin, e shtrydh, merr mushtin dhe zgjedh më të mirin. Lefter Çipa është një gurrë e pashtershme e tokës. Ne mund të kemi pasur ndoshta pak fat që kemi dëgjuar këngët polifonike që ka krijuar shpirti dhe i ka shkruar dora e Lefter Çipës. Atje në jug, pikërisht në thellësi të Labërisë duke shkuar për nga zona e Lumit, ndoshta Kuçi arrin në Pilur dhe nga lindja e trevës Himarë gjendesh sërish në Pilur. Ky fshat karakoll sipër malit është njohur nga kënga dhe nga kënga që krijoi Lefter Çipa, ai mjeshtër i rallë i këngës polifonike labe.

Lefter Çipa është zëri më i bukur dhe më i fuqishëm në folklorin lab. Në se do t'i quajmë këto zëra kroje, a burime, uji më i pastër, më kurativ, më i distiluar është Lefter Çipa. Kur përmendëm më lart, se poetet e tipit Lefter Çipa nuk janë Perëndi, por qëndrojnë përmbi kohën dhe hapësirën, do të thotë se ata do të jenë dhe do të mbeten të pavdekshëm e të paharruar.

Lefter Çipa hyri në folklor si një penë e artë, si një talent i rrallë, plot frymëzim që e gjeti aty ku bënte jetën e tij të përditëshme, tek ai fshat, tek ajo gurrë që buron e gurgullon vetëm vargje. Ai erdhi i vetëdijshëm që me talentin e tij zbuloi dhe ngriti lart, në pedestal atë pasuri shpirtërore të popullit të tij që ndoshta flinte diku.

Lefterin unë nuk e kam takuar asnjëherë në jetën time, ndërsa këngët e tij i kam dëgjuar e i dëgjoj përditë. E kam parë vetëm një herë në bibliotekën e Vlorës. M'u duk i zakonshëm. Pa e njohur pyeta si të gjithë të tjerët. I shkurtër dhe i imët dhe me cigaren që mbante në buzë.

- Po ai kush është, - pyeta.

- Nuk e njeh, - ma ktheu dikush, është Lefter Çipa.

Që në vështrimin e parë më befaso i dhe kërkova brenda vetes sime të shkruaja për këtë njeri që e shihja për herë të parë,

por që kisha dëgjuar e lexuar shumë për të. Diçka që nuk ngjante me fjalët e hedhura në plumb ose në bojë nga paraardhësit. Kështu nisa fjalët për Lefterin e këngës pilurite. Unë i njoh gjësimet e shpirtit poetik të tij, ndiej ngritjet dhe uljet e saj, tamam si ato dallgë deti që çukisin shpirtin e tij poetik. Brenda vargut të tij derdhet fjala e ëmbël, e fuqishme dhe e peshuar aq bukur. Cili është ndërkohë instrumenti matës i valës shpirtërore të këtij poeti? Nuk ka metronom për të matur dinamikën e vargut të Lefter Çipës. Shpirti i këtij poeti është i gjerë dhe ithellë, ai ka derdhur me një lakonizëm qindra vargje, mijëra fjalë që janë produkt i këtij deti shpirti të pafund njëkohësisht të paanë. Këngët që krijoi e vazhdon të krijojë Lefter Çipa janë një thesar i paçmuar për folkloristikën shqiptare, sa dhe ai vet ka propozuar për shtëpi folklori në Pilur dhe pse të mos bëhet, e meriton dhe organizmi ynë kulturor shtetëror le ta bëjë, një shtëpi folklori në Pilur, pra pikërisht shtëpinë e Lefter Çipës. Kënga e tij dëgjohet atje ku është hapësirë dhe rrojnë shpirtrat.

“Atje ku është dielli i paperëndueshëm”. Ndërkaq, ai shprehet: “Më bëni një nder të madh ose i bëni një nder iso-polifonisë, rriteni e seliteni trungun e saj”. Është ndriçimi më i madh në errësira të largëta. Le të bëhemi edhe ne pak të vetëdijshëm për atë që thotë poeti. Një poet si Lefter Çipa shikon pak më gjerë e pak më thellë, ai shikon andej nga drita. Këngët e tij dhe zëri ujë kroi i grupit të Pilurit është dhe do të mbetet si një testament që vjen nga ballkoni i Bregut. Këngët e Lefter Çipës që krijo shpirti i tij janë të futur thellë në kujtesën dhe në damarët e çdo shqiptari dhe më gjerë dhe bashkë me to dhe gjithë kulturën materiale. Në

këtë mënyrë i shtojmë edhe një vlerë turizmit kulturor atje në Pilurin e lartë sipër detit, ku është edhe shtëpia e Lefterit.

Ai lindi dhe u rrit bashkë me folklorin

GËZIM LLOJDIA

TË BISEDOSH ME LEFTER ÇIPËN

Lefter Çipa, poeti i njohur popullor, është nderuar nga Bashkia e Gjirokastrës me titullin “Qytetar Nderi” i këtij qyteti. Titulli iu dorëzua në një ceremoni që u zhvillua në qytetin e gurtë.

Të takohesh me Lefter Çipën në Himarë, është një privilegj i veçantë. “Ja, jetoj këtu në Himarë, pranë flamurit tim”, - thotë teksa përshëndetemi si dy miq të vjetër. Në fakt, metafora do të na ndjekë gjatë gjithë bisedës që zhvillojmë në një nga

lokalet e qytetit bregdetar. Për të, “polifonia shqiptare, por në veçanti polifonia bregase himarjote, është kënga e perëndive”. Ai jeton për të. Nuk mund të flasësh për polifoninë himarjote pa folur për Lefter Çipën. Ai i ka dhënë asaj jetë, bukuri, i ka dhënë shpirtin që lundron në valët e detit. Të takosh Lefter Çipën, do të thotë të takosh këngën himarjote, të prekësh magjinë e bregdetit himarjot. “Nocioni bregas është shumë më i madh se nocioni himarjot”, - thekson poeti i njohur popullor,- teksa shton se, “bregasit himarjotë këndojnë më bukur se bilbili”. Kjo këngë, thotë ai, i takon të 13 fshatrave të Bregut, madje deri në Nivicë. Sipas Çipës, të kënduarit greqisht në tri fshatra të Bregut, i është nënshtruar të kënduarit shqip të polifonisë. “Kënga nuk ka nevojë të quhet shqiptare, italiane, greke. Kënga e bukur këndohet në 1000 gjuhë”, - thotë Çipa, - teksa të sheh drejt në sy, si për të kuptuar e perceptuar thellësinë e filozofisë së këtyre fjalëve, që di t’i thotë vetëm Lefter Çipa. Askush më bukur se ai, nuk i shpreh me aq ndjenjë, me aq natyrshmëri, mesazhet që përcjell kënga himarjote. Ai hyn në thelbin e saj, e shtjellon atë, e bën më të thjeshtë dhe më të kuptueshme për bashkëbiseduesin, hyn në origjinën e saj, në shpirtin artistik të popullit që vjen në vargje brez pas brezi. Për Lefter Çipën, të flasësh për këngën bregase himarjote, do të thotë që ta trajtosh atë qysh në origjinë, “ta përkthesh” në fabulën e saj. “Atje, në djep, qesh dhe qan fëmija/ në natën e bukaniqes, ose natën e tretë të lindjes fëmija fillon e qesh/, por, ndërsa dëgjojmë fjalën e dëgjuar, por, jo shtatin e shikuar/kur u çua dhe kur do të flerë gjumë”. Çipa të bën për vete, të tërheq në magjinë e fjalëve të tij, që ai i thotë bukur. Teksa mban cigaren në dorë dhe flet e flet, ai ngjason me burrat himarjotë që rrinë në breg të detit që nuk tremben nga furtunat që, si bukuri të shpirtit të tyre, kanë këngën, kanë polifoninë. Polifonia shqiptare e perëndive bregase himarjote, është kënga e perëndive. Kur nis kjo këngë, perënditë zbresin në tokë, si në Greqinë e Lashtë, kur perënditë jetonin në tokë. Polifonia ka zjarr dhe shpirt në gjuhë, në muzikalitetin harmonik. Valët e detit janë

të trazuara e përplasen me njëra-tjetrën. Kur mali lëshon borën poshtë, kënga lëshon vellon e 257illii257. Përse quhen malet e Vetëtimës, të Akrokeraunit? “Sepse kur Zeusi, fjalosej me Perënditë, nga inati shkrepse vetëtimë! Tempullin e Zotit, e ke Himarën, vargmalet e Vetëtimës, që qëndrojnë si kurorë mbi breg të detit”. Bota e pasur e Lefter Çipës “lexohet” në këto fjalë të tij, aty në breg të detit në Himarë. Ato të fusin në një botë tjetër, të kthejnë prapa në kohë, të zhysin në mitologjinë e shekujve më parë. Sepse e tillë, është historia dhe kënga himarjote, të tilla janë ngjyrat e saj, që kanë ardhur nga njeri brez në 257illi. Por, Lefter Çipa thotë se, Himara është edhe një figurë mitologjike. Çipa të flet me sigurinë e një historiani të mirëfilltë, sepse i tillë është gatuar ai. Në vitin 1989, bashkë me ansamblin “Labëria” të Vlorës, si poet i këtij ansambli, ai mori pjesë në Festivalin e 17-të Folklorik Botëror, që u zhvillua në Francë, në 257illii e përvjetorit të ndërtimit të Kullës Eifel dhe Revolucionit Borgjez Francez. Përmes miqve të tij në Ambasadën Shqiptare në Paris, ai mësoi se, në Enciklopedinë Franceze, përfshihej edhe figura mitologjike e Himarës. Kjo figurë, sipas Çipës, paraqitet me një kokë luani, me gjoksin e dragoit, me barkun e dhisë dhe me bishtin e ujkut(!). Poeti popullor e shtjellon qartësisht domethënien e kësaj figure mitologjike që përfaqëson trimërinë e pahumbur të luanit, pathyeshmërinë e dragoit, pangopësinë e dhisë dhe dinakërinë dhe egërsinë e ujkut. Sipas Çipës, polifonia bregase himarjote, është më e lashtë se Greqia e Lashtë, se Roma, se Bizanti. Ajo është krijuar që kur u krijua Zoti. “Polifonia është shpirti i ditës dhe zëri i natës”, - thotë ai, duke shtuar se, - ditën vuan njeriu, ndërsa natën sheh ëndrra të bukura. Pikërisht vuajtja dhe bukuria e ëndrrave, përbëjnë edhe thelbin e polifonisë. “Polifonia është me kurorë qiellore, sepse ajo ka sakallëk”, shprehet Çipa. Ai shpjegon ndryshimin thelbësor të polifonisë bregase himarjote, krahasuar me atë të trevave të tjera. “Në Himarë ka një fenomen real; nuk i këndohet atij që merr hak, nuk i këndohet hakmarrjes, i këndohet faljes së gjakut”, sqaron poeti

popullor. Çipa e kujton me nostalgji 258illii e krijimtarisë së vet. Ishte 16 vjeç, në vitin 1958, kur, Themistokli Mone, artisti i njohur vlonjat i këngës qytetare, e angazhoi në këtë grup. “Ishte një rastësi, por, siç ndodh shpesh, rastësia mund të vulosë të ardhmen e një njeriu”, - thotë Çipa. Ai tregon se, kënga e parë e tij,

“Një flutur e vogël je,
16 pranvera ke
moj trëndafile,
sa e bukur je”,

zuri vend menjëherë në repertorin e Trios së famshme të këngës popullore qytetare vlonjate. Prej asaj kohe, ai punoi mjaft për vite me radhë për këtë grup të njohur në të gjithë vendin. Madje, tregon edhe një sekret; 80 për qind e teksteve të Trios Vlonjate, kanë autorësinë e tij. Këngë të tilla, si “Vlora jonë qytet i bukur”, janë shndërruar në “hit”-e, për këtë grup. “Trioja është brumi i Neço Mukës”, sqaron Çipa, duke u shprehur se, në themel të saj, është kënga e Neço Mukës së famshëm të Himarës. Lefter Çipa është autor i 16 librave. Në vitet e krijimtarisë së tij, për polifoninë, përfshihen “Bejkë e Bardhë” (1973); “Shqipëri moj ballëhapur” (1976); “Bilbilat e vendit tim” (1981), “Dheun tim përsipër marr” (1989); “Polifonia dhe vjershërimi i polifonisë” (1994); “Bilbili që këndon vetëm” (1999); “Për Kosovën prapë do ngrihem”(1999); Tre vëllime në vitet 1993-94-95 “Kënga që tret lotin”, “Këngët e Akrokeraunit” dhe “Këngët e Ruzharës” etj.

HARILLA KOÇI

(Marrë nga gazeta “Shqip” – 5 prill 2013)

KUSH NA VJEN NGA BREGU I DETIT...

Teksti: Sejmen GJOKOLI

Kënduar nga Grupi “Bilbili” në albumin “Shamiverdha shkoi...” “2007.

Marrësa : Tahire Bozhani

Vasil Sera

Kthyes : Sinan Gjoleka

Hedhës : Spiro Çino

Kush na vjen , nga Bregu i detit
Nga ballkoni , në Vanovë.

Lefter Cipa, vjershëtori
Penë artë e mëndje hollë.

Kush na vjen, porsì Naimi,
Mbi këngë e vargje kaluar,
Lefter Cipa, i pa gjumi,
Për këngën një jetë zgjuar.

Kush na vjen si Neço Muka
Që për këngë, shkriu rininë.
Lefter Cipa, mëndjedeti
Tretur për polifoninë.

Kush na vjen me çape bore,
Melodi, zile, këmborë.
Lefter Cipa që na pruri
Bejkën e bardhë si borë...

VJERSHËTORI POPULLOR DEMIR AGO

Në krahinën e Mesaplikut, breza të tërë rapsodësh e këngëtarësh të folklorit tonë tradicional, janë ushqyer nga kënga e vjershëtorit popullor Demir Ago Mystehaku. Kënga e tij ka jetuar e jeton edhe sot, edhe pse një pjesë e mirë e saj ka mbetur anonime. Mjeshtrat e këngës polifonike të kësaj treve, si :Tartar Zeka, Qazim Ademi, Selim Hasani, Xhemil Veli Duka, Mato Hasani, Xhebro Gjika e të tjerë, e kanë patur si model, duke mësuar nga kjo këngë.”Kënga e Demirit”, siç njihet në popull, ka qenë e kënduar në tërë krahinën tonë, thoshte në kujtimet e veta rapsodi Xhebro Gjika. Ndërsa Shevqet Musaraj fliste me patos për këngët e Demir Agos që kishte ngritur për Cane Miftarin dhe kryengritjet antiosmane.

Demir Ago Mystehaku ishte nga fshati Matogjin i Vlorës. Ka jetur rreth viteve 1780-1845. Në librin “Valët e detit” folkloristi Spiro Dine shkruan për Demir Ago vlonjaku: ”...ishte një mëmëdhetar i zjarrtë, i cili mund të ketë shkruar edhe të tjera këngë, por për fat të keq, miku, këtë mundi të më dërgojë dhe, po e shkruaj sikundër ishte, pa mos luajtur asnjë majë gjelpëre, se nuk ma do zemra ta ndryshoj dhe, mund të them, se çdo shqiptar, nuk duhet të këmbejë çdo gjë të mbledhur prej kombit, këngë, vaje, logori, duhen lënë siç janë për të marrë vesh të rinjtë se ku gemë e ku jemi”.

Sipas Spiro Dines, Demir Agoja dinte tri gjuhë të huaja, turqishten, arabishten e persishten.

Këtë vjershë Demir Agoja e ka shkruar rreth vitit 1821:

“Shokë, erdhi kiameti,
me sytë tanë ç’e pamë,
doli fermani nga mbreti,
shqiptarët nizamë.”

Kënga shpreh revoltën e shqiptarëve të Jugut për të mos shkruar nizamë në ushtrinë osmane. Në vitet 1791-1845 ai ngriti e këndoi edhe shumë këngë e vjersha të tjera popullore. Në vëllimin e Spiro Dines “Valët e detit” janë përfshirë edhe disa këngë që janë të përhapura në këtë trevë, si:

“Pesëqind shtëpi Smokthinë,
pleqtë ç’e lidhnë tertipnë,
që të mbrojnë Mesapliknë,
vanë e gjenë Nuredinë,
tek kullot dhentë në brinjë,
si drëri në trëndelinë,
si gjarpri në brazimë,
si sorkadh në përcëllimë.”

Një këngë tjetër e njohur e Demir Agos është edhe ajo që bën fjalë për trimin Cane Miftarin nga Smokthina. Kënga mund të jetë ngritur rreth viteve 1829 – 1832, kur u ndoqën ushtritë osmane nga Konja e Anadulli dhe Cane Miftari, si përkrahës i aleancës së luftës kundër osmanllinjve, organizoi dhe morri pjesë në kryengritjen antiosmane të fshatarsisë së Vlorës.

Kënga regjistron:

“Del, o Cane bukuria,
se në Konjë u prish hordhia,
e prishi Mehmet Alia,
Sadrazemi, turçelia,
Sadrazem, o Sadrazem,
na shpure në Konjë e mbemë,
shumë vanë, pak u kthemë,
edhe gratë mirë i gjemë,
bërë djali sa një dem.”

Demir Agoja u këndoi trimërisë e luftimeve të ashpra të shqiptarëve kundër hordhive osmane, duke u bërë një kronikan i kryengritjes shqiptare në Vlorë, Berat, Tepelenë e Delvinë. Për të figura qëndrore e këtyre luftimeve u bë trimi Cane Miftari, të cilin e helmuan osmanllinjët me dredhi. Dhe kënga e Demir Agos thotë:

“O Cane Miftar Smokthina,
t’u mbush varri trëndelina,
pse s’more me vete trima,
Vlorë të na bëhet prima...”

Demir Agoja u këndoi edhe betejave e trimave të tjerë, që morën pjesë në kryengritjet antiosmane të krahinës së Mesaplikut. I këndon edhe vrasjes së Ismail bej Vlorës, sundimtarit të Beratit nga kurthet e seresqerit të Rumelisë më 1829:

“Qaj, moj Vlorë e Kaninë,
Ismaili shkoi në Janinë,
i dërguan bujurdinë,

të piqet me Rumelinë.”

Një këngë e njohur e Demir Agos në tërë këtë trevë është edhe ajo:

“Pamporët e detit vinë,
që të mbledhin parësinë,
në Dukat Dervish Alinë,
Dule Zoton në Smokthinë,
Sadon e Dalan Seinë,
Mahmut Hoxhë tragjasinë,
në Stamboll duan t’i shpijnë...”

Në këngët e Demir Agos një vend të veçantë zënë ato që bëjnë fjalë për kundërshtimet e shqiptarëve për të mos shkuar nizam në vitet 1830 – 1834.

“O devlet, more devlet,
vit për vit po na thërret,
shkronjë e djallit na u qep,
na u qep si shkronja e djallit,
na mbaroi farën e djalit,
mbenë kopet’ brinjës së malit...”

Nga të paktat këngë të dashurisë që kanë arritur deri në ditët tona, tregojnë mjeshtërinë dhe zotësinë e këtij vjershëtori popullor.

Tri prej tyre janë:
“Moj e bukura prej nurit,
si thëllëza majë gurit,
o e shpejta si shigjeta,
ku do të shkojë jeta,
thëllëza në shkëmb të kuq,
pajë vënë në sënduq...”

Në këngën e dytë thuhet:

“I hoqe kyçet e brezit,
si trimi armët e mesit,
emërin e keshe grua,
po jeshe trime, fajkua,
vërje pëqinjte në brez,
i bëje punët me erëz...”

Ndërsa në këngën e tretë:

“O moj vitoria në mur,
tek rrije lëshoje nur,
gjithë jetënë me nder,
të kullon goja sheqer.”

Kënga e Demir Agos u ushqye nga luftrat e hallet, vuajtjet dhe mjerimi i popullit nën pushtimin osman. Në këtë kuadër, në krijimtarinë e tij zënë vend edhe grindjet e gjaqet e njerëzve. Edhe kënga:

“Që në Berat e në Vlorë,
gjithë pyesin e thonë,
ç’bën Isufi për këmborë,
tetë ditë ndenji pa folë,
sa zbardhi faqen me bojë.”

Merr shkas nga një ngjarje e thjeshtë në jetën e Mesaplikut. Fshatari Isuf Sullaj nga Mesapliku ishte bërë garant për faljen e një gjaku e pajtimin e tyre. Por hasmi e theu besën dhe kreu një vrasje në fisin e tij. Ai, siç thotë kënga, ndenji tetë ditë mbyllur, sa e mori hakun.

Këngëtari dhe vjershëtari popullor Demir Ago Mystehaku është një nga më të fuqishmit e më të rrallët në Lumin e Vlorës e tërë Labërinë që i këndoi aq shumë luftrave e përpjekjeve të popullit tonë për liri e pavarësi kombëtare. Këngët e tij janë futur

në hambarin e madh të popullit tonë, si pasuri e çmuar e pasurisë së tij.

BARDHOSH GAÇE

Marrë nga gazeta "Zëri i Vlorës", 9 korrik 1989

LIGJËRON BILBILI

(Dule Havari, pas vdekjes, (Dukat, Vlorë), "Naim Frashëri i Artë" me motivacionin: "Për punë të palodhur në fushën e folklorit, si krijues dhe organizues i grupit folklorik dhe këngës dhe valles së zonës së Dukatit").

Këto ditë, në një nga libraritë e qytetit më zuri syri një libër me titull "Ligjëro bilbili ynë" dhe në krye një emër të bardhë: Dule Havari.

E mora menjëherë, po nuk e di se çfarë ndjenje më shtyu të veproja kështu. Siç duket, u bënë bashkë; dëshira ime e kahershme për të lexuar vargje, por edhe ndjenja për të nderuar autorin, kjo e fundit, sidomos, kur e dija se nuk e kishim më fizikisht. Librin e lexova njëherësh, të 176 faqet me një frymë. Nuk e di në i lexova, apo i këndova njëkohësisht, se për afro dy orë m'u bë se isha me të famshmin grup të Dukatit, duke lexuar e kënduar bashkë.

Por edhe kur kam qenë me Lekon, Begon, Sulon e Fatosh Likën me shokë, me siguri kam mërmëritur me vete, se brezi im është rritur me ato këngë. Ende më duket sikur i dëgjoj këngë të tilla, si: "Kur të nisa për në çetë", "Kuvendon nëna me djalë", etj, ishin dhe mbeten kryekëngë të Labërisë, maja të vargmalit të stërmadh me këngë labe, për nga fjala, vargu dhe muzikaliteti, elementë të skalitur nga mjeshtri i polifonisë, Dule Havari. Të vjen keq që Dulja s'e pa dot vëllimin e tij për së gjalli, por hallall familjarëve për iniciativën e mbledhjes së krijimtarisë; përgëzime edhe autorëve të redaktimit e botimit. Jam i sigurt që ribotimit do t'i shtojnë vlerat edhe kujtimet e mjaft të tjerëve, miqve dhe shokëve të penës e këngës, njerëzve të shquar që ka njohur dhe e kanë njohur Dule Dukatin (Havarin).

Për të mos mbetur pas, unë po e nis qysh sot kujtimin tim...
Ishte viti 1978.

Isha student dhe një mbrëmje pranvere ndodhesha në klubin e Shtëpisë Qendrore të Ushtrisë në Tiranë. Befas, një grup njerëzish 10, 12 a 15 vetë, hyn në një prej dyerve të lokalit, asokohe tepër luksos dhe u ulën rreth disa tavolinave. Mes tyre dallova një të njohur.

Ishte rapsodi Hamdi Pulo, të cilin e njihja që nga Gjirokastra, kur bashkëpunonte me grupin polifonik të Pilurit. U ngrita dhe u takuam.

"Jam me grupin e Tragjasit, -më thotë Hamdiu. -Kemi ardhur sot të regjistrojmë disa këngë në Radio Televizion. Do të darkojmë këtu dhe do të dëgjosh edhe këngët, mbasi me vete kemi edhe Dule Havarin, rapsodin e Dukatit."

Kështu më thotë Hamdiu dhe, duke njohur pasionin tim për këngën, më fton të rri me ta. Aty, në mes të këngëtarëve tragjasiotë, këndonte edhe Dule Havari, të cilin e njoha për herë të parë. Siç e mora vesh, e kishin ftuar enkas dhe ai i kishte nderuar. Sakaq këngët ndiqnin njera-tjetrën. Siç dukej, Aranit Daupi me shokë, atëhere ishin në kulmin e karrierës së tyre. Ajo që po dëgjoja më dukej se ishte më shumë se një këngë lokale, më

tepër se një koncert i improvizuar. M'u kujtua ç'ka më tha më fillim Hamdiu..." do t'i këndojmë, t'i dëgjojë Dule Havari". Sikur më tha:- do t'i dëgjojë mjeshtri, apo ustai i këngës. Siç thashë, unë Dulen e shikoja për herë të parë, po emrin ia kisha dëgjuar. Pashë nga afër se çfarë respekti e vlerësimi të madh kishin këngëtarët për të. Mjeshtërit respektonin mjeshtrit.

15 tetor 2001. U nisa drejt Orikumit për një shërbim pune. Kur mbërrita në Orikum, në të dyja anët e rrugës, pranë pallateve të para, kishte grumbuj njerëzish. Qëndrojmë dhe pyesim njerin prej tyre.

Ka vdekur Dule Havari, tani do t'i bëhet përcjellja, - më thotë i pari që pyes.

Dule Havari, - thashë me vete dhe u preva. Iku një bard i këngës labe, - mendova. Kisha pyetur dukatasit e këngës, miqtë e mi të mirë dhe më kishin thënë që ishte sëmurë. Kushedi sa herë e kemi zënë në gojë trekëndëshin brilant të këngës dukatase, Begon, Lekon e Sulon në rrugët e gjata që kemi bërë bashkë në Moldavi, Holandë, Lituani, Itali e Maqedoni. Kritikova veten që indiferenca më kishte mundur dhe më kishte lënë pa e parë nga afër. Prej vitit '78, asnjëherë tjetër .

E lashë punën për të cilën kisha vajtur dhe u bëra pjesë e "polifonisë" gjigande të përcjelljes të burrit të këngës. Vështrova gjithandej, por sytë nuk më panë asnjë prej kolegëve të tij e miqve të mi, korifejve të krijimtarisë labe. As Lefter Çipa, as Kujtim Mici, as Hamdi Pulo, as Feti Brahimi, as Muhamet Tartari, as Llambro Hysi, as Lefter Haxhiraj, as Pelivan Bajrami, as Nertesit Asllani, as... për çudi asnjë. Me siguri, si edhe unë, nuk kanë ditur gjë për ikjen pa kthim të shokut, mikut e vëllait të tyre.

Atëhere vendosa dhe një copë rrugë, në cep të arkivolit, vura supin tim edhe për ta.

Doja të ndieja pak peshë, por peshë nuk ndieja. Siç duket, gjithë ai burrë i rëndë ishte bërë zog këngëtar e kushedi ku bridhte vendeve të këngës.

Kështu, zog këngëtar në fluturim, do të mbetet ngaherë Havari ynë, se ai vetë ligjëroi si bilbili...

(Marrë nga libri i Sejmen Gjokolit “Shpirti që rron”)

NJËRI NGA ZOGJTË E KËNGËS, FLUTUROI..

Ishte një njeri, në kuptimin e vërtetë të fjalës, ”Njeri”, ishte një mësues i devotshëm për t’u dhënë fëmijëve dije të sakta e të qëndrueshme, ishte një punonjës kulture i pasionuar, i dhënë me mish e me shpirt pas saj, ishte një poet popullor i talentuar, vargjet e krijimeve të të cilit gurgullonin si ujët e Llogorait në zërat e Pikë Gjolekës, Sulo Bozhanit, Leko Gjolekës, Bego Vangjelit e të të tjerëve këngëtarë. Ky ishte Dule Shaban Havari, nga fshati im, Dukati.

Thashë që në krye “ishte”, sepse fizikisht, ai nuk është më. U nda nga jeta në mesin e muajit tetor 2000, pas më shumë se katër vite lëngatë.

Dule Havari që një nga nismëtarët e krijimit të grupit të këngëve të Dukatit dhe ushqyesi i tij i përhershëm me tekste Ai krijoi ose, siç thonë në Labëri, ”vuri aq këngë, sa me to mund të

mbushësh disa faqe gazete, po t'i përmendësh të gjitha. Së bashku me grupin që u bë i njohur në tërë vendin e më tej, Dulja, solli risi në të kënduarit e labërishtes. Për këtë, studiuesi Spiro Shituni, thotë:” *Stili muzikor i Dukatit tërheq vëmendjen e opinionit shkencor e artistik, jo vetëm për idetë e mëdha e të fuqishme që sjell, por edhe për mjetet shprehëse...Mënyra dukatase e të kënduarit përfaqëson stilin muzikor më të qartë, më të thjeshtë, më recitativ që ka dalë deri më sot në historinë e zhvillimit të këngës shumëzërëshe labe. Këtu qëndrojnë edhe arsyet e popullarizimit të madh dhe të përvetësimit të gjerë të saj*”.

Njëri nga pararendësit e stilit të ri të këngës së Dukatit, është padyshim Dule Havari, i cili dha një ndihmesë të pazëvendësueshme, si në krijimin e grupit polifonik të fshatit, ashtu edhe në zhvillimin progresiv të stilit të ri të këngës dukatase.

Ai i këndoi atdheut, lirisë, dashurisë, heronjve dhe dëshmorëve të të gjitha kohërave. Nga moria e këngëve të vëna prej tij, mund të përmendim vetëm disa tituj, si:”Gjithnjë kokën përpjetë”, ”Do të thotë nëna ca fjalë” ,(kushtuar dëshmorit Xhuvel Xhuveli), këngë kushtuar pilotit dëshmor Kaso Petoshati, këngët:”Kuvëndon nëna me djalë” dhe “O trima flimi të qetë” etj, etj.

E shoh të udhës të citoj disa vargje nga kënga “ O trima flini të qetë”, e cila ka ka patur jehonë të gjerë:

Kur të pa nëna të vrarë,
të kuqon gjaku te balli,
aty plumbi të kish marrë,
aty ku vritet luani.

Kaq vjet shkuan e vanë,
që nëna nuk të ka parë,
po ti për atdhe ke rarë,
ndaj jeton e je i gjallë.

Nuk ka patur koncerte e festivale folklorike që të mos jetë përfaqësuar grupi i Dukatit me këngët e Dules. Atë e çmonin shumë edhe poetë popullorë të njohur. Në një bisedë me rapsodin popullor të *Tërbaçit, Kujtim Mici, i mirënjohuri Xhebro Gjika, i pat thënë: “Janë dy djem të mirë në Dukat e Tragjas, që ngrenë këngë të bukura. Kur t’i takosh, bënu të fala nga unë”*. Njëri nga “djemtë e mirë”, (ai i Dukatit), ishte Dule Havari.

Dule Havari ishte njëri nga zogjtë e këngës labe, i cili nuk pushoi së kënduari, as kur lëngonte në krevat. Është një thënie kuptimplote ajo e poetit të njohur popullor Lefter Çipa, i cili ka thënë: “*Bilbili ka si zakon që, po nisi këngën e parë, nuk dihet se kur i mbaron kënga e fundit...*”

Edhe tani që fluturoi si zogu e që shtegtoi për në përjetësi, Dule Havari jeton në këngët e tij, është i shtruar këmbëkryq në sofrën e madhe të këngës labe.

Nderim për njeriun e mirë, për bilbilin e këngës! Ai ka lënë te kënga labe zemrën dhe shpirtin e tij, ndaj mund të themi se trupi i Dules prehet në varrezat e fshatit, ndërsa shpirti i tij prehet në vargjet e këngëve.

SKËNDER HASKO

(Marrë nga gazeta “Drita”, 10 dhjetor 2000)

HAMDI PULO

Hamdi Pulo u lind në fshatin Tragjas të Vlorës në vitin 1941 dhe ndërroi jetë në vitin 2003. Është themeluesi i grupit folklorik të Tragjasit duke sjellë një traditë të shkëlqyer në folklorin në këtë zonë.

Ka botuar përmbledhjen me këngë e poezi me titull “Jataganë dhe trëndelinë” në vitin 2001, ku përmbledh gjithë krijimtarinë e tij.

Hamdi Pulo (pas vdekjes) i është akorduar titulli “ Naim Frashëri i argjendë” me motivacion “ Për evidentimin, zbulimin dhe zhvillimin cilësor të folklorit”

HAMDI PULO – OSE PORTRETI I GDHENDËSIT TË SHPIRTIT KOMBËTAR

Në traditën e mrekullueshme të këngës labe, një vend të veçantë zënë edhe vjershëtorët dhe rapsodët popullorë, të cilët me krijimtarinë e tyre kanë ushqyer vazhdimisht këtë pasuri shpirtërore të banorëve të kësaj treve dhe në tërësi folklorin shqiptar. Herë – herë ata shfaqen nëpër mjegullat e kohës si zjarre të ndezur që ngrohin shpirtin popullor të Labërisë.

Në vargun e poetëve popullorë bashkëkohorë, një vend të nderuar ka zënë edhe emrii poetit Hamdi Pulo nga Tragjasi i Vlorës.

Krijimtarinë dhe muzën e tij poetike, poeti Hamdi Pulo e ka përmbledhur në vëllimin poetik “Jatagan me trëndelinë”, duke shfaqur qartë prirjen e theksuar të vizionit të tij poetik. Në analizën që mund të bëjmë, mund të themi se në vargje shfaqen dukshëm shprehjet figurative, sintaksa poetike, fjalori poetik, e mbi të gjitha atë që poeti ravijëzon në pasurimin e këngës labe, në kohët e sotme me epikën dhe lirikën e saj. Në tërësi, në

krijimtarinë e këtij poeti, ndihet një ritëm ekspresiv e funksional, në spektrin e të cilit rrezatohet një pasion kërkues, me shqetësim e vrojtimit artistik, me preokupime të një dimensionit historik e aktual që shprehin shqetësimet e poetit për jetën shqiptare, luftrat e tij për liri dhe pavarësi kombëtare, por edhe shpirtin e tij të ndjeshëm e lirik, herë – herë befasues. Vargu i poetit përherë ka mbajtur të ndezur edhe sensibilizimin poetik të aspiratave të përgjithshme të shqiptarëve, dramën kombëtare të copëtimit të trojeve, luftëtarët e shquar e diplomatët, betejat e dëshmorët dhe vargjet e tij bëhen si kurora dafinash në ballin e Atdheut.

Veçori e këtij poeti është se, vargu i tij është i gdhendur me daltën e një shpirti të madh poetik dhe shpesh të ngjan me mjeshtrat drugdhendës e gurëgdhendës, por me një natyrë tjetër, duke u ngritur në kulturën shqiptare me portretin e një gdhendësi të shpirtit kombëtar.

Krijimtaria poetike e Hamdi Pulos shpalos tema e motive të rëndësishme nëpërmjet një ritmi të gjallë e dinamik të vargut e figurave artistike e kështu, ai dendëson mesazhet, në të cilat ngërthehen potenciale artistike me ndjeshmëri dhe emocione të fuqishme. Në tërësi vëllimi poetik “Jatagan me trëndelinë”, është një pasuri që i shtohet traditës folklorike të Labërisë dhe autori mbetet një lis i bleruar në varmalet e këngës labe, duke tërhequr edhe vëmendjen e studiusëve e poetëve të tjerë.

Prof.As.Dr. BARDHOSH GAÇE
(Marrë nga libri “Jatagan me trëndelinë”)

**HYSEN RUKA – KËNGËTARI VIRTUOZ I
SMOKTHINJOTÇES**



Nga Rukajt e Matogjinit, nip i Qazim Ademit nga babai dhe nip i Saliko Dalanit nga nëna. Nga të dy ata, trashëgoi zërin

virtuoz të lëvrimit të këngës smokthinjotçe, të cilën e ka ngritur në lartësi dhe variacione të reja. Ka mbaruar shkollën e mesme pedagogjike të Tiranë dhe ka punuar pa ndërprerë si mësues në Smokthinë e në fshatra afër saj.

Tërë jetën, Hyseni, është marrë me kulturën, ashtu edhe me punën arsimore. Ka shkruar rreth 30 vjersha të stilit popullor dhe të përshtatura për këngët e fshatit të tij. Disa nga titujt që ka shkruar: “Mëmëdheu”, “Vlorë, copëzë stërralli”, “Fshati im, burim gëzimi”, “Vlorë, krenaria jonë, ”Në mes të sheshit në Vlorë”, këngë për dëshmorët, për Razip Hiton, heroinën Qeriba Derri, këngën “Prite-prite ti, moj Kotë”, për heroin Zigur Lelo, etj. Tematika e këngëve të tij ka qenë kryesisht ajo patriotike. Fjalët i skalit në organizimin e vjershës 5-7 vargëshe:

Vlorë, copëzë stërrali,,
të qesh syri e të ndrit balli,
beden’ i kalasë me gurë,
shtizë që ngrite flamurë...

ose:

Mëmëdheu, Shqipëria,
janë për neve krenaria,
nderi, besa, burrëria,
faqja e bardh’ e lavdia..

Hysen Ruka u ka kënduar trimave popullorë, jehonë kanë patur këngët e tij për ngjarjet e kohës, si dhe shumë nga këngët lirike, si “Kumbulla prapa shtëpisë”, ”O pëllumb nëpër shkëmbenjë” , si dhe shumë këngë dasme, etj.

Ai u bë vazhduesi i mëvonshëm i qazimademçes, duke deputuar në grupin karakteristik të Smokthinës e duke u bërë solisti kryesor i tij. Ndoqi dhe vijën melodike të salikodalançes duke e perfeksionuar këtë më tepër edhe nga e ëma, e cila ishte këngëtare e mirë. Më se 50 këngë të kënduara prej tij janë të regjistruara në mediat audiovizive dhe është pjesëmarrës në disa

Festivale Folklorike Kombëtare, si dhe në festivalin ndërkombëtar në Ganat të Francës. Me zërin dridhës, kumbues, melodioz, karakteristik dhe veçues, rreshtohet ndër zërat më të arrirë të këngës dhe polifonisë labe.

Është dekoruar dy herë me medaljen “Naim Frashëri” për interpretim virtuoz të këngës. Ai mbetet një zë i thellë, virtuoz dhe i rrallë, i veçantë e që trondit me kumbimin e tij epik dhe ëmbëlsinë lirike.

IDAJET JAHAJ

(Marrë me shkurtime nga libri “Smokthina e bazave”)

KËNGA QYTETARE VLONJATE DHE TRIOJA



Duke shkruar këtë libër për festivalet folklorike kombëtare, duke qenë se edhe kënga qytetare vlonjate ka qenë disa herë në repertorin e këtij evenimenti, nuk mund të lëmë pa thënë dy fjalë për këtë gjini, e cila është pagëzuar me emrin “trioja vlonjate”, pasi është hedhur baza e të kënduarit nga një trio që me të vërtetë, bëri emër në kohën kur lindi nga këngëtarët Meliha Doda (Alimerko), Reshat Osmani dhe Kostandin Thana dhe që

vazhdohet të këndohet me interpretë të rinj të tjerë edhe në ditët e sotme.

Nëse do të kërkojmë një datë të saktë për lindjen e këngës qytetare vlonjate, do të bënim gabim, po ta datonim. Ashtu si të gjitha këngët e tjera, edhe kënga qytetare ka lindur me lindjen e qytetërimit të Vlorës, të këtij populli që e krijoi dhe e interpretoi, sepse nëpërmjet kësaj, populli ka shprehur dhe shpreh ndjenjat e tij shpirtërore, pra, hallet, dertet, ngjarjet, etj.

Nuk kam ndërmend të merrem me gjenezën e kësaj kënge, por edhe mund të them se është e hershme. Këto lloj këngësh njihen ndryshe edhe si “ këngë të ahengut qytetar”. Të dhënat historike flasin se kënga qytetare vlonjate mund ta ketë prejardhjen nga kënga e Kaninës, si kryeqendër e Vlorës që në lashtësi dhe Vlora në atë kohë shërbente si skelë. Për të hedhur sadopak dritë në këtë që themi, mund të përmendim disa këngë që flasin për kala, si “te porta e kalasë” etj, se vetëm Kanina ka patur kala në atë kohë. Më vonë kjo lloj kënge mund të ketë zbritur poshtë në Vlorë, me lëvizjen e lirë të popullsisë dhe bartësit e saj bashkë me ta erdhi edhe kënga. Kjo lloj kënge e kënduar nga Kanina, në disa variante të kënduarit ekziston edhe në ditët e sotme. Për të përforcuar këtë mendim, mund të përmend një bisedë të bërë me poetin e njohur vlonjat dhe drejtuesin e grupit polifonik të Kaninës, Meleq Kapllani. Ai thotë se kënga “ Te porta e Kalasë” është kënduar nga tre burra

të moshuar, të vendosur mu tek porta e kalasë së Kaninës në pozicione të ndryshme, shkallë – shkallë, ku ja merrte fillimisht i pari, pastaj vazhdonte i dyti dhe në fund i treti dhe në fund të tre përbënin një trezërësh. Lëvizja demografike e banorëve të Kaninës dhe vendosur në lagjet e vjetra të Vlorës, si Karabashi , etj, sollën me vete edhe këngën, e cila këndohej nëpër ahengje të ndryshme, ceremoni fejesash e dasmash që organizoheshin në qytetin e Vlorës dhe këndoheshin “acapella”. Duhet thënë, se

edhe sot e kësaj dite, disa këngë shumëzërësha që këndohen në Kaninë, kanë gjetur orkestrimin në këngët qytetare vlonjate.

Në botimin e Institutit të Folklorit “250 këngë popullore dasme” – Tiranë 1966 gjejmë këto këngë të kënduara ga këngëtarja Kimete Muça e datëlindjes 1941 nga Kanina. Këto këngë gjendjen në Institutin e Folklorit, në bobinat, si më poshtë:

1. “Thanas bem shtyll’ e shtëpisë” – Bobina 250/14
2. “Të veshja fustanin” – Bobina 250/17
3. “Më ngjitej në shkallë” – Bobina 250/12
4. “Këtu në sarajet tona” – Bobina 250/15
5. “Perëndon dielli, ra në det” – Bobina 250/13

Duhet përmendur se këto këngë janë edhe me partitura të shkruara nga Eftim Dheri.

Mjafton të nisemi nga këto të dhëna të Institutit të Folklorit, institucioni i specializuar për folklorin shqiptar për të menduar dhe njëkohësisht vërtetuar se kënga qytetare vlonjate e ka zanafillën te kënga e Kaninës.

Trioja vlonjate u shfaq në skenat tona pas organizimit të “Dasma vlonjate” që ka për protagonist themeluesin e kësaj kënge Artistin e Merituar Themestokli Mone. Ishte ky që pas shumë hulumtimesh e zbulime nëpër fshatra afër Vlorës, vuri gurin e parë të themelit në ngritjen e këngës qytetare në piedestalin që ne e njohim, në përgjithësi dhe trios vlonjate në veçanti. Si njohës i mirë i këngës së trevës së Vlorës, Th. Mone u mbështet në tabanin e këngës labe e sidomos në këngën e hershme të Kaninës. Kjo vërtetohet edhe në faktin se kënga e parë e kënduar nga kjo trio është kënga “ Ku këndojnë zogat-o”, këngë autentike e kaniniote. Bashkëpunimi i kompozitorit Themistokli Mones me kompozitorin tjetër dhe këngëtarin e mirënjohur Reshat Osmani bënë që t’i bashkangjisin edhe orkestrën me të cilat këto këngë do të shoqëroheshin. Përveç repertorit të gjetur dhe të përpunuar, më vonë lindën këngë të reja, një pjesë e mirë e teksteve të këtyre këngëve janë shkruar nga Lefter Çipa, të cilat u përpunuan dhe u

ngritën në një nivel më të lartë artistik, duke gërshetuar më së miri elementët kompozicional dhe strukturën e mirëfilltë të një kënge.

Dhe kënga qytetare vlonjate e nisi rrugës e saj me tri emra, të cilat më vonë e konsoliduan duke fituar autorësinë e saj. Struktura e saj u ndërtua e tillë sipas gjetjes dhe përshtatjes së zërave: dy burra dhe një femër, përkatësisht: Reshat Osmani, Kostandin Thana dhe Meliha Doda. Kjo trio ishte forma e parë që u shfaq në atë periudhë që për mendimin tim i përngjan trios karakteristike të Dukatit, por që në këtë trio nuk figuron elementi femër.

Dihet që në kohët e para nuk ka patur instrumenta, ato kanë lindur më vonë, ose janë importuar më vonë. Një gjë e tillë vërtetohet edhe me krijimin e sazeve popullore të qytetit që në fund të shekullit XIX dhe fillimin e shekullit XX. Njihemi me familjen Ceno, Asim e Bilbil Ceno që nuk ishin vlonjatë, por ardhës, nga Përmeti, të cilët, ndoshta me ardhjen e tyre e përpunuan këtë lloj kënge duke futur edhe instrumentat, të cilat janë edhe sot e kësaj dite. Bilbil Ceno në instrumentin e klarinetës dhe Asim Ceno me violinë, të cilët krijuan sazet popullore.

Flitet gjithashtu, se kënga qytetare vlonjate, mund të ketë ngjajshmëri me këngën beratase, apo dhe me ndonjë tjetër. Kjo, për mendimin tim, ashtu siç përmenda edhe më sipër, qyteti i Vlorës u dynd nga shumë ardhës, edhe nga Berati, të cilët sollën me vete edhe këngën, por që gjetën këtu një terren të ngritur dhe kështu iu bashkangjitën kësaj kënge, duke e përpunuar dhe e çuar më tej atë. Arsyeja tjetër që ka përjasje me këngën beratase është edhe për shkak të krushqive që kishin këto qytete me njëri- – tjetrin, si dhënie, ashtu edhe marrje. Mund të jenë huazuar tekste nga kjo trevë, ashtu siç mund të jenë marrë edhe nga treva të ndryshme të vendit, por që me kalimin e kohës kanë fituar autorësinë vlonjate. Por nuk mund të themi kurrësesi, se kënga vlonjate është e huazuar nga kënga beratase apo gjetiu. Historia tregon se edhe Vlora është një nga qytetet e vjetra të Shqipërisë

dhe pa dyshim ka patur edhe identitetin e saj kulturor e artistik. Pra, me një fjalë, mund të kemi ndërthurje kulturash, apo këngësh, por në një terren të përgatitur. E thënë me një fjalë, asgjë nuk ka të prerë me thikë.

Ndoshta nuk ishte rastësi, sepse kënga vlonjate është e hershme dhe kalon nëpër disa etapa, derisa vjen në ditët e sotme dhe këtë formë, në të cilën ne e kemi sot.

Dhe sa herë që përmendim këngën vlonjate, mendja të shkon fillimisht tek kompozitori i njohur Themistikli Mone , i cili rreth viteve '50 të shekullit të kaluar e vuri në baza muzikore, e përpunoi atë duke e sjellë dhe fituar kështu një fizionomi të vetën, atë që njohim edhe sot, duke vazhduar më tej me kompozitorë të tjerë si Reshat Osmani, Haxhi Dalipi, etj.

Me krijimin e estradës profesioniste të Vlorës, në vitin 1956, kënga qytetare ishte pjesë e pandashme e repertorit të kësaj estrade, me këngëtarët e shquar që formuan trion e bukur vlonjate: Meliha Doda, Reshat Osmani dhe Kostandin Thana që i vunë vulën këngës qytetare vlonjate dhe që e bënë të njohur, jo vetëm në qytetin e Vlorës dhe rrethinat e saj, por në mbarë Shqipërinë e më tej dhe që mbetën si një obelisk i përjetshëm në kulturën dhe muzikën popullore shqiptare. Pothuajse tematika e repertorit të këngës vlonjate, përfaqësuar nga “Trioja” kishte një karakter lirik. Mjafton të përmendim këngët :”Ku këndojnë zogat-o”, ”Ja thoshte bilbili”, ”Burbululeja”, ”Dy thëllëza në një portë”, ”Hanko Pelivaneja”, ”Unë të kisha trupin tënd”, pjesëmarrëse në festifalin folklorik kombëtar të Gjirokastrës në vitin 1988, ”Pse m’i mban sytë mbi mua”, ”Aromë portokalli” e shumë e shumë këngë të tjera mbetën në repertorin e muzikologjisë sonë dhe fituan një popullaritet të madh duke u bërë pjesë në dasma dhe gëzime të tjera familjare, pothuaj nga të gjithë. Kjo këngë u pasua më tej nga këngëtarë të tjerë; si Piro Cakrani, Kleopatra Skarço, Milika Meminaj, Milika Nerënxi, Mariza Miço, Veneranda Billa, Shaban Shabani, Flamur Haxhiraj që kontribuan për këngën vlonjate në vite e deri në ditët e sotme, ku vazhdon të këndohet

nga Ludmilla Baballëku, Lefter Suparaku, Drini Kanani (një trio e re), Mariola Kaçani, pjesëmarrëse në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës të vitit 2004, Silva Gunbardhi e të tjerë, pa përmendur këtu fëmijët e vegjël të Qendrës Kulturore të Fëmijëve që janë pasues të denjë të kësaj kënge, këtë trashëgimi të vyer dhe të bukur që do të vazhdojë edhe në të ardhmen me pasionin dhe dashurinë për këngën e bukur vlonjate.

Duke zbritur kalanë e Gjirokastrës, pas konkurimit të grupit të Qarkut të Vlorës, në Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës, 2009, një ndër shikuesit që kishte ndjekur festivalin, u shpreh: “Faleminderit, më sollët trion e vjetër vlonjate”. Ishte fjala për trion vlonjate që u këndua në këtë festival nga këngëtarët: Ludmilla Baballëku, Lefter Suparaku dhe Drini Kanani me këngën “Vashëza në zall të lumit”.

Në “Fjalori enciklopedik i trashëgimisë shpirtërore” me autor Dr. Fejzulla Gjabri, duke folur për këngën qytetare vlonjate, midis të tjerash shkruan: “Kënga qytetare e Vlorës është ndër më të pëlqyerat në gjithë vendin tonë. Kënga e ka zanafillën e vet që në hershmëri, por që i dha shtytje Bilbil Vlora në vitet ’20^{të} që mbetet reformator i këngës popullore polifonike me iso, të shtrirë më tej si kënga popullore qytetare labe. Pas viteve ’50^{të} të shekullit XX, kënga popullore qytetare e Vlorës ka një formacion të njohur (nën drejtimin e Artistit të Merituar Themistokli Mone-shënimi im) me emrim “trioja vlonjate” që vazhdoi për më se 40 vjet. Ky formacion përbëhej nga Kostandin Thana, Reshat Osmani, Besharete Ismaili dhe Meliha Doda që konsoliduan këngën qytetare vlonjate”.

Nuk jam dakort me disa artikullshkrues që shkruajnë se kënga qytetare vlonjate ka lindur gjatë viteve ’70 të shekullit të 20^{të}, ashtu siç nuk jam dakort se kjo trio është shuar. E them këtë duke u bazuar dhe argumentuar në veprimtaritë që organizohen sot në shekullin e 21^{të} qoftë ato me karakter lokal, apo edhe kombëtar. Pjesëmarrja e deritanishme e këngës qytetare vlonjate në përgjithësi dhe e trios vlonjate e ringjallur në veçanti, tregon

më së miri vazhdimësinë e kësaj tradite të shkëlqyer, e cila mbijeton edhe në këtë periudhë tranzicioni të stërzgjatur. Gjithashtu nuk jam dakort me disa eksperimente që luhen sot në kurriz të trios vlonjate duke ndërruar formulën e themelimit të saj nga dy burra dhe një femër, në dy femra dhe një burrë. Këto nuk janë gjë tjetër, përveçse stisje në emër të risisë, duke shkelur me të dyja këmbët shtratin tradicional që e ka vulosur njëherë e përgjithmonë këtë gjini kaq të bukur dhe domethënëse.

NJË LIS I BLERUAR I KËNGËS LABE



Muhamet Tartari ka lindur në fshatin Vranisht, ku tradita e këngës labe ka gjurmë të hershme, i cili zë një vend të rëndësishëm në pasurimin e këngës të këtij fshati.

Me krijimtarinë e tij, ai ka më shumë se tridhjetë vjet që punon me përkushtim për të mbajtur gjallë këngën e vallen e Vranishtit, e cila është ngritur në maja të reja. Më shumë se 800 tekste këngësh janë thurur nga Muhamet Tartari, të cilat kryesisht janë kënduar nga grupet polifonike të fshatit të tij, por mjaft këngë të tjera janë kënduar edhe nga grupet polifonike të Lumit të Vlorës, Himarës, Kurveleshit, Gjirokastrës e Ansambli i Këngëve e Valleve Popullore në Tiranë. Vallja dhe kënga e Vranishtit, nën drejtimin e Muhamet Tartarit kanë shprehur edhe më qartë

aftësitë artistike të brendshme, mundësitë shprehëse duke rrokur tema, motive e hapësira me një kolorit të pasur për trevën e Labërisë. Kulme të reja arriti vallja karakteristike e këtij fshati, ose vallja vënçe, siç e quan ai vet. Këmbëngulja e madhe e këtij krijuesi, mbeti përherë mendimi i tij për realizimin e elementit të valles së kënduar, ku valltarët kërcenin edhe duke ecur në gjunjë. Kjo shpesh shoqërohej edhe nga kërcimi i befasishëm i valltarëve. Valle të tilla, si: "O trima vallen ma mbani", "Shpata jonë gris fermanë", "Gjithë shqiptarët rreth flamurit", "Shqipëri, flamur qëndrese", "Labëri dyzet kështjella", "Shqipëria jonë me famë", patën fatin të kërcenhen nëpër skenat e Festivaleve Folklorike Kombëtare, duke mbartur vlera të veçanta në interpretimin dhe në gjurmimin e tyre.

Poeti popullor, me natyrën e tij energjike, shpesh shpërthen në këngët e veta, saqë duket në relievin e traditës folklorike si një shkrepëtimë në qiellin e këngës labe.

Duke folur për këtë figurë madhore të poetit të Labërisë, Muhamet Tartarin, poeti i njohur Lefter Çipa, midis të tjerave i shkruan: *"Poezia është një pentolirë në majë të jataganit, shumë shpejt ta rrëmben miku dhe vështirë është të ta marrin armiqtë. Ne pendëtarët, le të ruajmë pikën e penës, ashtu si ruajti pikën e qiririt Naimi, sepse kjo na siguron shpirtin e madh kombëtar dhe evropianizimin. Evropa kurrë s'ka patur qirinj më të ndezur se sa ne shqiptarët. Qirinjtë e shqiptarizmit dhe të kulturës së tij kanë ndriçuar përherë tempullin e dritës evropiane".*

(Marrë me shkurtime nga libri "Vallja e vetëtimave")

VENDIM KAPAJ (Mjeshtër i Madh)



Vendim Ibrahim Kapaj ka lindur në fshatin Kërkovë të Vlorës më 06.01.1959.

Kariera e tij artistike ka nisur qysh në moshë të vogël, ku ka spikatur talenti i tij i rrallë në instrumentin e fyellit, me një të rënë të veçantë që rrallë e gjen ose fare, siç është pozicionimi i të rënit me dhembë. Kjo e dallon atë nga të gjithë fyelltarët e tjerë. Që në këtë moshë ai ka qenë pjesëmarrës në aktivitetet kulturore e artistike në nivel rajonal dhe më gjerë.

Për jetën e vet, Vendimi, mes vargjeve na tregon të gjithëve se qysh në moshën 14-vjeçare u ngjit në skenë, duke e plotësuar ëndrrën e tij për të qenë pjesë e skenës dhe jo vetëm të dëgjonte veten e vet, qoftë një herë të vetme në radio.

Që në ato vite të fëmijërisë së tij që hipi për herë të parë në skenë dhe deri më sot ai nuk i ndahet skenave kombëtare dhe atyre ndërkombëtare.

Më poshtë po japim disa nga veprimtaritë kombëtare dhe ndërkombëtare ku ai ka marrë pjesë dhe është laureuar me çmime të ndryshme:

- Në vitin 1973 ai është pjesëmarrës për herë të parë në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës.
- Më 05.10.1975 nga Shtëpia e Kulturës dhe e Krijimtarisë Popullore Vlorë i jepet zotit Vendim Kapaj “Fletë Lavdërimi”, ku u dallua për “Interpretim të mirë në Festivalin Folklorik të zonës Nartë për melodi me fyell”.
- Më 20.10.1983 nga ana e Komitetit të Kulturës dhe Arteve, në bashkëpunim me Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës merr diplomën dhe Medaljen “Laureat” i Festivalit Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës.
- Më 24.01.1984 me Dekretin Nr. 6859 nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPSSH, merr medaljen “Naim Frashëri” si dhe titullin “Artist i Merituar” me motivacionin “Shoku Vendim Kapaj është dalluar në përgatitjen e grupit të Rrethit të Vlorës për Festivalin Folklorik të vitit 1983 të Gjirokastrës dhe nivel të lartë artistik”.
- Më 13.01.1988 merr pjesë në Festivalin Folklorik Gjirokastrë, nga ku merr “Diplomë” me përshkrimin “Grupin instrumentalist për melodinë “I dua malet e mia”. U dallua gjithashtu në Festivalin Folklorik

Kombëtar Gjirokastrës për interpretim të lartë artistik, ku ka marrë medaljen “Laureat” i Festivalit.

Më 13.10.1988 Komiteti i Kulturës dhe i Artit, i jep Fletë Nderi me motivacionin për “Melodinë instrumentale “ I dua malet e mia”.

- Në vitin 1989 ai është pjesëmarrës, së bashku me Ansamblin “Labëria” Vlorë në Festivalin Botëror “Gannat” , Francë ku dhe janë vlerësuar me çmimin e parë.

Që nga ky vit e deri më sot ai është pjesëmarrës në shumë festivale botërore, si në Francë, Spanjë, Itali, Gjermani, Holandë, Belgjikë, Poloni, Hungari, Bullgari, Rusi, Lituani, Kroaci, Maqedonia e Veriut, Jugosllavi, Slloveni, Mali i Zi, Kosovë, Greqi, Turqi, Izrael, Dubai etj.

- Në vitin 2000 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Qendra Kombëtare e Veprimtarisë Folklorike Fest Folk Kombëtar Gjirokastër 2000, Komiteti organizativ i jep “Certifikatë” Z. Vendim Kapaj si pjesëmarrës në Festivalin Folklorik Kombëtar.
- Më 24-26 nëntor 2002 Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me Qendrën Kulturore e Veprimtarisë Folklorike, Bashkia Vlorë, merr “Diplomë” me përshkrimin: “ I jepet instrumentistit të Iso-Polifonisë”, zotit Vendim Kapaj, fitues i çmimit të karrierës në Festivalin Kombëtar Tipologjik të Iso-Polifonisë”.
- Më 04.06.2003 nga Këshilli i Qarkut Gjirokastër, në Festivalin Folklorik të veglave të muzikës popullore, i jepet Çmim i Parë instrumentistit Vendim Kapaj me motivacionin “Për interpretimin me nivel të lartë artistik në festivalin folklorik të veglave të muzikës popullore, Gjirokastër 2003.

- Më 30 nëntor 2006, nga Bashkia Vlorë, në bashkëpunim me Qendrën Kulturore Vlorë dhe rjeti kombëtar i shoqatave të polifonisë, i jepet zotit Vendim Kapaj, titulli “Nderi i Artit Vlonjat” për “Kontribut të shquar në interpretimin, ruajtjen dhe pasurimin e polifonisë, si vlerë e paçmuar e folklorit shqiptar dhe kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit e mbrojtur nga UNESCO”.
- Në 30 qershor 2007, merr pjesë në festivalin folklorik burimor “Sharri këndon” – Tetovë, i jep “Mirënjohje”, zotit Vendim Kapaj si pjesë e grupit “Çipini” – Vlorë, Shqipëri për “Pjesëmarrje dhe për kontributin e dhënë në ruajtjen dhe kultivimin e folklorit burimor shqiptar”.
- Më 24-25 maj 2008 Shoqata Kulturore Artistike “Polifonia shqiptare” i jep “Çmim karriere”, zotit Vendim Kapak për “Kontribut të shquar në zhvillimin, pasurimin, interpretimin me mjeshhtëri të lartë artistike dhe transmetimin me nivel të lartë ndër breza të këngës polifonike shqiptare gjatë dy dekadave të fundit”.
- Në vitin 2009 Shoqata Kulturore Artistike “Shtëpia e Polifonisë” i japin këngëtarit Vendim Kapaj “Diplomë” me përshkrimin “Vlerësohet për talentin dhe pjesëmarrjen në aktivitetin e festivalit të parë kombëtar, “Polifonia flet”.
- Më 04.06.2010, Bashkia Gramsh, si dhe Qendra Kulturore “Vëllezërit Çetiri”, i japin zotit Vendim Kapaj “Diplomë” për paraqitje me dinjitet në takimin mbarëkombëtarë me motivacionin “Ruajtja e traditës të fyejve dhe trashëgimi i tyre ndër breza”, si edhe çmimin “Magjia e fyejve”.

- Më 21 korrik 2010, Bashkia Burrel, në bashkëpunim me Qendrën Kulturore Burrel, i japin zotit Vendim Kapaj “Mirënjohje” për pjesëmarrje në Fest Folk.
 - Më 04.02.2014 me Vendimin Nr. 9 të po kësaj date, nga Këshilli i Qarkut Vlorë i jepet zotit Vendim Kapaj titulli “Personalitet i shquar i Qarkut Vlorë” me përshkrimin “Instrumentist i shquar me kontribut të veçantë në zhvillimin e Polifonisë Shqiptare”.
 - Më 28.04.2015 nga Presidenti i Republikës, zoti Bujar Nishani, Dekretin Nr.9070, merr titullin “Mjeshtër i Madh” me përshkrimin “Bartës i traditës tipologjike të instrumenteve të stilit baritor në ekzekutimet magjike të felli të tij të famshëm”
 - Më 16.05.2015 pjesëmarrës në Festivalin Folklorik Kombëtar Gjirokastër, si instrumentist si dhe pjesë e grupit “Çipini”, vlerësohet me “Çmimin e karrierës”.
 - Më 24-25 nëntor 2016, pjesëmarrës në Edicionin IX të festivalit “Tipologjik të rapsodëve dhe instrumentistëve popullorë”, zhvilluar në qytetin e Lezhës vlerësohet dhe pajiset me Certifikatë pjesëmarrje. Po në këtë veprimtari vlerësohet me çmimin e parë nga Ministria e Kulturës, Qendra Kombëtare Vendore Folklorike Lezhë, me motivacionin “Instrumentisti më i mirë për interpretim të spikatur në lojën me instrument popullor”.
- Aktiviteti i këtij Mjeshtri të Madh nuk përfundon këtu. Ai vazhdon të jetë aktiv në vazhdimësi, duke qenë i pranishëm në çdo veprimtari të kulturës shpirtërore si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

NJË POET QË I KËNDON ZEMRA (NERTESI ASLLANI)



Në pyllin e blertë të këngës polifonike të Lumit të Vlorës prej vitesh cicëron edhe zëri i poetit e këngëtarit të mirënjohur, Nertesi Asllani.

Në Kurveleshin e Poshtëm dhe në vtërësi në brigjet, në të anët e rrjedhjes së Shushicës, Nertesi Asllani me pasionin dhe punën e tij gjurmuese dhe ekzekutuese u bë në dhjetëvjeçarin e fundit përfaqësuesi më në zë i brezit të zi në pasurimin e këngës tradicionale polifonike të Labërisë. Në krijimtarinë e tij poetike dhe në veprimtarinë polifonike një ndikim të fuqishëm ka dhënë sidomos tradita e pasur e fshatit Bolenë me këngët, rrëfimet, legjendat dhe traditën e pasur zakonore. Vet fshati Bolenë është

shquar në këtë trevë për pasurinë e larminë e folklorit e sidomos të këngës “labçe vënçe”. Në mjaft këngë të thurura nga poeti popullor Nertesi Asllani janë po ai ndikim i dukshëm i logatjeve, monofonisë dhe këngëve të djepit që praktikohen gjerësisht në këtë fshat. Gjurmimi që i ka bërë kësaj pasurie Nertesiu, e ka ndihmuar atë në dy drejtime: së par, në përpunimin dhe ekzekutimin e vlerave të traditës me grupin polifonik të fshatit dhe ushqimi i krijimtarisë së tij. Së dyti, duke qenë në afërsi gjeografike me fshatra të tillë si Kallarati, Vranishti dhe Tërbaçi, poeti reflektoi në gjallërimin e këngës së fshatit të tij duke i dhënë dinamizën e frymëmarrje më të gjerë motiveve, melodive dhe alternimit me instrumentet popullore. Në krijimtarinë poetike të tij ndihet ndikimi i fuqishëm i Ali Dines, Tartar Zekës, Xhemil Veli Dukës, Xhebro Gjikës, Selim Hasanit, Miftar Shuaipit, Qazim Ademit, nga të cilët mori motivet, por edhe mënyrën e të kënduarit. Ndërsa nga poetë të tjerë të shquar të kësaj treve, si Kujtim Mici, Muhamet Tartari e Llambro Hysi, ai u ndikua në strukturimin e poezisë së tij dhe flladitjen e shpirtit lirik.

Në analizën e krijimtarisë poetike të Nertesit Asllanit vë re se ai, duke reflektuar në pasurimin e këngës së vet, ka përthithur elemente të veçanta edhe nga kënga polifonike e Dukatit, Pilurit dhe Kurveleshit. Është e natyrshme, se nxjerrja në skenë e disa prej vlerave të rralla të këngës së Bolenës, është bërë me një përkushtim të rrallë prej poetit., por edhe me një gjurmim të kulturuar në planin krahasues për ta ngritur në nivele të reja.

Vet shtëpia e Nertesit Asllanit ka qenë një sofër e shtruar këngës labe. Babai i tij, Tare Asllani, ka qenë i njohur si këngëtar dhe instrumentist popullor në trevën e Kurveleshit. Nga ana tjetër, rapsodët e njohur popullorë, si Feri Mezini, Lufto Sakaj dhe Ruzhdi Bajrami, pararendës të tij, i dhanë një shembull të mirë në gjallërimin e këngës polifonike të fshatit. Vet Nertesiu është një nga fëmijët këngëtarë të kësaj tradite që u shqua qysh në moshë të vogël. Ky pasion u ushqye edhe në vitet më pas, kur iu dha mundësia të punonte si përgjegjës i shtëpisë së kulturës së

Bolenës. Në 20 vjet të punës së tij, ai mblodhi rreth 800 njësi folklorike e etnografie., një bazë e mirë kjo për të gjetur e shfrytëzuar elementet e kulturës shpirtërore të këtij fshati. Shumë elemente të këngës tradicionale, ai i gjeti tek mjeshtrat e këngës e të valleve karakteristike si: Idriz Azemi, Shaqir Bega, Maze Veipi, Malo Razipi, Mico Trako, Hariz Mato, Begë Alimi etj. Rreth këtij poeti popullor për shumë vite u mblodhën e i dhanë jetë këngës tradicionale të Bolenës këngëtarët e vallëtarët virtuoze, si: Rrapo Tartari, Davo Zeneli, Durimi Lalaj, Lavdosh Begaj, Toto Zeneli, Vangjel Asllani, Fatbardha Hosi, Vitori Hosi, Myrvete Begaj, Pajtim Zeneli etj. Ky brez këngëtarësh, në vitet 1980-1990, e ridimendionoi këngën e Bolenës duke i dhënë vlera të reja kombëtare. Nga ky grup polifonik janë ekzekutuar rreth 200 këngë e valle. Në fondin e tyre janë të regjistruara në Arkivin e Institutit të Kulturës Popullore, Radio – Televizioni Shqiptar, Radio Gjirokastra e gjetkë rreth 127 këngë, valle, melodi. Në shtratin e këtyre baladave, ninullave, legjendave, valleve humoristike, këngëve të dasmës, ato patriotike e elegjiake është një botë e tërë që jep vizione të gjera estetike e artistike të jetës së banorëve të kësaj treve. Vet Nertesiu ka ngritur e vënë në skenë më shumë se 120 këngë, një pasuri e tërë kjo që përcakton qartë individualitetin e tij krijues duke sjellë vlera të bukura në polifoninë shqiptare. Nën drejtimin e Nertesi Asllanit, grupi polifonik i fshatit Bolenë është Laureat i katër Festivaleve Folklorike Kombëtare. Në fondin e folklorit shqiptar kanë zënë vend të nderuar këngët “Paku me plakën ç’u zunë” (valle humoristike e kënduar) 1983, “Rritu se të pret martina” 1988, kënduar nga këngëtarja virtuoze Fatbardha Hosi, “Bluaj millona” 1995, kënduar nga grupi polifonik në Festivalin Folklorik Kombëtar në Berat. Vlera të veçanta paraqet edhe kënga “Jo, mor jo, s’besohet karta” (baladë), e cila në shtratin e saj polifonik dhe interpretim plastik, përbën vlera studimi.

Për vlerat e punës folklorike të Nertesi Asllanit dhe grupit folklorik të Bolenës kanë dhënë mendime disa nga personalitetet

e njohura të kulturës popullore. Prof. Qemal Haxhihasani, duke dëgjuar disa nga logatjet dhe ninullat e interpretuara nga ky grup thotë: “ Mbështetja në traditën e mëparshme folklorike dhe gjurmimet e Nertesi Asllanit janë për t’u admiruar, pse kjo është rruga e vetme për të ringjallur vlerat e vërteta të folklorit tonë”. Studiuesi Kozma Vasili ka bërë këtë vlerësim në vitin 1989. “Nertesi Asllani dhe grupi i këngëtorëve të Bolenës suksesin e polifonisë së vet e kanë në gërshetimin e elementeve të traditës me frymën e re të kohës, duke i dhënë dallgë shpirti këngës së tyre”. Ndërsa poeti i mirënjohur popullor Muhamet Tartari nga Vranishti e përcakton kështu punën pasionaste të Nertesi Asllanit dhe grupit polifonik të Bolenës: “ Këngën e Bolenës e ngritën dhe e lartësuan grupi i ri me Nertesi Asllanin, të cilët me dashuri të rrallë kanë pasqyruar jetën dhe traditën e këtij fshati me histori e kulturë”.

Br. Bardhosh Gaçe

ANSAMBLI I VALLEVE “KRAHU I SHQIPONJËS” VLORË

Siç dihet, në qytetin e Vlorës, në përbërje të popullsisë të këtij qyteti, ka një popullsi çame, ardhur që në kohën kur ata u dëbuan nga vendi i tyre, Çamëria, e cila ndodhet në shtetin fqinj, Greqi.

Ardhja masive e tyre daton kryesisht që në vitet e para të pasçlirimit dhe u ngulën përfundimisht në Vlorë.

Së bashku me ardhjen e tyre në këtë qytet, ata sollën me vete edhe kulturën shpirtërore dhe materiale të krahinës së tyre, duke përfshirë këngët, vallet, doket dhe zakonet. Kjo kulturë shpirtërore shfaqej herëpashere në gëzimet e tyre familjare dhe kryesisht nëpër dasma që organizonin e deri sa dolën jashtë mureve të shtëpive të tyre, duke krijuar grupe e më vonë i emërtuan ansamble. I tillë është edhe Ansambli artistik “Krahu i Shqiponjës”, me seli në Vlorë, me drejtues njeriun e pasionuar Sali Nuredini.

Ansambli “Krahu i Shqiponjës” Vlorë, për herë të parë në historinë e tij arrin të kalojë të gjitha provat seleksionuese që bëhen para festivalit dhe të jetë pjesëmarrës në Festivalin e 9-të Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës në vitin 2009. Marrja pjesë në një eveniment të tillë, i motivoi më tepër në drejtim të ngritjes së cilësisë artistike. Nuk duhet harruar dhe vlen për t’u përmendur që një ndihmesë të madhe në këtë ansambël ka dhënë koreografi i shquar i valles çame, mjeshtëri Taip Madani. Profesor Taip i edhe pse nuk banonte në qytetin e Vlorës, ai vinte shpesh dhe e drejtonte këtë grup me përvojën e tij shumëvjeçare dhe si një profesionist i vërtetë.

Në këtë festival ansambli “Krahu i Shqiponjës” u paraqit me një suitë vallesh çame, ku padyshim, vendin kryesor e mbante vallja e Osman Takës. Në përfundim të Festivalit, juria, për individë të caktuar, laureat i çmimit të parë iu dha valles së Osman Takës, interpretuar me mjeshhtëri nga valltari i këtij ansambli Denis Lekgegaj.

Pas këtij prezantimi dinjitoz në festivalin e vitit 2009 në Gjirokastrë, ansambli nisi të rritej duke punuar me seriozitet për një ecuri sa më dinjitoze, falë ndihmës së mjeshhtërit Taip Madani. Kështu që ky ansambël tashma i kishte rrugët të hapura për të marrë pjesë edhe në veprimtari të tjera kombëtare dhe mbarëkombëtare dhe veprimtaritë artistike nisën të shtoheshin. Rrugëtimi i tyre nisi me pjesëmarrjen me sofrën dibrane, Tropojë në të gjitha edicionet e saj që nga viti 2008 e në vazhdim dhe fitues i dy çmimeve të dyta. Ky ansambël ka qenë pjesëmarrës në Festivalin e Çamërisë në Sarandë, ku fiton një herë çmim të dytë dhe dy herë çmim të parë.

Me rastin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare, në vitin 2012, ky ansambël u paraqit me një cilësi të lartë artistike dhe interpretative.

Në Festivalin e Deçanit, Kosovë, ka qenë fitues i çmimit të parë. Gjithashtu ka dhënë disa koncerte në disa qytete të Kosovës, si : Mitrovicë, Prishtinë, Gjakovë, Skënderaj, Gjiilan, disa herë në Gjakovë e Prizren. Në festivalin e këngës dhe të valles shqipe “Presheva jehon”, në maj të vitit 2011, ansambli “Krahu i Shqiponjës” është fitues i çmimit të parë. Në shumë raste, ky ansambël ka shoqëruar videoklipe të ndryshme të këngëtarëve me motive çame.

Është meritë e padiskutueshme e drejtuesit të pasionuar të këtij ansambli, zotit Sali Nuredini, i cili me të vërtetë vlen për t’u lavdëruar dhe falënderuar për punën që ka bërë dhe po bën vazhdimisht.

METLLI SHAMETI

Ndoshta është hera e parë që ai kap majën më të lartë të organizimit të një festivali në shkallë mbarëkombëtare, siç është Festivali Folklorik i Gjirokastrës, duke iu realizuar kështu një nga ëndrrat më të bukura dhe më të pritshmet e tij.

Metlli Shameti hyn në pjejadën e atyre këngëtarëve të polifonisë labe që ka ruajtur me fanatizëm autenticitetin e vet në këngën polifone të Sevasterit.

Ka lindur në fshatin Sevaster të Vlorës më 24 shkurt 1947 dhe është rritur po atje duke thithur deri në pikën e fundit nektarin e këtyre këngëve dhe duke i transmetuar ato me mjeshtëri dhe origjinalitet, ashtu siç e ka dëgjuar nga bartësit e këtyre këngëve dhe duke i qëndruar besnik variantit të tyre.

Duke u rritur në një ambient të tillë, ku kënga ishte parësore në çdo sofër të shtruar, gosti, dasmë apo gëzime të ndryshme familjare, ka kultivuar tek ai atë melos original qysh në fëmijërinë e tij të herëshme, ku ai provoi dhe nisi të këndonte që në këtë moshë këngët epike të krahinës, si edhe këngët lirike tradicionale. Kjo dëshirë, e cila rritej dalëngadalë brenda tij, e frymëzoi duke marrë guximin ta radhisë atë si këngëtar, fillimisht në festat lokale për arritur dhe kapur majën më të lartë të trashëgimisë shpirtërore që e çoi atë dhe grupin e tij të Sevasterit për të qenë pjesëmarrës në vitin 2004 në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës të Gjirokastrës, jo vetën si këngëtar, por edhe si rapsod, duke i rritur më tepër vlerat e grupit që ai përfaqëson.

Kontributi i tij si rapsod e lartëson më tepër figurën e tij. Në këtë krijimtari, ne vëmë re se si shkruan për burra të nderuar të krahinës e më gjerë dhe pena e tij vazhdon të shkruajë akoma.

Në krijimtarinë e tij vihen re qartë krijime me karakter kombëtar, këngë lirike, ku në to gjen herë dhembje e herë lotë e brenga, të cilat diktohen sipas situatave që paraqiten në periudha të ndryshme kohore.

Falë punës dhe përkushtimit të tij dhe pjesëtarëve të tjerë të grupit, grupi polifonik i Sevasterit është dekoruar nga Presidenti i Republikës, zoti Bujar Nishani, në vitin 2018.

VESHJET POPULLORE NË RRETHIN E VLORËS

Vlora është një rreth me paraqitje gjeografike shumë të larmishme; larmi në reliev, në klimë, në bimësi, në jetë ekonomike e në burime ekonomike. Kemi vargmalet e larta të malësisë së Labërisë, të cilat janë vazhdimi i atyre të Tepelenës e duke përfshirë pjesën më të madhe të vendit, përfundojnë në anë të Bregdetit të Himarës e në Karaburun. Nga veriu ulen butë-butë, duke përfunduar në kodrina e së fundi në ultësitrat e Myzeqesë së Vlorës. Në to rriten shkurre e shumë pak pyjet e mëdha. Malësitë, luginat e ultësitrat janë të pasura me kullota verore e dimërore, luginat e këtyre maleve janë të thella e përshkohen nga lumenj e përrrenj malorë.

Natyra e vendit ka përcaktuar burimet kryesore ekonomike të vendit, për rrjedhojë dhe burimet e lëndës së parë për veshjet popullore. Në vendet malore me klimë të ftohtë, me blegtori të zhvilluar, veshjet popullore në pjesën më të madhe të tyre bëheshin prej leshi. Në luginat e malësive është prodhuar edhe liri. Diku më pak e diku më shumë është përdorur pothuajse kudo gjeshtra (gjineshtra) për veshje e për shtroje. Në pjesët fushore e bregdetare, krahas leshit, është përdorur edhe liri me gjineshtrën. Gjineshtrën për veshje e kanë përdorur fshatrat e Bregdetit të Himarës dhe fshatra të ndryshme të malësisë së Vlorës. Këmishët prej gjeshtrë janë punuar në fshatra deri në kohën e Pavarësisë. Këmishët prej gjeshtrë, të bëra prej grave, kanë qenë të përmendura për bukurinë e tyre.

Në ndryshimet e veshjeve popullore ka ndikuar dhe shkalla e lidhjes së fshatit me tregun. Këtë ndikim më shumë e kanë ndjerë fshatrat fushore, kodrinore e sidomos ato bregdetare. Tregjet me të cilat lidheshin fshatrat e Vlorës kanë

qenë: qyteti i Vlorës, Gjirokastra, Berati e pika të ndryshme tregtare e artizanale të bregdetit.

Vlora, në pjesën themelore të saj është Labëri, bën përjashtim këtu pjesa fushore e saj që quhet Myzeqe e Vlorës. Pra dhe veshjet e malësisë së Vlorës dhe të Bregdetit nuk kanë ndonjë ndryshim të madh në origjinë nga ato më të herëshmet të përdorurra në Tepelenë. Edhe ndërrimet e veshjeve, sipas kushteve e rrethanave të ndryshme historike, sipas shtresave shoqërore, sipas zejeve, profesioneve e burimeve ekonomike ndjekin aty-këtu të njëjtën rrugë zhvillimi e ndryshimesh.

Për një shqyrtim të drejtë e të kuptueshëm të veshjeve popullore, Vlorën do ta ndajmë në katër rrethina kostumologjike.

1.Rrethina kostumologjike e malësisë së Vlorës përfshin Kurveleshin e Ulët, Lumin e Vlorës, Smokthinën, grupfshatrat Velçë – Sevaster dhe zonën e Koculit pjesërisht.

2.Rrethina kostumologjike e Myzeqesë së Vlorës. Zë pjesën fushore, në veri të Vlorës, duke filluar që nga zona e Koculit. Popullsia e kësaj rrethine në gjendjen e sotme është e përzier si popullsia, këtu kemi myzeqarë, lebër të zbritur nga malësitë dhe vllahë të ngulur.

3.Rrethina kostumologjike e Bregdetit, përfshin bregdetin e Himarës, Nartën dhe Zvërnecin.

4.Rrethina kostumologjike e Dervenit të Vlorës përfshin qytetin e Vlorës dhe fshatrat: Kaninë, Dukat, Gumenicë, Mavrovë, Tragjas – Radhimë.

I. Rrethina kostumologjike e malësisë së Vlorës. Në këtë rrethinë në të kaluarën ka zotëruar blegtoaria që ishte shumë e zhvilluar, banorët e këtyre fshatrave janë marrë pak me bujqësi, bujqësia ishte e zhvilluar pak në luginat e lumenjve e të përrenjve e në ultësitat e këtyre maleve. Në të kaluarën këto fshatra kanë qenë pak të lidhura me tregun, e pra, në ato kushte atje ka zotëruar ekonomia natyrore. Veshjet e shtrojet për njerëzit e shtëpisë, në këto malësi, ishin punë e duarve të grave. Lënda e

parë ishte kryesisht leshi i bagëtime; leshi i deleve e i dhive, por veshjet e shtrojet punoheshin dhe nga material gjeshtrë, apo fije liri që kultivohej në ultësiat mes këtyre maleve. Për veshje është përdorur dhe material i blerë në treg, por i punuar nga gruaja në shtëpi. Nga mesi i shekullit XIX e këtej veshja e grave ndryshon rrënjësisht. Pra, veshja me fustan(këmishë të gjatë) përmendet si element qëndror i veshjes më të vjetër i gruas labe. Linjën në Labëri e kanë shoqëruar gjithnjë dy futa,(përparje) një përpara, më e madhe e me xhufka sipër, anash e në fund të saj, e bërë në tezgjah, në dy lisa, me material leshi e në raste të rralla dhe prej gjeshtrë; një prapa e bërë si e para, por më e vogël.

Linja e gjatë është përdorur njëherësh edhe si këmishë, edhe si fustan. Këtë e ndeshim në emra të ndryshme, si “Linjë”, “këmishë”, “fustan”.

Si shoqëruese të linjës së parë kanë qenë jeleku, lëkurçja, brezi, futat që u përmendën, shargani i zi, flokata, vilarja (gunë treçerekëshe) të mbathura, të gjitha këto fillimisht prej leshi. Ndër këto si element shumë i vjetër ka qenë lëkurçja.

Veshja e mëvonshme e gruas labe që ka arritur deri në çlirim, është ajo me çitjane, e cila në elementet orientale të huajtura ndryshon kryekëput nga veshja e vjetër e vendasve tradicionale me “linjë të gjatë”.

Veshja e burrave në përgjithësi është ruajtur origjinale, por edhe kjo ka kaluar nëpër disa faza zhvillimi, duke zëvendësuar disa elemente më të vjetra të veshjes me disa më të reja. Ka ndryshuar disa herë pjesa e poshtme e veshjes (që nga brezi e deri te këmbët). Me kohë kanë ndryshuar ngjyrat, janë shtuar ornamentet. Kështu, duke i radhitur sipas një kronologjie, kemi disa variante të veshjes për burra:

1. Veshja më e vjetër është veshja me një këmishë të gjatë, të bërë prej një cope poshtë e lart e që me kohë vjen e zgjerohet një çikë nga fundi, me mëngë të gjata e të ngushta.
2. Veshja me fustanellë e me tirqe kofsharë.

3.Veshja me poture e tirqë gjunjarë, të vënë re që nga fundi i shekullit XIX.

4.Veshjet me qillota që hyn nga Lufta e Parë Botërore e këtej.

Në veshjet më të vjetra vendase janë përdorur opinga të lopës, por me kohë nga tregu kanë hyrë këpucët me proka, opingat me shollë të regjur, opingat me xhufka.

Në kokë është mbajtur qylafi i bardhë me thumb në majë, aty- këtu, në shtresa të pasura e me nëpunësira, në fund të shekullit XIX gjejmë të përdorur dhe qylafin e kuq me tufa prapa. Por në popull kemi takuar dhe gjurmët e përdorimit të një kësule leshi të bërë në formë sferike, të punuar nga gratë në shtëpi. Mendojmë se ky është një element shumë i vjetër i mbulesës së kokës për burra.

Në të katër variantet e veshjes janë përdorur të njëjtat veshje të leshta si xhamadani i bardhë, ose i zi, mëngorja e bardhë e punuar me gajtana, por e shoqëruar gjithnjë me xhamadan të bardhë, guna e dhirtë e llabanja për barinjte, shargani i bardhë me flokë nga brenda dhe cibuni (sharku) i zi me flokë nga jashtë, brezi i leshtë. Të gjitha këto janë elemente të lashta të punuara në shtëpi nga gruaja labe. Nga fundi i shekullit XIX, kur marrëdhëniet me tregun u bënë më të afërta, filluan të hyjnë dhe të blera nga qyteti.

Në formën më origjinale e më të hershme elementet prej leshi kanë qenë në ngjyrë natyrore: xhamadani i bardhë, tirqë të bardhë, poture të bardha. Qendisjet, si në këmisha, ashtu edhe në elementet e lashta kanë qenë të bardha në të bardhë. Në Smokthinë ndeshim deri tani vonë të qendisurit “ të bardhë në të bardhë”. Më vonë, sidomos nga barinjte, xhamadani u përdor i zi dhe poturet të zeza, çorapët të zinj, me sa duket për nevoja praktike.

Veshjet e burrave në disa elemente të tyre ndaheshin sipas llojit të punës dhe vendit që zinte ai në familje. Gunën ose xhokën e thjeshtë prej shajaku pa mëngë e mbante bariu, ndërsa xhokën e

bardhë, sharganin e bardhë me lesh nga brenda, ose cibunin(sharkun) e mbante i zoti i shtëpisë, ai që dilte në kuvend të burrave, ai që merrte udhëtime jashtë fshatit dhe këto ishin të detyrueshme për këdo në raste martesë e ceremonish familjare me rëndësi.

Fustanella është përdorur më shumë si veshje martesë, veshje ceremoniale, veshje për dalje në kuvend të burrave e në udhëtimet jashtë fshatit.

Nga sasia e kindave të fustanellës dalloheshin shtresat e ndryshme shoqërore. Të pasurit e mbanin fustanellën deri me 300-400 kinda, ndërsa njerëzit e thjeshtë me nga 12 deri në 50 kinda.

II.Rrethina kostumologjike e Myzeqesë së Vlorës. Banorët e saj janë marrë me bujqësi e me blegtori, me vreshtari e me agrume e ullinj. Në të kaluarën veshjet e holla janë bërë prej liri e të trashat prej leshi. Në Myzeqenë e Vlorës, në fshatra të ndryshme, ndeshim banorë të zbritur nga malësitë e Labërisë, sidomos pas çlirimit, me reformën agrare. Duke qenë popullsi e përzier(myzeqarë, vllhë, lebër) janë përzier dhe veshjet popullore të rrethinave të ndryshme. Në zonën e Koculit, në fshatrat që përfshiheshin aty, gjejmë një veshje kalimtare nga ajo labe në atë myzeqare, kështu gjejmë gunën larë, takien myzeqare, diku gjejmë të përdoren dhe brekushet. Veshja e grave përkon me veshjen labe.

Myzeqarët e kësaj rrethine, si veshje burrash dhe si veshje grash, kanë pasur në përdorim po atë veshje që përdoret në Myzeqe të Fierit.

Veshja vllhe e grave është e një origjine të veçantë e bërë në vegjë në shtëpi dhe e mbushur me qendisje të pambukta, ose të leshta.

Veshja e burrave vllhë është si ajo e lebërve, por me xhamadanin dhe poture gjithnjë të zeza, ose ngjyrë manushaqe të errët. Ngjyra e zezë e pjesëve të leshta të veshjes i është përshtatur jetës së tyre baritore.

Në këtë trevë, në të kaluarën, një vend shumë të rëndësishëm ka zënë punimi i lirit për veshje dhe për shtroje. Këmishat e linjta, të bëra në vegjë nga gruaja e shtëpisë, kanë vazhduar të përdoren deri në vitet pas çlirimit, kur atë e zëvendësuan pëlhurat e fabrikuara.

III.Rrethina kostumologjike e Bregdetit. Bregdeti i Himarës është pjesë e Labërisë, por për vet kushtet natyrore të veçanta ka pasur burime ekonomike të ndryshme nga malësia e Vlorës.

Bregdetasit, në të kaluarën, janë marrë me blegtori, me vreshtari, me agrume. Kjo trevë është e njohur veçanërisht për kultivimin e ullirit. Janë marrë shumë me peshkim. Në të kaluarën shtëpi të tëra kishin mjetet vetiake të peshkimit e të tregtisë. Një pjesë e banorëve të saj janë me origjinë nga Kurveleshi, ndërsa shumica janë lebër. Në origjinë veshjet e grave e të burrave kanë qenë si të malësisë së Vlorës, por zhvillimi i tyre ka ecur në një rrugë të ndryshme. Për të bërë veshjet e tyre, deri nga shekulli XIX, kanë përdorur leshin e bagëtive, kanë punuar lirin dhe gjeshtrën. Nga fundi i shekullit XIX e këtej, në sajë të kurbetit e të tregtisë, veshja e grave ka ndryshuar shumë. Veshja e burrave, për atë pjesë të banorëve që nuk e kanë rrahur kurbetin, është ruajtur ajo vendase, ose në raste të tjera, është zëvendësuar me veshje qytetare të kohës.

Në afëri kostumologjike me Bregdetin është dhe Narta, bashkë me një pjesë të banorëve të Zvërnecit. Si traditë këtu ka qenë e zhvilluar bujqësia, pemtaria, kultivimi i ullirit, veçanërisht janë të përmendur për vreshtari. Vera e Nartës ka qenë me zë. Burrat nartiotë janë marrë shumë me nxjerrjen e kripës dhe me peshkim.

Në këtë fshat në të kaluarën është kultivuar shumë liri e veshjet e grave e një pjesë e veshjeve të burrave kanë qenë kryesisht me material liri.

Në veshjet e grave të të gjithë rrethinës dallojmë tri variante kryesore në rrugën e zhvillimit, por kjo nuk do të thotë

se nuk kanë hyrë e nuk kanë dalë dhe forma të tjera veshjesh sipas modave të kohëve të ndryshme. Këto tri variante kanë bashkëjetuar deri në vitet pas çlirimit.

1. Veshja me linjë të gjatë, të bardhë e me elementë të tjera prej leshi si në tërë malësinë e Vlorës. Me kohë kjo linjë është shndërruar në një fustan me shumë pala.

2. Veshje me fustan të gjatë, me pala e me polkë ngjyrë trendafili, a ngjyrë deti (bojë qielli), e përdorur kjo dhe me triko e me shumë zbukurime me dantella. Si veshje e sipërme: një xhokë pa mëngë prej stofi e doku.

3. Veshje me të zeza. Fillimisht është përafruar si veshje për zi, por që nga shekulli XIX e këtej u përdor si veshje e përditëshme e grave të kurbetllinjve, ashtu siç ka ngjarë dhe në Bregdetin e Sarandës.

Edhe veshja e burrave ka kaluar nëpër disa faza, duke bashkëjetuar e duke kryqëzuar njera me tjetrën.

1. Veshja më e vjetër e më origjinale ka qenë ajo e malësisë së Vlorës. Pas një kohe, kjo ndryshoi vetëm ngjyrën; nga e bardhë në ngjyrë të zezë ose manushaqe (si dallim fetar i detyruar në kohë të Turqisë)

Përdorimi i potureve e më vonë i qillotave ka hyrë menjëherë e në mënyrë masive.

2. Në një fazë të dytë një pjesë e banorëve, veshjet filluan t'i bëjnë me material tregu e me rrobaqepës profesionistë, në fillim si forma prerje ish-in ato, në vazhdim hynë në masë dhe prerje qytetare të kohëve të ndryshme. Ato bëheshin me stof blu i errët, sidomos poture, jelek e mëngore. Krahas tyre vazhduan të përdoren dhe veshje të bëra nga gruaja në shtëpi me material tezgjahu.

IV. Rrethina kostumologjike e Dervenit. Në qytetin e Vlorës, në Kaninë e në fshatra të tjera të afërta, ndikimi i tregut ka prurë dhe ndryshime të shpeshta të veshjeve. Sipas shtresave shoqërore këtu janë përdorur veshjet me material tregu të

kushtueshëm, me ngjyra të ndezura e me qëndisje e zbukurime të rënduara.

Banorët e kësaj rrethine, në përgjithësi, janë lebër.

Elementët më tradicionalë të tyre, me sa ka qenë e mundur të dokumentohen, kanë qenë po ato të malësisë së Labërisë.

Gruaja e Dervenit si veshje më të hershme ka pasur linjën e gjatë me pala, të bardhë, e përdorur në funksion të fustanit. Me kohë, kjo linjë me pala, është zëvendësuar nga një fund e polkë me ngjyra të ndryshme, me beze, me dok ose me stof sipas ofertës së tregut dhe sipas shtresave shoqërore. Nga mesi i shekullit XIX e këtej ka hyrë veshja me çitjane si veshja e përditshme dhe veshja me një fustan të gjatë, me shumë pala e sipër ferexhe ose dolloma për ceremoni të ndryshme familjare e shoqërore. Në fshatra dhe në qytete, në shtresat e varfëra të popullsisë, si veshje e përditshme janë përdorur çitjanet e zeza, ndërsa në masën me gjëndje ekonomike më të mirë dhe në pasanikët janë përdorur çitjanet me ngjyra të ndryshme e nga copa të kushtueshme.

Burrat kanë përdorur veshjen me fustanellë bashkë me elementet e tjera që shkojnë me të, por të gjitha nga material i blerë në treg dhe qepur te mjeshtër profesionistë. Xhamadanët e mëngoret janë mbajtur në ngjyrë të zezë ose manushaqe (si një ndikim nga tregu i jashtëm e nga kurbeti).Që nga shekulli XIX është përdorur në masë veshja me poture. Nga Lufta e Parë Botërore e këtej është përdorur në masë veshja me qillota. Që nga fillimi i shekullit XX veshjet popullore filluan të dalin nga përdorimi. Në këtë rrethinë evolucionin më të madh që nga fillimi i shekullit XIX e këtej e ka pasur qyteti i Vlorës me Kaninën, ndërsa fshatrat përreth në rrugën e ndryshimeve të veshjeve kanë ecur me hapa të ngadaltë.

MARK TIRTA

(Marrë nga libri “Të njohim veshjet popullore”.Tiranë

1984

*Veshje të krahinave të
ndryshme të Florës*



Kostumi popullor qytetar i Vlorës



Kostumi popullor i zonës së Dukatit



Kostumi popullor i zonës së Çamërisë



Kostumi popullor i Labërisë (Vranisht)



Kostumi popullor i zonës së Gërnecit



Kostumi popullor i zonës së Novoselës

Në vend të pashënies

Dëshira për t'u marrë me folklor nuk është e rastësishme tek unë. Ajo e ka burimin herët që në fëmijërinë time, sepse u rrita në një ambient fshati, në Palasë të Bregut të Detit që kishte tradita në folklor, si dhe me prindër të shkolluar që ishin në një farë mënyre interpretues të mirë të këngës polifonike, gjë që e kisha vënë re që në fëmijëri nëpër gëzime familjare, apo dhe ritet fetare që organizoheshin në fshatin tim në atë periudhë. Ndoshta, kjo më ka detyruar që në moshë të vogël të dëgjoja dhe të ndiqja me vëmendje dhe kureshtje, jo vetëm këngët dhe vallet polifonike të fshatit tim, por edhe të fshatrave përreth. Mbjaj mend, në një nga emisionet e radio-Tiranës, ishte një rubrikë, e cila një herë në javë, transmetonte këngë labe dhe himarjote. *(Duhet përmendur këtu se fshati im është elektrifikuar në vitin 1955.)* Dhe sa herë transmetohej kjo rubrikë, pothuaj ndizeshin të gjitha radiot e fshatit dhe buçiste kënga. Isha i vëmendshëm dhe mbaja mend orën e transmetimit dhe kështu lija çdo punë a lojë që kisha dhe mbërthehesha pranë radios për të dëgjuar atë gjysmë ore me këto këngë. Kështu, dalëngadalë, brenda meje lindi dhe nisi të rritej një ndjenjë e zjarrtë që do të zinte vend, jo vetëm në shpirtin tim, por dalëngadalë kjo ndjenjë dhe kjo këngë e bukur depërtonte nëpër damarë, ku më vonë dhe unë provova ta interpretojë këtë lloj kënge dhe në disa raste të isha pjesëtar i grupit të fëmijëve, si marrës i këngës, në ato veprimtari që zhvilloheshin atëhere. Kjo ndodhi deri në fund të vitit të parë të shkollës së mesme, sepse periudha e pubertetit bëri të sajën, por kjo nuk më largoi asnjëherë nga kënga.

Kalimi në shkollën e mesme në qytetin e Vlorës, lënda e letërsisë dhe e folklorit që bënim në shkollë, jo vetëm që nuk e zbehu dëshirën për t'u marrë me folklor, përkundrazi, e shtoi akoma edhe më shumë, sa që, kur shkoja në vendlindje, kërkoja nëpërmjet gjyshes dhe mamasë sime, të shkruaja ato këngë që

këndoheshin në fshat dhe këngët e tjera himarjote që dëgjoja nëpërmjet radios, duke bërë kështu një fletore me këngë. Njëkohësisht më pëlqente shumë edhe kënga qytetare vlonjate dhe është për t'u habitur, gjatë jetës së gjimnazit, pothuaj çdo të shtunë, unë do të prisja biletë dhe do të shkoja në teatër ku jepej estrada që në repertorin e këngëve kishte edhe këngë qytetare vlonjate.

Vazhdimi i studimeve të larta për gjuhë shqipe dhe letërsi, rënia në kontakt me personalitete të larta të letërsisë, të folklorit dhe të kulturës, më shtynte akoma më tepër ta dashuroja folklorin, t'i hyja punës e të mblidhja këngë popullore nga më të ndryshme. Aktivizimi në atë periudhë nëpër brigada të ndryshme kulturore që funksiononin në atë kohë, ndikuan pozitivisht në formimin tim në këtë fushë.

Pasioni për folklorin u rrit më tepër, kur fillova punë në vitin 1970 në Shtëpinë e Kulturës "Riza Cerova" në Skrapar, punë, të cilën e prita me kënaqësi të madhe që mund të them se m'u realizua ëndrra që kaq shumë e kisha pritur. Edhe aktivizimi në festalet e ndryshme folklorike dhe ato kombëtare që organizoheshin më futën plotësisht në gurrën popullore. Kështu, tanimë, ajo pak përvojë e grumbulluar dhe duke ditur më së miri edhe metodikën e mbledhjes së këngëve popullore, në Skrapar mblodha rreth 300 këngë.

Po në të njëjtën mënyrë veprova edhe ato pak vite pune që punova në arsim në Kocul të Vlorës. Nisa të mblidhja jo vetëm këngë, por edhe rite e zakone të ndryshme të zonës. Tashmë folklori ishte bërë pjesë e jetës sime.

Në vitin 1986 punova si drejtor në Shtëpinë e Kulturës në Orikum, ku edhe kjo kohë më ndihmoi shumë të njihja mirë folklorin e një krahine, siç është Dukati, me tradita të shkëlqyera në këtë fushë. Këtu më ndihmoi jo pak edhe bashkëpunimi me rapsodin e mirënjohur të kësaj zone, pjesëmarrës në disa Festivale Folklorike Kombëtare, zotin Dule Havari, me të cilin

komunikojta dhe diskutoja shpesh rreth këngës polifonike të trevës, duke përfshirë edhe Tragjasin. Në këtë periudhë u mora seriozisht me këngën polifonike, duke ngritur kështu edhe një grup pranë institucionit ku punoja dhe drejtoja. Në vitin 1988 për herë të parë, në Vlorë, u angazhova me organizimin e Festivalit Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës që mbahej po atë vit dhe që drejtohej nga Artisti i Merituar Haxhi Dalipi. Unë kisha pozicionin e tekstologut dhe bashkëpunoja me poetin Hiqmet Meçaj. Këtë e quaj si një shkollë në drejtimin e këngës polifonike. Kjo punë e konsolidoi së tepërmi formimin tim dhe ndezi akoma më shumë dëshirën për t'u marrë me polifoninë në përgjithësi. Më vonë jo pak ka ndikuar edhe puna si drejtor i Qendrës Kulturore Vlorë që nga viti 1992 e deri në janar 2001, ku drejtova Festivalin e vitit 1995 që u mbajt në Berat, të vitit 2000 që rinisi në Gjirokastrë e deri te festivali i fundit i vitit 2015 që kam qenë në stafet drejtuese dhe organizative të këtyre festivaleve.

Por duhet theksuar se ajo që më ndihmoi më tepër për ta dashuruar akoma më shumë folklorin ishte edhe pjesëmarrja në disa ekspedita me Institutin e Kulturës Popullore për mbledhjen e këngëve, riteve, zakoneve në zonën e Bregut dhe të tjera. Në këto ekspedita rashë në kontakt me personalitetet më të njohura të folklorit shqiptar, si Anton Papeleka, Bardhosh Gaçe, Mark Tirta, Shaban Sinani, Yllka Selimi, Afërdita Onuzi, mjeshtrin e këngës pилurjote dhe himarjote Lefter Çipa e deri tek Agron Xhangolli, etj. E them me bindje se në këto ekspedita dhe me këta korifej të folklorit, plotësova ato boshllëqe që ndoshta kishin lënë mangut studimet e larta.

Arsyeja që ndërmorra këtë nismë për të shkruar këtë libër është e thjeshtë. Kisha kohë që e mendoja dhe e sillja nëpër mend të hidhja në letër ato çka unë dija nga përvoja e grumbulluar në vite, me mendimin se mund t'u shërbejë sadopak atyre njerëzve që merren me studimin e folklorit. Dhe

hapin e parë e hodha në prag të Festivalit Folklorik Kombëtar të vitit 2004 me një përmbledhje të prurjeve të atij Festivali. Tani e shikoj se ajo mbetet nxitësja për hapin që po hedh. Qëllimi im në këtë libër është që t'i jap lexuesit një vëzhgim të shkurtër historik dhe të sistemojnë pjesë të konsiderueshme të atyre këngëve që janë interpretuar nëpër Festalet Folklorike Kombëtare që nga viti 1968 e deri në festivalin e fundit të vitit 2015.

Ndoshta ky libër nuk është i plotë dhe për këtë jam i vetëdijshëm. Është vetëm një hap i parë për t'u çelur rrugë studiuesve që duan të njihen me këngën e iso- polifonisë labe, stilet e të kënduarit, mënyrën interpretative të saj, etj. Rruga është e gjatë dhe e hapur. Unë e nisa këtë rrugë. Këtu është një pjesë e studimit në përgjithësi të këngës polifonike labe. Një studim, ndoshta më i plotë, i takon së ardhmes. Ky botim më impenjon më shumë dhe më grish për t'iu futur punës për një studim më të thellë. Se sa ja kam arritur qëllimit, atë mund ta thonë më mirë studiuesit, bartësit, interpretët e këngës labe dhe lexuesi.



Kozma Billa ka lindur më 25.07.1950 në fshatin Palasë të Himarës – Vlorë. Ka mbaruar studimet në Institutin Pedagogjik të Shkodrës në degën Gjuhë shqipe – Letërsi në vitin 1970.

E nisi punën në Shtëpinë e Kulturës në Çorovodë, Skrapar, si specialist kulture dhe në vitin 1980 transferohet në Vlorë, ku deri në vitin 1986 punon si mësues dhe më pas transferohet si drejtor i Shtëpisë së Kulturës Orikum, Vlorë. Në vitin 1992, fillon punë si Drejtor i Pallatit të Kulturës Vlorë e më vonë Drejtor i Qendrës Kulturore Vlorë deri në janar të vitit 2001. Më vonë emërohet në Qendrën Kulturore të Fëmijëve, ku në vitin 2004 emërohet drejtor i saj deri në tetor të vitit 2008 dhe më pas po në këtë institucion si përgjegjës në sektorin e artit, specialist kulture deri më 4 prill 2013, datë kur e largojnë nga puna.

Ka filluar të shkruaj që herët. Ka botuar vëllimet me poezi: “Nesër”, “Një emër, një firmë”, “Natën vonë”, “Më mungon”. Është aktiv në krijimtarinë letrare.

Ky është libri i parë në fushën e folklorit.

